



UNIVERSITETI I TIRANËS

**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
DEPARTAMENTI I FILOZOFISË**

**FILOZOFIA, SHKOLLA E LIRISË
QË MUNDËSON SISTEMI
ARSIMOR SHQIPTAR DHE MASH**

**(FILOZOFIA DHE EDUKIMI FILOZOFIK,
NDIKIMI I TYRE NË ZHVILLIMIN E
QËNDRUESHËM TË VENDIT.
VLERËSIME DHE ALTERNATIVA)**

Paraqitur në kërkim te gradës shkencore “Doktor në Filozofi”

Nga: Ma. Majlinda Keta

Udhëhequr nga Prof. Dr. Dhori Kule

Tiranë, 2015

DEKLARATË STATUTORE

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar ndonjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Emri Mbiemri:

Majlinda Keta

Firma:



UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

**FILOZOFIA, SHKOLLA E LIRISË
QË MUNDËSON SISTEMI
ARSIMOR SHQIPTAR DHE MASH**

**(FILOZOFIA DHE EDUKIMI FILOZOFIK,
NDIKIMI I TYRE NË ZHVILLIMIN E
QËNDRUESHËM TË VENDIT.
VLERËSIME DHE ALTERNATIVA)**

Paraqitur në kërkim të gradës shkencore “Doktor në Filozofi”

Nga: Ma. Majlinda Keta

Udhëhequr nga Prof. Dr. Dhori Kule

Juria e vlerësimit:

- 1.....KRYETAR
- 2.....Anëtar (oponent)
- 3..... Anëtar (oponent)
- 4..... Anëtar
- 5..... Anëtar
- 6..... Anëtar

Tiranë, 2015

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	4
Lista e tabelave, diagrameve, shtojcave	6
Mirënjohje	8
Shkurtesa	10
Hyrje	11
Metodologjia	15
KAPITULLI I	
ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM: REALITETI DHE SFIDA E GLOBALIZMIT	26
I.1. Zhvillimi i qëndrueshëm si realitet dhe sfidë e postmodernizmit	26
I.1/a. Përmbajtja e konceptit “ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM”	29
I.1/b. Çështja e “ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM”	32
b/1 Rritja numerike e popullsisë	33
b/2 Zhvillimi ekonomik	33
b/3 Ushqimi dhe uji	34
b/4 Energjia	35
b/5 Udhëheqësia	37
I.2 Raporti: zhvillim i qëndrueshëm/shoqëri	38
I.2/1 Pse edukimi është qenësish i lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm?	40
I.2/2 Filozofia si instrument i rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm, sipas organizmave ndërkombëtarë	51
KAPITULLI II	
ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE QYTETET INTELIGJENTE	55
II.1 “Smart city”, “Qyteti inteligjent” dhe edukimi filozofik	55
II.2 Zhvillimi i qëndrueshëm dhe Shqipëria	57
II.2/a Administrata publike në zhvillimin e qëndrueshëm	57
II.2/b Administrata publike shqiptare nën nevojën e shndërrimit në administratë inteligjente	61
II.3 “Smart city” dhe modeli i Tiranës	66
II.4 Politikat evropiane mbi EZHQ-në, DEAR-in.	80
II.5 A kemi ne një trashëgimi të edukimit filozofik ku mund të referohemi?	84
KAPITULLI III	
EDUKIMI NË SHQIPËRINË E SHEKULLIT XXI	90
III.1 Edukimi filozofik në arsim	90
III.2 Arsimi dhe edukimi filozofik në sistemin parashkollor	98
III.2.a Modelet bashkëkohore të edukimit filozofik në sistemin parashkollor	100
III.2.b Modeli klasik shqiptar i edukimit parashkollor	103
III.3 Arsimi dhe Edukimi filozofik në sistemin 9-vjeçar	112
III.4 Arsimi dhe Edukimi Filozofik në shkollën e mesme	122



III.4.a Çfarë duhet të kuptojmë me “filozofi” dhe “të filozofuar” për nxënësit e shkollës së mesme?	122
III.4/b Rezultatet e studimit mbi edukimin filozofik në shkollat e mesme (Tiranë)	125
III.4/c Sfida të edukimit qytetar për shekullin XXI dhe DotNets-at	149

KAPITULLI IV

EDUKIMI FILOZOFIK DHE ARSIMI I LARTË	144
IV.1 Filozofia në Arsimin e Lartë	144
IV.2 Studim krahasues mbi edukimin filozofik në Arsimin e Lartë	147
Mbyllje	174
Përfundime	175
Rekomandime	185
Bibliografia e përdorur	190
Shtojca	201

LISTA E TABELAVE, GRAFIKËVE, SHTOJCAVE

Nr.	EMËRTIMET TABELORE	Faqe
1	Qytetari i aktualizuar, qytetari nën përgjegjësi	41
2	Çfarë të bën një "qytetar i mirë"?	45
3	Perceptimi i nxënësve të vitit të parë gjimnaz - Çfarë të bën një "qytetar i mirë"?	46
4	Perceptimi i nxënësve të vitit të dytë gjimnaz - Çfarë të bën një "qytetar i mirë"?	46
5	Perceptimi i nxënësve të vitit të tretë gjimnaz - Çfarë të bën një "qytetar i mirë"?	46
6,1	Perceptimi i studentëve	48
6.2	Analizë e cilësive qytetare - Çfarë të bën një "qytetar i mirë"? Studentët	49
7	Ndryshueshmëria e konceptit "Smart City" në periudhën e viteve 2000-2010	56
8	Përmbajtja e konceptit "mjedis" për nxënës, studentë dhe qytetarë të Tiranës	69
9	Përmbajtja e konceptit "mjedis i shëndetshëm" për nxënës, studentë e qytetarë	69
10	Cilësia e vlerësuar e mjedisit nga nxënës të shkollave, studentë dhe qytetarë të qytetit të Tiranës	70
11	Faktorët që ndikojnë në kulturën tonë mjedisore	70
12	Faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në kulturën tuaj mjedisore	71
13	Ndikimi i përfaqësuesve të burimeve informative tek kultura jonë mjedisore	72
14	Kuptimi për konceptin "mjedis i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm"	72
15	Burimet e ndotjes mjedisore në qytetin e Tiranës	73
16	Ku e ndeshim ndotjen mjedisore në qytetin e Tiranës?	74
17	Kush mund ta ndryshojë gjendjen e ndotur mjedisore në qytet?	74
18	Çfarë duhet të ndryshosh në qëndrimin tënd ndaj mjedisit?	75
19	Çfarë duhet të ndryshosh tek qëndrimi i familjes tënde ndaj mjedisit?	76
20	Çfarë kërkon të ndryshosh tek komuniteti ku jeton për një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm?	76
21	Çfarë duhet të ndryshosh në qëndrimin e shtetit për politikën mjedisore	77
22	Çfarë kërkon të ndryshojë për qeverisjen mjedisore nga Bashkia Tiranë	78
23	Çfarë kërkon të ndryshojë në politikën e medias për një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm (përgjigje të hapura)?	79
24	Cilin konsideroni si faktor tjetër të rëndësishëm në ndryshimin e gjendjes mjedisore në qytet?	79
25	Numri i nxënësve dhe i institucioneve në APU, Publik dhe jopublik	91
25/1	Të dhëna mbi institucionet arsimore parauniversitare në rang vendi	92
26	Të dhëna mbi institucionet arsimore publike parauniversitare në rang vendi	92
27	Të dhëna për burimet njerëzore për arsimin parashkollor, qyteti Tiranë	103
28	Plane mësimore të edukimit parashkollor në qytetin e Tiranës (2010-2015)	106
29	Mësues që japin filozofi në qytetin e Tiranës	133
29/1	Të dhëna për krimin nga minorenë	141
30	Të dhëna për studentë që studiojnë filozofi	155
31	Të dhëna për studentë që studiojnë filozofi, vite/profile	156
32	Gjendja e kimit ndër të mitur në Republikën e Shqipërisë	179
33	Programet në kopshtet e Tiranës	180



Nr.	EMËRTIMET E GRAFIKËVE	Faqe
1	Analizë e krahasuar e sondazhit "Qytetar i mirë" me qytetarë të Tiranës	50
2	Analizë e krahasuar e sondazhit "Qytetar i mirë", studentë/ qytetarë të Tiranës	50
3	Procesi i të filozofuarit tek fëmijët	102
4	Modeli i kurrikulës së International Bachalaureate, (PYP), 3-12 years	110
5	Shkolla që ndiqni, e mesme e përgjithshme apo profesionale?	126
6	Struktura e gjinisë të të anketuarve në shkollat e mesme	126
7	Sa orë në javë e zhvilloni orën e filozofisë?	126
8	Për çfarë shërben filozofia?	127
9	Metodat e zhvillimit të lëndës së filozofisë	127
10	Përdorni tekste apo materiale të mësuesit	128
11	Si vlerësohet dija në filozofi	128
12	E tejngarkuar, cilat janë arsyet?	128
13	Sa orë studimi në ditë i dedikoni filozofisë?	129
14	A e përdor Internetin për filozofinë?	129
15	A e keni futur filozofinë si lëndë me zgjedhje?	130
16	A përdorni kurse shtesë për filozofinë?	130
17	Si e vlerësoni metodën e dhënies së filozofisë. Gjinitë	131
18	Përdorni tekste apo materiale të mësuesit? Gjinitë e ndryshme	131
19	Cili është objektivi i Filozofisë në shkollat e mesme? UNESCO/SHQIPËRI	132
20	Përmbajtja e koncepteve filozofike në lëndët e tjera	133
21	Nga sa prej mësuesve të diplomuar për filozofi zhvillohet filozofia?	135
22	Për cilat nga arsyet e mëposhtme nuk e kanë zgjedhur?	135
23	Kërkesat e nxënësve për degën e filozofi-sociologji, Matura Shtetërore 2011	135
24	Kërkesat për degën e filozofisë, Matura Shtetërore 2013	136
25	Si vlerësohet statusi i filozofisë në shkollën e mesme?	136
26	A jeni gati për një status të ndryshuar të filozofisë në shkollë të mesme, 2015?	138
27	Sa vite keni që lexoni në fushën e filozofisë?	148
28	A keni mundur të botoni një ese apo opinion tuajin për filozofinë?	149
29	A merrni pjesë në forume, blogje në internet për filozofinë?	149
30	A ndiqni simpoziume shkencore në universitetin tuaj për filozofinë?	150
31	Sa orë studimi realizoni për përgatitje?	150
32	Çfarë niveli studimesh filozofike ofron universiteti juaj?	151
33	Si mendoni, vitet e fundit, cili është niveli i studimit të filozofisë?	152
34	Si dhe sa e përdorni Internetin në studimet e filozofisë?	153
35	Ku janë mundësitë e punësimit të studentëve të filozofisë në vendin tuaj?	153



MIRËNJOHJE

Shekulli në të cilin po jetojmë mund të emërtohet nga shumëkush si shekulli i teknologjisë dhe informacionit, por për mua është shekulli i mirëmenaxhimit të të drejtave njerëzore, lirisë dhe institucionalizmit. Kjo, pasi në raportin e shprishur mes natyrës dhe humanes mbetet kjo e fundit në sfidën e saj për të mirëformuar, mirëmenaxhuar vetveten në grup, por edhe natyrën për të përmbushur detyrimin për cilësinë e jetës së gjeneratave të reja.

Mirënjohja e parë i shkon Universitetit të Tiranës, institucionit që, në respekt të të drejtave dhe lirive të akademizmit, ka mundësuar studimet e mia universitare, pasuniversitare dhe ato kërkimore në 34 vite!

Institucioni, fryma institucionaliste prej tij nuk do të jetësohej në cilësi të spikatura pa frymën institucionaliste të drejtuesit të saj, Rektorit Dhori Kule. Mirënjohje për kontributin që kjo frymë institucionaliste, përmes vendimeve të Senatit të Universitetit të Tiranës, bazuar në ide dhe kërkesa të Departamentit të Filozofisë, mbështetur nga Këshilli i Fakultetit të Shkencave Sociale, në vitet e studimit tim doktorat, realisht, mundësoi një vlerësim në rritje të kërkimit përmes rëndësisë që i dhatë Filozofisë dhe studimeve për filozofi pranë Fakultetit. Mirënjohje për mundësitë që m'u krijuan edhe përmes përfitimit që pata, ndërsa u bashkëmbështeta me kolegë e studentë në studime nga programe me partnerët e huaj të UT-së (studentë nga Erssmundus Mundus Programe dhe DAD).

Ky vlerësim institucional u shpreh përmes pranimin të studimeve për filozofi si një veprimtari universitare, që duhej të menaxhohej nga një departament më vete, me të njëjtin emërtim-Departamenti i Filozofisë (duke e pavarësuar nga Departamenti Sociologji-Filozofi), po aq sa në këto vite është ndjerë mbështetja për iniciativat, në favor të përmirësimit të kurrikulave, menaxhimeve të niveleve të studimit me alternativa të 3 tipave të masterit dhe deri në Shkollën Doktorale.

Fryma mbështetëse dhe vizionare **më jep mundësinë t'i shpreh mirënjohjen time drejtuesit të punimit tim doktorat, Prof. Dr. Dhori Kule** që, si njohës dhe menaxher i suksesshëm i gjithë sistemit të edukimit shqiptar, dhe në veçanti të atij universitar, ka mentoruar punën time disavjeçare me profesionalizëm dhe një komunikim të spikatur



akademik. Kam patur fatin, që ai, ndërkohë që mentoronte punimin tim, njëkohësisht më mundësonte edhe përfitimin nga mbështetja morale dhe institucionale, në favor të ndikimit të pritur për punimin.

Kolegëve të mi të Departamentit, punës së tyre, skepticizmit të tyre për tezën e zgjedhur dhe ndikimit të mundshëm të saj në zhvillimet brenda UT-së dhe në vend, këshillave për punimin tim, **në mënyrë speciale aktivitetit publik dhe qytetar në media të Prof. Dr. Gjergj Sinanit dhe Dr. Adriana Anxhaku, u shpreh mirënjohjen time** për motivimin që më kanë dhënë për të besuar në tezën e zgjedhur! 5 vite më pas, të gjithë bashkë kemi mundësuar që publiku shqiptar të dijë e njohë më shumë misionin e Filozofisë në jetën e shoqërisë shqiptare.

Punimi doktoral në pjesën e kërkimit nuk do të ishte i mundur pa bashkëpunimin cilësor me **Drejtorinë Arsimore Rajonale të Tiranës dhe, në mënyrë të veçantë**, pa komunikimin dhe bashkëpunimin me **fëmijë, nxënës, edukatore dhe arsimtarë** të qytetit. I jam mirënjohëse shumë për mbështetjen pa hezitim në gjithçka që kemi dashur të evidentojmë, në mbrojtje të tezës sime doktorale: **"ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I SHQIPËRISË VARET NGA CILËSIA E EDUKIMIT"**, dhe ky i fundit do të jetë me standardet e edukimit për zhvillim të qëndrueshëm kur të bazohet në edukimin filozofik për të gjitha nivelet e edukimit në Shqipëri.

Ndërsa kam punuar në 5 vite, kam tentuar të kontribuoj publikisht dhe mediatikisht për të mundësuar mbështetje publike në favor të tezës doktorale, me synim ndikimin në instrumente politikbërëse apo politikmatëse, dhe kjo më detyron t' **i shpreh mirënjohjen time shumë drejtuesve dhe specialistëve të televizioneve, gazetave, revistave, konferencave, tryezave të rrumbullakta, forumeve dhe rrjeteve sociale** nën këtë tematikë, aktiviteteve publike dhe Auditoreve të Ditës Ndërkombëtare të Filozofisë, në Shqipëri dhe jashtë saj. Janë me qindra minuta dhe faqe të bashkëkontribuara me JU. **Familja ime mbetet ajo që jetoi dhe mbështeti vitet e punës.** Ajo, edhe në momentet kur "mbaronte oksigjeni i moralit" për kërkimin, mundësoi rienergjizimin për ta finalizuar.

Mirënjohje të gjithëve me besimin se kemi ende rrugëtim mendor dhe aktivitet institucional e publik, për të bërë së bashku deri në ndikimin e duhur në favor të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Shqipëri, për sigurinë e cilësisë së jetës së gjeneratave të reja.



SHKURTESA

AL	Arsimi i Lartë
ASHMDF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
AP	Administrata Publike
APU	Arsimi Parauniversitar
BE	Bashkimi Evropian
DAR Tiranë	Drejtoria Arsimore Rajonale, Tiranë
DEAR	Development Education and Awareness Raising
DESD	(Decade of Education for Sustainable Development), Dekada e Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm
EZHQ	Edukimi për Zhvillimin e Qëndrueshëm
FpF	Filozofia për Fëmijë
FSSH	Fakulteti i Shkencave Sociale
ILP	Instituti i Lartë Pedagogjik
ISP	Instituti i Studimeve Pedagogjike
IZHA	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MM	Ministria e Mjedisit
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MPV	Ministri i Pushtetit Vendor
OECD	(Organization for Economic Co-operation and Development), Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik
PISA	Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve
SKAP	Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, 2009-2013
SZHAPU	Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar
ToT	Trajnerë të trajnerëve (rrjeti qendror ose lokal i trajnim-kualifikimit bazuar në përgjegjësitë e mësuesve të intervistuar dhe certifikuar në fusha dijesh dhe ekspertizë kualifikimi)
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNESCO	United Nations Educational Scientific and Cultural Organization
UE	Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan
UK	Universiteti i Korçës
UT	Universiteti i Tiranës
ZHQ	Zhvillim i Qëndrueshëm
WCED	(World Commission on Environment and Development) Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin



HYRJE

Shekulli XXI na ka mundësuar (falë edhe demokracisë) kontaktin e vazhdueshëm me botën. Ajo që na kishte munguar ndër vite, tashmë, është një realitet i ditës, por mbi të gjitha i domosdoshëm. Në rrafshin tonë komunikativ, ky kontakt merr vlera njohëse, reflektuese, kërkuese e shkencore, njëkohësisht. Falë këtij kontakti, jam njohur me Dekadën e Edukimit filozofik me lirinë. Kjo nismë e UNESCO-s, e diktuar pikërisht nga karakteristikat e para të shekullit të ri, më kuriozoi të kërkoja, reflektoja dhe më në fund të studioja problematikën që ngrihej në këtë studim, por në terrenin shqiptar. Në dokumentin e këtij organizmi ndërkombëtar gjeta eksperiencën nga shumë vende të botës, gjeta shembuj dhe artikulime për pjesën tjetër të vendeve, por nuk gjeta asnjë shembull apo artikulum mbi Shqipërinë. Një arsye më shumë për ta qasur filozofinë e kësaj nisme me realitetin tonë shqiptar.

*Shqipëria, edhe pse në vitin 1997 u përfshi në projekt nën një emër “Edukimi global”¹ (Projekt i realizuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Instituti i Studimeve Pedagogjike, UNICEF, Instituti Ndërkombëtar për Edukimin Global, si dhe Universiteti i Torontos) dhe pse u përcaktuan faza e hapa konkretë në zhvillimin e këtij modeli global, sërish ajo nuk gjeti dot prezencën e vet në Strategjinë e UNESCO-s për Edukimin filozofik me qasje Shkollat e Lirisë, si strategji e shekullit të ri. **ËSHTË KY NDOSHTA MOTIVI QË MË SHTYU TË STUDIOJ NË MËNYRË VERTIKALE, POR EDHE HORIZONTALE GJITHË PROBLEMATIKËN QË LIDHET ME EDUKIMIN FILOZOFIK.***

Nga ana tjetër, Shqipëria, për gati çerek shekulli, mbeti e dyzuar në një udhëkryq që e kemi përcaktuar si tranzicion, por që realisht është një ngërç që vjen nga mungesa e modeleve të qëndrueshme të zhvillimit. Gjatë kësaj periudhe 25-vjeçare, Shqipëria ka pësuar ndryshime kaq të egra, saqë spontaniteti, mungesa e zbatueshmërisë së ligjit dhe mungesa e një kulture të qëndrueshme e kanë zhveshur atë nga pyjet; kanë shkatërruar shtratin e lumenjve, kanë evaduar nëntokën dhe kanë shkatërruar mbitokën. Brezat e nesërm, sigurisht, do të na fajësojnë për mjedisin që do të trashëgojnë nga ne apo dhe

1 http://www.unicef.org/albania/global_ed_eval.pdf



për burimet që po u lëmë. Dhe mbi të gjitha, modeli ynë i zhvillimit është pa sens dhe i deformuar, jashtë çdo standardi që bota globale po përcakton. Duke parë shqetësimin global për modele të zhvillimit të qëndrueshëm, duke parë se sa shumë mendimi shkencor po investohet drejt problemeve të trashëgimisë mjedisore, ekonomike dhe kulturore është gati e pamundur të mos vëresh nevojën që kemi ne si vend e si popull për të kuptuar zhvillimin, si nevojë për zhvillim të qëndrueshëm dhe për të kuptuar sfidën tonë të edukimit si edukim për zhvillim të qëndrueshëm.

Zhvillimi i qëndrueshëm është një zhvillim që i përgjigjet nevojave aktuale, duke mos kompromentuar kapacitetet e brezave të ardhshëm në plotësimin e nevojave të tyre. Si i tillë, ky zhvillim është ekonomik, social e ambiental; por mbi të gjitha është problem edukimi, pasi janë burimet humane ato që e realizojnë një model të tillë zhvillimi. Strategjitë e para evropiane morën formë me shekullin e ri, pra në vitin 2000. Por, pesë vite më vonë, këto strategji u ripanë, me parimin e integritit të edukimit dhe politikave mbi ambientin dhe për ambientin. Ndër objektivat bazë të këtyre strategjive qëndron edukimi nëpërmjet arsimit, si motori kryesor për lëvizjen në drejtim të një zhvillimi të qëndrueshëm. Në Strategjinë e BE-së përcaktohet se: "Përpyetje të veçanta duhet të bëhen në fushën e edukimit dhe trajnimit të sa më shumë njerëzve, për të nxitur ndryshimin e sjelljes dhe për të pajisur qytetarët me aftësitë e nevojshme për të arritur objektivat e vendosur. Për më tepër, kërkimi shkencor dhe teknologjik duhet të inkurajohet, veçanërisht nëpërmjet programeve kornizë për hulumtim dhe zhvillim, e që duhet të lidhet me universitetet, institutet kërkimore, kompanitë"² etj.

Nisur nga këto nevoja, tashmë të projektuara në strategji afatmesme e afatgjata, është i kuptueshëm dhe reagimi shumë i fuqishëm i UNESCO-s, në lidhje me edukimin filozofik si pjesë e sistemeve arsimore. Krijimi dhe zhvillimi i shkollave të lirisë është nevojë që përcaktohet në një nivel urgjent nga vetë shpejtësia e vendosjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm global. Edukimi i qytetarëve me konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me konceptin e lirisë si përgjegjësi, është sfida jo vetëm e dhjetëvjeçarit, por edhe e shekullit.

Pse edukim filozofik? Nuk është rastësi që UNESCO e ka trajtuar problemin e edukimit si edukim filozofik ose si shkollë të lirisë. Qytetari i shekullit XXI, edhe pse nën trysinë e teknologjisë, është sërish individ që pyet, kërkon dhe vepron sipas "unit"

2 http://europa.eu/legislation_summaries/environment/sustainable_development/l28117_it.htm



ose indoktrinimit. Qytetari i përgjegjshëm është qytetari i lirë. ***Të jesh i lirë do të thotë të mundësh, por edhe të dish të zgjedhësh***, në mënyrë që rezultati të përkthehet në lumturi personale dhe komunitare. Të mundësh dhe të dish është thelbi i lirë. Çdo përmbajtje tjetër e këtij koncepti, i jep shtysë kapërcimit në gjendje natyrore dhe aspak civile. Ndaj, edukimi filozofik është në thelb edukim për të kuptuar, gjykuar, kritikuar dhe reflektuar mbi gjithçka e mbi këdo. UNESCO e konsideron këtë lloj edukimi, si detyrën e arsimit global.

Shqipëria në trashëgiminë e saj kulturore ka mangësi në edukimin me konceptet e lirisë dhe barazisë. Këto mangësi reflektohen në sjelljen politike të brezit të sotëm. Kjo është një arsye e shtuar e studimit të kurrikulës shkollore në tri nivelet e saj: studimi i mundësive dhe i kapaciteteve që shoqëria jonë ka dhe vë në funksion të këtij edukimi, dhe në analizë të fundit, të dëshmojë me argumente nevojën e shtuar të këtij edukimi në politikat arsimore dhe akademike.

Studimi im ka përfshirë dy qasje, të cilat shkojnë në thellim e vazhdimësi të njëra-tjetrës: e para ka të bëjë me studimin e nivelit të qytetarisë në metropolin shqiptar, nëpërmjet standardeve të modeleve: Dutiful Citizen; dhe - Actualizing Citizen. Gjetjet e këtij studimi më kanë orientuar më tej në kërkimin e modeleve të sistemit edukativ që realizohet në gjithë sistemin tonë arsimor. Kështu, studimi ka filluar me sistemin parashkollor, duke u mbështetur në këto elemente:

- a) përmbajtja e kurrikulës edukuese,**
- b) cilësia e burimeve humane që realizojnë këtë kurrikul,**
- c) niveli i formimit kritik e të përgjegjshëm, nëpërmjet cilësisë së të menduarit dhe të pyeturit,**
- d) produkti i realizuar.**

Ky studim, me këto qasje, thellohet si në nivelin parauniversitar, ashtu dhe në nivelin universitar. Qëllimi i këtij studimi në këtë formë ka të bëjë me problemin kyç, të vendosur në krye të punimit: A ekzistojnë në Shqipëri parametrat e kërkuar nga realiteti ynë global, për edukimin filozofik, si instrumenti kyç në realizimin e zhvillimit të qëndrueshëm?

Dhe më tej: a ekzistojnë kapacitete ligjore, politike dhe humane për një edukim të tillë? Studimi ka vërtetuar se, në politikat arsimore të zhvilluara në dhjetë vitet e fundit, pavarësisht kryerjes së reformave dhe ndryshimeve pozitive që janë bërë, problemet



me të cilat dukshëm përballen realiteti ynë kanë prodhuar edukim, por jo edukim të qëndrueshëm; kanë prodhuar cilësi³, por jo standarde cilësore; kanë prodhuar qytetarë "të mirë", por jo qytetarë të përgjegjshëm. Madje dhe vetë kurrikula është deformuar në diskriminim të edukimit filozofik, një edukim që të pajis me mendim kritik e të përgjegjshëm, e që mundëson shkollën e lirisë për çdo individ në shoqëri.

Modelet e përparuara, të cilat gjenden sporadikisht në vendin tonë, mund të jenë një qasje e mirë e krijimit në të ardhmen e modeleve të qëndrueshme të edukimit filozofik, si edukim për një zhvillim të qëndrueshëm. Gjetjet e këtij studimi, mendoj se duhet të zënë vendin e tyre në filozofinë e politikave arsimore, pasi bëhet fjalë për të ardhmen e cilësisë së burimeve humane në një vend ku ende mosha mesatare është më e reja në Evropë (46% është nën 30 vjeç). *Ky shekull do të sfidohet nga ato vende që do të kenë fituar sfidën me përgatitjen e burimeve humane, si kapital i investuar për gjithë zhvillimin e vendit, burime që në mënyrë inteligjente do të tejkalojnë edhe "analfabetizmin ekologjik"⁴ të botës postmoderne, me qëllim moskompromentimin e të ardhmes së gjeneratave të tjera.*

Strategjia dhjetëvjeçare e UNESCO-s, e cila u përmbyll me raportin e fundit në 2014-ën, sërish nuk ka asnjë paragraf për Shqipërinë dhe angazhimet e saj për ZHQ-në apo EZHQ-në. "Dhjetëvjeçari ka aktivizuar qindra dhe mijëra njerëz për të riorientuar edukimin global drejt një qëllimi kryesor: **të mësojnë për të jetuar dhe punuar qëndrueshëm**"⁵. Ndaj këtij misioni, vendi ynë është ende në nivele modeste angazhimi. Por, në fund të kësaj dekade, Irena Bokova shprehet se:

"Dhjetëvjeçari ofroi një bazë solide, të përshkallëzuar të përpyekjeve tona për të përgatitur qytetarët e së nesërme që t'i përgjigjen sfidave të së sotme. EZHQ-ja progresoi cilësinë në edukim nëpërmjet inovacionit në mësimdhënie dhe në të mësuarin, sikurse edhe në angazhimin e të gjithë aktorëve"⁶, **nuk mund të anashkalojmë gjendjen ku ndodhemi e të mos përcaktojmë krahasimisht nevojën për një edukim për zhvillim të qëndrueshëm edhe për Shqipërinë, sikurse edhe instrumentet politike që na mundësojnë suksesshëm këtë lloj edukimi.**

Besoj shumë që ky punim të jetë një gurë modest në trajtimin e këtij problemi madhor.

3 Studimi ka vërtetuar se cilësia në rritje e treguesve sipas MAS-it është shumë larg standardeve që kërkohen sot nga edukimi bashkëkohor. PISA (testimi) është një tregues i dukshëm i këtij pohimi

4 Orr, D. (1992) *Ecological Literacy: Education and the Transition to a Postmodern World*, State University of New York Press.

5 Bokova, I. (2014) "Shape the future we want", Final Report 2005-2014. UNESCO. Pg. 3.

6 Bokova, I. "Shape the future we want", Final Report 2005-2014. UNESCO, 2014. Pg. 4.



METODOLOGJIA

Misioni i studimit:

përmirësimi i instrumenteve të politikave institucionale, edukative, filozofike përmes vlerësimit të ndikimit në Zhvillimin e Qëndrueshëm në vend.

Objektivat specifike:

- Përshkrimi i lidhjes mes zhvillimit të qëndrueshëm të vendit dhe treguesve të cilësisë së burimeve njerëzore (arsimi dhe administrata) në Shqipëri.
- Analiza e ndikimit të filozofisë dhe procesit të të filozofuarit në cilësinë e burimeve njerëzore në Shqipëri, përmes sistemit arsimor.
- Përshkrimi i situatës aktuale për cilësinë e edukimit qytetar, edukimit me lirinë në sistemin tonë arsimor.
- Përshkrimi i situatës aktuale dhe mundësisë me ndikimin e filozofisë dhe procesit të të filozofuarit në disa fusha dhe veprimtari njerëzore në Shqipëri.
- Përshkrimi i situatës aktuale dhe mundësisë me ndikimin e filozofisë dhe procesit të të filozofuarit nga niveli parashkollor tek arsimi i lartë. Pra, raporti status aktual dhe perspektivë zhvillimi do të jetë binomi në zhvillimin e studimit.
- Vlerësimi dhe ndërtimi i një linje kombëtare për "filozofinë" dhe "të filozofuarin" në sistemin arsimor dhe institucionet politikbërëse arsimore e më gjerë.
- Krahasimi i situatës shqiptare në arsimin e lartë për filozofi me sisteme arsimore të tjera evropiane e më gjerë, në mënyrë të veçantë me direktivat dhe Strategjitë Ndërsektorale të UNESCO-s për filozofinë (2006).
- Ofrimi i sugjerimeve dhe modeleve për përmirësimin e gjendjes mes realitetit dhe të dëshirueshmes, si standard evropian dhe ndërkombëtar i integritit tonë me botën, referuar kjo Strategjisë Ndërsektorale të UNESCO-s për filozofinë.
- Ideimi dhe ndërtimi i një rrjeti social të filozofëve të rinj; të dashamirësve të procesit të të filozofuarit, brenda dhe jashtë vendit.

Studimi ka për qëllim të sjellë pasqyrimin e lidhjes që ekziston mes filozofisë, procesit të të filozofuarit dhe edukimit me lirinë, si dhe standardet e ZHQ-së në shoqërinë tonë,



problematikat që lidhen me to. Ai do të sjellë edhe analizën e hapave të ndërmarrë deri më sot nga politika, për deklarimin e një filozofie edukimi apo për statusin e filozofisë në sistemin arsimor shqiptar. Studimi është realizuar nëpërmjet analizës së detajuar shkak-pasojë (niveli i përfshirjes së filozofisë – cilësia e sistemit arsimor), analizës dhe krahasimit të statistikave mbi cilësinë. Analiza e cilësisë fillon me pjesën kurrikulare të deklaruar, cilësinë e burimeve njerëzore që jetësojnë atë në sistem edukimi, të dhënave që na ofrohen nga aktiviteti edukativ i marrë në analizë studimore apo dokumentacioni zyrtar i ofruar.

Metoda kërkimore e përdorur në këtë studim është metoda cilësore dhe ajo sasiore. Ky studim, për nga forma e tij, kërkon domosdoshmërinë e përdorimit të metodave cilësore, për shkak të natyrës së problemit dhe specifikave të vetë kërkimit shkencor. Kërkimi cilësor i referohet kuptimeve, koncepteve, përkufizimeve, karakteristikave, metaforave, simboleve dhe përshkrimeve të gjërave. Metodatat kërkimore mbi qeniet njerëzore lejojnë kërkuesit të diskutojnë me detaje konturet e ndryshme sociale dhe proceset që qeniet njerëzore përdorin për të krijuar dhe mbajtur realitetet e tyre sociale (Bogdan & Taylor, 1975). Nëse njerëzit studiohen në një mënyrë simbolikisht të reduktuar, statistikisht si modele agregate, ka rrezik se përfundimet (edhe pse nga ana matematikore të sakta) të dështojnë në përshtatjen me realitetin (Mills, 1959). Siç sugjeron Douglas (1976, p. 12), metodat e përdorura nga shkencëtarët socialë zgjasin në vazhdimësi nga teknika totalisht të pakontrolluara (dhe ndoshta të pakontrollueshme) që dalin nga ambientet natyrore në teknika totalisht të kontrolluara të vëzhgimit.

Për këtë arsye është përzgjedhur kërkimi përmes metodës cilësore dhe sasiore duke kombinuar analizën bibliografike dhe instrumentin e pyetësorëve dhe intervistës gjysmë të strukturuar referuar edhe modeleve që ka ofruar studimi i UNESCO-s "Philosophy-a school of freedom". Rubin (2005) theksoi procesin e zhvillimit të intervistave kërkimore gjysmë të strukturuar, të cilat përfshijnë zhvillimin e një guide intervistimi, udhëheqjen e intervistës dhe analizën e të dhënave të intervistës.

Studimi është pilotuar me nxënës, mësues, edukatore në kopshte dhe shkolla të qytetit të Tiranës dhe studentë nga disa universitete brenda dhe jashtë vendit. Kjo është shoqëruar dhe me analiza krahasuese të detajuara bibliografike nga organizma kombëtarë dhe ndërkombëtarë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe edukimin filozofik, po aq sa edhe mbi dokumente ligjorë dhe statistikore mbi edukimin. Kërkimi ka



përdorur edhe intervista me specialistë dhe studiues të fushës dhe analizën e tyre. Analiza e të dhënave cilësore ishte një proces i vazhdueshëm, sistematik dhe krijues nga unë si kërkuese. **Analiza tematike është një strategji e zakonshme e përgjithshme për të dhëna cilësore.** Given (2008: 867) përcakton analizën tematike si “një reduktim të dhënash dhe teknikë analize”, me anë të së cilës të dhënat cilësore segmentohen, kategorizohen dhe rindërtohen në një mënyrë që kap konceptet e rëndësishme brenda setit të të dhënave. **Analiza tematike u përdor për të analizuar transkriptet e intervistave** në këtë studim. Braun dhe Clarke (2006) propozojnë se analiza tematike përfshin interesimin e kërkuesve në të dhëna deri në pikën ku ato të familjarizohen me gjerësinë dhe thellësinë e përmbajtjes. Kjo sugjeron se ka të bëjë me “të lexuarit e përsëritur të të dhënave në një mënyrë aktive”.

Përshkrimi i hapave të ndjekur në procesin kërkimor:

- Hapi 1** Familjarizimi me të dhënat. Kopjimi i të dhënave, leximi dhe rileximi i të dhënave; shënimi i temave fillestare.
- Hapi 2** Gjenerimi i kodeve fillestare. Tipare interesante të kodeve të të dhënave në një model sistematik përmes tërë setit të të dhënave; sistemimi i të dhënave relevante për secilin kod.
- Hapi 3** Kërkimi i temës. Sistemimi i kodeve në tema potenciale; mbledhja e të gjitha të dhënave relevante për çdo temë potenciale.
- Hapi 4** Rishikimi për tema. Kontrolli nëse temat funksionojnë në lidhje me ekstraktet e koduara (niveli 1) dhe i tërë setit të të dhënave. Gjenerimi i hartës tematike të analizës.
- Hapi 5** Përcaktimi dhe emërtimi i temave. Analiza e vazhdueshme për të përcaktuar specifikat e çdo teme dhe e temës së përgjithshme që analizon tregimtarin e historisë; gjenerimi i përkufizimeve të sakta dhe emrave për çdo temë.
- Hapi 6** Prodhimi i raportit. Përzgjedhja e shembujve imponues të ekstrakteve; analiza finale e ekstrakteve të përzgjedhur. Rilidhja e analizës me pyetjet dhe literaturën e kërkimit. Prodhimi i raportit të analizës (Braun & Clarke, 2006).



Pyetjet specifike të kërkimit shkencor:

1. Pse edukimi filozofik konsiderohet globalisht si nevojë imediate përkundrejt ZHQ-së?
2. Sa e përfshirë është edhe Shqipëria në këto nevoja? Çfarë trashëgimie kemi në edukim?
3. Sa kurrikula të edukimit i përgjigjen kësaj kërkese?
4. Sa e zhvilluar është disiplina e filozofisë në Shqipëri?
5. Ç'lidhje ekziston mes filozofisë dhe edukimit filozofik në nivelin parashkollor?
6. Çfarë lidhje ekziston mes filozofisë dhe edukimit filozofik në nivelin e arsimit të detyrueshëm?
7. Çfarë lidhje ekziston mes filozofisë dhe edukimit filozofik në nivelin e arsimit të mesëm?
8. Çfarë lidhje ekziston mes filozofisë së edukimit dhe edukimit filozofik në sistemin universitar?
9. Çfarë lidhje ekziston mes filozofisë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri?
10. Si mund të vlerësohet kontributi i filozofisë në formimin e përgjithshëm të individit në shoqërinë shqiptare, ndikimi mbi cilësinë e qytetarisë?
11. Cilët mund të jenë disa instrumente dhe metodika që do përmirësojnë treguesit e përfshirjes së filozofisë në edukimin e brezave të ardhshëm?
12. Çfarë roli duhet të marrë Departamenti i Filozofisë së Universitetit të Tiranës përkundrejt nevojave për EZHQ-në?

Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij studimi **konsiston në një kombinim të të dhënave primare me ato sekondare.** Të dhënat sekondare janë siguruar përmes raporteve të realizuara nga institucione ndërkombëtare (UNESCO etj.), si dhe duke shfrytëzuar burime institucionale vendase, të tilla si: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria Arsimore Rajonale e qytetit Tiranë dhe institucionet që janë nën varësinë e saj etj. Rëndësi të veçantë për pjesën analitike të punimit marrin të dhënat primare të siguruar përmes anketimit të drejtpërdrejtë të stafit pedagogjik të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, studentë, nxënës të shkollave 9-vjeçare e të mesme, dhe qytetarë të shpërndarë në qytetin e Tiranës.

Metodat e aplikuara në funksion të zbatimit të metodologjisë janë metoda sasiore të fokusuara në statistikat deskriptive të fenomenit, si dhe në statistika inferenciale.

Për të studiuar Filozofinë si shkollë mendimi po aq sa dhe si lëndë e kurrikulës



shkollore, me të gjitha format e shfaqjes relativuar niveleve të arsimit, në sistemin arsimor shqiptar dhe për të krahasuar cilësitë e këtij fenomeni në Shqipëri me zhvillimet ndërkombëtare (UNESCO) në edukim, duke plotësuar kështu analizën cilësore dhe sasiore të informacionit të marrë përmes anketimit, kemi realizuar pyetësorët e mësipërm.

Kufizimet në kërkim

Për të realizuar studimin më është dashur të shfrytëzoj shumë materiale në gjuhë të huaj, që lidhen me ZHQ-në dhe EZHQ-në ndërkohë që ka shumë pak materiale në gjuhën shqipe. Kërkimi "vështirësohej" ndërkohë që shfrytëzonte për analizë intervista apo pyetësorë, përmbajtja e të cilëve ishte si ajo e disa studimeve më në zë të fushës nga organizma ndërkombëtare, si UNESCO apo qendra të specializuara kërkimesh në Amerikë etj., të cilat kanë përdorur për këto mini-studime angazhime skuadrash studiuesish dhe fondesh.

Vitet që kapi studimi përkuan me prodhime politikash në edukim, që edhe kundërshtonin njëra-tjetrën për EZHQ-në ndërkohë që Shqipërisë i afronte mbarimi i dekadës me objektiva precize për këtë edukim në gjithë nivelet e tij, prej kopshtit tek universitetet dhe qendrat kërkimore.

Mungesa e studimeve në këtë fokus vështirësonte metodën krahasuese mbi tendencat e zhvillimeve në EZHQ brenda vendit.

Një vështirësi tjetër ka qenë *mungesa e raporteve mbi ZHQ-në dhe EZHQ-në*, në nivel lokal dhe qendror, sikurse edhe koncepti minimalist i kuptimit të standardeve të tyre në fushën e edukimit nga politikbërës dhe menaxherë të arsimit.

Fokusimi në kërkim, kryesisht në edukimin publik, paraqet në vetvete një risk pasi në këto vite të rrotacionit politik ndjehej "hermetizmi" i informacionit sikurse "fshirja" e asaj që ishte investuar më parë, po aq sa politika e burimeve njerëzore me influencë politike vështirëson edhe qëndrueshmërinë e investimeve për këtë lloj edukimi në sistem.



Etika në kërkim

Gjatë kërkimit dhe zhvillimit të tezës doktorale është respektuar etika në kërkim. Kështu, është respektuar në përputhje me tezën doktorale ndërtimi i përmbajtjes së çdo pyetëso, interviste apo tryeze të rrumbullakët me institucionet arsimore në Tiranë. Kërkimi ka ndjekur dhe zhvilluar standardet etike të disa studimeve ndërkombëtare⁷ mbi bazën e të cilëve janë ngritur instrumentet e kërkimit. Zgjedhja e çështjeve kërkimore është bazuar në gjykim shkencor dhe në një vlerësim të përfitimit sa më të mundshëm prej pjesëmarrësve në studim si dhe tendencën e kthimit të tyre në përfitues nga studimi, kjo pasi studimi është i lidhur me çështje të rëndësishme intelektuale të filozofisë së institucioneve dhe të edukimit në vend. Kërkuesja ka konsideruar edhe konsekuencat që mund të kishin individët apo grupe individësh mes njëri-tjetrit ndërsa intervistoheshin apo në raport me kolegë dhe shoqërinë në tërësi. Kërkimi është pasuruar dhe ka respektuar konsultimet me kolegë, publikime dhe ekspertë të tjerë në fushën e kërkimit, kjo për t'u bindur për metodat e zgjedhura në mbrojtje të tezës. Personat bashkëpunëtorë në kërkim për realizimin e pyetësorëve dhe intervistave, vëzhgimeve dhe analizave janë përzgjedhur të kualifikuar ose janë kualifikuar për të respektuar procedurat dhe etikën në kërkim. Ndërkohë vetë kërkimi cilësor të imponon përzgjedhjen e një kampioni të qëllimshëm si përpjekje e vetëdijshme për të përzgjedhur përfituesit që plotësojnë kriteret për hulumtim (Coyne, 1997), dhe ata (nxënës, mësues, studentë etj.) u përzgjedhën për shkak të përvojave apo opinionëve të tyre lidhur me temën e hulumtimit.

Hulumtimi është kryer në përputhje të plotë me ligje, rregullore dhe standarde të institucioneve dhe grupeve të përzgjedhura për t'u analizuar me një tematikë të përcaktuar të kërkimit, kjo e shprehur edhe në cilësinë e dokumentit të prodhuar.

Është shprehur dhe respektuar edhe "refuzimi" për të marrë pjesë në kërkim dhe instrumente të përdorura nga ai, por që nuk ka pasur asnjë rast të tillë gjatë bashkëpunimeve.

Kërkuesja i ka bërë të ditura rezultatet e kërkimit rast pas rasti me bashkëpunëtorë dhe pjesëmarrës, sikurse ka respektuar dhe privatësinë apo konfidencat e tyre. Ndërkohë janë bërë të qarta limitet e përdorimit të të dhënave dhe të elementëve të tjerë në studim.

Në publikimet e bëra referuar objektivave të këtij kërkimi janë respektuar marrëveshjet me standardet e kërkimit bazuar në tezën kërkimore.

⁷ Shpjeguar në metodologjinë e studimit.



TË DHËNA MBI PYETËSORËT E PËRDORUR NË STUDIM

Pyetëtori 1

Qëllimi i vrojtimit: Ky vrojtimit ka për qëllim të vlerësojë rankimin e shprehive qytetare sipas këndvështrimit të dy grup-moshave (1.15-25 vjeç, 2. ≥ 26 vjeç) (sipas modelit: What Makes a Good Citizen? by Kurtz, K., Rosenthal, A., Zukin, C., "Citizenship, A Challenge for All Generations", © 2003 by the National Conference of State Legislatures).

Shtrirja gjeografike: Vrojtimi është përqendruar për grup-moshën e parë tek nxënësit e shkollave të mesme dhe studentë të Tiranës; për grup-moshën e dytë tek qytetarë, të asaj grup-moshe të këtij qyteti.

Objekti i vrojtimit: Nxënësit e shkollave të mesme, studentë, qytetarë të Tiranës për grup-moshën e dytë.

Zgjedhja e përdorur për secilën grup-moshë është e rastësishme probabilitare. Përkatesisht, referuar literaturës (Zukin, at the National Conference Of State Legislature on "Citizenship, a challenge for all generation"), zgjedhja është realizuar në formatin $n_1 = n_2 = 300$.

Pyetëtori 2

Qëllimi i vrojtimit: Ky vrojtimit ka për qëllim të vlerësojë cilësinë e formimit të edukatoreve që vijnë nga edukimi filozofik dhe sistemi i kualifikimit për standarde të mundshme bazuar në procesin e të filozofuarit.

Shtrirja gjeografike: Vrojtimi është përqendruar tek ekipi i edukatoreve në Kopshtin Nr. 8, në qytetin e Tiranës.

Objekti i vrojtimit: DAR Tiranë (tetor 2010) e ofroi si modelin e institucionit të edukimit parashkollor në qytet, gjë e cila shprehej në kërkesa të shumta të komunitetit për pranimin e fëmijëve të tyre atje. Vlen për t'u përmendur që kopshti ka qenë qendër trajnimit për modelin "Step by step" nga Projekti për Arsimin i Fondacionit "Soros" në Shqipëri. Stafi ka qenë në qendër të kualifikimeve nga projekti dhe DAR-i, dhe një pjesë e tyre kishin statusin "trajnerë të trajnerëve", ToT. Kopshti zotëronte një infrastrukturë dhe pajisje didaktike të vlerësueshme në raport me kopshte të tjera në qytet dhe mbështetej fuqimisht nga Bordi i Prindërve. Për të vlerësuar si



paraqitet situata në rastin më të mirë, është fokusuar vërtetimi në Kopshtin Nr.8. Gjithsej janë 10 edukatore të pyetura, aq sa ç'është dhe numri total i edukatoreve të kopshtit. Kemi të bëjmë këtu me popullatë, dhe $N=10$.

Teknikat e përpunimit të informacionit i referohen kështu statistikës deskriptive.

Pyetësi 3

Qëllimi i vërtimit: Ky vërtim ka për qëllim të "masë" shkallën e lirisë që fiton një nxënës në fund të ciklit të ulët të shkollës 9-vjeçare (klasa e 5-të) dhe në fund të ciklit të lartë të shkollës 9-vjeçare (klasa e 9-të).

Shtrirja gjeografike: Vërtimi është përqendruar në tre shkolla 9-vjeçare publike të qytetit të Tiranës, në 3 njësi administrative të ndryshme (7, 1, 2), të cilat njihen për traditën e tyre në edukimin e fëmijëve me të drejtat e tyre dhe qytetarinë ("Sabahudin Gabrani", "1 Maji", "Osman Myderizi"). Shkolla "Sabahudin Gabrani" ka gëzuar statusin e shkollës "ToT" në nivel Republike.

Objekti i vërtimit: Cilësia e edukimit qytetar tek nxënësit e klasave të 5-ta dhe të 9-ta të këtyre shkollave, që kanë zhvilluar kurrikulën e edukimit qytetar për këtë nivel.

Përcaktimi i kampionit të marrë në studimin tonë është realizuar duke u mbështetur në metodën e zgjedhjes së rastit tipike (me strata) për nxënësit e klasave të 5-ta dhe të 9-ta të shkollave 9-vjeçare publike të qytetit të Tiranës, për tre shkollat e sipërcituara. Numri i nxënësve të zgjedhur për vitin përkatës, në kampionin tonë, përbën rreth 10% të popullimit, duke konsideruar kështu një zgjedhje të madhe ($n/N=0.1 > 0.05$), më konkretisht $n=300$ për kampionin e klasave të pesta dhe $n=300$ për kampionin e klasave të 9-ta.

Pyetësi 4

Qëllimi i vërtimit: Synon vlerësimin e ndikimit dhe statusit të filozofisë në shkollat e mesme sikurse edhe në disa elemente të këshillimit të karrierës në Maturën Shtetërore 2011.

Shtrirja gjeografike e vërtimit: Qyteti i Tiranës (600 nxënës).

Objekti i vërtimit: Nxënës të "Maturës Shtetërore" 2011 (vite të 4-ta në shkollat e mesme të përgjithshme apo të 5-ta në ato profesionale).



Përmes këtij pyetësi është synuar të sigurohen variablat e nevojshëm cilësorë e sasiorë, të cilët janë përfshirë në testimin e hipotezave që shtrohen për zhvillimin e lëndës së Filozofisë në shkollat e mesme dhe mënyrën e perceptimit të saj nga nxënësit dhe nga mësuesit, nëpërmjet mënyrës se si kjo lëndë përveçohet në këtë nivel arsimit. Pyetjet në këtë nivel, por edhe në atë universitar janë formuluar në qasje me pyetjet që pyetësi i studimit të UNESCO-s ka në "Philosophy: a school of freedom", 2007, në të cilin mungojnë të dhënat nga Shqipëria.

Përcaktimi i kampionit të marrë në studimin tonë është realizuar duke u mbështetur në metodën e zgjedhjes së rastit "tipike" (me strata) për nxënësit e Maturës Shtetërore të vitit 2011 (viti i fundit kur filozofia ishte lëndë me detyrim) në shkollat e mesme të qytetit të Tiranës. Për çdo shkollë të mesme publike janë zgjedhur (nh) maturantë dhe në total ($n = \sum nh$) numri i maturantëve të zgjedhur në kampionin tonë përbën 20% të popullimit, duke konsideruar kështu një zgjedhje të madhe ($n/N = 0.2 > 0.05$).

Në analizën e testimit të hipotezave, ku kryesisht përdorim testin Chi-square, teoria e zgjedhjes statistikore gjykon se numri i elementëve të shqyrtuar në çdo cross-tabulim duhet të jetë të paktën 5, gjë që është respektuar në çdo test të përdorur.

Ndër të tjera, statistikisht dimë se: $\Delta = z \cdot \sqrt{\frac{p(1-p)}{n} \cdot \frac{N-n}{N-1}}$ (ek.1) Për një nivel gabimi 5%, duke mos patur asnjë studim të mëparshëm në lidhje me këtë temë, si dhe duke menduar se Filozofia ka 50% mundësi të jetë lëndë e zgjedhur nga maturantët, përafërsisht $n \approx 400$ studentë. Ndërkohë që ne kemi përfshirë në zgjedhje rreth 600 studentë, gjë që **zvogëlon marzhin e gabimit në rreth 3%**, për pyetje të veçanta, kur kemi përgjigje të plota pa vlera të humbura.

Pyetësi 5:

Qëllimi i vrojtimit: Ky vrojtimit ka për qëllim të njohë opinionin e studentëve që studiojnë për filozofi (universitete publike) në lidhje me ndikimin që ka patur në formimin e tyre, të njohë shkallën e informimit të studentëve mbi vendin dhe rolin që zë shkenca e filozofisë në universitete në vendin e tyre, si edhe mundësitë për punësim e karrierë pas studimeve të tyre për filozofi.

Shtrirja gjeografike e vrojtimit: Shqipëri (Universiteti i Tiranës), Spanjë



(Universiteti i Granadës), Gjermani (Universiteti "Fridrih Shiler" i Jenës).

Objekti i vrojtimit: Studentë të vitit të dytë për filozofi, që studiojnë në universitetet e mësipërme sipas shteteve të përcaktuara më lart.

Kjo zgjedhje është përcaktuar nga fakti që dy shtetet (Spanjë dhe Gjermani) përbëjnë truall historik të spikatur në zhvillimin e mendimit filozofik dhe të universiteteve me këtë formim, sikurse u mundësua kërkimi nga burime njerëzore brenda vetë UT-së në kuadrin e programit Erasmus Mundus, BE dhe programi DAAD i Gjermanisë. UT-ja ka marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbim studentësh e kërkuesish shkencorë, faktor që u shfrytëzua nga unë.

Zgjedhja e kampionit është bërë në një kurs të rastësishëm të këtyre fakulteteve, të vitit të dytë, Bachelor. Qëllimi pse zgjedhja u përqendrua në vitin e dytë, ishte për të mos u ndikuar nga fillimi (viti i parë i studimeve) apo fundi (viti i tretë) i studimeve për filozofi, Bachelor.

Fillimisht, pyetësorët i janë nënshtruar fazës së pilotimit të tij, duke u shpërndarë në një numër të vogël të intervistuarish; rreth 50 nxënës për pyetësorin e parë dhe rreth 20 studentë për pyetësorin e dytë, 30 për pyetësorin e tretë dhe 40 për pyetësorin e katërt. Ky proces pilotimi ndihmoi për të testuar vështirësinë në perceptimin e pyetjeve dhe plotësimin e pyetësorëve. ***Qëllimi i këtij testimi ishte vlerësimi i pyetësorëve dhe përmirësimi i tyre aty ku do ishte i nevojshëm.***

Pas kësaj faze, ***pyetësorët u përpunuan*** në disa pyetje të tyre sipas një terminologjie të kuptueshme për subjektet të cilave ju adresohet.

Shpërndarja e pyetësorëve është realizuar përmes pikave të kontaktit të vendosura: mësues të filozofisë të shkollave të mesme asistuar nga studentë vullnetarë të filozofisë (për pyetësorin 4); nga vetë studentët koordinorë sipas vendeve përkatëse (për pyetësorin 1); nga mësuesit e Edukimit Qytetar dhe drejtuesit e të 3 shkollave në kampion (për pyetësorin 3); nga vullnetarë të angazhuar në rrugët e Tiranës (për pyetësorin 1); nga studentë koordinorë të Filozofisë në programin Erasmus Mundus (BE) në Granada, Spanjë (S. Keta, 2011) dhe studenti i UT-së në studimet "Master në gjermanistikë" nga programi DAD, Jena Gjermani (M. Janku, 2011).

Harku kohor i realizimit të pyetësorëve në kërkimin tim përfshiu dhe u shtri në periudhën **2011-2015**.

Duke mbajtur në konsideratë humbjet e mundshme në mbledhjen e pyetësorëve të shpërndarë, të cilat mund të rezultojnë nga mosplotësimi i pyetësorëve ose nga plotësimi jo i plotë i tyre, u mendua të shpërndahej një numër më i madh se kampioni i synuar dhe konkretisht u shpërndanë **650 pyetësorë për pyetësorin 4, 110 pyetësorë për pyetësorin e pestë, 650 përkatësisht për pyetësorin 3 dhe 1.**

Nga 650 pyetësorë të shpërndarë u dorëzuan nga nxënësit vetëm 620 pyetësorë të plotësuar (pyetësori 4); 100 pyetësorë, 5 të plotësuar, përkatësisht 600 pyetësorë për pyetësorët 3 dhe 1. Gjatë hedhjes së të dhënave në program për përpunimin e tyre u vu re se rreth 600 (4), 100 (5), 600 (3), 600 (1) pyetësorë rezultojnë me përgjigje në të gjitha pyetjet dhe ishin të vlefshëm për t'u përdorur në studim.

Bazuar në sa më sipër, kampioni i mundshëm për studim rezultoi përfaqësues.

Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve është realizuar përmes **programit SPSS 17.0.**

Duke marrë në konsideratë mënyrën e funksionimit të programit, përpara hedhjes së të dhënave **është realizuar fillimisht kodimi i tyre** dhe pastrimi i të dhënave.

KAPITULLI I

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM: REALITETI DHE SFIDA E GLOBALIZMIT

I.1 ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM SI REALITET DHE SFIDË E POSTMODERNIZMIT

Globalizimi dhe nevoja e vazhdueshme e shoqërisë për zhvillim ekonomik e ka sjellë në qendër të debateve globale konceptin e “Zhvillimit të qëndrueshëm”. Stili ynë i jetesës, që po ndryshon shumë shpejt falë ndryshimeve të vrullshme të teknologjive dhe shkencave, domosdoshmërisht na ka vënë përpara problemeve të mëdha, sikundër janë problemet me mjedisin. Çfarë është zhvillimi i qëndrueshëm?

Ruajtja e burimeve natyrore, përdorimi sa më racional i tyre dhe gjetja e mundësive të reja të zhvillimit (duke ruajtur burimet natyrore) janë pjesë e debatit të madh që zhvillohet kudo në botë e që ka në thelbin e vet një koncept të veçantë të zhvillimit ekonomik: zhvillimin e qëndrueshëm!

Ky term, që gjithnjë e më shumë po zë vend në tryeza të niveleve të larta politike botërore, ka sjellë në vëmendjen e të gjithëve dhe nevojën e edukimit të njerëzve sipas këtij koncepti.

Por, që një model të shndërrohet në veprim, kërkon edukimin masiv të aktorëve që i shërbejnë këtij modeli. Në këtë rast, problemi i edukimit me modelin e zhvillimit të qëndrueshëm merr një përparësi jo vetëm të nevojshme, por edhe përcaktuese në rezultat. *Ndaj, asocimi i modelit të zhvillimit të qëndrueshëm me edukimin filozofik të zhvillimit të qëndrueshëm përbën nevojën, por edhe sfidën e shekullit ku jetojmë.*

UNESCO është Organizata e Kombeve të Bashkuara, që e ka kthyer si pjesë të misionit të saj këtë filozofi edukimi dhe promovon modelet më të arrira në vite në të katra anët e rruzullit tokësor, sikurse dhe bën raportet bilance të angazhimeve ndaj ZHQ-së nga të gjithë aktorët dhe faktorët⁸.

8 <http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002303/230302e.pdf>



Në vitin 1975, Kombet e Bashkuara përcaktuan konceptin e "Edukimit për zhvillimin" si një iniciativë që "...do të aftësojë njerëzit të marrin pjesë në zhvillimin e komuniteteve të tyre, të kombeve dhe botës në tërësi". Kjo pjesëmarrje kërkonte dhe **kërkon ndërtimin e një ndërgjegjeje kritike ndaj situatave lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare**, bazuar në kuptimin e proceseve sociale, ekonomike dhe politike... dhe gjykimin mbi rrugët e arritjes të një **RENDI të RI ekonomik-social botëror**. Pas kësaj, shtete, rajone, organizata e grupe individësh përcaktuan objektivat e tyre, ndërtuan e rindërtuan politika të tyre, hartuan programe, ngritën projekte, përcaktuan koncepte bazë e tregues, instrumente po aq sa përcaktuan dhe mënyrën e matjes së monitorimit të tyre.

Në këtë proces të organizimit dhe menaxhimit të së tërës, "Edukimit për zhvillimin" iu besua ndërtimi i kapaciteteve kritike në procesin e të mësuarit, të cilat mund të drejtonin lëvizjen drejt një rendi të ri social botëror. Këto kapacitete, në rreth 4 dekada, u përpoqën e përpiqën të ndërtojnë një edukim të përshtatur me nevojat, përparësitë, politikat e zhvillimit ekonomik të botës. Kështu, edukatorët (ku futen dhe qarqet akademike të edukimit) u besuan si **agjentët e ndryshimit drejt këtij Rendi të Ri**. Termi "Zhvillim i qëndrueshëm" erdhi nga *Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës*. Pra, erdhi nga një cilësi aktiviteti që synonte për të na kujtuar të gjithëve se rendet dhe qeniet shoqërore duhet të vihen në shërbim të një pasurie që e zotërojmë si mundësi të gjithë, në mënyrë të barabartë, pa e diskutuar, por që duhet ta diskutojmë domosdoshmërisht mes nesh për ruajtjen e vlerave të saj e t'i mundësojmë jetëgjatësi përtej nesh, për t'ia lënë pasuri brezave në vazhdim. Cilësisë së vlerësuar në pozitivitetin a negativitetin e trashëguar, paqëndrueshmërisë në rende a sjellje njerëzore duhet domosdoshmërisht t'i bashkëngjisim standardin e një sjelljeje tonën, që arrin të mundësojë sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm si kolateral për brezat që do të vijnë. Rendi dhe individit i duhej t'i humbte "e imja", pasi ndërvarësitë mes tyre, e mira dhe e keqja, shkaku dhe pasoja e kanë ekspozuar këtë pasuri me një tendencë të humbjes së imunitetit nga revanshi i veprimit të mendjeve pa moral social, nga konkurrenca pa principe për fitimin dhe supremacinë jo vetëm në stere, por dhe në qiell. Rendi po e ndjente rrezikun që i kanosej nga shfrytëzimi pa moral i kësaj pasurie të përbashkët, ku kufijtë dhe diversitetet mes nesh humbën kuptimin. E gjithë shoqëria kishte nevojë për edukim, ne kishim dhe kemi nevojë për analizë dhe etikë sjelljeje, si gjendje e mendjeve tona. Në këto kushte socio-politike erdhi Raporti i Komisionit Ndërkombëtar për Mjedisin

dhe Zhvillimin, “**E ardhmja jonë e përbashkët**” (WCED, 1987; 43), ku flitet për një zhvillim të qëndrueshëm, ku zhvillimi do të takonte nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm, për të takuar e përmbushur nevojat e tyre.

Në 1992-shin, “**Agenda 21**”, paraideuesja e shekullit të ri, e identifikoi sistemin e edukimit si shtyllën më kryesore në të cilën do të arrihej zhvillimi i qëndrueshëm. Takimi mbi “Zhvillimin e qëndrueshëm”, në **Johanesburg, në vitin 2002**, theksoi nevojën e promovimit të një sistemi edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm, bazuar në ndërtimin e standardeve dhe mekanizmave të kontrollit, që në mënyrë konfidenciale do të vlerësonte progresin drejt realizimit të tij. Sot, në diskutime dhe raporte të ndryshme, ky takim është vlerësuar si ai që përcaktoi **parimet e para dhe truallin e përgjegjësive për punonjësit e edukimit, drejtuesit komunitarë apo politikë, të çdo faktori brenda qytetarisë globale.**

Në dekadën e fundit, koncepti i edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm (**ESD**) është shumë i njohur dhe shumë i mbështetur në terrenet akademike, nën një mbështetje ndërkombëtare. Në mënyrën më të spikatur dhe më të mirënjohur, ai erdhi nga Proklamata e Kombeve të Bashkuara, 2005-2014, e cila e përcaktoi këtë periudhë si Dekada e Edukimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm (**DESD**).

Kësaj cilësie zhvillimi i janë bashkëngjitur treguesit e shfaqjes apo matjes së tij. Kështu:

- barazia,
- shëndeti,
- strehimi,
- siguria,
- popullsia,
- atmosfera,
- toka, oqeanet, detet, brigjet, ujërat e ëmbla,
- biodiversiteti,
- struktura ekonomike,
- konsumi dhe prodhimi i patentave,
- korniza institucionale,
- kapacitetet institucionale;

të gjithë janë tregues që **mendimi dhe aktiviteti njerëzor tenton dhe duhet t’i prodhojë, t’i shohë e analizojë në mënyrë kritike, t’i riformatojë me qëllim që cilësia e jetës në progres të sigurohet për çdo banor të globit.**



I.1/a. Përmbajtja e konceptit “ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM”

Shqetësimi i vendeve për të integruar mjedisin dhe zhvillimin ka çuar në krijimin e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithëse ky koncept përmendet në një sërë traktatesh dhe marrëveshjesh mjedisore, Raporti i Bruntlandit nga Komisioni Botëror i Mjedisit dhe Zhvillimit, krijuar nga Kombet e Bashkuara, i vitit 1983, shikohet si dokumenti që përcaktoi **zhvillimin e qëndrueshëm si objekt të politikës globale** dhe çoi në krijimin e një sërë rregullash, të quajtur “e drejta ndërkombëtare në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm”⁹.

Raporti i Bruntlandit e përkufizon zhvillimin e qëndrueshëm si “zhvillimi që plotëson nevojat e tanishme pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre”¹⁰.

Ky përkufizim përmban dy koncepte: atë të **nevojave** – veçanërisht të nevojave themelore të brezit të tanishëm dhe konceptin e **kufizimeve**, të imponuara nga gjendja e teknologjisë dhe organizimit shoqëror, të aftësisë së burimeve mjedisore për të plotësuar nevojat e së tashmes dhe së ardhmes. Pra, problemet tashmë kishin kapërcyer gjeografinë vendore për t’u shndërruar në problem global.

Arritja e zhvillimit të qëndrueshëm nuk është detyrë e lehtë.

Katër dekadat e fundit kanë qenë dëshmitare të një ndërgjegjësimit në rritje të efekteve shkatërruese të njerëzimit ndaj mjedisit, por natyra dhe shkalla e shqetësimit kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe.

Megjithëse çështjet mjedisore filluan të merrnin përmasa politike që në vitet 1950, interesi ishte kryesisht i fokusuar në çështjet mjedisore vendore, pra nuk kishim më dimension ndërkombëtar.

Nga fundi i viteve ’60 u bë e qartë që ndotjet nuk respektonin kufijtë kombëtarë dhe se shumë çështje mjedisore ishin me rëndësi ndërkombëtare. Transportimi i largët i ndotjeve të ajrit të tipit të **shiut acid** të impianteve që prodhonin energji në Britani, dëmtonte pemët në Norvegji dhe mbetjet e derdhura në lumin Rin në Gjermani dilnin në brigjet e Holandës.

Natyrshëm, koncepti i kontrollit të popullsisë ndeshej me probleme etike në shumë pjesë të botës. Po kështu, ideja që zhvillimi ekonomik duhej të ngadalësohej për të

9. Raporti mori emrin e Kryetarit të Komisionit Gro Harlem Bruntland.

10. Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin. “E ardhmja jonë e përbashkët”, fq. 43, 1987, Konferenca e OKB-së për Mjedisin Njerëzor, e mbajtur në Stokholm në 1972-shin.

siguruar mbrojtjen mjedisore ishte pak e besueshme, kryesisht në vendet në zhvillim, dhe në vitin 1983, me formimin e Komisionit Botëror për Mjedisin, i trajtoi këto çështje, madje i shtroi për zgjidhje.

Raporti përfundimtar i këtij Komisioni, “E Ardhmja Jonë e Përbashkët”, bënte një shtjellim për një integrim pozitiv të dimensioneve mjedisore, sociale dhe ekonomike të mjedisit. Raporti Bruntland zhvilloi në një mënyrë konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm: *zhvillim që përballon nevojat e sotme pa kompromentuar aftësinë e gjeneratave të ardhme për të përmbushur nevojat e tyre.*

Sipas këtij raporti, ishte më mirë një kompromis për një çështje të ravijëzuar dobët, sesa mosrënia dakord mbi një çështje shumë të qartë.

Me dhënien dhe pranimin e një përcaktimi kaq të gjerë, Konferenca e Kombeve të Bashkuara e vitit 1992 për Zhvillimin dhe Mjedisin (**Samiti i Tokës i Rios**) do të arrinte në një pakt veprimi për promovimin e “zhvillimit të qëndrueshëm”, duke përfshirë 38 çështje; që nga atmosfera deri tek turizmi i qëndrueshëm, për të cilat u përpiluan 27 parime juridike.

U pranua fakti se, që të përballoheshin të gjitha këto problematika, duheshin burime të jashtëzakonshme dhe, në mënyrë thjesht rastësore, rënia e Murit të Berlinit solli një “Paqe” nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve për problemet ushtarake.

Fundi i Luftës së Ftohtë premtonte gjithashtu një rimarrje në konsideratë të çështjeve të sigurisë dhe çoi në *konceptin e sigurisë mjedisore*, ku u riformulua ideja: **degradimi mjedisor mund të çojë në kolapse sociale dhe ekonomike, emigracion masiv, dhe si përfundim, mund të çojë në konflikte të dhunshme.** Kjo i dha një shtysë akoma më të madhe nevojës për veprim, në drejtim të “zhvillimit të qëndrueshëm”.

Pavarësisht nga studimet substanciale të dhjetëvjeçarit të shkuar, akoma ka paqartësi shkencore për sa i përket parashikimit të së ardhmes globale mjedisore. Toka nuk është dhe asnjëherë nuk ka qenë një sistem i pandryshueshëm. Ndryshueshmëria natyrore është dhe ka qenë një pjesë e ndërlikuar e të gjitha sistemeve mjedisore, dhe vetëm shkurtimi i kohëzgjatjes së vëzhgimit të drejtpërdrejtë të aktivitetit njerëzor jep një ndjesi stabiliteti.



Pyetjet që shtrohen janë:

- A është ritmi i ndryshimit që i atribohet direkt faktorit njeri kaq i ngadaltë sa do të ketë kohë të mjaftueshme për të reaguuar?
- Qeveritë e botës, a janë shumë të kujdesshme për të investuar para në një çështje akoma të paqartë?

Nisur nga kompleksiteti i problemit, mungesa e dëshirës politike përpara paqartësive shkencore apo thjesht vështirësitë e problemeve bënë që angazhimet e marra në Rio, në vitin 1992, të jenë të pamjaftueshme për të përballuar këtë detyrë.

Nga ana tjetër, ka pyetje të tilla si:

- A është komuniteti ndërkombëtar në gjendje për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm?
- A do të arrihet balanca ndërmjet mjedisit, ekonomisë dhe popullsisë?
- Do të arrihet të shmangen efektet e kolapsit ekonomik, luftës, urisë, sëmundjeve?

Këto pyetje, mbas Samitit të Johannesburgut të gushtit 2002, mbetën akoma probleme të kohës, pa përgjigje dhe pa një vizion të saktë.

“Bota është e rrezikshme e do të bëhet gjithnjë më fortë e tillë: dhuna po përhapet ngado e në shumë vende; ajo bën kërdrinë në emër të intolerancës më të pashpirt dhe ideologjive më të errëta; po ndizen luftëra fetare; po ndahen shtete; dallimet nuk shërbejnë më si pasurim i ndërsjelltë; mjedisi po rrënohet; ushqimi po ndotet gjithnjë e më tepër dhe punësimi po zhduket; shtresat e mesme po shkërmoqen; rritja ekonomike nuk u përgjigjet më nevojave të një popullate urbane gjithnjë e më të dendur; pabarazia mes një grupi të vogël të pasurish dhe një numri gjithnjë e më të madh të varfërisht po zgjerohet.”¹¹

Kjo është panorama që na përshkruan për situatën aktuale Jasques Attali.

Sikundër shihet, shoqëria sot ka nevojë për strategji afatgjata. Kjo i jep dyfish më shumë rëndësi nevojës për të konceptuar dhe përpunuar strategji të një zhvillimi të qëndrueshëm në nivele globale dhe kombëtare.

11. Jasques Attali “Të bëhesh vetvetja”, botim GreenTech, 2015, fq. 8-9.

I. 1/b. Çështja e “ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM”

Koncepti i “Zhvillimit të Qëndrueshëm”, me gjithë gjerësinë e tij konceptuale, mbetet i vështirë të përdoret si një mjet i nevojshëm për të adresuar problemet e mëdha me të cilat duhet të ndeshemi. Arsyeja është e thjeshtë: ky koncept shihet i lidhur me përcaktimin që i jepet konceptit “zhvillim ekonomik”, por ky zhvillim duhet të ecë me atë hap dhe në atë mënyrë që të bëhet e mundur nga njëra anë, “të ruhet mjedisi dhe burimet natyrale të harxhueshme”, dhe nga ana tjetër, në formën e saj më ekstreme, “popullsia njerëzore të stabilizohet dhe burimet e ripërtëritshme të përdoren gjerësisht”. Bazuar në këtë përcaktim, problemi që duhet të trajtojë “Zhvillimi i Qëndrueshëm” është raporti i rritjes së popullsisë dhe rritjes ekonomike, njëkohësisht dhe i përgatitjes reale të njerëzve për të përballuar sfidat e këtij raporti.

Në nivelin më esencial, një popullsi me ritme rritëse kërkon më tepër ushqim, ujë dhe energji.

Ndërkohë, pyjet po zhduken për t’i lënë vend prodhimit të ushqimeve, ujërat nëntokësorë shfrytëzohen për të marrë ujin për përdorim të popullsisë dhe për ujitje, karburantet fosile digjen me një ritëm më të madh dhe në rritje, për të përballuar kërkesat në rritje për energji.

Djegia e karburanteve fosile pakëson rezervat e parikuperueshme dhe shton dioksidin e karbonit, CO₂ në atmosferë: një problem ky që përkeqësohet nga ulja e aftësisë përpunuese thithëse globale të këtyre gazrave, për shkak të uljes së sipërfaqes së pyjeve. Këta mekanizma kështu çojnë në rritjen potenciale të ngrohjes globale dhe ndryshimet klimatike. Ndryshimet klimatike, nga ana e tyre, kanë potencialin për ndikim të drejtpërdrejtë dhe negativ në prodhimin e sasive të kërkuara të ushqimit dhe ujit në pjesë të ndryshme të botës, nëpërmjet shkretirizimit, ngritjes së nivelit të detit, gërryerjeve dhe përmytjeve. Ndotës të tjerë ndikojnë drejtpërdrejt në atmosferë, oqeanë dhe rezerva ujore, duke ulur direkt mundësinë e prodhimit të produkteve ushqimore në det dhe tokë. Rezultati i të gjitha këtyre ndikimeve negative është shfrytëzimi më i egër i burimeve, duke krijuar kështu një rreth ciklik. Po t’i shtojmë këtij skenari edhe aspiratat e vendeve në zhvillim për të arritur të njëjtin nivel të zhvillimit ekonomik si ato të zhvilluara, arrijmë në një problem me pasoja potenciale shumë serioze.

Ky model, sigurisht, është shumë i thjeshtëzuar dhe nuk arrin të trajtojë një sërë problemesh të zhvillimit të qëndrueshëm, nga biodiversiteti deri tek problemet



shëndetësore, shumë prej të cilave kanë rëndësi lokale dhe rajonale.

Thjeshtëzimi i një problemi shumë kompleks ka rreziqet e veta, por këta shembuj shërbejnë për të nxjerrë në pah faktorët kryesorë me rëndësi globale: rritja e popullsisë, rritja ekonomike, ushqimi dhe uji, energjia.

b/1 Rritja numerike e popullsisë

Rritja numerike e popullsisë gjithmonë ka qenë e vështirë të parashikohet dhe aq më pak të kontrollohet. Ritmi i rritjes së popullsisë ka rënë nga 2.1%, që ishte në vitet '60 në 1.3% në vitet 2000. Por, megjithëse duket sikur ka njëfarë rënieje të ritmit, sipas studimeve të Divizionit për Popullsinë të Kombeve të Bashkuara, popullsia e sotme, prej 7 miliardë, do të arrijë në 7.9 deri në 10.9 në mesin e shekullit XXI. Nga viti 1968, popullsia e botës është dyfishuar! Akoma më e vështirë bëhet mundësia për të parashikuar aftësinë mbajtëse të njerëzimit për të gjithë planetin. Aftësia mbajtëse e planetit varet nga zhvillimi ekonomik dhe niveli i konsumit të burimeve, dhe këtu duhet bërë i qartë ekuacioni: *planeti mund të mbajë 20 miliardë njerëz, duke jetuar sipas stilit të fshatarëve të Evropës Qendrore apo shumë më pak, duke jetuar sipas stilit të amerikanëve të Veriut.*

Sigurisht që, kur Malthus-i shkroi teorinë e tij mbi ekuacionin e mësipërm më 1798-ën, ka rrjedhur shumë kohë dhe sot mendimet janë të ndryshme. Disa i kundërvihen duke e argumentuar pasojën e tij tragjike si një pikënisje optimiste, të tjerët, përkrahës të teorive të Malthusi-t, e shikojnë rrezikun e kufijve mbajtës të Tokës shumë të afërt. Por të gjithë vijnë në një përfundim:

çfarë modelesh duhen ndjekur që të mos shkojmë drejt një katastrofe të tillë?

b/2 Zhvillimi ekonomik

Zhvillimi i ekonomisë (edhe sipas modeleve Kentsiane) mbështetet edhe në një koncept: limitimi i burimeve që sigurojnë zhvillimin ekonomik. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se do ketë zhvillim ekonomik për aq kohë sa burimet garantojnë këtë zhvillim që të jetë funksional.

A është kjo një frikë e shoqërisë në epokën globale që lidhet me mundësinë e reduktimit të këtyre burimeve? Në fakt, ky problem nuk është i ri. Që nga antikiteti, çështja e limitimeve të burimeve natyrore në raport me zhvillimin e njeriut ka qenë problem.

Në mitologjinë greke, kur Prometeu i dha zjarrin njerëzimit dhe e shkëputi nga bota e egër, i dha njëkohësisht dhe idenë se do i duhej të luftonte shumë me natyrën dhe me vetveten për të mbijetuar.

Trekëndëshi: *njeri - natyrë - zhvillim ekonomik* është konsideruar gjithnjë si problem madhor i nevojës për ekuilibra.

Sot, në shekullin XXI, duket se ky problem ka humbur. Të paktën në pasojë. Sot kemi një përdorim të vazhdueshëm të burimeve natyrore pa e “vrrarë mendjen” as për pasuritë globale e as për brezat që vijnë. Ndaj, koncepti “zhvillim ekonomik” nuk mund të mbështetet në burime të limituara. Njerëzimi nuk mund të presë pemën mbi të cilën është ulur, kjo për shkak se nevojat e tij janë shumë më të mëdha sesa arritja e një përfitimi të çastit, por edhe sepse shoqëria vepron mbi baza racionale dhe aftësi parashikuese. Në këtë rrafsh lindi nevoja për një rikonceptim të modeleve të zhvillimit ekonomik. Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm duket se jep qasje optimiste në lidhje me këtë problem. Sipas raportit të Brutland, “ky zhvillim do kënaqë nevojat e sotme pa kompromentuar nevojat e brezave që vijnë”. Në thelb, ky sistem i mbyllur tokësor ka shfrytëzimin e burimeve të ndryshme, të cilat nuk prekin natyrën dhe mjedisin. Lindi kështu një paradigmë e re e zhvillimit ekonomik, paradigmë të cilën sot e shprehim qartazi në ekuacionin e mëposhtëm:

$$Y = F(P, K, N, A)$$

Ku **Y**-ni është prodhimi (pasuria), **P**-ja është resurset natyrore, **K**-ja është kapitali i prodhuar nga njeriu, **N**-ja është Puna dhe **A**-ja është progresi teknik.

Në këtë paradigmë, ekuilibri realizohet në shërbimet mjedisore, të cilat garantojnë ekuilibër mes Natyrës dhe Njeriut. Por, që të realizohet kjo, më së pari, kërkohet një

edukim i Njeriut për t’u aftësuar njëkohësisht në dy drejtime:

- *së pari*, për të kuptuar nevojën e zhvillimit të qëndrueshëm;
- *së dyti*, për të gjeneruar mundësi në gjetje teknologjike të reja, duke shfrytëzuar çdo gjë që prodhohet si mbetje.

Ndaj elementët e mëposhtëm janë problem dhe ndërkohë sfida të shekullit që jetojmë.



b/3 Ushqimi dhe uji

Prodhimi i ushqimeve ka kaluar ritmin e rritjes së popullsisë gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Kjo është arritur nëpërmjet zgjerimit masiv të sipërfaqes së tokës bujqësore dhe rritjes së produktivitetit, nëpërmjet sistemimeve të ujitjes dhe bujqësisë intensive. Por, rritja e sasisë së prodhimit të ushqimit ka sjellë si pasojë degradimin e tokës arë, shpyllëzim, zhdukje të vegjetacionit natyral, kripëzim dhe kanalizim të tokave, të cilat vijnë si pasojë e sistemeve jorezultative të ujitjes. Vlerësimet tregojnë se, gjatë viteve 1980, rreth 10 milionë hektarë tokë nën ujë braktiseshin në vit dhe se afërsisht 10-30% e emisioneve të CO2 shkaktoheshin nga ndryshimi i drejtimit të përdorimit të tokës. Kërkesat në rritje për ujitje kanë sjellë përdorime intensive të burime ujore dhe sot përbëjnë 2/3 e sasisë së ujit të përdorur nga njeriu. E njëjta gjë po ndodh edhe me rezervat e ujërave nëntokësore, të cilat më shpejt po harxhohen sesa zëvendësohen. Duhet thënë që edhe këto rezerva janë të ndikueshme nga bujqësia dhe ndotjet industriale. Ndotja, gjithashtu, po ndikon në oqeanet e planetit, të cilat po dëshmojnë se kapaciteti prodhues i tokës për ushqim është jo vetëm i kufizuar, por edhe mund të reduktohet nga veprimet e paqëndrueshme. Shkatërrimet e pengesave koralore dhe shtimi i algave shkatërruese, të cilat ndihmohen në zhvillimin e tyre nga mbetjet e fermave të ndryshme, janë bërë një gjë e zakonshme në shumë zona bregdetare dhe kanë sjellë si pasojë shkatërrimin e peshkimit lokal dhe humbjen e një burimi të rëndësishëm proteinash për vendet në zhvillim. Rezervat e peshkut, që dikur ishin me shumicë, janë në ulje tanimë nga peshkimi i tepruar.

A flasin këta tregues për limitim të burimeve natyrore?

b/4 Energjia

Përdorimi i energjisë, si asaj industriale, bujqësore apo për përdorim shtëpiak, ose transport është një çështje kryesore e zhvillimit të qëndrueshëm, sepse mbështetja në karburantet fosile të harxhueshme rezulton në zhdukjen e burimeve të pazëvendësueshme, si edhe në prodhimin e gazrave që ndikojnë në efektin serë. Sot rreth 1 miliardë e gjysmë njerëz janë ende të përjashtuar nga përdorimi i energjisë elektrike, për shkak të varfërisë ekstreme të tyre. Sigurisht, ky fakt përbën një nevojë të shtuar për gjetjen e burimeve të reja energjetike në rrafsh global. Në "Objektivat e Mijëvjeçarit" të OKB-së është propozuar strategjia e reduktimit të njerëzve që jetojnë

me 1 dollarë në ditë. Madje, kjo strategji ka projektuar që brenda vitit 2015-të, ky numër të ulet në mënyrë të ndjeshme. Por nuk mund të arrihet ky objektiv nëse këtyre njerëzve nuk u sigurohet më së paku akses në përdorimin e energjisë elektrike. Pra, nevoja për përdorim në rritje të energjisë kërkon strategji të veçanta jo vetëm për shfrytëzim me kriter të burimeve natyrore, por edhe gjetjen e mundësive alternative. Për sa i përket harxhimit të pazëvendësueshëm, duket sikur, megjithë zbulimet e mëdha që kanë bërë teknologjitë e reja, nuk do të mundin që të ndërpritet përdorimi i tyre nga ekonomitë që kërkojnë gjithmonë të prodhojnë më shumë. Përdorimi i këtyre burimeve fosile të energjisë do të vazhdojë të lëshojë në atmosferë sasi gjithmonë e më të mëdha të CO₂, i cili prish ekuilibrin kompleks të ciklit global të karbonit dhe kontribuon në ndryshimet klimatike, nëpërmjet efekteve tashmë të njohura si efektet serë dhe ngrohje globale.

Paneli Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike (IPÇ) ka parashikuar një rritje globale të temperaturës së sipërfaqes së tokës nga 1.4 deri në 5.4 gradë celsius, me një tendencë që vendet e lartësive të veriut do të ngrohen më shpejt sesa mesatarja vjetore. Parashikimet janë në rritje të nivelit të ujërave dhe përmbytjet bregdetare, ndryshime ekstreme të temperaturave dhe përhapje më të mëdha të epidemive. Modeli i Panelit Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike tregon, gjithashtu, për një ngadalësim të qarkullimit të rrymave oqeanike, duke sjellë si pasojë uljen e transmetimit të nxehtësisë në gjerësitë veriore, për shembull, Golf Strimi.

Roli i pyjeve si filtra të CO₂ është kuptuar drejt, por është më pak i njohur fakti që oqeanet prodhojnë nga 1/3 deri në 2/4 e rezervës së O₂. Oqeanet ndihmojnë në rregullimin e raporteve të CO₂ nëpërmjet një mekanizmi të quajtur pompa biologjike. CO₂ hyn në shtresat e sipërme të oqeanit, ku përdoret nga fito planktonet dhe bimë të tjera detare në procesin e fotosintezës, duke ngadalësuar kështu grumbullimin e gazeve që shkaktojnë efektin serë në atmosferë. Ndotja dëmton organizmat ujorë dhe, ndërsa ndotësit kanë tendencë të grumbullohen në ujërat sipërfaqësore, ato ka mundësi që të kenë efekt negativ në dispropocionimin e fotosintezës marine, duke u bërë kështu një kërcënim për efektet rregullatore dhe në klimën globale. Fotosinteza marine është gjithashtu themeli i një zinxhiri ushqimor që na jep miliona ton ushqim deti në vit.

A është raporti nevojë/mundësi një problem që krijon realiteti global në gjetjen e modeleve të reja? Dhe nëse po, si do realizohet kjo gjetje?



b/5 Udhëheqësia

Sikundër shfaqet qartë, **faktori çelës është Udhëheqësia**. Asnjë model dhe asnjë politikë qeverisëse nuk mund të realizohet pa një model të ri Udhëheqësie. Zhvillimit nën këtë cilësi (ZHQ) i duhet të ketë dhe të ndërtojë "kampionet" apo "modelet" e qëndrueshme të cilëve, ju duhet të zotërojnë kompetenca dhe konfidenca të duhura për të qenë "udhëheqës" për ZHQ-në, bazuar në njohuri dhe aftësi të nevojshme për të. *Për këto udhëheqës apo udhëheqësi, ZHQ-ja fillon me cilësinë e të kuptuarit dhe të zbatuarit e koncepteve për të, ndërtimin e një sistemi të menduarit që i zhvillon edhe ato vetë nën sfidat e kohës po aq sa ndërtimin e një mjedisi inovativ dhe nën inovacione sikurse edhe udhëheqësi politike nën këto cilësi në një shkallë të gjerë.*

Sigurisht që, duke kuptuar rëndësinë për sa më sipër kuptohet, që mundësi dhe sfidave në ZHQ, në kontekst hapësinor dhe kohor, do t'ju duhet të përballen me cilësinë e organizimit që shoqëria ofron për të. Është ky lloj kuptimi që e bën të domosdoshëm zhvillimin e shkathtësive të transferueshme dhe kompetencave të rëndësishme për të gjithë ata individë, shtete dhe udhëheqës që aspirojnë për të siguruar një udhëheqësi në zhvillim të qëndrueshëm përtej kufijve të shteteve dhe në një ndërvarësi të cilësueshme. Arritja e zhvillimit të qëndrueshëm do të kërkojë një udhëheqësi politike shumë të fortë, partneritete të fuqishme dhe të qëndrueshme, si dhe qeverisje ndërkombëtare për shumë probleme. Kompanitë e mëdha kudo në botë po riorientojnë vizionet e tyre në formimin e një udhëheqësie që do mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm. Sipas parashikimeve të WEDC-së brenda 2050-ës, rreth 9 miliardë njerëz do të jetojnë më mirë brenda të njëjtave burime të natyrës në Tokë. Roli i UDHËHEQËSISË në përmbushjen e këtij misioni është i madh dhe vendimtar. Rritja e efikasitetit (që konsiderohet si faktori 3) i sigurimit të një zhvillimi të qëndrueshëm kërkon përgatitjen e një udhëheqësi me dy parime:

"Mëso duke vepruar!";

"Të arrish më shumë, me sa më pak!".

Këto dy parime sollën realisht nevojën e rikonceptimit të vetë sistemit të edukimit.

I. 2 RAPORTI: ZHVILLIM I QËNDRUESHËM/SHOQËRI

Zhvillimet e fundshekullit të kaluar, me kërkesën për zhvillimin e qëndrueshëm për një **REND të RI ekonomik-social botëror**, shtruan përpara shoqërisë nevojën e një edukimi masiv me termat dhe nevojat e këtij rendi. Në Proklamaten e Kombeve të Bashkuara për vitin 2005-2014, e cila e përcaktoi këtë periudhë si Dekada e Edukimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm (DESD-në anglisht), ka sjellë para edukimit global, botës së kërkimit shkencor, auditoreve të universiteteve dhe rrjeteve publike të komunikimit nevojën e rigjenerimit të konceptit **“Kapital human”** dhe kërkimin e analizës së cilësive të tij në kushtet e reja të informimit dhe komunikimit njerëzor. Kur trajtesat i referohen këtij koncepti, nënkuptohet *krijimi i një “rrjeti social, që secili njuh se çfarë duhet të bëjë për veten dhe për njëri-tjetrin”, kur njëri dhe tjetri nuk kanë kufij shtetesh e moshash. “Kapitali human” shpreh një komunitet pa kufij, bazuar në vlera kolektive, komunitete që njohin dhe respektojnë mes këtyre vlerave normën e reciprocitetit në liri dhe përgjegjësi*. Ai është një shprehje e formimit dhe cilësisë së veprimit të qytetarit aktiv global, aktiv në informim dhe veprim, pavarësisht vendit ku jeton, por fokusuar në problemet që na shtron për diskutim cilësia e jetës njerëzore. **Cilësia e krijimit të tij është një cilësi ekzistencialiste për një shëndet publik e politik të kombeve dhe të fshatit të vogël global për ne sot, por dhe për gjeneratat e reja**. Në të takohet njeriu që përdor lirinë e tij përkundrejt përgjegjësi ndaj vetes dhe tjetrit, e brendshmjia dhe e jashtmjia e individëve qytetarë, por mbi të gjitha ngjizja e një fryme kolektive pa kufij, përmes një ndërgjegjeje qytetare bazuar në vlerat e sipërpërmendura.

Në tërësinë e vlerave të pranuar në këtë komunitet, pretendohet të arrihet në një shumëllojshmëri përfitimesh, që bazën e kanë te këto vlera, ku spikasin: ***e vërteta, besimi, reciprociteti, informacioni dhe bashkëpunimi i fuqishëm në institucione edukimi po aq sa dhe në rrjetet sociale***.

Ky lloj kapitali human mundëson demokracinë funksionale, ndërsa vetë ai mundësohet gjatë gjithë jetës. Themelet e tij sigurohen hershëm në cilësi nga institucioni i familjes dhe i edukimit, duke vazhduar me një dialektikë të shtrirë në kohë dhe fokusim objektivash referuar gjeneratave gjatë gjithë jetës.

Duke iu qasur pohimit të John Dewey: ***“Demokracia ka për të lindur rishitas çdo brez***



*dhe edukimi është mamia e saj*¹². Kështu, ky “Kapital human pa kufij” krijon vlera për njerëzit që jo domosdoshmërisht duhet të jenë në kontakt të përditshëm me njëri-tjetrin, mund të takohen rrallë, një herë apo asnjëherë, por që komunikojnë përmes cilësive të edukimit global për zhvillim të qëndrueshëm, përmes sistemeve kombëtare të edukimit, që objektohen dhe progresojnë nën filozofi të tilla edukimi. Edukimi i pritur sot fuqizohet edhe përmes rrjeteve sociale me objektiva të përcaktuar cilësisht, referuar DESD-së. Ky lloj edukimi vazhdon gjatë gjithë jetës edhe nga institucione të kërkimit shkencor, punësimit, besimit, lëvizje për të drejta civile etj., të cilat na sjellin dy konkluzione të rëndësishme:

1. Pranimin e *misionit* të edukimit global. Ky mision shihet si edukim që siguron për çdo shoqëri “*Kapitalin human*” të aftë për të prodhuar: a) një shëndet publik; b) shëndet politik të kombeve; c) tejkalim sfidash në formimin e cilësisë së qytetarisë, demokracisë, ekonomisë dhe mjedisit.
2. Ky “Kapital human” e konsideron individin si “Vepër kapitale” me identitet dhe solidaritet të gjerë, *që mendërisht na mundëson kalimin nga “Unë” në “Ne”, në liri e përgjegjësi.*

Është e kuptueshme se nevoja për një rikonceptim në këto përmasa të edukimit dhe prodhimit të një kapitali human bëhen edhe më të dukshme përballë ndryshimeve të mëdha teknologjike e demokratike.

Referuar një studimi të Karl T. Kurtz, Alan Rosenthal, Cliff¹³ mbi brezin e të rinjve që lindin dhe edukohen në epokën e internetit dhe rrjeteve sociale (të cilët quhen “DotNets” dhe nënkuptojnë të rinjtë e moshës nga 16 deri në 26 vjeç), ata theksojnë se “...ne mendojmë se karakteristikat përcaktuese të tyre janë se: **1. quhen të ardhur së bashku me moshën e internetit;** **2. informacioni ka qenë gjithmonë pothuajse universalisht i lirë dhe në dispozicion të tyre;** **3. në kushtet e një teknologjie të lirë dhe të lehtë për t’u zotëruar;** **4. të një hapësire më shumë si dixhitale për interesa të përbashkëta sesa për një hapësirë të përbashkët fizike;** **5. ata erdhën nga moshë në epokën e bum-it të skandalit të Klinton-it;** **6. kur prekëm një tërheqje të ekonomisë, por edhe me** **7. një tendencë të rifokusimit tek familja**”¹⁴.

12. John Dewey, “The school and society”, Chicago University of Chicago Press, 1900. Pg. 72.

13. Zukin, “Rutgers University” në NATIONAL CONFERENCE of STATE LEGISLATURES mbi “Citizenship, A. Challenge for All Generations”, shtator 2003.

14. Po aty, fq. 2.

I. 2/1 Pse edukimi është qenësisht i lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm?

Në vitin 2005, UNESCO merr rolin e drejtimit të udhëheqësisë globale për ZHQ-në dhe prodhon dokumentin i cili njihet si “Skema ndërkombëtare e implementimit të EZHQ-së 2005-2014”¹⁵ ku përcaktohen detyra për shtetet anëtare (nënkupto edhe për Shqipërinë) në katër përqëndrime vëmendjesh kryesore të edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm;

1. përmirësimin e qasjeve për një arsim bazë (të detyrueshëm) cilësor;
2. riorientimin e kurrikulave ekzistuese drejt EZHQ-së;
3. zhvillimin e një kuptimi dhe ndërgjegjësimi publik për ZHQ-në dhe EZHQ-në;
4. ofrimin e kualifikimeve në arsim për EZHQ-në.

Edukimit, kurrikulave dhe sistemit të tij të kualifikim-trajnimit, ju njoh e drejta e misionit për kuptimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve dhe qytetarëve përmes adresimit në to të tre sferave të ZHQ-së: *shoqërisë, mjedisit dhe ekonomisë*. Në dokument janë të sakta adresimet ***drejt kurrikulave*** të vendeve anëtare të UNESCO-s për EZHQ-në, për të drejtat e njeriut, politikat e qytetarisë dhe qytetarit global, politikat e paqes, politikat e barazisë gjinore, politikat e reduktimit të varfërisë, politikat migratore, ndryshimet klimatike, politikat e urbanizimit etj. Këto adresime kurrikulare ***do të fuqizoheshin nga edukimi përmes vlerave, vlera të shoqërisë ku fëmijët dhe të rinjtë jetonin, por edhe të vlerave të të tjerëve përreth tyre dhe nëpër botë***, si një pjesë e rëndësishme e ***të edukuarit me të ardhmen e qëndrueshme të gjeneratave dhe udhëheqësve të rinj***. Shtetet, sistemi i tyre i edukimit, grupet e ndryshme kulturore brenda tyre, individë novatorë, qytetarë aktiv, do të përfshiheshin në një edukim që do të promovonte lidhjen që ***vlerat njerëzore kombëtare, të trashëguara dhe të fituara nga komunikimi me botën*** (për Shqipërinë dhe shumë si ajo nga proceset demokratike pas viteve ‘90), kishin dhe duhet të kishin nën kontekstin e ZHQ-së dhe EZHQ-në në vendet e tyre. Nëse ndjek logjikën e atij dokumenti ideues të rrugëtimit 10-vjeçar të EZHQ-së, vlerëson standardet që ai promovoi për zhvillimet në edukimin botëror duke marrë nën vete edhe Objektivat e Mijëvjeçarit apo iniciativa botërore kundër analfabetizmit. Duke e shprehur ***edukimin si burim dhe tregues të ZHQ-së*** përmes formimit të qytetarit, institucioneve dhe politikave, nëpërmjet nënvizimit të vlerave njerëzore, rëndësisë së proceseve dhe vendimmarrjeve logjike, sjelljeve të përgjegjshme dhe transparente publikisht për individë, grupe, shtete.

15. <http://unesdoc.unesco.org/images/0014/001486/148654e.pdf>,pg7



Në përmbyllje të Dekadës (2005-2014), vazhdohet të diskutohet rreth dy dimensioneve të qytetarisë, të cilat shihen shumë të domosdoshme për t'u përfshirë në edukimin qytetar, formal dhe informal. Këto dy dimensione shprehen edhe nën dy modele kompozimi cilësish qytetare:

1. **DC** - Dutiful Citizen;
2. **AC** - Actualizing Citizen.

Le të shohim dy dimensionet e qytetarisë së pretenduar, duke dhënë përmbajtësinë e tyre, por dhe për të vlerësuar kontrastin.

Tabela 1¹⁶.

AC, Actualizing Citizen. Qytetari i aktualizuar	DC, Dutiful Citizen Qytetari nën përgjegjësi
Zvogëlim të sensit të detyrimit të qeverisë dhe sensit të lartë të qëllimeve individuale.	Detyrimi për të marrë pjesë në aktivitete të qeverisjes.
Votimi është më kuptimplotë se aktet e tjera, personalisht të përcaktuara si: konsumizmi, komunitetarizmi, vullnetarizmi apo aktivizmi ndërkombëtar.	Të votuarit është bërthama e veprimit demokratik në shoqëri.
Humbja e besimit tek media dhe politikanët, që përforcohet nga mjedisi negativ i masmedias.	Informohet rreth çështjeve dhe qeverisë duke ndjekur masmedian.
Favorizon rrjete të lirshme të komunitetit në veprim shpesh të themeluar ose të mbështetur përmes miqësive dhe marrëdhëniet mes moshatarësh, të mbajtura nga teknologjitë e informacionit interaktiv.	Bashkohet me organizatat e shoqërisë civile dhe/ose shpreh interesat nëpërmjet partive të cilat tipikisht punësojnë një mënyrë komunikimi për të mobilizuar mbështetësit.

Sfidat ndaj edukimit qytetar në këtë skemë janë të dukshme. Rezultatet treguan se është e domosdoshme të punohet me një sistem edukativ të edukimit qytetar (të cilat i pretendojnë kryesisht në shkolla), duke u bazuar në modelin e QC-qytetarit nën përgjegjësi.

Në të njëjtën kohë, duke pranuar se gjeneratat e reja sot mund të kenë përvoja më të ndjeshme publikisht, të ndryshme në dimensionin social dhe politik nga ato të prindërve të tyre, kjo nuk shmang nevojën e një riformatimi të modelit edukativ në kushte të reja, me një përmbajtje të rishikuar. Kështu, *dimensioni qytetar ndaj mjedisit*

16. The Divided Citizenry: The traditional civic education ideal of the Dutiful Citizen (DC) vs the emerging youth experience of self - Actualized Citizenship (AC) by Bennet. W. Lance, "Civic Learning in Changing Democracies", University of Washington, 2003, p. 7.

dhe menaxhimit të tij është një prioritet i edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm në këtë dekadë të edukimit global.

Debati mbi këto dy dimensione lidhet me shkallën e **aktivizimit të “Kapitalit human”** po aq sa me vetë zhvillimin e demokracisë në këtë mijëvjeçar (Bennet & Lance, 2003). Teoritë e “Kapitalit human” u bënë një kornizë e analizave dhe studimeve në dhjetëvjeçarët e mëpasëm (Coleman, 1998; Dika & Singh, 2002; Lin, 2001; Maeroff, 1999). Portes (2000), në fillim të mijëvjeçarit, nënvizoi: **“Koncepti i Kapitalit human i argumentuar është një nga eksportet më të mëdha nga sociologjia tek shkencat e tjera sociale dhe tek diskursi publik.”**

Këto janë debate që zbresin në fushën e akademizmit, të cilat lidhen konceptualisht dhe praktikisht me filozofinë, sociologjinë, psikologjinë, shkencat politike. Qytetarët kudo në botë, edukatorët po ashtu, vazhdojnë të kenë ankesa të dukshme, veçanërisht për krijuesit e politikave arsimore. Bazuar në perceptimin e arsyeshëm që shkolla apo shoqëria civile, aktivitetet qytetare të tyre, *debatet i kanë përqendruar në vite në aftësi që lidhen me votën, votimin, pjesëmarrjen e këtyre target-grupeve vunerabël, dhe më pak është bërë për të futur në edukimin e gjeneratave të reja edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm, vullnetarizmi dhe bamirësia humaniste, në mënyrë që përmes tyre të mund të sigurojmë qëndrueshmërinë e shoqërive demokratike.* Problemi i madh mbetet:

A do edukojmë qytetarë të “mirë” e të bindur, apo qytetarë aktiv e të “rebeluar”?

“Rrallëherë qëllon që prindërit t’i shtyjnë fëmijët të zgjedhin modelin e tyre të suksesit, duke u mjaftuar, në përgjithësi, t’u diktojnë vijën e tyre. Edhe orientimi shkollor e universitar, thuajse kudo i shkatërruar, nuk ndihmon aspak në zbulimin e gjenialitetit specifik që fle te gjithkush...¹⁷”

Ndaj prodhimi i kurrikulave fleksibile në varësi të: a) **moshës**, b) **nevojave**, c) **standardeve** përbën një problem kyç të procesit edukativ në nivele institucionale.

Referuar kohëzgjatjes së mundësisë për reformim të kurrikulave, një model të së cilës na e jep programimi 10-vjeçar i edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm, DESD, 2005-2014, rëndësi kanë disa hapa:

17. Jacques Attali, “Të bëhesh vetvetja”, botim Green Tech, 2015, fq. 161.



1. *Analiza bazuar në studime mbi efektshmërinë e mendimit dhe veprimin qytetar në vend, cilësinë e qytetarisë.*
2. *Krahasimi për t'u përfshirë edhe në zhvillime globale të këtyre analizave.*
3. *Debati i hapur akademik dhe me shoqërinë civile.*
4. *Politikbërja me transparencë.*
5. *Feed back-u publik.*
6. *Monitorimi në zbatim.*
7. *Fuqizimi përmes sistemit të karrierës profesionale të mësuesve.*
8. *Mbështetje nga tregu i hapur i teksteve shkollore mbi këto formime.*

A mund të pohojmë se sot ka standarde të konceptimit të "Qytetar i mirë" si premisë për prodhimin e "Kapitalit human", që paraprin zhvillimet e qëndrueshme në demokraci?

Pas përcaktimit të Dekadës së Edukimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm kemi një konceptim shumë më me vlera dhe të axhenduar të cilësive të qytetarit të mirë, që shfaqet përmes tre dimensioneve:

1. **ndërgjegjësimit** për zhvillimin e qëndrueshëm;
2. **inteligjencës** në gjykim e vlerësim;
3. **vetëkontrollit** në veprim.

Kur flasim për ndërgjegjësim, pranojmë se hap pas hapi, institucion pas institucioni me të cilin hyn në ndërveprim gjatë jetës, për të gjitha grupet sociale, duke filluar nga familja, duhet të realizojmë një rend të drejtësisë dhe lojalitetit të bashkëveprimit mes nesh, për sot dhe brezat e ardhshëm. Nisur nga debatet dhe blogjet e panumërta që lidhen me cilësitë qytetare, në vitin 2012, kemi një renditje (jo sipas rëndësisë, por sipas shprehjes) të këtyre cilësive:

1. **I shëndetshëm:** Vetëm një trup i shëndetshëm mundëson një mendje të shëndoshë. Një qytetar i mirë është i fuqishëm dhe i shëndetshëm. Ai është i kujdesshëm në lidhje me rregullat e shëndetit dhe i vëzhgon në mënyrë kërkuese.
2. **Inteligjenca dhe arsimimi:** Një qytetar i mirë duhet të zotërojë një shkallë inteligjence të mjaftueshme për të dalluar të mirën nga e keqja dhe të marrë në sy riskun në zgjidhjen e çdo problemi. Edukimi i tij duhet t'i mundësojë që të luajë rolin e tij në shoqëri, në mënyrë të suksesshme dhe të dobishme.
3. **Vetëkontrolli dhe vetëbesimi:** Një qytetar i mirë është i matur në temperamentin

dhe ushtron vetëkontrollin në marrëdhëniet e tij publike. Ai zotëron një karakter të disiplinuar dhe beson tek ajo që është.

4. **Shpirti publik:** Një qytetar i mirë është i gatshëm për t'i marrë si një interes jetësor të gjitha çështjet publike. Ai është i përgatitur për të luftuar për të drejtat e të tjerëve dhe merr pjesë aktive në të gjitha aktivitetet publike.
5. **Vetësakrifica:** Një qytetar i mirë vartëson interesin për veten e tij në interes të komunitetit. Ai është i mbushur me frymën e shërbimit dhe përkushtimit ndaj të mirës së përbashkët.
6. **Ushtrimi i ndershëm i ekskluzivitetit:** Një qytetar i mirë është menduar të jetë i sinqertë në ushtrimin e votës së tij. Vetëinteresi ose interesi sektorial i shtetit, klasës, fesë apo komunitetit etj., nuk tenton të korruptojë gjykimin e tij në ushtrimin e ndershëm të ekskluzivitetit.
7. **Performanca e sinqertë e përgjegjësi:** Një qytetar i mirë kryen përgjegjësitë e tij sinqerisht dhe me besnikëri. Ai bashkëpunon me zyrtarët e shtetit në kryerjen e detyrave të tyre dhe bën pagesën e duhur të tatimeve.
8. **Rregulli i drejtësisë përmes luajalitetit:** Qytetaria e mirë ekziston dhe shprehet përmes luajalitetit. Një shtetas është anëtar i grupeve të ndryshme sociale dhe këtë, rregulli i drejtësisë, e shpreh përmes luajalitetit në familje, lagje, qytet, shtet dhe botë.

Të shohim njërin prej studimeve amerikane që vlen edhe për objektivat që EZHQ-ja vendosi në raport me shtetet, sistemin e tyre të edukimit, qytetarët aktiv të cilët do të përfshiheshin në një edukim që do të promovonte lidhjen që **vlerat njerëzore kombëtare janë trashëguar dhe fituar nga komunikimi me botën.**

Modeli mund të ofronte standardet që duhet të konsideroheshin burim, por edhe tregues për cilësinë e edukimit për vendet që do përfshiheshin në EZHQ, pra edhe të Shqipërisë. Sondazhi është realizuar në shoqërinë amerikane me një kampionim prej 600 individësh.

Ky projekt nxorri para shoqërisë amerikane nevojën e ndryshimit të kurrikulës shkollore në lidhje me edukimin dhe formimin e njeriut të shekullit të ri. Nëse ndjek me vëmendje rezultatet e këtij studimi, diferencat mes brezit të vjetër dhe brezit të DosNet-save nuk janë shumë të mëdha, por gjithsesi ka një lloj diference që çon drejt një risku në krijimin e qytetarit të mirë.

Nevoja për të parandaluar këtë risk solli një rikonceptim të plotë të sistemit edukativ.



Ja rezultatet:

Tabela 2.¹⁸

Çfarë të bën një “qytetar i mirë”?			
(studim amerikan)			
Nr.	Shprehja e sjelljes qytetare	DotNets-at_PO	Brezat e tjerë_PO
1	Zbatues i ligjit	87 %	95 %
2	Merr pjesë në votime	66 %	83 %
3	Të vëmendshëm ndaj politikës dhe qeverisë	54 %	78 %
4	Kontaktojnë me zyrtarët dhe deputetët e zgjedhur për çështje dhe probleme të ndryshme	48 %	67 %
5	Vullnetarizmi në ndihmë të të tjerëve	49 %	59 %
6	Të dhurosh para në ndihmë të të tjerëve	35 %	46

Siç shihet, dimensionin e kërkuar për “Kapitalin human” shprehet në formime të filozofisë morale, psikologjisë, sociologjisë, shëndetit fizik e mendor, jurisprudencës etj. Pas këtij studimi, politikat qeverisëse u angazhuan në ribërjen e pothuaj të gjitha kurrikulave shkollore, me synim rigjetjen e modelit të duhur edukativ për qytetarin e shekullit të ri.

I jam kthyer këtij instrumenti të vlerësimit të këtij studimi duke dashur ta pranoj si **standard tregues** për të përcaktuar sadopak se ku u adresua ndryshimi i pritur nga reformat që edukimi shqiptar do të ndërmerre pas detyrave të UNESCO-s për dekadën 2005-2014 për EZHQ-në, për brezin e DosNet-save shqiptarë. *Ky instrument synon për të vlerësuar se sa priremi në filozofitë tona në edukim apo politikat në arsim që të respektojmë standardet burim të EZHQ-së.* Sigurisht, i realizuar në 2014-ën, vit kur përmbylleshin objektivat e 10-vjeçarit të EZHQ-së, studimi duhet të përfaqësonte një standard tregues për EZHQ-në në Shqipëri. Në fakt, ai mbetet një standard burim prej nga ku edukimi shqiptar ende duhet të rimendojë veten.

Le t’i krahasojmë rezultatet e këtij studimi me studimin e realizuar me nxënës dhe qytetarë të Tiranës¹⁹ (të brezit DotNets, 15 - 26-vjeçar).

18. **What Makes a Good Citizen?** By Kurtz, K., Rosenthal, A., Zukin, C., “Citizenship, A Challenge for All Generations”, © 2003 by the National Conference of State Legislatures, p. 7. (The survey was conducted August 1 - 25, 2003. The sample was stratified to over-sample the DotNets-those who are 15 through 26 years of age. Our goal was to interview representative samples of DotNets and their older cohorts in the American public. We interviewed 632 respondents in the 15 to 26 age group and a companion sample of 654 in the over-26 age group.)

19. Rezultatet e sondazhit (Çfarë të bën një “qytetar i mirë?”) të realizuar me 300 nxënës të shkollave të mesme në tri vite dhe 300 qytetarëve të moshës 18-26 vjeç. Shtojca 1.

Tabela 3.

Çfarë të bën një “qytetar i mirë”?		
Rezultate bazuar në perceptimin e nxënësve të vitit të parë gjimnaz		
Renditja 1-6	Cilësitë qytetare	Shumica e përcaktuar nga të intervistuarit sipas çdo cilësie
1	Zbatimi i ligjit	73.3%
2	Vullnetarizmi në ndihmë të të tjerëve	43.3%
3	Të dhurosh para në ndihmë të të tjerëve	43.3%
4	Kontaktojnë me zyrtarët dhe deputetët e zgjedhur për çështje dhe probleme të ndryshme	46.7%
5	Të vëmendshëm ndaj politikës dhe qeverisë	50%
6	Merr pjesë në votime	63.3%

Tabela 4.

Çfarë të bën një “qytetar i mirë”?		
Rezultate bazuar në perceptimin e nxënësve të vitit të dytë gjimnaz		
Renditja 1-6	Cilësitë qytetare	Shumica e përcaktuar nga të intervistuarit sipas çdo cilësie
1	Zbatimi i ligjit	80.6%
2	Vullnetarizmi në ndihmë të të tjerëve	54.8%
3	Të dhurosh para në ndihmë të të tjerëve	38.7%
4	Kontaktojnë me zyrtarët dhe deputetët e zgjedhur për çështje dhe probleme të ndryshme	41.9%
5	Të vëmendshëm ndaj politikës dhe qeverisë	25.8%
6	Merr pjesë në votime	35.5%

Tabela 5.

Çfarë të bën një “qytetar i mirë”?		
Rezultate bazuar në perceptimin e nxënësve të vitit të tretë gjimnaz		
Renditja 1-6	Cilësitë qytetare	Shumica e përcaktuar nga të intervistuarit sipas çdo cilësie
1	Zbatimi i ligjit	78.4%
2	Vullnetarizmi në ndihmë të të tjerëve	67.6%
3	Të dhurosh para në ndihmë të të tjerëve	40.5%
4	Kontaktojnë me zyrtarët dhe deputetët e zgjedhur për çështje dhe probleme të ndryshme	29.7%
5	Të vëmendshëm ndaj politikës dhe qeverisë	48.6%
6	Merr pjesë në votime	32.4%



Duke analizuar rezultatet e mësipërme kemi:

Në nxënës të vitit të parë rezultojnë shprehja "Zbatimi i Ligjit", me 73.3%. Shprehja "Marr pjesë në votime" kap vlerësimin e 63% në një kohë kur, bazuar në ligjin shqiptar, kjo grup-moshë ende nuk e ka kapur cakun zyrtar të moshës të marrjes pjesë në votime, ndonëse e rendit të dytën për nga rëndësia.

Në vitin e dytë kemi një renditje tjetër: 80.6% rendisin të parën "Zbatimi i ligjit", në vend të dytë rezultojnë shprehja e "Vullnetarizmit" me 54.8%, ndërkohë që vërehet një rënie në shprehinë "Pjesëmarrjes në votime" dhe "Të vëmendshëm ndaj politikës dhe qeverisë". Kemi diferencë të madhe mes renditjes 1(80.6%) dhe 2(54.8%).

Në vitin e tretë, situata ndryshon: në vend të parë rezultojnë "Zbatimi i ligjit" me 78.4%, "Vullnetarizmi në ndihmë të të tjerëve" listohet i dyti me 67.6%, ndërkohë që "Merr pjesë në votime" bie me 32.4%.

Çfarë vërehet në këto rezultate?

Qartazi shënohet shprehja "Zbatimi i Ligjit" si shprehja kryesore (madje e vetme) e një qytetari të mirë. Pra, **për DotNets-at tanë të gjimnazeve, të jesh qytetar i mirë mjafton të zbatosh ligjet.** "Pjesëmarrja në votime" sërish vlerësohet, por kurrsesi në nevojat që paraqet kjo shprehje qytetare. Ndërsa, çuditërisht, për shprehjet e tjera kemi shumë vlerësime.

Pse ndodh kjo?

- ***Sepse nxënësit tanë nuk e kanë të formuar që në familje kulturën e të qenit i lirë në mendime.*** Ndaj një pjesë e madhe e tyre përpiqen të japin përgjigjet që i afrojnë më shumë me interesat e atyre që i zhvillojnë këto pyetje. Kjo sjell realisht një marzh gabimi në përgjigje. Kjo sjellje ndaj vlerësimeve në sondazhe duket më pas, kur sondazhin e shoqëron me fokus-grupe dhe ku rezultatet nuk janë fort të përputhshme me sondazhin e kryer. Ndoshta kjo mungesë kulture, sjellje e trashëguar, bën që edhe rezultatet e sondazheve në vendin tonë të kenë marzh të lartë gabimi.
- ***Sepse nxënësit nuk kanë një qartësi konceptuale në lidhje me qytetarin e mirë,*** ndaj vlerësojnë vetëm zbatueshmërinë ligjore si elementin apo cilësinë bazë të këtij qytetari.

Me po këto kategori (target grup) dhe me këto pyetje, kam realizuar fokus-grupe. Teknika e investigimit me fokus-grupe përfshin diskutimin e organizuar mes individëve

(Merton & Kendall, 1946). Pjesëmarrësit mund të kenë eksperiencë ose opinione specifike rreth çështjes së investiguar, fakt ky që i parashtron kërkuesit shkencor që t'i zgjedhë me kujdes ato. Prandaj, kërkuesi duhet të jetë më shumë realist kur përshkruan atë çka pjesëmarrësit mendojnë, pasi ato reflektojnë opinionet e tyre, por edhe mund të ndryshojnë opinionet e tyre (Bryman, 2008). Rezultatet kanë qenë të ndryshme.

Nga fokus-grupet, shprehi të tilla si “Vullnetarizmi” apo “Dhurimi ndaj të tjerëve” gjykohen më së shumti si anakronizma të “kohës së Enverit”, por ndërkohë këto shprehi janë vlerësuar në sondazh maksimalisht. Kjo dëshmon se nxënësit, edhe kur i rendisin teorikisht në vlerësime të larta shprehite e një qytetari të mirë, e bëjnë këtë sepse “duhet” ta bëjnë për të qenë në “dukje” të pritshmërive që kërkohen në këto raste, por nuk kanë një bindje të vërtetë në lidhje me to.

Mangësi të konceptimeve mbi qytetarin e mirë i vërejmë edhe në renditjen që u kanë bërë nxënësit shprehive të qenurit i tillë, pra “qytetar i mirë”. Vlen të theksohet se ***të gjithë nxënësit e anketuar nuk kanë zhvilluar filozofi në shkollën e mesme.***

Le të pasqyrojmë rezultatet e këtij sondazhi me studentët e Degës së Filozofisë, të vitit të tretë, Bachelor, në vitin akademik 2013-2014.

Tabela 6.1

“Çfarë të bën një qytetar i mirë?”						
Rezultate bazuar në perceptimin e studentëve të vitit të tretë, Filozofi						
	Zbatimi i Ligjit	Merr pjesë në votime	Të vëmendshëm ndaj politikës dhe qeverisë	Kontaktojnë me zyrtarët dhe deputetët e zgjedhur për çështje dhe probleme të ndryshme	Vullnetarizmi në ndihmë të të tjerëve	Të dhurosh para në ndihmë të të tjerëve
1	80.0	8.33	1.67	1.67	8.33	0.0
2	11.67	20	23.33	5	35.0	5.0
3	0	35.0	15	16.67	13.33	13.33
4	6.67	23.33	18.33	20.0	30.0	8.33
5	1.67	10	23.33	21.67	11.67	31.67
6	0	3.33	18.33	35.0	1.67	41.67
	100	100	100	100	100	100

Bazuar në tabelën 6.1, ndër shprehite e sjelljes:

Mesatarja më e vogël, domethënë, konsiderohet si më e rëndësishmja edhe në mesatare, tek “Zbatimi i Ligjit”. “Merr pjesë në votime” dhe “Vullnetarizmi në ndihmë të të tjerëve” konsiderohen pothuajse të 3-ta në vlerësimin mesatar për nga rëndësia. “Të vëmendshëm



ndaj politikës dhe qeverisë”, si shprehi, ka një mesatare pothuajse 4, për nga rëndësia. “Kontaktojnë me zyrtarët dhe deputetët e zgjedhur për çështje dhe probleme të ndryshme” dhe “Të dhurosh para në ndihmë të të tjerëve” konsiderohen mesatarisht si të pestët për nga rëndësia.

Mendimi për rëndësinë e “Zbatimi i ligjit” si shprehi qytetare është më heterogjen (ka luhatshmëri më të madhe të renditjes së rëndësisë për këtë shprehi) – koeficienti i variacionit është 0.566.

Mendimi për rëndësinë e “Të dhurosh para në ndihmë të të tjerëve” si shprehi qytetare është më homogjen (ka luhatshmëri më të vogël) të renditjes së rëndësisë për këtë shprehi) – koeficienti i variacionit është 0.249. Pra, në një format të ngjashëm me studimin e parë kemi këtë përfundim:

Tabela 6.2

Çfarë të bën një “qytetar i mirë”?						
Studentët						
	Zbatues i Ligjit	Pjesëmarrës në votime	Vëmendje politik qeveri	Kontakti Zyrtar Deputet	Vullnetarizmi	Dhuro para
Valid	60.0	60.0	60.0	60.0	60.0	60.0
Missing	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Mean	1.32	3.17	3.39	4.6	3.07	4.92
Std. Deviation	.748	1.21	1.494	1.343	1.274	1.225
Variation Coef.	.566	.381	.38	.292	.414	.249

Sikundër shihet, kemi një qartësi të konsiderueshme mendimi të studentëve të filozofisë në formimin e një qytetari të edukuar të shekullit XXI e që krahasimisht ngjan me modelin e kërkuar nga OKB-ja.


Ka dhe një detaj që duhet nënvizuar: pjesa më e madhe e tyre nuk kanë bërë filozofi në shkollën e mesme.

Sikundër shihet, edukimi me Filozofinë e bën të dukshme diferencën e një edukimi me cilësitë e qytetarit të kohës postmoderne, të gatshëm për të kuptuar nevojën e një zhvillimi të qëndrueshëm. Megjithëse pretendimi për të patur “qytetarë të mirë” nën përgjegjësi do të na duhet më së pari, të mundësojmë të krijojmë, edukojmë “Lirinë” si premisë të parë dhe të fundit në procesin e edukimit. Ky përfundim vjen sërish pas ballafaqimit të sondazhit me fokus-grupe, ku rezultatet e fokus-grupit sërish nuk kanë përputhshmëri të plotë me sondazhin²⁰.

Tani le të bëjmë krahasimin me grup-mosha të brezave të rritur.


20. Fokus-grupet janë ndërtuar me studentë të cilët kanë realizuar sondazhin me po të njëjtat pyetje.

Grafiku 1. Analizë e krahasuar e rezultateve të sondazhit mbi shprehitë qytetare për të qenë “qytetar i mirë”, me qytetarë të Tiranës.



Le t'i krahasojmë këto të dhëna me rezultatet e studimit me studentët.

Grafiku 2. Analizë e krahasuar e rezultateve të sondazhit mbi cilësitë qytetare që na nevojiten për të qenë “qytetar i mirë”, realizuar me qytetarë të Tiranës dhe studentët.



Sikundër shihet, në shoqërinë shqiptare, edhe pse me shumë mungesa në kulturën politike, sërish gjejmë diferenca mes brezit të rritur me studentët.

Ajo që të bie në sy është fakti se të rinjtë janë më shumë të angazhuar të marrin pjesë në votime, duke e konsideruar këtë cilësi qytetare. Ky rezultat na çon të mendojmë për dy shkaqe: a) **të rinjtë kanë kuriozitetin** që votojnë për herë të parë, b) **të rriturit kanë patur përvoja zhgënjyese** në procesin e drejtimit të votës së tyre, ndaj dhe e shikojnë në përqindje më të ulët pjesëmarrjen në votime.



E njëjta gjë duhet thënë edhe për cilësinë "Zbatimi i ligjit". Por është për t'u vlerësuar fakti se zbatimi i ligjit konsiderohet si cilësi e parë e një qytetari të përgjegjshëm. Diferenca të konsiderueshme gjejmë në cilësitë e tjera qytetare mjaft të rëndësishme, sikundër janë vullnetarizmi apo të dhurosh ndihma. Këto rezultate na flasin për një qasje të një sjellje me tendenca individualiste që po formatohen tek të rinjtë.

Ajo që të bën përshtypje është se në fokus-grupe me të rritur, përgjigjet e tyre përputhen pothuaj plotësisht me përgjigjet për pyetëtorët.

Gjithsesi, duke marrë marzhin e gabimit me 3% dhe duke iu referuar fokus-grupeve të të rinjve dhe të të rriturve mund të konkludojmë se: brezi i ri ka një qasje jo fort të mirë me "Lirinë" e mendimit dhe me të vërtetën. *Kjo tregon për një sistem edukativ të formuar mbi baza sipërfaqësore të një edukimi jo të qëndrueshëm.*

Krahasimi me studimin amerikan, ku diferencat mes grupeve nuk ishin kaq të mëdha, por sollën nevojën e rikonceptimit të sistemit edukativ, na bën të shikojmë me shumë përparësi nevojën e rishikimit të kurrikulave tona edukuese, pasi rezultatet na e diktojnë këtë.

I. 2/2 Filozofia si instrument i rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm, sipas organizmave ndërkombëtarë

United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO), pjesë e bashkësisë së United Nations, është një organizëm ndërkombëtar dedikuar edukimit, shkencës dhe kulturës. Filozofia ka qenë gjithmonë pjesë integrale e UNESCO-s. Ajo ka inspiruar në një masë të konsiderueshme Kushtetutën e saj dhe, që prej vitit 1945, UNESCO ka në përmbajtjen e saj një program filozofie. Prania e filozofëve të mëdhenj, si Jean-Paul Sartre, Emmanuel Mounier and Alfred J. Ayer në Konferencën e Përgjithshme të Organizatës, mbajtur në Sorbonne, bindshëm dëshmon rëndësinë që kjo disiplinë dhe praktikuesit e saj e paraqesin për organizatën.

Në fillim të vitit 1950-të, në sesionin e saj të pestë, Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, iu dedikua zhvillimit të një kërkimi në vendet ku mësohej filozofia në disa institucione arsimore, mbi mënyrën se si ajo mësohej, si dhe influencën e saj mbi modelimin e individëve. Zhvilluar në një hark kohor 2-vjeçar (1951-1952), ky studim trajtoi mënyrën e mësimdhënies së filozofisë, dhe veçanarisht, vendin që zinte ajo në sistemin arsimor në vende të ndryshme, mbi rolin e saj në modelimin e shoqërisë,

si dhe rëndësinë e supozuar të saj në nxitjen dhe përmirësimin e mirëkuptimit mes njerëzve. Në vitin 1978, vendet anëtare i kërkuan UNESCO-s të zhvillojë një studim lidhur me filozofinë e mësimdhënies dhe kërkimin filozofik në çdo vend të botës. Për rajonin e Afrikës, një mbledhje filozofësh u organizua në Nairobi, Kenia, në qershor të vitit 1980 e cila çoi në një sërë rekomandimesh me rëndësi dhe të shumëdëshiruar për filozofinë në Afrikë. Pjesëmarrësit vunë theksin te një numër problemesh lidhur me filozofinë, atë të mësimdhënies dhe kërkimin filozofik në Afrikë.

Për rajonin e Paqësorit – Azisë, një mbledhje filozofësh u mbajt në shkurtin e vitit 1983 në Bangkok, Tajland. Ky takim u fokusua veçanërisht në profesionalizimin e filozofisë dhe nxorri në pah lidhjen e fortë që ekzistonte mes filozofisë, fesë dhe historisë. Gjithashtu, ky takim nxorri në pah nevojën imediate për të rivendosur një linjë komunikimi mes sociologëve dhe filozofëve, në mënyrë që të reduktojë hendekun mes këtyre dy disiplinave dhe për të lejuar një shkëmbim të frytshëm në kuptimin e problematikave shoqërore.

Për rajonin e Amerikës Latine dhe Karaibet, një mbledhje ekspertësh u mbajt në qershorin e vitit 1985 në Lima, Peru. Ekspertët informuan UNESCO-n lidhur me një sërë kërkesash, si: përgatitja e një studimi ndërdisiplinor lidhur me marëdhëniet e filozofisë me shkencat e tjera, si ato: ekzakte, natyrore, sociale dhe humane; promovimi i studimeve mbi historinë e mendimit dhe influencës së tyre; promovimin e një biografie bashkëkohore të filozofisë në Amerikën Latine dhe Karaibe; nxitja për pjesëmarrje e filozofëve nga Amerika Latine dhe Karaibet në revistën “Diogène” dhe nxitja e përkthimit të punimeve filozofike (nga/në spanjisht dhe portugalisht).

Për rajonin e Arabisë, një mbledhje filozofësh u mbajt në Marrakech, Marok, korrikun e vitit 1987. Tema e kësaj mbledhje ishte “Mësimdhënia dhe kërkimi në filozofi në Botën Arabe”. Ky takim arriti të ofrojë një portretizim të detajuar të mësimdhënies dhe kërkimit filozofik në disa vende të Botës Arabe. Kjo mbledhje rezultoi mjaft efektive në identifikimin e disa filozofëve me impakt në filozofinë e rajonit, duke diskutuar veprën dhe influencën e saj në sistemin arab. Ashtu si dhe takimet e mëparshme, kjo mbledhje u konkludua me sugjerime për UNESCO.

Për rajonin e Evropës, gjetjet nga takimet e ekspertëve u materializuan në një punë filozofike, publikuar në Evropë në vitin 1993 në bashkëpunim me International Institute of Philosophy (IIP) dhe International Council for Philosophy and Humanistic Studies



(ICPHS). Ky studim i gjerë u fokusua në përshkrimin e situatës aktuale të filozofisë në Evropë. Ai përmban të dhëna për çdo vend, trendet kryesore dhe problemet më shqetësuese lidhur me filozofinë. Një element i rëndësishëm i përfshirë ishte dhe analiza e qarkullimit të mendimit kritik, e cila ende haste barrierat kombëtare dhe kulturore, duke çuar në një mungesë shkëmbimi efektiv.

Në vitin 1994, UNESCO dëshironte të thellonte hulumtimin e nisur në 1951-shin. Me idenë e hapjes së një forumi të ri debati lidhur me rolin e filozofisë në kulturën dhe formimin e mendimit të lirë qytetar, studimi i ri i zhvilluar nga Roger-Pol Droit përfshinte kontribute nga figura të rëndësishme nga 66 vende. Në 1995-ën, UNESCO organizoi "Ditën Ndërkombëtare" në Paris, nga ku dhe rezultoi Deklarata e Parisit për Filozofinë (Paris Declaration for Philosophy). Pas vitit 1995, programi i filozofëve të UNESCO-s do të ndiqej nga krijimi i rrjeteve rajonale, veçanërisht aktive në Azinë Juglindore, Evropë, Amerikën Latine dhe Karaibe, si dhe Afrikë.

Ne jemi pjesë e një bote në ndryshim të vazhdueshëm, ku dinamizmi dhe kompleksiteti shoqërojnë çdo aktivitet në të përditshmen tonë. Ne jemi pjesë e fshatit të madh global, ku kufijtë dhe barrierat kulturore janë thjesht pjesë e axhendave të politikave nacionale. Sot jetojmë në botën e internetit, aty ku informacioni merr dimension tjetër, duke u shndërruar shpeshherë në armën më të fortë të njeriut. Kanë qenë pikërisht rrjete sociale dhe forume të ndryshme që kanë ftuar njerëzit në bashkim, revolucionet kanë marrë jetë dhe kanë pasur ndryshime radikale. Me po të njëjtat ritme po ndryshon dhe mësimdhënia e filozofisë dhe kërkimi filozofik. Tashmë kërkohet një mënyrë e re të menduari, qasur me ndryshimet në fshatin global. "Nuk mjafton të luftojmë analfabetizmin: ne gjithashtu duhet të dimë librat që duhen lexuar. Nuk mjafton që të punojmë bashkë në kërkime shkencore, çdokush duhet ta kuptojë që vlera e vërtetë e shkencës, më tepër se sa në aplikimin e saj, qëndron tek emancipimi i mendjes njerëzore dhe krijimi i një bashkësie të gjerë spirituale përtej klaneve apo perandorive.²¹" Për një qëllim të tillë, në vitin 2007 u mbajt një tjetër studim që thellonte punën e bërë deri atëherë nga UNESCO.

Një analizë e mendimit dhe mësimdhënies filozofike sot, e parë në këndvështrimin e kërkesave që vetë UNESCO ka shtruar për debat, por edhe për reflektim ndërkombëtar, fokusohet në katër elemente kryesore:

21. Memorandum on the philosophy program of UNESCO, June 1946.

1. *Filozofia në moshë të kuriozitetit, mësimi i saj në grup-moshat parashkollore dhe fillore.*
2. *Filozofia në moshën e pyetjeve, mësimi i saj në shkollën e mesme.*
3. *Filozofia në studimet universitare.*
4. *Zbulimi i filozofisë ndryshe – aplikimi i saj në botën reale.*

Këto katër nivele përfaqësojnë realisht dhe udhëtimin e një individi nën një edukim filozofik për një zhvillim të qëndrueshëm. **Është e dukshme se nevoja për një strategji të re të edukimit filozofik buron në radhë të parë nga problematikat që zhvillimi ekonomik dhe zhvillimi teknologjik në nivele globale kanë vënë për zgjidhje para shoqërisë.** Globalizmi po prodhon në mënyrë të shpejtë nevojën për një riformatim të qyteteve inteligjente, ku edukimi filozofik zë pa dyshim një vend të rëndësishëm. *Sfida e shekullit XXI, me të gjitha problematikat që ky shekull mbart, kërkon pa hezitim gjetjen e modeleve sa më efektive me edukimin filozofik si edukim me konceptet bazë të Lirisë, Drejtësisë dhe Solidariteti njerëzor. Vetëm me një kapital human efektiv dhe të investuar, sfidat do mund të përballohen në rrugën drejt zhvillimit të qëndrueshëm.*

KAPITULLI II

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE QYTETET INTELIGJENTE

II.1 “SMART CITY”, “QYTETI INTELIGJENT” DHE EDUKIMI FILOZOFIK

Zhvillimi i qëndrueshëm ka nxjerrë në plan të parë funksionimin e konceptit “Smart city”.

Po çfarë përfaqëson “smart city”?

Si çdo koncept tjetër, edhe ky koncept ka evoluar në periudha shumë të shkurtra. Në fillim, duke u lidhur me erën dixhitale, koncepti u identifikua me “qytetin dixhital”. Më tej, u konkludua se qyteti dixhital pa organizimin social nuk mund të quhej inteligjent. Sot ka përfshirë edhe nevojën e shoqërisë për të jetuar më mirë e me cilësi.

Pra, kërkohet edhe një mjedis natyror, politik, social dhe edukativ që të lehtësojë dhe të kënaqë pritshmëritë e njeriut të postmodernizmit. Megjithëse nuk ka një përcaktim përfundimtar të qytetit inteligjent, përmbajtja e tij tashmë është pothuaj e përcaktuar:

- Logjika e “smart city” bazohet në nevojën për të jetuar në një qytet “ideal”, në një kohë kur qytetet vetë po shndërrohen në super qytete. Në radhë të parë, logjika e “smart city” bazohet në konceptin e qëndrueshmërisë.
- Teknologjia, projektet dhe politikat shkojnë drejt një ideje: e ardhmja është e garantuar nëse ka rrënjë të forta tek e sotmja dhe e djeshmja. Kjo do të thotë që shoqëria duhet të njohë mirë të kaluarën (në kuptimin e përgjithshëm, me synim njohjen e dobësive, gabimeve dhe mosrealizimeve) që të ndërtojë politika të nevojshme për të tashmen, në mënyrë që të sigurojë vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e zhvillimit.
- Në një qytet inteligjent kërkohen të minimizohen kërkesat e thjeshta (minimale) dhe të tentohet drejt përmbushjes së kërkesave të larta të shoqërisë.
- Qyteti inteligjent duhet të jetë një model urban, i aftë të drejtojë dhe garantojë një cilësi në rritje të jetës sociale dhe individuale, duke vënë në eficiencë të gjitha



resurset natyrore e humane.

- Qyteti inteligjent duhet t'i japë përgjigje nevojave në rritje të shoqërisë dhe individëve të saj. Ndaj lipset një qeverisje inteligjente.
- Suksesi i qytetit inteligjent është i lidhur ngushtë me teknologjinë, mjedisin dhe burimet njerëzore. Këto të fundit mbeten objekti i qenësishëm në realizimin e “Smart city”-it.

Si ka ndryshuar në pak vite koncepti mbi qytetin inteligjent?

Tabela 7. Ndryshueshmëria e konceptit “Smart City”

në periudhën e viteve 2000-2010.

Viti 2000	Mesi i viteve 2000	Nga vitit 2010
“Smart city” si qyteti dixhital	“Smart city” si qytet i përfshirjes sociale	“Smart city” si cilësi e jetës
ICT (information communication technologies)	Kapitali human, përfshirja qytetare	Qeverisje, mjedis, shërbime qytetari, cilësi jete

Sikundër shihet, evoluimi në përmbajtjen e konceptit “smart city” çon në disa përfundime:

1. Po jetojmë në një periudhë ndryshimesh gjigante, të cilat gjithnjë e më shumë fokusohen tek dy elemente: njeriu dhe teknologjia.
2. Të gjitha qasjet lidhen pa dyshim me individin tek i cili fokusohen nevojat dhe cilësia e jetës.
3. Nuk mund të realizohet një “smart city” pa një qeverisje “smart”, pa një administratë publike “smart”.
4. Nuk mund të ketë qytet inteligjent pa shoqëri inteligjente, kjo nga ana e saj do të kërkojë: më shumë qytetari, më shumë edukim, më shumë profesionalizëm.
5. Elementi më i qenësishëm i “smart city”-t është edukimi.
6. Edukimi filozofik merr në këto kushte një përmasë të re: edukimin me qytetarinë dhe aftësinë për të menduar, gjykuar dhe vepruar nga vetvetja.

II. 2 ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE SHQIPËRIA

“Ndërsa trajton nevojën për identitet simbolik në bllokun e ideve mbi imazhin e qytetit tek vepra e tij ‘Rënia e qytetit’ shprehet: Hapësira që është zhveshur nga identiteti i vet simbolik bëhet një zë deprimues për individin dhe kolektivitetin. Jeta nis dhe humb bukurinë e vet, stresi rritet dhe mjedisi bëhet përjashtues për njeriun. Vlera të tilla, si: patriotizmi, solidariteti kolektiv, humanizmi nuk mund të zhvillohen harmonikisht nëse mjedisi dhe hapësira nuk simbolizojnë edhe identitete të spikatura shpirtërore. Identiteti urban është një vlerë simbolike. Sado është materializuar në objekte të ndryshme, ai ka një kuptim simbolik, shpreh në radhë të parë një vlerë shpirtërore madhore²².”

Në 24 vitet pas ndryshimit të sistemit nga diktaturë në demokraci, Shqipëria në perceptimin popullor, ka ecur me një pasiguri dhe paqëndrueshmëri të dukshme. Kjo paqëndrueshmëri duket në një masë të madhe në reforma të vazhdueshme që kanë zëvendësuar njëra-tjetrën pa analizuar më parë rezultatet e sjella nga reforma paraardhëse. Shteti dhe politikat qeverisëse kanë treguar se janë larg perceptimit, por edhe kërkesave për një zhvillim të qëndrueshëm në shkallë vendi. Problemet e mëdha që bota ka shtruar për krijimin e një administrate publike “smart” me synimin e krijimit të një modeli të qëndrueshëm, duket se në kushtet e vendit tonë janë akoma larg ravijëzimit në politikbërje. Po i referohem një elementi, i cili konsiderohet si element kyç në konceptimin e “smart city”.

II. 2/a Administrata publike në zhvillimin e qëndrueshëm

Njëzet vite më parë, kur u mendua se globalizimi do të sillte dhe fundin e qytetit si koncept, as që mund të mendohej se jo vetëm nuk do të kishte fund, por përkundrazi qyteti i epokës globale duhej detyrimisht të ishte “inteligjent”. Kjo do të thoshte se, në qendër të tij do duhej të vihej individi me liritë e tij, me të drejtat dhe detyrat. “Smart city” kërkon detyrimisht “smart people” dhe “smart people” kërkojnë detyrimisht shërbime maksimale. Pra, “smart people” dhe “smart administration” është binomi trend i postkapitalizmit. Qytetet e së nesërme (brenda disa dhjetëvjeçarësh, 75% e popullsisë së botës do të jetojë në qytete) kërkojnë që individi inteligjent të krijojë

22. Fuga, A. “Rënia e qytetit”, ShB “Papyrus”, fq. 322.



disa marrëdhënie inteligjente me shoqërinë, me natyrën dhe me vetë punën e tij. Pra, po krijohen qytete, ku individit kërkon e tenton drejt shërbimeve, duke shfrytëzuar burimet në mënyrë racionale, duke shfrytëzuar informacionin në mënyrë efektive, duke realizuar të drejtat e tij dhe duke plotësuar nevojat.

Koncepti shërbim është në qendër të aktivitetit të qytetit inteligjent. Individët krijojnë me dhjetëra lidhje, rrjete e marrëdhënie, të cilat kanë në bazë shkëmbimin. Cilësia e këtij shkëmbimi varet nga dy elemente: *nevojat* dhe *mundësitë*. Individët të ndryshëm kanë nevojat të ndryshme dhe orientojnë shkëmbimin e tyre drejt këtyre nevojave. Ana tjetër është mundësia që ka në tregun e madh të shkëmbimeve, të maksimizohet shërbimi për nevojat.

Kur flasim për shërbime është e pamundur të mos adresosh problemin tek raporti qytetar administratë. Administrata publike është ajo që në një qasje të gjerë e të pashmangshme krijon një rrjet të madh shërbimesh të domosdoshme e të paevitueshme ndaj qytetarit. Një raport i zgjuar mes tyre krijon mundësinë e qëndrueshmërisë së zhvillimit. Cilësia e infrastrukturës së transmetimit dhe menaxhimit të të dhënave ndikon gjithnjë e më shumë në efikasitetin dhe eficiencën e shërbimeve të ofruara ndaj qytetarit. Administrata publike merr kështu një rol të shumanshëm dhe mjaft të rëndësishëm të ngritjes dhe realizimit të “smart city”.

Pse ndodh kështu?

Përgjigjja gjendet në rolin e saj si promotore e ndërhyrjeve dhe koordinimit të zhvillimit. Administrata publike realizon integrimin e iniciativave të ndryshme, furnizon me të dhëna dhe informacione sasiore e cilësore, është përgjegjësjë kryesore e ofrimit të shërbimeve në plotësimin e nevojave të “qytetarit inteligjent”, është subjekt financiar për shërbimet dhe suportin e tyre, madje mund të jetë dhe partner i subjekteve ose operatorëve të ndryshëm. Nuk është rastësi që administrata publike konsiderohet si një hallkë tejet e rëndësishme për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm.

Koncepti i “smart administration” në kontekstin e “smart city”

Në të vërtetë, koncepti i një administrate inteligjente përkon me konceptin filozofiko-politik të “open governance”.

“Open governance” është në fakt faza e tretë e një qasjeje të re që mori qeverisja si pasojë e përshtatjes me teknologjinë e re. Një ndër njohësit më të mirë të shoqërisë së rrjeteve të komunikimit, Manuel Castells, thotë se: “Interneti vendos në komunikim në

një Agora publike, njerëzit pa asnjë dallim, për t'i dhënë zë shqetësimeve të tyre dhe për të ndarë shpresat. Kontrolli i masave nëpërmjet kësaj Agore publike është ndoshta çështja më e rëndësishme e politikës, e krijuar nga zhvillimi i internetit.²³”

Çfarë solli një zhvillim i tillë i teknologjisë së komunikimit?

Solli pa dyshim nevojën e vendosjes së raporteve të reja ndërmjet qytetarit dhe shërbimeve ndaj tij. Nga ana tjetër solli nevojën për të gjetur dhe përshtatur format më të mira të mundësive që ofron teknologjia për qëndrueshmërinë e zhvillimin e vetë administratës publike. Rrjetet e internetit e kanë shndërruar përdoruesin e tij jo thjesht në një konsumator, por në një prodhues informacioni. Në internet realisht zhvillohet beteja e vërtetë për LIRI Reale. Duket si një lëvizje e tipit grassroot. Rrjetet sociale janë instrumenti, por edhe vendi ku realizohet komunikimi nga poshtë. Ky ndryshim radikal në komunikimin qytetar solli respektivisht nevojën që qeverisja të përdorë teknologjinë për të përmirësuar qeverisjen. Ndaj lindi një qasje e re, e cila njihet si: e-governance.

Përmbajtja e konceptit e-governance mund të përmblihet në këto drejtime:

- përdorim i informimit dhe komunikimit;
- cilësi në informim dhe shërbime të ofruara nga institucionet;
- rritje e mundësive të qeverisë për qeverisje më të mirë;
- lehtësim shërbimi për qytetarët.

Përhapja e shpejtë e këtij modeli u bë trendi i administratës publike. Por, mjaftuan disa vite për të parë rezultatin:

E-governance aq shumë e elaboruar në gjuhën politike dhe e praktikuar në qeverisjen Clinton, nuk solli plotësim të dukshëm cilësor të nevojave dhe shërbimeve ndaj qytetarit. Shkaku ishte i thjeshtë: u spostua në internet po ajo mënyrë e veprimit dhe komunikimit vertikal që sundonte edhe me parë! Pra, kishte ndryshuar teknologjia, por jo përmbajtja e mendimit dhe veprimit! Kështu, nuk mund të realizohej komunikimi real me qytetarin dhe pse informacioni përcillej më shpejt. Shoqëria e shekullit XXI nuk mundej më të zhvillohej me modelin e shekullit të 20-të! Kjo vlente edhe më shumë për administratën publike dhe institucionet. Nevoja për “smart administration” do të thoshte nevojë për një administratë “ndryshe”. Çfarë do ndryshonte në konceptin e “smart administration”? Thelbi i konceptit si shërbim ndaj qytetarit, kërkonte

23. Castells, M. “Communication power” Oxford University, 2009, p. 178.



një riformatim të formës dhe përmbajtjes së kësaj administrate. Ndaj dhe "smart administration" do të thotë:

- Zhvillim i qëndrueshëm në aktivitetin shërbyes dhe informues ndaj qytetarit.
- Administratorë të zgjuar dhe të "hapur" që me profesionalizmin dhe qytetarinë e tyre janë të aftë të shfrytëzojnë instrumentet më eficiente për të kryer misionin e tyre.
- Open data që siguron një riformatim të marrëdhënieve qytetar/qeverisje.

Në demokraci kërkohet përgjegjshmëri dhe llogaridhënia kërkon transparencë. Në demokracinë bashkëkohore, "Liria e Informacionit", e cila inkurajon llogaridhënien përmes transparencës, është shprehja më e rëndësishme e një angazhimi të thellë kombëtar, për të siguruar qeverinë e hapur (Open governance). Zemra e këtij angazhimi, sikundër ka pohuar Presidenti Obama, "është ideja se përgjegjësia duhet të jetë sa e administratës, aq edhe e qytetarit"²⁴.

Sikundër vihet re në thelbin e transformimit të administratës publike në modelin postmodern qëndron koncepti i lirisë dhe demokracisë bashkëpunuese. Në fakt, Liria si model mendimi dhe veprimi është shprehje reale e një demokracie funksionale. Por, e parë më vertikalisht, kjo qasje ka të bëjë më dy shtylla: nga njëra anë kërkon një administratë publike mjaft të aftë, jo thjeshtë profesionalisht, por të edukuar me një mënyrë të menduari dhe të vepruari mbi bazën e lirisë. Nga ana tjetër, kërkon një qytetar të edukuar me *lirinë si mënyrë mendimi e veprimi*. Në të dyja qasjet, **liria vjen detyrimisht si përgjegjësi**.

Dhe në të dyja qasjet problem mbetet një: Të gjenden të gjitha instrumentet që shërbejnë për të edukuar një mendim të lirë!

Natyrisht që edukimi filozofik ka, në këtë tërësi instrumentesh, rolin e vet parësor. Po e ripërmend nevojën e shoqërisë për këtë edukim filozofik, të shprehur nëpërmjet strategjisë së edukimit filozofik të përcaktuar nga UNESCO, nevojë që në rrafshin global ka marrë një shtrirje mjaft të gjerë.

24. B. OBAMA, Memorandum for the Heads of Executive Departments and Agencies on Transparency and Open Government, 2009, disponibile on-line all' URL: http://www.whitehouse.gov/the_press_office/Transparency_and_Open_Government

II. 2/b Administrata publike shqiptare në nevojën e shndërrimit në administratë inteligjente

Po, si paraqitet administrata publike dhe qeverisja në Shqipërinë e shekullit XXI?

Administrata publike në përmbajtjen, por deri-diku edhe në formën e saj, është ende shumë larg konceptit të një administrate eficiente. Kuadri ligjor që kornizon veprimtarinë e saj gjatë 25 viteve ka pësuar disa herë ndryshime të dukshme, që realisht kanë dëmtuar zhvillimin e saj të qëndrueshëm.

Departamenti i Administratës Publike (DAP) është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 443, datë 05.09.1994, si një njësi brenda strukturës së Kryeministrit, e cila në përputhje me programin e qeverisë do të kryente studimet, projektligjet dhe projektaktet. 2 vite më vonë miratohet ligji për shërbimin civil. Ligji Nr. 8095, datë 21.03.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, synoi t’i jepte fund politizimit të administratës, duke ngritur një shërbim civil të bazuar në meritat. Njëkohësisht, krijohet një ndarje mes funksioneve politike dhe atyre tekniko-profesionale, për të cilat mendohej të funksiononte sistemi i karrierës. Miratimi i këtij ligji u shoqërua edhe me Vendimin Nr.657, datë 16.09.1996 “Për rregullat e etikës në shërbimin civil”, qëllimi i të cilit synonte përsosjen e shërbimit civil shqiptar, si dhe forcimin e besimit dhe mbështetjes së publikut ndaj tij, duke përcaktuar rregulla të sjelljes së personave që punojnë në shërbimin civil.

Gjatë periudhës 1996-1999 u miratuan disa ndryshime ligjore dhe nënligjore, të cilat synuan zbatueshmërinë më të mirë të ligjit të shërbimit civil. Në vitin 1999, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, në 27 janar të vitit 2000, u krijua mundësia për fillimin e implementimit të një sistemi tërësisht të ndryshëm, në menaxhimin e burimeve njerëzore në institucionet e administratës qendrore, ato qendrore të pavarura dhe në njësitë e pushtetit vendor (bashki dhe qarqe). Ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, rikonfirmoi disa institucione që do të mbikëqyrnin zbatimin e reformës në shërbimin civil, duke i dhënë kompetenca të veçanta dhe të zgjeruara, të cilat nuk i kishin pasur më parë. Brenda një dhjetëvjeçari, administrata publike u duk sikur kompletoi të gjithë kuadrin e saj ligjor për të realizuar me efektivitet misionin e saj. Pavarësisht këtyre ndërhyrjeve, politizimi i administratës dhe sidomos mbushja e saj me militantë partiakë dhe jo profesionistë mbeti kritika më e fortë e të



gjitha raporteve të BE-së mbi të. Më 2012-ën hyn në fuqi Ligji për ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ADMINISTRATËS SHTETËRORE. Sërish, si pasojë e përplasjeve politike në vend, u kërkua ndryshimi i Ligjit për “statusin e punonjësit civil”. Pas shumë debatesh, në tetor të vitit 2013, u miratua Ligji i ri: LIGJI Nr. 152/2013 PËR NËPUNËSIN CIVIL, i cili shfuqizon një varg aktesh ligjore e nënligjore²⁵.

Vetëm një vit pas miratimit konsensual të këtij ligji, ky u ndryshua në disa nene dhe sërish është në fazë ndryshimesh. Të gjitha këto ndryshime në rrafshin ligjor, kanë krijuar një kuadër jo fort të qëndrueshëm të zhvillimit dhe funksionimit të Administratës Publike. Filozofia e këtyre ndryshimeve nuk bazohet në nevojën organike të zhvillimit të shërbimeve ndaj qytetarit, por në qasjen politike që i lehtëson subjektet politike të vendosin nën kontrollin e tyre administratën publike. Kjo mendësi e politikës shqiptare është vazhdim i psikologjisë dhe mentalitetit të trashëguar mbi shtetin dhe administratën publike. Pushteti e ka konsideruar administratën publike si pronën e vet, me të cilën garanton pushtetin.

25. 1. Ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “statusi i nëpunësit civil”.
2. Vendim nr. 231, datë 11.5.2000, “për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”.
3. Vendim nr. 221, datë 16.5.2002, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave “për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”, ndryshuar me vendimin nr. 196, datë 6.4.2001 të Këshillit të Ministrave.
4. Vendim nr. 838, datë 13.12.2006 për një ndryshim në vendimin nr. 231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave “për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”, të ndryshuar.
5. Vendim nr. 306, datë 13.06.2000 “për disiplinën në shërbimin civil”.
6. Vendim nr. 315, datë 23.06.2000 “për krijimin dhe funksionimin e institutit të trajnimit të administratës publike dhe trajnimin e nëpunësit civil”.
7. Vendim nr. 316, datë 23.06.2000 “për miratimin, në parim, të projektit ‘krijimi i institutit të trajnimit të administratës publike’, të financuar nga programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara”.
8. Vendim nr. 355, datë 07.07.2000 “për organizimin e dosjes për regjistrin e personelit”.
9. Vendim nr. 342, datë 14.07.2000 “për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të nëpunësit civil”.
10. Vendim nr. 360, datë 14.07.2000 “për lirin nga shërbimi civil”.
11. Vendim nr. 325, datë 21.2.2003 “për pozicionin, detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarit të përgjithshëm në ministri”.
12. Udhëzim nr. 1, datë 13.06.2000 “për strukturën e renditjes të punëve në shërbimin civil, metodologjinë përkatëse dhe përshkrimin përgjithësues të rolit të sekretarit të përgjithshëm në këtë shërbim”.
13. “Për strukturën e klasifikimit të punëve në shërbimin civil, metodologjisë përkatëse dhe përshkrimin përgjithësues të rolit të sekretarit të përgjithshëm në këtë shërbim”.
14. Udhëzim nr. 2, datë 07.07.2000 “për sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore individuale të nëpunësve civil”.
15. Udhëzim nr. 5, datë 19.12.2007 për disa ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 7.7.2000 të Këshillit të Ministrave “për sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore individuale të nëpunësve civil”.
16. Udhëzim nr. 6, datë 19.12.2007 për disa ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave “për strukturën e renditjes së punëve në shërbimin civil, metodologjisë përkatëse dhe përshkrimin përgjithësues të rolit të sekretarit të përgjithshëm në këtë shërbim”.
17. VKM nr. 173, datë 07.03.2003 “për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, kryeministrit ose të ministrit” i Këshillit të Ministrave. - See more at: <http://www.sot.com.al/politike/ja-17-ligjet-p%C3%ABr-administrat%C3%ABn-q%C3%AB-rr%C3%ABzohen-n%C3%AB-1-tetor-ligji-i-ri-spastron-automatikisht#sthash.9aMQM5fX.dpuf>

Kjo qasje e gabuar filozofike ka sjellë një kaos në mënyrën e funksionimit të kësaj administrate. Por, le të ndalemi të analizojmë rrethin vicioz ku lëviz kjo filozofi.

Koncepti i shqiptarit për “Lirinë” është një koncept që nuk ka asgjë të përbashkët me konceptin filozofik të lirisë. Për shqiptarin, “Liria” dhe “barazia” janë shprehje të ekzistencës së tij natyrore, e për rrjedhojë, janë të bashkëlindura e të bashkëtrashëguara. Liria, si liri pa kufizime dhe barazia si barazi vlerash, e kanë mësuar shqiptarin të mos njohë lirinë e vërtetë të mendjes dhe veprimit. Dembel në praktikën e tij (dembel më shumë mendor), shqiptari është rrekur të shkojë me symbyllur pas “Njëshit”. Kjo qasje e trashëguar nga historia duket se është në qendër të marrëdhënieve që karakterizojnë administratën publike. Pra, funksionimi i administratës publike nuk tenton përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarit, por përmirësimin e “Sjelljes” ndaj “Njëshit”. Kjo është qasja e parë.

Qasja e dytë ka të bëjë me konceptin e gabuar mbi pushtetin. Historikisht, pushteti është konsideruar nga pushtetmbajtësit si meritë personale dhe shteti si pronë. Lidhja e pushtetarëve me pushtetin ka përngjarë gati në një simbiozë historike nga e cila ka humbur vetëm qytetari. Duke e konsideruar shtetin “pronë,” sigurisht dhe administrata është konsideruar si e tillë, ndaj dhe liria e ndërhyrjes së pushtetit në gjithë ndërtimin dhe funksionimin e kësaj administrate ka këtë bazë filozofike. Ngjyrimi politik i administratës publike është shprehje e një mungese të kulturës qytetare, që në thelbin e vet ka mangësi në edukimin me lirinë e të menduarit.

Modeli i nëpunësit në Shqipëri

Në teoritë mbi administratorin publik, tri janë qasjet më të ndjeshme në lidhje me rolin e burokratit si punonjës i administratës publike.

- **Modeli liberal** i William Niskanen, sipas të cilit burokrati ushtron njëfarë “presioni” mbi politikën për të maksimizuar rolin e buxhetit burokratik.
- **Modeli i preferencave politike** (me përfaqësues Von Galer etj.), i cili pretendon se politika merr përparësi ndaj burokratit dhe vetëm kur politikën nuk janë të qarta e të qëndrueshme, burokrati mund të ndjehet më i fuqishëm përkohësisht.
- **Modeli i strukturimit burokratik** (me përfaqësues Patrick Dunleavy), i cili e sheh burokratin si mjet të politikës për të arritur qëllime elektorale dhe fuqia e tij bazohet kryesisht në faktin se burokrati ka nën kontroll kostot.

Burokrati në Shqipëri duket se është më afër modelit të tretë. Kjo për vetë mënyrën e



ndërtimit të administratës publike në vendin tonë. Dhe arsytet janë, në radhë të parë, ekonomike, pasi buxheti i administratës publike është i limituar në tavan, tërësisht të përcaktuar nga buxheti i shtetit. Po kështu dhe misioni i shpërndarjes së fondeve ka më shumë ngjyrimet politike (që kërkojnë konsensus) sesa administrative. Këtyre faktorëve, nëse u shtojmë dhe karakterin militantist të përzgjedhjes së nëpunësve në administratën publike, rezulton se modeli ynë është një model miks, i cili vështirëson rolin menaxhues të punonjësit të administratës publike dhe ngadalëson plotësimin e nevojave të qytetarit.

Pasojat:

Nisur nga filozofia shqiptare e organizimit, funksionimit dhe përdorimit të administratës publike, rezulton se administrata jonë publike është:

- E prirur drejt politizimit, gjë e cila ndikon jo vetëm në shërbime të diferencuara politikisht, por edhe në prishjen e kohezionit social që zakonisht krijojnë AP-ja funksionale.
- E prirur drejt korrupsionit, pasi pamundësia e gjetjes së rrugëve për financim e ulje kostosh dhe filozofia e "karriges" si pronë private, kanë bërë që jo vetëm perceptimi për korrupsion nga ana e popullsisë të jetë i lartë, por edhe studimet e organizatave të huaja e rendisin në vendet me korrupsion të lartë në AP Shqipërinë.
- E prirur drejt mungesës së etikës. Zhan Zhak Rusoi theksonte se "urtësia e pushtetit, veprimi i ligjeve, ndershmëria e shefave, besimi i popullit... janë në themel të institucioneve... dhe sidomos dëshira e përgjithshme e së mirës publike"²⁶.

Është e kuptueshme se qytetari kërkon jo vetëm të marrë shërbimin që i nevojitet, por ta marrë atë dhe në mënyrën më qytetare dhe etike. Nëpunësi ynë karakterizohet nga dembelizmi dhe arroganca, që vijnë si rezultat i trashëgimisë sonë kulturore dhe si rezultat i kuptimit të gabuar për pozicionin në administratën publike.

Fan Noli, kur diskutonte mbi cilësitë e nëpunësve shqiptarë tek "Ligji është themeli i shtetit" dhe raportin me Ligjin për Administratën, shpreh të njëjtin shqetësim ndërsa jepte argumentet për "grykimin e nëpunësve drejtpërdrejt gjykatoreve pa marrë lejen e superiorëve të tyre". Ai pohon dilemën e diskursit: "Të nderojmë më tepër ligjin apo

26. Zhan-Zhak Ruso, "Kontrata Sociale", Shëpia Botuese "Luarasi", Tiranë 1998, fq. 83.

memurin (nëpunësin)? Doni që të poshtërohet ligji që është themeli i shtetit apo memuri që e merr ligjin nëpër këmbë? Doni të nderohen më tepër memurët që ndërrojnë ditë më ditë pas qejfit të guvernave apo partive, apo ligjin që nuk ndërron e qëndron përmbi të gjithë?”²⁷

Megjithatë, kur themi e prirur do të thotë se mbart gjithnjë me vete rrezikun e këtyre qasjeve negative. Por, realisht këto janë karakteristikat që shfaq punonjësi i administratës tonë publike. Dhe ky nuk është thjeshtë perceptim, por rezultat i konkluzioneve të vazhdueshme të institucioneve ndërkombëtare, që monitorojnë veprimtarinë e administratës publike.

Duke marrë parasysh kërkesat aktuale për një administratë eficiente dhe efektive në shërbim të nevojave të individit, si dhe duke patur parasysh trashëgiminë tonë kulturore dhe mangësitë e formimit me bazë lirinë e mendimit, është e kuptueshme nevoja për një edukim të qëndrueshëm mbi bazën e edukimit filozofik. Në dhjetëra trajnime që bën Administrata Publike nuk rezulton asnjë modul me qasje filozofike bashkëkohore, që nxit integritetin nëpërmjet lirisë së mendimit.

Përdorimi i teknologjive të reja në administratën publike, që vijnë të diktuar jo vetëm nga nevojat reale për këtë teknologji, por edhe nga kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare (BE etj.) rrezikon të shndërrohet në një “iron cage”, sikundër parashikonte Weberi, kur mendonte në një bashkim të teknologjisë me fuqinë burokratike. Teknologjia dhe përdorimi i rrjetit dhe internetit e largon fizikisht “burokratin” nga qytetari. Në kushtet kur qytetari dhe burokrati janë “inteligjentë” në mendimin dhe bashkëveprimin e tyre të lirë”, marrëdhënia individ-administratë publike është në favor të qëndrueshmërisë, por në kushtet kur të dy anët e raportit vuajnë nga

një kulturë jo fort e qëndrueshme dhe pa një edukim të brendësuar qytetar, ky bashkim është në

të vërtetë thyerje e raportit të qytetarit ndaj shtetit. Kjo thyerje çon detyrimisht në largim të qytetarit, në indiferencë të tij dhe mund të sjellë armiqtësi të shfaqur në marrëdhënien reciproke.

Ndaj është me shumë emergjencë rikthimi i vëmendjes drejt skemave edukative për të përballuar me sa më pak kosto përdorimet e reja teknologjike.

Në zhvillimet globale është gati e pamundur të mendosh se vende të veçanta mund të

27. Kulla, N. “Antologji e Mendimit Shqiptar”, 1870-1945. ShB “Plejad”, fq. 282, 283.

ndjekin rrugën e tyre pa u tagencuar me zhvillimin global. Dhe Shqipëria, detyrimisht, do të ndjekë hapat e krijimit të modelit “*smart cities*”. Tirana, e cila vetëm 25 vite më parë numëronte **244 200 banorë**, sot numëron **726 547 banorë**²⁸. Pra edhe Tirana tenton drejt metropolit, ku nevoja për ta shndërruar qytetin në inteligjent bëhet jetike.

II. 3 “SMART CITY” DHE MODELI I TIRANËS

Dy pyetjet bazë do të ishin:

- A qeveriset Tirana me modelin e një administrate smart?
- A është Tirana një qytet me cilësi të mira jetese?

Le t’i referohemi mënyrave se si pasqyrohet në web site-t e Bashkisë qëllimi i qeverisjes nga viti 2007 deri në 2014 për të kuptuar nëse Tirana qeveriset sipas një modeli “smart”.

“Për një Tiranë të bashkëjetesës qytetare, për një Tiranë të shanseve të barabarta, për individin e çfarëdo bindjeje politike a përkatësie krahinore, për një Tiranë, ku ligjin duhet ta bëjë fryma e Kushtetutës së Republikës sonë dhe jo arroganca e klaneve politike, për një Tiranë, ku të dobëtit nuk duhet të ndihen të pambrojtur dhe të fortët nuk mund të lihen jashtë kontrollit, për një Tiranë, ku pushteti të jetë i qytetarëve dhe qyteti i të gjithëve.”²⁹”

Kështu shprehet **misioni i institucionit** për kryeqytetin në vitin 2007-të, një qytet pothuaj i barabartë me gjysmën e popullsisë shqiptare të mbetur pas emigracionit në 20 vite. *Krahasuar me parametrat që shprehin “zhvillimin e qëndrueshëm”, kjo shprehje misioni, edhe pse jo shumë pranë parametrave botërorë për një “smart city”, sërish vë theksin tek “humania” dhe cilësia e jetës së qytetarëve.* Pra, në misionin e saj, Bashkia përcakton nevojën për ndërtimin e disa raporteve qeverisje/qytetar, të cilat mundësojnë një bashkëjetesë të ekuilibruar dhe për një qeverisje me qytetarin e për qytetarin. Ky mision lidhet me një kohë kur pushteti në Bashkinë e Tiranës qeverisej nga “e majta” dhe kjo i shkon edhe qasjes së saj politike në nivelin makro. Por në këtë

28. Të dhënat nga INSTAT <http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx>

29. <http://www.tirana.gov.al/en/>

mision, Tirana është ende pa një plan rregullues³⁰ i cili, për nga rëndësia jo vetëm urbane, por në radhë të parë humane, ravijëzohet me shumë ide optimiste, të cilat në fund të mandatit mbeten të parealizuara.

Qeverisja vendore në vitin 2011 kaloi në pushtetin e së djathtës, e cila ndryshoi objektin e saj në qëllimin qeverisës, duke vendosur si prioritet qytetarin si konsumator. Kjo qasje e qeverisjes në nivelin makro i shkon për shtat krahut politik, por realisht është shumë larg standardeve të një qeverisje “smart”. Përpjekja për të vendosur si element transparence tregues të mjedisit u vendosën në vitin 2012 dhe mbetën të paazhuruara deri në vitin 2015. Nga ana tjetër, qeverisja bashkiake siguron një plan rregullues për qytetin, por duke mbetur sërish më shumë fiktiv sesa real. Por, nëse i krahasojmë këto standarde me detyrimet që burojnë nga **Konventa e Aarhusit (Konventa e Demokracisë mjedisore, 1998)**:

- *Akses në informimin e qytetarëve.*
- *Akses për pjesëmarrje në vendimmarrje të qytetarëve.*
- *Akses në drejtësi për qytetarët në shqetësimet mjedisore.*
- *Ndërtimi i kapaciteteve për politika mjedisore.*

Duket se qeverisja e Tiranës është larg këtyre kërkesave. Në asnjë element të këtij lloji informacioni për qytetarët, Bashkia nuk shprehet se sa % e taksave të mbledhura prej saj i shkon përmirësimit të situatës mjedisore në metropol po aq sa prej tyre duhet të mbështesin studime shkencore ose projekte për motivimin e qytetarëve për:

- *Akses në informim, i cili do të ishte gurë themeltar për cilësinë e vendimmarrjes, fuqizimin e publikut me njohuri e tregues që do t'i mundësonin atij zgjidhjen më të mirë për zhvillimin e qytetit po aq sa do t'i mundësonin monitorimin e “shtetërores” për **demokracinë mjedisore.***
- *Pjesëmarrje publike, për të shprehur opinionet e tyre, të kontestojnë vendime të Këshillit Bashkiak e KKRT-së, të refuzojnë politikat që cenojnë komunitetin dhe mjediset e tyre po aq sa të iniciojnë e mbështesin politikat e qëndrueshme mjedisore.*
- *Aksesin tek drejtësia, pra mekanizmat që do të lidhin qytetarin e ligjin dhe institucionet e tij me aksesin e tyre për të ushtruar të drejtën e procesit gjyqësor në rastet kur ato vuajnë nga dëmtimet mjedisore.*
- *Fuqizimin e kapaciteteve institucionale, ku institucionet dhe agjencitë shtetërore,*

30. Plani rregullues i qytetit, bazuar në websiti-n e Bashkisë Tiranë, 2007.



shoqëria civile me njohuritë, qëndrimet e shprehuritë mjedisore lehtësojnë aksesin publik për informacion, pjesëmarrje dhe drejtësi.

Kjo është dukja e një modeli qeverisës të administratës lokale të Tiranës, e cila në mungesë të statistikave të tjera, na çon drejt konkluzionit se: koncepti "smart" për qeverisjen dhe administratën e saj është larg modeleve qeverisëse. Krahasuar me modelet e vitit 2000, kur "smart" konsiderohej dixhitalizimi apo dhe pjesëmarrja e qytetarëve në qeverisje mund të themi se koncepti i administratës publike të Bashkisë Tiranë është ende larg këtyre parametrave. Kjo do të thotë se jemi edhe disa herë më larg standardeve të sotme të qeverisjes vendore, ku koncepti "smart" ka të bëjë me vetë mendimin, administrimin, shërbimin që administrata duhet të realizojë e natyrisht me dy elementë të rëndësishëm: 1) **mjedisin** dhe 2) **cilësinë e jetës**. *Thelbi i qeverisjes "smart" ka të bëjë me një cilësi gjithnjë e më të mirë të jetës së qytetarit.* Ndaj dhe pyetja tjetër është:

A është Tirana një vend me cilësi të mirë jetese?

Tirana sot është pa dyshim në qasjen e një metropoli. Në Tiranë banojnë rreth një e treta e popullsisë së vendit. Nevoja për një shndërrim të Tiranës në "*smart city*" është jo vetëm në ide, por tashmë është shndërruar në nevojë urgjente. Perceptimi qytetar mbi Tiranën shpesh afrohet me një të vërtetë, e cila dukshëm nxjerr në pah disa probleme të mëdha.

Le t'i referohemi elementit **Mjedis**³¹

Tirana mund të cilësohet "kampionimi" më i gjetur për perceptimin nga banorët e saj të problemeve mjedisore, shkallës së aksesit për informim, kuptimit të rolit të tyre në pjesëmarrje dhe për vendimmarrje në politikat mjedisore lokale. Kjo, për faktin se ajo përbën qytetin ku popullsia e 4-fishuar në 18 vite është shoqëruar me një "*boom ndërtimesh*". Metropoli shënon kulmin e *informalitetit urban* me një pasojë të dukshme, sikundër është *ndotja mjedisore*. Në vitet e tranzicionit, Tirana ka *thithur fondet më të mëdha shtetërore dhe të donatorëve* të huaj, në shumësi provash dhe ndikimi në përmirësim të mundshëm të standardeve. Ky fakt të çon apriori të mendosh se duhet të perceptohet pozitivisht nga banorët e saj. Por, nëse i referohemi rezultateve të një studimi që përfshin kategori të ndryshme qytetarësh, përfundimet janë pak më të ndryshme.

Studimi im në lidhje me vlerësimin mjedisor në qytetin e Tiranës dhe me aktorët e përgjegjësive, i është referuar kategorive të ndryshme. Studimi është bazuar në

31. Perceptimi, koncepti dhe sjellja ndaj mjedisit konsiderohet si instrument i vlerësimit të raportit qytetari/qeverisje në "smart city".

Anketimi është zhvilluar me 400 banorë të Tiranës në këto target-grupe:

- nxënës të shkollave 9-vjeçare publike dhe jopublike;
- nxënës të shkollave të mesme, publike dhe jopublike;
- studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Juridike;
- qytetarë (nga 18 deri në 55 vjeç).

Synimi është të kuptojmë qëndrueshmërinë në perceptimin, gjykimin dhe më tej pjesëmarrjen e qytetarëve të Tiranës në problemet mjedisore³².

Tabela 8

Përmbajtja e konceptit “mjedis” për nxënës të shkollave, studentë dhe qytetarë të qytetit të Tiranës.				
Koncepti “mjedis”	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Aty ku jeton e ke mirëqenie	0	22	50	4
Çdo gjë që na rrethon	94	54	30	34
Çdo gjë që lidhet me jetën	6	18	18	50
Të tjera	0	10	2	12

Vlerësim: Ka një variacion të konceptit që plotësohet me rritjen e moshës. Ai fillon me përcaktimin “fizik” të tij në moshën 7-14 vjeç, për të ardhur tek më i ploti, ku lidhet fizikja me cilësinë e jetës. Fakti që anketimi është bërë me klasat e 8-ta, pra drejt përfundimit të arsimit të detyruar, nevojitet të shihet mundësia e reflektimit në kurrikul, tekstet mësimore e ndihmëse dhe plotësimi i përmbajtjes së konceptit në elementet e tij.

Tabela 9

Përmbajtja e konceptit “mjedis i shëndetshëm” për nxënës të shkollave, studentë dhe qytetarë të qytetit të Tiranës.				
Koncepti për mjedisin e shëndetshëm	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Ajër pa ndotje	30	57	40	54
Hapësirë ku kontribuojnë të gjithë	12	18	8	28
Rrugë të pastra	0	0	6	0
Hapësirë e gjelbëruar	33	39	9	0
Aty ku vepron ligji	0	0	8	18
Aty ku ka jetëgjatësi	21	27	29	0

32. Pyetjet e intervistës në vitin 2013 (400 të anketuar gjithsej, 100 për çdo kategori të sipërpërmendur) janë bashkëlidhur në Shtojcën 2.



Vlerësim: Të anketuarit barazojnë cilësinë “të shëndetshëm” me “të pastër”.

Referuar paraqitjes së të dhënave, konstatohet që në **total** shprehen të gjithë parametrat, sikurse vërehet humbja e parametrin “rrugë të pastra” në kategori, ndërkohë që shfaqet dobët tek studentët. Vërehet që tek qytetarët humbet totalisht parametri “jetëgjatësi”. Mungesa në vlerësim “aty ku vepron ligji” mungon tek mosha 7-18 vjeç, për të dyja ciklet e shkollimit. Kjo kërkon rishikimin e cilësisë së kurrikulës dhe botimeve të këtij formimi, në të 2 ciklet e arsimit parauniversitar (APU).

Tabela 10

Cilësia e vlerësuar e mjedisit nga nxënës të shkollave, studentë dhe qytetarë të qytetit të Tiranës.				
Cilësia e vlerësuar e mjedisit në qytet	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Pak i ndotur	0	0	0	0
Ndotur	100	100	100	100
Pastër	0	0	0	0

Vlerësim: Është tepër shqetësuese të ndjerit e 100% të të anketuarve se jetojnë në një mjedis të ndotur. Pra, shenjat e para të një vlerësimi jo fort pozitiv në raport me mjedisin në kryeqytet e ndeshim që në pyetjet e para. Pra, perceptimi për cilësinë e mjedisit ku jetojnë për të intervistuarit është totalisht negativ. Shkaqet për këtë shkallë ndotje mësohen nga si më poshtë në përgjigjet e dhëna.

Tabela 11

Faktorët që ndikojnë në kulturën tonë mjedisore				
Faktorët që ndikojnë në kulturën tonë mjedisore	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Shkolla	23	63	40	57
Familja	19	36	28	82
Gazeta	0	21	36	31
TV	37	63	52	90
Radio	14	3	12	12
Projektet	0	12	4	2
Publikime e botime	0	36	12	70
Interneti	7	24	0	0

Vlerësim: Vërehet se blloku mediatik është ai që ndikon më shumë në kulturën mjedisore. Ndërkohë që vërehet se, kohën më të madhe dhe cilësinë më të ndikuar në nxënie e ka TV-ja, shkolla, familja. Duke ju referuar anketimit, i cili është bërë në Tiranë, vlerësohet shqetësuese gjendja e ndikimit që ka “interneti” në kategorinë e studentëve dhe qytetarëve, sikurse dhe “projektet” për shkollën e mesme (*Iniciativat për mjedis të pastër mbeten ende fushëfokus i projekteve në shkollë dhe jo e përgjegjësive institucionale.*). Është për t’u vlerësuar fakti që qytetarët kërkojnë nga media vizive modele të edukimit mjedisor. **Kjo cektësi në këtë analizë shkaqesh e faktorësh në ndikim duhet të risjellë në vëmendje nevojën e një edukimi filozofik në të gjitha nivelet e edukimit në shkollat tona, edukim që do të mundësonte edukimin me përgjegjshmërinë dhe institucionalizmin për qytetarët.** Televizioni (siç pranohet më sipër) mund të sjellë një model ndikimi në edukim, por një edukim i mirë filozofik e bën të qëndrueshëm gjykimin ndaj çdo modeli që mund të sillet në ekrane.

Tabela 12

Faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në kulturën tuaj mjedisore.				
3 faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në kulturën tuaj mjedisore	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Shkolla	23	63	40	57
Grupi mediatik	51	87	100	133
Familja	19	36	28	82

Vlerësim: Punimi sheh me shqetësim vlerësimin që shprehin të anketuarit për rolin e shkollës në edukimin mjedisor. Kështu, vërehet se në shkollën e mesme kemi nivelin më të lartë të besimit tek edukimi shkollor, ndërkohë që ka një situatë kritike tek studentët. Qëndrimi i qytetarëve shpreh një fakt tashmë të mirëpranuar mbi rolin e medias dhe familjes në të gjitha ndryshimet demokratike që i nevojiten Shqipërisë. Ndërkohë, vlerësoj qëndrimin kritik ndaj familjes (në raport me median) për edukimin mjedisor, tek 3 nivelet e shkollimit. Kjo situatë duhet shoqëruar me një angazhim institucional të MES-it dhe institucioneve vartëse.

Siç shihet, kopshti mbetet niveli i edukimit me dinamikën më të madhe të **komunikimit të prindërve me fëmijët në rritje**. Tendencia shkon në ulje tek nivelet e tjera.

**Tabela 13**

Ndikimi i përfaqësuesve të burimeve informative tek kultura jonë mjedisore				
Ndikimi i përfaqësuesve të burimeve informative tek kultura jonë mjedisore	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Gazeta	0	21	36	31
TV	37	63	52	90
Radio	14	3	12	12
Grupi mediatik	51	87	100	133

Vlerësim: Blloku mediatik shpreh një epërsi totale mbi të gjitha burimet e tjera informative për çdo target-grup. Kjo situatë duhet kthyer në favor të fuqizimit të kapaciteteve televizive që nga KKRT-ja, Instituti i Medias apo Shoqata e Gazetarëve që, në bashkëpunim me aktorë të OJQ-ve dhe shtetin, mund të ndikojnë për qëndrime më pozitive të qytetarëve ndaj mjedisit. Nga ana tjetër, kjo flet për një “gozhdim” para tyre nga të gjitha moshat, kohë kjo që i merret studimit dhe komunikimi gojor (për moshat shkollore) apo aksionit qytetar për ndryshimin e gjendjeve mjedisore nga të rriturit. Ky pohim i fundit përkon me kërkesat femërore “të kemi ujë e drita që të pastrojmë me prindërit” si përgjigje e pyetjes “*Si mund t’u mbajmë më pastër kopshin, shkollën, lagjen apo qytetin?*”³³.

Tabela 14

Kuptimi për konceptin “mjedis i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm”				
Koncepti “mjedis i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm”	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Sëmundje	90	96	52	89
Vdekje	0	0	24	0
Shëndet mendor të cenuar	0	0	12	22
Mirëqenie e humbur	0	0	14	0
Qytet i trishtë	0	0	8	0
Ngrohje globale	10	0	0	0

33. Fokus-grup i parashkollorëve të shkollës “S. Gabrani”, Tiranë, 2014

Vlerësim: Të anketuarit lidhin maksimalisht ndotjen e qytetit me nivelin e sëmundshmërisë. Në kategorinë studentore vlerësoj plotësimin konceptual të ndikimit dhe me faktorë socialë (mirëqenie e cenuar). Pra, tek nxënësit deri në 18 vjeç dhe qytetarët, cilësia mjedisore ende nuk ka të pasuruar përmbajtjen me ndikimin që ka në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të qytetit. Ndërkohë, po tek studentët kemi të shprehur edhe elementin psikologjik (qytet i trishtë). Nxënësit e 9-vjeçares shprehin edhe elemente të fantashkencës që ndikojnë shumë mbi ta (ngrohja globale) dhe që humbin totalisht te kategoritë e tjera. **Tirana duhet të ketë kurrikulën e saj mjedisore në arsim, për të gjitha nivelet e APU-së.** Ndaj unë rifroj idenë se, në edukimin e nxënësve në tre nivelet parauniversitare është e nevojshme që edukimi mjedisor të mos jetë Unik, por specifik në raport me problematikat që ka zona. Kjo përvojë ka qenë si një bashkëpunim i Drejtorisë Arsimore Rajonale të qytetit Tiranë dhe Bashkisë Tiranë në vitet 2003-2005 nën mbështetjen e Organizatës Jofitimprurëse, REC-Albania.

Tabela 15

Burimet e ndotjes mjedisore në qytetin e Tiranës.				
Burimet e ndotjes mjedisore	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Kultura qytetare	28	23	34	17
Teknologjitë dhe ndërtimi	12	32	26	44
Makinat	34	28	32	28
Qeverisja e dobët	10	12	8	11
Mbipopullimi	6	5	0	0
Shkatërrimi i pyjeve	10	0	0	0

Vlerësim: Tirana me qytetarë të shumë nënkulturave perceptohet nga të gjithë se po ndotet nga ndërtimet pa kriter, nga makinat e panumërta, mungesa e kulturës qytetare etj. Është për t'u nënvizuar fakti se studentët e shikojnë si faktor kryesor mungesën e një kulture qytetare në raport me mjedisin, ndërkohë që kategoritë e tjera e konsiderojnë si pasojë e teknologjive dhe ndërtimeve, ndërkohë që qeverisjen e konsiderojnë faktor të fundit.



Pra, nuk njohin dhe nuk pranojnë përgjegjësitë dhe kompetencat që ka qeverisja mbi problemin, sikurse dhe raportin e dykahshëm mes qeverisjes së mirë dhe minimizimit të burimeve të ndotjes në qytet. Kjo flet për një mungesë të edukimit filozofik të tyre, për mungesën e një logjike të shtrimit dhe zgjidhjes së problemeve. Teknologjitë dhe ndërtime të jetës urbane. Ajo që e çon në rrugën e duhur këtë trend është padyshim një qeverisje e mirë, gjë e cila në këtë rast vlerësohet në vendin e fundit.

Tabela 16

Ku e ndeshim ndotjen mjedisore në qytetin e Tiranës?				
Ku e ndeshim ndotjen mjedisore?	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Askund	0	0	0	0
Diku	0	0	0	0
Kudo	100	100	100	100

Nga përgjigjet shohim se ndotja mjedisore është cilësi e jetës në qytet nga të gjithë target-grupet. Ndërkohë më poshtë shohim si e gjykojnë përgjegjësinë për ndryshimin e saj në favor të tërëve.

Tabela 17

Kush mund ta ndryshojë gjendjen e ndotur mjedisore në qytet?				
Kush mund ta ndryshojë gjendjen mjedisore?	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Qytetarët vetë	22	31	34	38
Qeveria	30	23	16	27
Bashkia	40	34	38	24
OJF-të	0	11	12	6
Shkolla	4	1	0	10
Të tjerë	0	0	0	0

Vlerësim: Nga tabela vërehet që të anketuarit kërkojnë zgjidhjen e situatës nga institucioni i zgjedhur, “Bashkia”, ndërkohë që nuk ngurrojnë të shprehin kërkesën ndaj vetes dhe bashkëpunimit me njëri-tjetrin. Parë në bllokun “Bashki-Qeveri”

vlërësorj tendencën e tyre për të kërkuar *marrjen e përgjegjësisë nga shteti*. Vërehet *rënie e shifrës së besimit tek Bashkia* me rritjen e moshës së të anketuarve, sikurse *ka një pranim të zbehtë të rolit të OJF-ve dhe shkollës* si institucione, e ndryshme kjo nga kërkesat e tyre në edukimin mjedisor.

Tabela 18

Çfarë duhet të ndryshosh në qëndrimin tënd ndaj mjedisit?				
Çfarë duhet të ndryshosh në qëndrimin tënd ndaj mjedisit?	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Bashkëpunim me të tjerët	36	22	36	46
Kujdes për trajtim mbeturinash	18	18	20	30
Më shumë sensibilizim	33	38	18	19
Zbatim ligji	4	17	16	0
Lobime qytetare	0	0	10	0
Refuzime	9	5	0	5

Vlerësim: Referuar kërkesës për veten, në qëndrimin ndaj mjedisit, janë 3 premisa shumë pozitive, që për nga rëndësia shprehen: 1) kërkoj bashkëpunim me të tjerë (*pjesëmarrje nga 3 target-grupe*); 2) më shumë sensibilizim (*dëshirë për akses në informacion - veçanërisht nga parauniversitari*); 3) trajtim të ndryshuar ndaj mbeturinave (*përmirësime teknologjike në përpunim mbetjesh - të rriturit*). Pra, shprehet qartë **trinomi Qytetar-Informacion-Teknologji**.

Vlerësimi qytetar është ende i dobët në kërkesën për të marrë pjesë drejt vendimmarrjes apo të përdorimit të lobeve qytetare. Kjo edhe për faktin se ndjehet mungesë aksesit nga institucionet shtetërore, Bashki apo Njësi Administrative e më gjerë për vendimmarrje mjedisore në qytet.

Bashkia duhet të vendosë raporte institucionale me matrica veprimi dhe përgjegjësish të ndara dhe të përbashkëta me Drejtorinë Arsimore (bazuar në përvojat 2003-2005, me kurrikul dhe tekst mësimor), sikurse iniciativa të vetë fëmijëve dhe të rinjve për mjedisin në qytet (forumet respektive lokale si Parlamenti i Fëmijëve të Tiranës apo Parlamenti Rinor i Tiranës) shoqëruar këto me buxhetime të deklaruara nga Bashkia (*një pjesë e të ardhurave nga vjelja e Taksës së Gjelbërimit mund të shkojë për mbështetje të modeleve të tilla institucionale*).

**Tabela 19**

Çfarë duhet të ndryshosh tek qëndrimi i familjes tënde ndaj mjedisit?				
Çfarë duhet të ndryshosh tek qëndrimi i familjes tënde ndaj mjedisit?	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Përgjegjësi të shtuara	19	3	36	18
Mosabuzim	0	13	32	38
Rritje sensibilizimi	0	24	14	27
Infrastrukturë mjedisore (kosha...)	44	15	10	5
Bashkëveprim për mbrojtje	37	45	8	12

Vlerësim: Qëndrimi i të anketuarëve është sa kritik për familjet e tyre, aq edhe me kërkesë e gatishmëri për të ndryshuar qëndrimin. Vërehet që deri në 14 vjeç, fëmijët nuk shprehen për sensibilizim të familjes apo për kërkesën ndaj saj për të mos abuzuar me mjedisin, formime që duhen reflektuar në kurrikulën përkatëse. Aktiviteti për mbrojtjen e mjedisit mbetet rubrika më e pëlqyer deri në përfundim të shkollës së mesme, duke u zbehur me kalimin e kohës. Të bën përshtypje konstatimi i nxënësve të 9-vjeçares, që i quajnë të pamjaftueshme infrastrukturën mjedisore ndihmëse nga Bashkia e Minibashkitë (që kanë vitin e fundit të funksionimit).

Tabela 20

Çfarë kërkon të ndryshosh tek komuniteti ku jeton?				
Çfarë kërkon të ndryshosh tek komuniteti ku jeton për një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm?	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Më shumë përgjegjësi	39	43	60	0
Përmirësim të ambientit të përbashkët	0	33	16	46
Mirëtrajtim mbeturinash	17	4	12	20
Higjienë më të mirë komunitare	14	0	8	34
Gjelbërim të shtuar	28	20	0	0

Vlerësim: Vërehet se në të 3 nivelet e sistemit arsimor kemi kërkesën për më shumë përgjegjshmëri komunitare. Kjo për faktin se ata e njohin si koncept në edukim këtë kërkesë, ndërkohë që tek qytetarët mbizotëron kërkesa për “përmirësim të ambientit të përbashkët”. Rezultatet tregojnë *dinamikën e fjalorit të përdorur në mosha dhe formime të ndryshme në raport me mjedisin*. Gjithashtu, “gjelbërimin e shtuar në komunitet” e ndeshim vetëm deri në 18 vjeç (9-vjeçar + të mesme), duke paraqitur pamjen reale të jetës qytetare në Tiranë, ku pemët mbillen ose nga fëmijët e shkollave, ose nga punonjësit e Bashkisë. Bashkisë dhe Minibashkive iu duhet një politikë për përfshirje të komuniteteve në veprim, por mbi të gjitha duhet t’i bindë se vetë ajo është në shërbim të tyre edhe në këtë përgjegjësi.

Tabela 21

Çfarë duhet të ndryshosh në qëndrimin e institucioneve shtetërore për politikën mjedisore. (SHKOLLA)				
Çfarë kërkon nga shkolla dhe shkollimi juaj?	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Programe e botime	13	21	40	4
Të qenit model për mjedisin	25	24	32	41
Më shumë sensibilizim komunitar	0	0	24	33
Aktivitete qytetare	39	29	24	33
Projekte	0	26	0	0
Grup ambientalist	23	0	0	0

Vlerësim: Vërehet se ka një kërkesë të shprehur për të gjitha nivelet e arsimit për pasqyrim të edukimit mjedisor qytetar në kurrikulat përkatëse (për IZHA dhe MES). Të gjitha kategoritë e anketuara, duke filluar nga fëmijët e kopshteve, janë shprehur kritikë për mjedisin brenda institucioneve të tyre, sikurse i kërkojnë institucioneve shkollore të përfaqësojnë modelin institucional.

**Tabela 22****Çfarë kërkoni të ndryshojë për qeverisjen mjedisore nga Bashkia Tiranë**

Çfarë kërkoni të ndryshojë për qeverisjen mjedisore nga Bashkia Tiranë?	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Zbatim ligji e ndëshkueshmëri	34	0	42	38
Infrastrukturë mjedisore	42	31	24	33
Shtim i hapësirave të gjelbërta	21	4	20	0
Ushtrim përgjegjësish për taksat që merr	0	18	0	0
Më shumë vendimmarrje qytetare	0	0	0	24
Frenim i ndërtimeve	1	8	8	0
Barazi rrethinë, qendër	0	0	6	0
Programe e projekte mbështetëse	0	39	0	5

Vlerësim: Të dhënat sjellin kërkesën që të anketuarit kanë për zbatim të ligjit dhe të penaliteteve, përgjegjësi dhe kompetenca të institucionit të Bashkisë. Kjo rubrikë bëhet "0" në vlerësim tek nxënësit e shkollave të mesme, duke i dhënë epërsi mbështetjes për më shumë programe e projekte të buxhetuara nga Bashkia. Po kjo kategori është e vetmja që "kërkon llogari" për taksat mjedisore, kjo nën konceptin e ligjit. Vërehet që kërkesa për shtim të infrastrukturës mjedisore (kosha e kazanë) mbetet kërkesë absolute, por që në fakt është tregues i kapshëm për cilësinë ende kritike të menaxhimit të tyre nga Bashkia. Nxënësit dhe studentët kërkojnë më shumë hapësira të gjelbërta nga angazhimet që duhet të ndërmarrë Bashkia. Në përgjigje të të anketuarve **u vlerësuan edhe shprehjet e të ndjerit të pabarabartë, rrethinë - qendër nga studentët.**

Tabela 23

Çfarë kërkoni të ndryshojë në politikat e medias për një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm (përgjigje të hapura)?			
Çfarë kërkoni të ndryshojë në politikat e medias për një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm?	Më shumë informacion formues e krahasues me BE-në	Pasqyrim realist të cilësisë së mjedisit	Më shumë spote e reklama
Totali i 4 kategorive	180	128	92

Vlerësim: Siç shihet nga të dhënat jo vetëm të kësaj tablele, por edhe tek ndikimi i burimeve të informimit të medias në total, bllokut mediatik i kërkohet rol më i spikatur për formimin qytetar, dhënien e informacioneve mbi standardet mjedisore të BE-së, për gjendjen e treguesve mjedisorë në Tiranë, krahasuar edhe me metropolet evropiane, sikurse edhe sensibilizime në spote e reklama. Ky është standardi që kërkojnë ato në aksesin për informim e pjesëmarrje për vendimmarrje, gjë që duhet të vlerësohet nga Bashkia për politikat e deritanishme mjedisore në raport me qytetin e qytetarët e tij.

Tabela 24

Cilin konsideroni si faktor tjetër të rëndësishëm në ndryshimin e gjendjes mjedisore në qytet?				
Cilin konsideroni si faktor tjetër të rëndësishëm në ndryshimin e gjendjes mjedisore në qytet?	9-vjeçar	E mesme	Studentë	Qytetarë
Komuniteti i biznesit	0	24	33	17
Komuniteti ndërkombëtar	0	0	18	0
Organizatata fetare	0	0	9	0
Organet e rendit, drejtësisë	0	21	0	0
Refuzim	100	55	40	83

Vlerësim: Vërehet se nxënësit e shkollave të mesme, studentët dhe qytetarët kërkojnë që edhe komuniteti i biznesit të bëhet faktor për ndryshimin më pozitiv të parametrave mjedisorë në Tiranë, kjo në një vazhdim logjik të pranimit të tyre dhe si shkak ndotjeje. Ndërkohë, *vetëm studentët shprehen për rolin e komunitetit ndërkombëtar* në ndryshimin e dëshiruar, fakt ky i panjohur në rol që të shprehej edhe nga formimet e arsimit të detyruar e të mesëm. Bie në sy fakti i kërkesës *për ndërhyrje të organeve*



të vendit, të rendit dhe drejtësisë për ndryshim gjendjeje nga kategoria e nxënësve të shkollave të mesme. Në përgjigjet e dhëna, ka edhe një ftesë nga studentët për ***rol të organizatave fetare*** në konceptin dhe aksionin e ndryshimit të cilësisë mjedisore të Tiranës. Kritik mbetet qëndrimi i 9-vjeçares në vlerësimin e faktorëve të ofruar në anketim, refuzojnë 100%. **Ky është defekt kurrikular.**

Tirana ende vuan mungesën e modelimit të kopshte-shkollave si një “institucion i gjelbër shtetëror” po aq sa, edhe për infrastrukturën publike. Për vlerësimin kritik të të anketuarve dhe nga përvoja 30-vjeçare në arsim, konstatoj mungesën për to të standardeve mjedisore institucionale të deklaruara, për më shumë, po shkojnë drejt degradimit dhe të atyre ekzistuese³⁴.

“Qytetet duhet të flasin, shkruan Prof. A. Fuga, pra nuk janë thjesht zona ekonomike. Do të ishte fyerje për njeriun. Njeriu ka nevojë të dialogojë me hapësirën që e rrethon, të gjejë tek ajo pasqyrimin e vetes, ta humanizojë hapësirën urbane ku jeton, të kuptojë thelbin simbolik të saj dhe të jetojë në paqe me të.”³⁵

II. 4 POLITIKAT EVROPIANE MBI EZHQ-NË, DEAR-IN.

“Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm” në Evropë erdhi nën variacione të emërtimeve të ndryshme. Kështu, në literaturë dhe diskutime akademike evropiane ai vjen nën simbolikën (**DEAR**) bazuar në termin në anglisht – **Development Education and Awareness Raising**, si: edukimi global, edukimi për zhvillimin global, të mësuarit global, edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm, që në fakt është një miksim i gjithë rrugës së përpunimit të **bashkëpërgjegjësive që edukimi dhe zhvillimi njerëzor botëror kanë dëshiruar t’i njohin njëri-tjetrit.**

“Konsensusi Evropian mbi Zhvillimin” është një dokument që e vlerëson DEAR-in si një kontribut për çrrënjosjen e varfërisë dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm përmes:

- ***rritjes së ndërgjegjësimit publik,***
- ***qasjes së sistemit të edukimit*** dhe aktiviteteve, të cilat bazohen në vlerat e të drejtave të njeriut, përgjegjësia sociale, barazia gjinore dhe sensi i përkatësisë në të njëjtën botë (European Consensus on Development; The Contribution of

34. EPI (Indeksi i Performancës Mjedisore), në vite, Shqipërinë e rendiste në 2010-ën në vendin e 23, midis 178 vendeve me 71.4 pikë. Shqipëria në 2014-ën renditet e 67-ta midis 178 vendeve me 54.73 pikë (EPI 2014).

35. Fuga, A., “Rënia e qytetit”, ShB “Papyrus”, fq. 328.

Development Education and Awareness Raising, 2007, 5).

Vizioni dhe objektivat e DEAR-it lidhen në mënyrë të detyrueshme me misionin e arsimit kombëtar apo lokal përmes:

1. **ofrimin të njohurive të diferencuara** dhe të kuptuarit kritik të ndërvarësisë globale mbi:
 - zhvillimin dhe sfidat mjedisore lokale dhe globale,
 - lidhjet mes pushteteve,
 - çështje të identitetit dhe diversitetit;
2. **fuqizimin e njerëzve** për të marrë pjesë në punët dhe çështjet publike përmes:
 - formimit të qytetarit aktiv të përfshirë dhe angazhuar në ndryshimet socio-ekonomike në mjediset komunitare, lokale e kombëtare,
 - qytetarisë aktive dhe bashkëpërgjegjëse në nivel global shoqëror;
3. **nënvizimin e vlerave njerëzore**, si: drejtësia, barazia, përfshirja, të drejtat e njeriut, solidariteti, respekti për të tjerët dhe për mjedisin;
4. aspiratat e **“Qendrave e të mësuarit”**, inicuese dhe lehtësuese e dialogjeve të orientuara dhe pedagogjive eksperimentuese që ndihmojnë “Të mësojmë atë që duhet mësuar”;
5. **ndikimin tek informimi dhe advokacia qytetare** për më shumë drejtësi dhe qëndrueshmëri në politikën, në strukturat politiko-sociale, si dhe praktikën individuale.

Pas platformës “DEAR”, edhe në dokumentin kryesor të zhvillimit të vendeve të Bashkimit Evropian “**Evropa 2020**”, ndërsa shprehet misioni i BE-së ritheksohet “... **zhvillimi inteligjent, i qëndrueshëm, i gjelbër dhe ekonomia përfshirëse....**”, ku këto 3 cilësi të qenësishme të zhvillimit 10-vjeçar projektuan 6 objektiva:

Punësimi, Novacioni, Edukimi, Kohezioni social, Klima dhe Energjia,

të cilat do të realizojnë Evropën e Bashkuar me zhvillim të qëndrueshëm.

Siç njihet nga filozofia e integritit evropian të vendeve të cilat futen në proces anëtarësimi, “Axe Evropeane” për arsimin dhe shëndetësinë është një **axhendë e decentralizuar me fizionomi kontekstuale hapësinore**, ku lokalja dhe kombëtarja kanë ndikimin e vlerësueshëm në performancë e përmbajtje.

Në gjykim të kësaj filozofie zhvillimi të Shqipërisë, pra të Shqipërisë “*Smart, Green and Sustainable*” (**Inteligjente, e gjelbër dhe e qëndrueshme**) merr rëndësi të madhe



konceptimi i qyteteve me të njëjtat tipare në proceset e veta urbanizuese. Sigurisht, në këto mendësi qeverisëse të humanes për sot dhe gjeneratat e reja, metropolet bëhen ambicja qytetare dhe politike, dhe për këtë qëllim punimi doktoral do tentojë të vlerësojë e konkludojë se sa “inteligjente, e gjelbër dhe e qëndrueshme ‘prodhoet’” Tirana me bazë edukimin, nga kopshtet tek universiteti publik.

Qyteti i Tiranës, qasje dhe tendenca për Konsensusin Evropian për Zhvillimin me bazë EZHQ.

Qasjet dhe tendencat për sa më sipër lidhen domosdoshmërisht me institucione dhe misionet e tyre, në politika dhe masterplane, në studime që prodhojnë reforma po aq sa dhe projekte zhvillimi për qytetin. Ajo që duhet të shoqërojë këtë proces është transparenca e komunikimit me publikun dhe komoditeti për “ta lexuar” qytetin dhe zhvillimin e tij në cilësi.

Ku mund t’i lexojmë apo ku mund të komunikojmë publikisht me standardet e zhvillimit inteligjent, të gjelbër dhe të qëndrueshëm (ZHQ) të qytetit të Tiranës?

Çfarë tendencash ka qyteti në referim të treguesve të ZHQ-së? Ku shprehen ato?

Ku shprehet Edukimi për ZHQ-në në qytet?

Konsensusi Evropian është dokument bazë për standarde në filozofi zhvillimi urban, statistika për efekte analizash dhe prodhime politikash, për cilësi funksionimi institucionesh bazuar në strategji zhvillimi po aq sa një dokument që mundëson monitorim me cilësi, të menduar kritik e refleksion mbi qasje më kontekstuale politikash lokale dhe të fushës.

Masterplanet lokale si burim kryesor

Vlerësimi i gjendjeve të tilla fillon me referimin në Masterplanin e Zhvillimit të Qytetit. Referuar “Konsensusit Evropian mbi Zhvillimin” apo vizionit dhe objektivave të DEAR-it, Tiranës i mungon shprehja e saj publike me këtë gjuhë standardi. Ne na mungojnë mbi aq sa shkruhen e shfaqen, njohuritë e diferencuara në të kuptuarin kritik të ndërvarësisë kombëtare dhe globale që ka Tirana në zhvillimin dhe sfidat mjedisore lokale, në lidhjet e së drejtës dhe përgjegjësisë mes pushteteve mbi të po aq sa pak mundësohemi në çështje të identitetit dhe diversitetit të saj me vendin në tërësi, rajonin e më gjerë.

Më shumë se kurrë, në këtë fazë të proceseve integruese të vendit në BE, Bashkia e Tiranës, ende nuk ka një konceptim bashkëkohor të shërbimeve me “kontekstualitetin e ZHQ-së përmes edukimit” dhe ndërtimi i informacionit përkatës publik. Deri më sot, ai mungon, duke u parë si përgjegjësi e statistikës së MAS-it apo përfshirjes në Strategji dhe Udhëzues Kombëtarë.

Vjetarët Statistikorë si pikënisje dhe pikë reflektimi për cilësinë e politikave dhe pjesëmarrjes qytetare në ZHQ-të e qytetit apo “Smart City”-t.

Dokument thelbësor referues bazë është **Vjetari Statistikor 2010 (i fundit)**, i cili na informon për treguesit socialë-ekonomikë të qytetit të Tiranës. Në vitin 2012 hartohet “Koncepti për Zhvillimin Rajonal të Qarkut Tiranë³⁶”. Edhe në këtë “Koncept”, *zhvillimi i qëndrueshëm është parë thjeshtësisht në tri momente: a) projektet mbi mjedisin, të financuara nga BB-ja dhe SIDA, b) krijimi i shoqatave të pyjeve komunale, c) baza ligjore e kompletuar për pyjet dhe kullotat*. Nuk gjen asnjë paragraf mbi konceptin “zhvillim i qëndrueshëm” dhe përmbajtjen e tij reale. Sigurisht nuk gjen as dhe një paragraf në trajtimin e nevojave edukuese për këtë zhvillim të qëndrueshëm.

Kjo dëshmon për një mungesë të theksuar të përmbajtjes së vetë standardeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe, aq më tepër, për nevojat strategjike të edukimit me këtë koncept.

Nga vlerësimi i Vjetarit, në koncept kompozimi të informacionit statistikor apo përmbajtja në rubrikën “Paraqitje lënde”, në të nuk kemi aspak përkim dhe pasqyrim me gjuhën dhe logjikën e treguesve të Zhvillimit të Qëndrueshëm, të përcaktuar nga Kombet e Bashkuara (UN, Indicators of Sustainable Development Guidelines and Methodologies, October 2007, Third edition, Economis & Social Affairs) apo nga DEAR. Të pakonceptuar si përmbajtje në këtë lloj, si statistika zyrtare nga institucionet shtetërore apo mes tyre, në mbledhje dhe përpunim informacioni, të pabëra transparente në rrugë elektronike për publikun a më gjerë, vështirësojnë situatën për t’u shprehur mbi Tiranën nën filozofi të ZHQ-së. Për më tepër, na pamundëson vlerësimin, monitorimin, raportimin apo vlerësimin e cilësisë “qëndrueshëm” apo “inteligjent” të qytetit edhe për faktin se nuk konceptohet si pjesë e informacionit të integruar në web-Bashkinë e Tiranës.

36. <http://www.qarkutirane.gov.al/alb/Koncepti%20i%20Zhvillimit%20Rajonal%20per%20Qarkun%20e%20Tiranes.pdf> Fq. 53.



Fokusohe mi tek INSTAT-i, pasi ligjërisht ai është institucioni që koncepton, bazuar në Vendim të Këshillit të Ministrave, cilësinë e statistikës dhe detyrimet institucionale apo ndër-institucionale për tregues të ndryshëm të ZHQ-së. Mjafton të krahasojmë konceptin e statistikës së arsimit nga “UN, Indicators of Sustainable Development Guidelines and Methodologies, October 2007, Third edition, Economic & Social Affairs” dhe atë nga INSTAT - Vjetari Statistikor 2010 i Tiranës dhe të kuptojmë sa larg jemi me atë çka bota ka ideuar dhe aplikon që prej 2007-ës. Sigurisht që këto cilësi, në qenie e mosqenie të tyre, shkojnë paralel me filozofitë dhe konceptet që ushqejnë reformimin e sistemit të edukimit në tërësi dhe qeverisjes vendore.

Pra, mjedisi, transparenca dhe administrata e Bashkisë Tiranë në konceptin e qytetarit, por edhe në raport me standardet ndërkombëtare të një “smart city”, është shumë larg krahasimeve me këto standarde. Raporti qytetar-mjedis apo edhe qytetar-qeverisje janë të shformuara, duke na treguar mangësi thelbësore në edukimin e humanes, qytetare me konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mangësi të kuptimit qeverisës për qeverisje vendore sipas modelit “Qytete nën zhvillim të qëndrueshëm”.

Gjendja reale në qytetin e Tiranës e bën emergjente rikonceptimin e edukimit masiv me një kulturë qytetare, aq sa e bën emergjente ndryshimin e politikave qeverisëse në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm në kushtet e “smart city” me bazë edukimin për zhvillim të qëndrueshëm, kur vetë ky i fundit duhet të bazohet tek filozofia si shkollë e cilësisë së mendimit dhe lirisë.

Nga duhet filluar për këtë lloj edukimi të humanes për sot dhe gjeneratat që do vijnë?

II. 5 A KEMI NE NJË TRASHËGIMI TË EDUKIMIT FILOZOFIK KU MUND TË REFEROHEMI?

Më parë na duhet të shtrojmë një pyetje më të thjeshtë: A kemi ne një trashëgimi historike në një edukim të qëndrueshëm? Anton Harapi më 1930-ën, tek “Hylli i dritës”, shkruan: “Na në Shqipëri, nuk jemi në një vend, ku sajohet jeta mbas një teorie a sistemi filozofik; në këtë pikëpamje të gjithë jemi një lësh (lësh) me aq fije sa janë pikëpamjet e shkurtra mbas të cillave endemi. Me gjithë kta mahemi si të muejshim m’ë për ligjë para arsyes e ditunis sistemin jetësues tonin, kemi nacionalizëm dhe me shitë, dogmatizojmë mbi fatbardhësinë e kombit në mënyrën ma kategorike, si të mos të

qeshëshim nën mustakë, sa herë të na shfaqet kjo ide magjike³⁷ .

Në të vërtetë, e gjithë Rilindja jonë kombëtare e ka konsideruar arsimimin e popullit si kushtin, por edhe premisën e parë në zhvillimin e vendit. Fakti që shqiptarët kanë mbijetuar për një kohë të gjatë pa gjuhë të shkruar, nuk mund të justifikonte (pas shpalljes së Pavarësisë) mungesën e politikave serioze në drejtim të edukimit dhe arsimimit. Shqipëria vërtetë hapi shkollën e parë vetëm në 1887-ën, por edhe pas kësaj nuk pati ndonjë politikë prioritare në favor të edukimit dhe arsimimit të popullit. Mungesa e shkrimit të gjuhës (alfabeti shqip), si dhe mungesa e dukshme e ndikimit të edukimit fetar (nga institucionet fetare) bënë që shqiptarët të hyjnë në shekullin XX jo vetëm të pa shtet, por edhe të pashkollë. Është e kuptueshme se çfarë edukimi filozofik kemi të trashëguar. Mendimi filozofiko-politik i viteve '30 të shekullit XX e ka shtruar me shumë forcë, madje e ka konsideruar parësore nevojën për një edukim qytetar të shqiptarëve.

Sot flitet shumë për raportin e kulturës, traditave kombëtare dhe qytetërimit modern, duke përcaktuar qartë edhe vijat ndarëse në qëndrimet ndaj tyre. Mirëpo s' duhet harruar se në përfundime befasuese dhe largpamëse kishte arritur në fundin e vet elita e mendimit shqiptar të traditës ose më saktësisht mendimi i viteve '30, madje edhe për probleme që atëherë nuk shtroheshin me fuqinë urdhëruese që kanë sot.

“Nevoja jonë më kryesore në pikëpamjen kombëtare, sot është përtëritja e një jete të qytetëruar dhe fitimi i kulturës së një jete të tillë, pasi në raportin midis kulturës dhe qytetërimit, nisja është kultura. E kjo për shkak se përpjekjet politike në mes të një populli me kulturë të shëndoshë, por me një qytetërim të shprishur dhe të një populli me kulturë të shprishur, por me një qytetërim të shëndoshë, përfundojnë gjithmonë në favor të popullit të parë. Kultura triumfon kurdoherë³⁸.”

Duket qartë se tehu i penës së këtij brezi mendimtarësh jo vetëm ishte i mprehtë në prerjen e kallëpit të ideologjisë së jetës shqiptare, por kishte arritur të paralajmëronte edhe rrezikun më kanosës të saj, nevojën e një **kulture të plotë e sistematike**, që duhet të karakterizojë jetën mendore të popullit.

“Vallë, pse tash tridhetë e ca vjet të pamvarësisë, me të gjitha përpjekjet për kulturë, erdhëm e u vorfnuem shpirtnisht? Ky problem i madh, për mue, ka një shkak të vetëm,

37. Ndriçim Kulla, “Antologji e mendimit shqiptar, “1870-1945”, ShB “Plejad”, botimi i parë 2003, fq. 465.

38. “Vepra”, Branko Merxhani, Sh.B. “Plejad”, 2003, fq. 142.



nji spjegim të thjeshtë: rreziku i ynë pse vumë leskër kulture d.m.th. nuk morëm kulturën vetë, por morëm format e përfitimet e kulturës dhe i përshtatëm; shndërruem vlerat objektive me vlerat relative; përparuem për dukë, ndërsa realisht në shpirt borëm shumë, mbetëm mbrapa; u dhamë randësi të parë mjeteve e harruem qëllimin; tue kërkue ta bajm jetë sa ma të lehtë, shvleftësuem jetën vetë. ***Lavrimi e mendjes, trajtimin e vullndesës, ndiesitë e nalta shpirtnore i qitëm e i lamë në vend të dytë e të tretë. Faktori shpirtnor nuk pati vendin e vet, vendin e pare.***³⁹”

Flaka e shpirtit reformonjës në historinë shoqërore dhe politike të një vendi, përbëhet pikërisht nga jeta dhe ideologjia e atyre njerëzve që shërbyen për t’ia ruajtur dhe pasuruar vlerat gjatë periudhave të caktuara të saj, ku më e pakta që mund të thuhet është se kemi të bëjmë me aktet më dramatike të një drame sociale të shpirtit të kombit, shpesh të ndërfutur brenda vorbullës së idealeve dhe ndërgjegjes më të thellë të rilindjes së dinamizmës kombëtare. E në historinë e Shqipërisë, flaka e një lëvizjeje të tillë me të vërtetë reformonjëse shndriti me germa të ngulitura thellë Brenda shpirtit të saj tek neo-shqiptarizma dhe ideatori i vet më i madh, Branko Merxhani: ***“Krijimi i një jete intelektuale duhej të ishte baza sociologjike, psikologjike, dhe historike e kësaj doktrine të re”***.

Sot, shqiptarët kanë një dëshirë të madhe që të gjithë të bëhen qytetarë të lirë të Evropës Demokratike. Por, shqiptarët, sot kanë probleme të mëdha me veten dhe shtetin e tyre. Mendësia shqiptare po qëndron e pambrojtur, e fragmentarizuar përballë problemeve të mëdha që ekzistojnë, sidomos përballë shansit kombëtar që na ka trokitur për të ndryshuar të ardhmen tonë. Po ta vrojtosh dhe ta analizosh me paanësi jetën e shtypit në përgjithësi, do të thuash në fund një të vërtetë, se nuk ka një opinion të vërtetë publik të kristalizuar, që të tregojë veten e tij si një fuqi udhëheqëse dhe bindëse mbi zhvillimin e jetës sonë shqiptare. ***Gjithashtu, është sërish e vërtetë se nuk kemi edhe një lëvizje mendore të pjekur dhe të formuar gjer në atë shkallë sa të mund të arrijë të krijojë refleksime mbi jetën tonë shoqërore.***

Veçse edhe njëherë tjetër na vjen në ndihmë trashëgimia e vyer e korifejve të mendimit shqiptar. Në shkrimet sociologjike, vështrimit të tyre nuk u ka shpëtuar asnjë problem i qenësishëm shoqëror, siç mund të jetë raporti i brezave, gjendja e gruas, kriza e familjes shqiptare, pengesat e mënyrës orientale të jetesës dhe predikimi i tyre për t’i

39. Ndiriçim Kulla, “Antologji e mendimit shqiptar”, ShB “Plejad”, 2003, fq. 493.

zgjedor ato me mënyrën e të jetuarit dhe të punuarit perëndimor.

Është me rëndësi nevoja e rimarrjes seriozisht të njohjes me trashëgiminë tonë historike. Pa kuptuar këtë trashëgimi do ta kemi vështirë të sigurojmë një kulturë të qëndrueshme qytetare, e cila do të prodhojë në të ardhmen qytetarë shqiptarë dhe globalë njëkohësisht. Njohja me mendimin rilindas është nevojë që prek të sotmen, por edhe të ardhmen tonë.

“Realisht, shqiptarët gjithnjë e kanë patur dëshirën për të qenë të parët dhe kanë rezultuar të fundit. Ndoshta nuk kanë patur mundësi, ndoshta koha nuk i ka lejuar, ose ndoshta vetë ata nuk kanë kuptuar se cili qe vendi i ‘parë’. Ndoshta! Por ‘çuditërisht’ në ngjarje që kanë ndryshuar pamjen e popujve të Evropës, ne kemi qëndruar në fund. Kemi ardhur me vonesë në ‘gostitë’ politike e sociale të Evropës. Të fundit në rrëzimin e diktaturës. Madje edhe sot jemi ende në fund, kur popujt e tjerë e kanë gjetur rrugën drejt Evropës së Bashkuar. Pse me kaq vonesë?⁴⁰”

Sigurisht që përgjigjja vjen vetë: **për shkak se nuk kemi ndonjë traditë në fushën e edukimit e aq më pak në fushën e edukimit filozofik.**

“Të studiosh mendimin politik shqiptar, do të kuptosh shumë më mirë sjelljen e shqiptarit të shekullit të ri. Por kaq nuk do të mjaftonte. *Të njohësh është njëra anë e medaljes, tjetra është ta vësh në punë këtë njohje.* Nëse arrijmë e kuptojmë atë çka kemi trashëguar keq, do duhet të ndalemi për ta korrigjuar e, atë çka kemi trashëguar mirë, do duhet ta përforcojmë. Vetëm kështu do ecim në rrugëtimin tonë të sigurt, që nuk do jemi me vonesë.⁴¹”

Ndaj Branko Merxhani shkruante: *“Të mësuarit nuk është të edukuar.* Sepse vetëm atëherë kur të arrijmë të formojmë edukatën e brendshme dhe dispozitat shpirtërore dhe ideologjike të një brezi, vetëm atëherë mund të arrijmë të nxjerrim ndoshta një ditë njëfarë qytetërimi. Por s’do të arrijmë kurrë një “kulturë”, pasi diçka e tillë lyp një individualizëm ideologjik të goditur dhe një dozë të qëndrueshme moraliteti” (’30). “Vetëm vlera shoqërore e njeriut i jep atij një ‘kulturë’”, - thotë Kanti (A kemi vallë në gjirin e jetës intelektuale njerëz që mund të quhen vërtetë “njerëz të kulturës” nën prizmin e vlerësimit të kulturës nga kritere të tilla? Apo mos ndoshta një “kulturë” e tillë sot duhet të kthehet në një ideal udhërrëfyes?).

40. Zamira Cavo, “Ridimensionimi i Rilindjes”, Shtëpia Botuese “Naimi”, faqe 323.

41. Zamira Çavo, “Ridimensionimi i Rilindjes”, Shtëpia Botuese “Naimi”, faqe 323.



Ndjenja kolektive! Njeriu-qytetar! Jeta intelektuale që influencon shoqërinë! Ja, sfidat që si të trashëguara, na kanë ndjekur vazhdimisht pas, e që sot na shfaqen me gjithë qelibarësinë e domosdoshmërisë dhe jetikën e dhimbshme të aktualitetit të tyre⁴².

“Theksimi i jetës intelektuale dhe kulturore ishte, dhe mbetet përsëri, rruga kryesore për t’i dhënë një kombi ushqimin e domosdoshëm shpirtëror dhe moral për të pretenduar madhështi dhe lavdi. Një Shqipëri e lirë dhe demokratike kërkonte jo vetëm lirinë kombëtare, por, mbi të gjitha duhej të organizonte **lirinë shoqërore**. Pra, pas lirisë kombëtare kërkohet emancipimi intelektual dhe kulturor për lirinë shoqërore⁴³”. Vlera e kësaj analize të Profesor Sinanit vlen edhe në vërtetësinë e pohimit se edukimi me lirinë mbetet ende sfida e edukimit të shqiptarëve të shekullit XXI, shekull i sfidës së humanes për një zhvillim global të qëndrueshëm. Tradita na sjell mendimin dhe instrumentet për këtë zgjidhje sikur na bën të mendojmë në mënyrë kritike dhe për pasojat e reformave në edukim që shmangin këtë edukim me lirinë për ne dhe gjeneratat e reja.

42. Branko Merxhani, “Vepra”, Shtëpia Botuese “Plejad”, 2003, fq. 341.

43. Gjergj Sinani, Parathënie e “Enciklopedi antologjike e mendimit shqiptar”, Vëllimi i I, (1807-1927), Shtëpia Botuese “Plejad”, faqe 9.

EDUKIMI PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM



UNESCO "Shaping the future we want", Final Report, 2005-2014, fq.89.

KAPITULLI III

EDUKIMI NË SHQIPËRINË E SHEKULLIT XXI

III. 1 EDUKIMI FILOZOFIK NË ARSIM

Nevoja për një edukim filozofik të qëndrueshëm në kushtet e Shqipërisë, përtej rekomandimeve të UNESCO-s për edukimin filozofik, lidhet edhe me dy arsye madhore tonat:

- a) Fakti që, sikundër u provua më sipër, nuk kemi një trashëgimi të edukimit arsimor e aq më tepër të edukimit filozofik, kjo duket mjaftueshëm në sjelljen dhe kulturën tonë qytetare e politike. Pasojë e kësaj sjellje është varfëria, korrupsioni, mungesa e pjesëmarrjes etj.
- b) Nevojat e ngutshme për t’ju qasur parametrave globalë në fushën e edukimit dhe zhvillimit. Varfëria dhe paqëndrueshmëria ekonomike e bëjnë jetike nevojën për *shndërrimin e kapitalit njerëzor nga inaktiv në të investuar*. Shqipëria është ende një vend me popullsi me moshë mesatare të re. Kjo do të thotë se burimet njerëzore ekzistojnë, por janë inaktive dhe të papërgatitura për sfidat e kohës.

Për të, këto arsye edukimi filozofik në procesin arsimor, marrin një rëndësi të dorës së parë. Në fillim të këtij mijëvjeçari, arsimi në vend ka filluar me disa reforma, të cilat kanë synuar më së paku të afrojnë parametra vlerësues e krahasues me sistemet e tjera bashkëkohore. Analiza e këtyre reformave dhe krahasimi i tyre me kërkesat dhe standardet botërore në lidhje me sistemin e edukimit filozofik, dëshmon mangësitë e këtyre reformave, si dhe tërheq vëmendjen në orientimet e së ardhmes.

Nismat globale, si “Edukimin për të gjithë”, “Edukimi në Mijëvjeçarin e Ri” etj., kanë shërbyer si katalizatorë për reformime rrënjësore në sistemet arsimore të shumë vendeve në zhvillim, përfshirë dhe Shqipërinë. Nisma të tilla kanë ofruar strategji të ndryshme dhe plane veprimi për arritjen e reformave të thella në sistemet arsimore të vendeve implementuese. Përmbajtja dhe mesazhi i këtyre lëvizjeve globale për



arsimin zbërthehen përmes 12 hapave, të cilët janë edhe pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar Shqiptar, 2009-2015. Ndër hapat e rekomanduar për zhvillimin e lëvizjes "Edukim për të gjithë", në kuadër të nismave evropiane për përmirësimin dhe humanizimin e arsimit në rajon, veçojmë:

- Zhvillimi i metodave të mësimdhënies që inkurajojnë pjesëmarrjen dhe zhvillimin individual.
- Reformimi i sistemit të provimeve që shoqëron çdo nxënës për të demonstruar arritjet e tij/saj.
- Stimulimi ekstra i kurrikulës mbështetur në nivel shkolle.
- Rritja e pjesëmarrjes së prindërve dhe komunitetit në jetën e shkollës.
- Investigimi i punëve të ndaluara të fëmijëve dhe përfshirjes së tyre në shkollë.
- Kujdesi në cilësinë e edukimit të fëmijëve nga shtresat dhe familjet e varfra.
- Integrimi i fëmijëve me paafësi në edukim.
- Inkurajimi i zhvillimit të fëmijërisë së hershme dhe atyre me nevoja të veçanta.
- Vëmendje për edukimin në grupin e fëmijëve të pakicave.
- Respektimi i të drejtave të fëmijëve të komunitetit rom.
- Kontrolli i cilësisë së shkollës në nivel lokal dhe qendror përfshirë edhe kurrikulën.
- Decentralizimi dhe transferimi i buxhetit nga qeverisja qendrore në atë lokale⁴⁴.

Tabela 25

Arsimi Publik dhe privat							
	Gjithsej	Parashkollor	%	Bazë	%	I mesëm	%
Nr. i nxënësve	627,127	81,865	13.05	390,837	62.32	154,425	24.62
Nr. i institucioneve	3,609	1,911	50.30	1,472	38.75	510	13.42
Nr. i mësuesve	38,371	4,498	11.72	25,263	65.84	8,610	22.44

Por vërehet një paradoks: nga njëra anë politikat arsimore synojnë drejt përmirësimit të standardeve edukative në sistemin arsimor parauniversitar, nga ana tjetër vërehet një ulje e ndjeshme e nivelit të regjistrimit dhe frekuentimit të arsimit parauniversitarë.

44. Mimoza Gjokutaj. "Shqipëria: Situata në arsimin parauniversitar, Raporti i vlerësimit, 2013."

Sipas statistikave, niveli i regjistrimit në shkollat fillore është mjaft i lartë (rreth 95 %) dhe thuhet gjysma e këtyre nxënësve i nënshtrohen për herë të parë një sistemi formal edukimi (niveli i frekuentimit të arsimit parashkollor përlogaritet rreth 50 %⁴⁵). Aspak premtuese janë statistikatat për arsimin e mesëm, të përgjithshëm dhe profesional, ku niveli i regjistrimit në shkolla të mesme është rreth 70%, por ai i frekuentimit nuk i kalon 40 %. Aksesit në arsimin parauniversitar paraqet nivel të ulët në krahasim me vendet e OECD-së. Mesatarja e ndjekjes së shkollës në Shqipëri është 11.9 vjet, ndërsa në vendet e OECD-së është 14 vjet, gjë që shpjegohet me strukturën e vetë sistemit tonë arsimor, si dhe me shkallën e ulët të frekuentimit të arsimit të mesëm. Gjithashtu, *vihet re një variacion edhe brenda vendit, ku një nxënës në Tiranë ndjek mesatarisht 3.5 vjet më shumë arsimin parauniversitar, krahasuar me mesataren në vend.*

Tabela 25/1

Të dhëna mbi institucionet arsimore parauniversitare në rang vendi.

Arsimi Publik dhe privat	Gjithsej	Parashkollor	%	Bazë	%	I mesëm	%
Nr. i nxënësve	627,127	81,865	13.05	390,837	62.32	154,425	24.62
Nr. i institucioneve	3,609	1,911	50.30	1,472	38.75	510	13.42
Nr. i mësuesve	38,371	4,498	11.72	25,263	65.84	8,610	22.44

Tabela 26

**Të dhëna mbi institucionet arsimore publike parauniversitare në rang vendi
2012-2013.**

Arsimi Publik	Gjithsej	Parashkollor	%	Bazë	%	I mesëm	%
Nr. i nxënësve	584,078	76,735	13.14	370,238	63.39	137,105	23.47
Nr. i institucioneve	3,303	1,778	51.40	1,346	38.91	385	11.13
Nr. i mësuesve	34,559	4,136	11.97	23,452	67.86	6,971	20.17

45. "Shqipëria: Situata në arsimin parauniversitar", Raporti i vlerësimit; Mimoza Gjokutaj, 2013



Nga të dhënat në këtë raport mbi numrin e nxënësve, institucioneve dhe mësuesve në Arsimin Parauniversitar (2012-2013), vihet re se **në sistemin parauniversitar dominon shërbimi publik**, me një total prej 3303 institucionesh kundrejt 306 institucioneve private (vetëm 9%). Gjithashtu, numrin më të madh e zënë institucionet e arsimit parashkollor (1911), ndjekur nga ai bazë (1472) dhe së fundmi arsimit mesëm (510).

Ekzistenca e institucioneve të arsimit është vetëm "a"-ja e krijimit të sistemit të arsimimit, por thelbi mbetet produkti që krijohet, dhe ky produkt sjell impaktin e vet në gjendjen aktuale ku ndodhemi pas 24 vitesh tranzicion demokratik.

Analiza e kësaj gjendjeje (sot vazhdojmë të konsiderohemi vendi më i varfër në Evropë, me tregues të lartë të korrupsionit, me nivele të larta të krimit dhe me shfaqje demokracie infantile), dëshmon se ky produkt nuk është me cilësinë e parametrave që kërkon koha.

Ndaj, reformat që bëri Shqipëria në arsim e që lidhen në standardet e përcaktuara nga UNESCO-ja sa nuk u njohën si duhet po aq nisën të cinguara kur pretenduan reforma, sikurse, mbetën edhe përgjysmë në kohështrirjen e tyre.

Arsyet janë sa politike, aq dhe mungesë vizioni nga drejtuesit e reformave.

Më konkretisht:

Takimi i ekspertëve të UNESCO-s në 1998⁴⁶ ka dhënë një sërë rekomandimesh për FpF-në (Filozofinë për Fëmijë), duke ripohuar rolin e madh që ka filozofia në mësimin e demokracisë. Takimi theksoi me forcë rëndësinë e shtrirjes së edukimit filozofik nga kopshtet drejt shkollave të mesme. Këto rekomandime duhet të respektonin edhe specifikat që kanë sistemet e edukimit në vende të ndryshme, si edhe kulturat respektive përkatëse.

Rekomandimet përfshijnë:

- *ndryshimet kurrikulare në 3 nivelet: kopsht, arsim i detyruar, arsim i mesëm;*
- *kualifikimi i mësuesve jo vetëm i atyre të filozofisë dhe qytetarisë, por edhe i mësuesve të tjerë me metodat që ofron dija filozofike;*
- *shkëmbimi i përvojave dhe reflektimeve mes niveleve të ndryshme të parauniversitarit.*

46. UNESCO, "Philosophy for children": Meeting of experts, 26, 27 march, 1998, p. 29.

Për të qartësuar edhe më shumë prioritetet nga takimi u ravijëzuan **6 fusha**:

1. ***Të menduarit për veten***, si zhvillim i shprehive gjykuese, mendimit kritik dhe të ndërtimit të kapaciteteve për të menduar rreth vetes nga fëmijët dhe adoleshentët.
2. ***Të edukuarit me kuptimin e plotë mbi qytetarinë***, ku komunitetet e fëmijëve në shkollë ndërtojnë debatin dhe aftësitë për të debatuar në demokraci.
3. ***Të ndihmuarit në zhvillimin personal të fëmijëve***, kjo përmes të mësuarit logjik.
4. Fuqizimin përmes aftësive të gjuhës, të folurit dhe debatit nën moton: ***“Mendojmë duke folur”***, fokusuar në ndërtimin e grupeve të diskutimit, kapaciteteve gjuhësore, veprimit dhe ndërveprimit social intelektual, sikurse dhe formës së prezantimit.
5. Të tërhequrit e fëmijës në këndvështrimet filozofike të pyetje-përgjigjeve apo në proceset e të filozofuarit ***përmes mendimit kritik dhe argumentit***, “Jo” formalitetit dhe përsëritjes.
6. ***Ndërtimin e didaktikës për fëmijë bazuar në filozofi dhe të filozofuar***, të refleksionit mbi identitetin e tyre, marrëdhëniet me të tjerët dhe botën rreth tyre.

A ju përgjigj Shqipëria këtyre rekomandimeve?

Në vitin 1998-të, Shqipëria ndërmori reformën në sistemin e arsimit të mesëm, duke sjellë një qasje sa të nevojshme, aq edhe bashkëkohore. Arsimi i mesëm u organizua në **dy degë: arsim i mesëm i përgjithshëm i profilizuar** dhe **arsimi i mesëm profesional**. Vetë arsimi i mesëm i përgjithshëm u nda në **dy profile: shkencor** dhe **shoqëror**. Filozofia ishte pjesë e kurrikulës bazë në të dy profilet, duke patur epërsi në orët javore, plus 1 orë në profilin shoqëror. Ndërsa tekstet e filozofisë u qasën nga filozofi problemore (nga Prof. Artan Fuga) në histori filozofie pas vitit 1998 (nga Prof. Gjergj Sinani). **Shqipëria përfaqëson një rast unik në konceptimin e reformave në arsim apo në lëndë të veçanta. Reformat konceptohen sa herë kemi rrotacione politike, sikurse ndërmerren pa asnjë analizë të përfitimeve apo risqeve që krijoi ndryshimi i mëparshëm.**

Nëse shohim kulturën e reformimit në Francë për filozofinë, do të vërejmë se në licetë franceze, në vitet 1973 deri në 2001, u mbajt i njëjti sistem mësimdhënës i filozofisë. Vitet më pas sollën debatet mbi ndryshimin e saj (në 2003-shin) dhe vetëm në 2005-ën u aprovua një program tjetër, ku fituesi programi i hartuar nga grupi Fichat u shpall i tillë pas një konkurrence dhe debatesh me të tjera programe të lëndës.

Ndërsa në Shqipëri (pas ‘98-ës, Reforma për shkollën e mesme të profilizuar), kur



u kalua në një **këndvështrim tjetër të konceptimit** të edukimit filozofik në shkollën e mesme (nga probleme filozofike në histori filozofie) ai nuk u parapri dhe nuk u mbështet nga debati dhe konkurrenca ideore, dhe jo më të tentohej të fuqizohej në program-tekstin për mësues, apo të përfshihej në sistemin e organizuar të kualifikim-trajnitimit për mësuesit në sistem nga institucioni përgjegjës (ISP) për to dhe pse jo nga fakulteti respektiv ku prodhohej mësuesia për filozofi. Investimet nga Instituti i Studimeve Pedagogjike (ISP, njësi përgjegjëse në nivel kombëtar) për trajnim dhe kualifikim të stafëve mësimore në grup-lëndët e shkencave shoqërore u kufizuan në kualifikimet e këtyre mësuesëve në "Edukim qytetar" dhe "Edukim me të Drejtat e Fëmijëve", **duke e minimizuar misionin dhe ndikimin që do të kishte edukimi filozofik dhe edukimi përmes procesit të filozofuarit në vetë cilësinë e lëndës**, por edhe në krejt grup-lëndët nëse edukimi me të "filozofuarin" (përfshirë edhe filozofinë) konceptohej si një kroskurrikul (për të gjithë mësuesit në shërbim), sidomos pas ngjarjeve që vendi ynë kaloi në 1997-ën. Po në të njëjtat vite, në një dokument të Reformës Franceze në arsim (2001), ndërsa flitej për domosdoshmërinë e filozofisë në licetë franceze, thuhej: **"Mësimdhënia e filozofisë luan ndërkaq një rol krejt të veçantë, në masën që ajo ndërhyr në vetë momentin kur individi përballet me zgjedhje që do të strukturojnë jetën e tij si adult (i rritur) dhe qytetar⁴⁷".**

UNESCO në 1995-ën, në vëzhgimin që bie mbi "Filozofia dhe demokracia në botë", shprehej: **"Mësimdhënia e filozofisë kontribuon në krijimin e qytetarëve të lirë. Ajo (filozofia) inkurajon të gjykosh për veten, të kundërvësh të gjitha llojet e argumenteve, të respektosh atë që të tjerët kanë për të thënë dhe t'i nënshtrohesh vetëm autoritetit të arsyes.⁴⁸".**

Minimizimi i mësipërm nga reforma shqiptare nuk qasej me këtë koncept.

Pra, kjo reformë, sikundër shihet, ishte e pa plotë për këtë nivel arsimor, pasi nuk përfshiu kualifikimet e mësuesve që ishin në shërbim për të mos pretenduar për refleksionet e saj mbi universitetet që prodhonin "mësues". Ajo nuk rroku dot as nivelet e tjera të edukimit sikundër ishte edukimi parashkollor apo ai 8-vjeçar, sikundër këshillohej për politikbërjen në arsim. Në të njëjtën kohë, me fillimin e mijëvjeçarit, vendet e tjera reformuan sistemin në të gjitha nivelet duke ju përgjigjur kështu të gjitha rekomandimeve të UNESCO-s.

47. Annexe de l'arrêté de programme de philosophie des classes terminales des séries généralés (1/VI/2001).

48. Philosophy and democracy in the World, UNESCO's survey, UNESCO Publishing, 1995, p. 8. Philosophy and democracy in the World, UNESCO's survey, UNESCO Publishing, 1995, p. 8.

Dhe pse reforma për një edukim filozofik filloi dhe mbaroi në vetëm një nivel studimi, në shkollën e mesme, sërish kjo reformë nuk arriti të kapërcente të gjitha fazat e saj, ndaj, dhe pse shtrirja horizontale u duk e plotësuar, *shtrirja vertikale e reformës, ajo e cilësisë së burimeve humane, mbeti e porealizuar*. Mungesa e debatit publik mes profesionistëve, në institucionet e specializuara dhe në mjediset shkollore, politika dhe orekset e saj për “Risi pas rrotacioneve politike”, puna me “grupazhe teknikienësh” jo me përfshirje në debate e projekte konkurruese ka fituar dhe vazhdon të fitojë mbi apolitizimin dhe kompetencën shkencore, që duhet të kenë institucionet shkencore të arsimit në Shqipëri, kjo edhe për rastin e filozofisë dhe statusit të saj në kurrikulën e arsimit shqiptar.

Pas “mosqëndrueshmërisë” në zhvillimin dhe matjen e politikave arsimore reformuese, që pretendojmë se kemi realizuar këto 20 vite, pas konceptimit, *financimi* mbetet pika e dobët e çdo reforme arsimore. Sistemi parauniversitar në Shqipëri merr pjesën më të madhe të Buxhetit Vjetor për Arsimin, duke e përafëruar me raportet e OEC-së dhe BE-së sipas të cilëve raporti i Shpenzimeve për Sistemin Parauniversitar me atë Universitar duhet të jetë në nivelet 4:1.⁴⁹

Ndonëse fondet ekzistojnë dhe do vijnë edhe në rritje, procesi i reformimit haset me vështirësi të natyrave të ndryshme.

- **Së pari**, mosrespektimi i standardit të depolitizimit të drejtuesve të institucioneve arsimore dhe shkencore në vend, siç është rasti i rëndësisë që merr ky standard për ISP-në etj. (sot Instituti i Zhvillimit të Arsimit, përgjegjës për reformimin e APU-së në vend).
- **Së dyti**, ndryshimet, proceset reformuese në arsim duhet të paraprihen nga analiza dhe platforma konkurruese përmes debatit në ambiente akademike dhe mësimdhënëse.
- **Së treti**, politika e pastabilizuar e karrierës profesionale në arsim, apo liberalizimi i sistemit të krediteve dhe qendrave kualifikuese që ofrojnë shërbime (pas vitit 2010), kanë sjellë një paqëndrueshmëri në objektiva edukative sa edhe mungesën e formimeve prioritare afatgjata që na nevojiten në edukim, në nivel qendror apo lokal.
- **Së katërti**, politika e liberalizimit të teksteve shkollore e pas vitit 2005, *Altarteksti*, ka prodhuar një kaos në vetë procesin e edukimit. Në kurrikula të

49. Strategjia Kombëtare e Arsimit, në RSH, 2009-2013.



paqëndrueshme, në ndryshime kurrikulare të paparapirra nga analiza vendase gjendjesh në edukim (ndërsa standardet botërore kanë ofruar shumë të tilla në vite për ne, si PISA), tekstet në shkolla i bën një aset i rëndësishëm për mësuesit dhe nxënësit. Përdorimi i një numri të madh tekstesh (eksperienca deri në vitin 2013 njohu deri në 12 tekste për të njëjtën lëndë), përkundrejt të njëjtit program, në një vend të vogël si yni vë në pikëpyetje qëndrueshmërinë dhe cilësinë e dijes në sistemin arsimor parauniversitar.

- **Së pesti**, mungesa e një raporti më të balancuar mes arsimit profesional dhe atij të përgjithshëm ka ndikuar në cilësinë e përgjithshme të arsimit parauniversitar. Megjithë ambicjen e liderit politik (pas vitit 2005-së) për të arritur në raportin 40/60 në favor të arsimit të mesëm të përgjithshëm, përmirësimi në përfshirjen e nxënësve në këtë nivel në arsimin profesional mbetet ende utopi.
- **Së gjashti**, sistemi parauniversitar ofron pak mundësi për arsimimin e grupeve sociale me disavantazhe. Fëmijët nga shtresat më të varfëra të shoqërisë kanë një qasje mjaft të ulët ndaj arsimit parauniversitar dhe në rastet kur është shërbimi i ofruar nuk është cilësorë. Kritike mbetet situata për fëmijët nga komuniteti rom, ku shkalla e analfabetizmit është shumë e lartë. Gjithashtu, sistemi parauniversitar në Shqipëri nuk parashikon asnjë masë mbështetëse apo përshtatje me nevoja specifike për fëmijët me aftësi të kufizuara. Mund të përmend fëmijët me sindromën daun ose autik.

Sikundër shihet, reforma arsimore, e pos 2005-ës, në veçanti zhvillimet në të për vitin 2009-2012, nuk dëshiruan t'u përgjigjeshin kërkesave të UNESCO-s, përkuar kjo edhe me mungesën e pohimit të këtij cilësimi, si "EZHQ", ndërsa shprehej si 'Edukim për të gjithë' apo "Cilësia në arsim" por me një tendencë të diskriminimit të vendit dhe rolit të edukimit filozofik në të. Për shkak të këtyre arsyeve të mësipërme apo të statusit në degradim që çoi dijen dhe edukimin filozofik në APU, *këto reforma nuk kanë sjellë produkte të qëndrueshme në cilësitë humane në arsim e për pasojë nuk mund të vlerësojmë dot as arritjet apo mangësitë në qasje cilësore me atë çfarë i duhej Shqipërisë me zhvillim të qëndrueshëm për gjeneratat e reja dhe raportimet e saj në këtë përmblyllje të DEZHQ-së.*

Punimi vazhdon t'i referohet kërkesave që UNESCO ka vënë dhe për edukimin për një zhvillim të qëndrueshëm në këtë dhjetëvjeçar. Kjo, përmes krahasimit të këtyre

kërkesave me ndryshimet e ideuara nga reformat në nivele të ndryshme të edukimit shqiptar, nga parashkollori tek ai universitar.

Në aspektin gjuhësor dhe në komunikim publik, prej 2 vitesh, kemi një faktor mbështetës për punimin, pasi, që prej korrikut të 2013-ës, Qeveria shqiptare, Zhvillimin e Qëndrueshëm në vend, e ka shpallur si mision qeverisës ndërkohë që nuk bashkëqaset me Edukimin për ZHQ-në nga politikbërja e MAS.

Le të shohim qasjet që kishte marrë, ka dhe duhet të marrë arsimit shqiptar sipas këtyre standardeve për EZHQ-në në çdo nivel të arsimimit të gjeneratave të reja, bazuar në edukimin filozofik që UNESCO e ka modeluar në përvoja dhe sugjerime për institucionet arsimore dhe vendimmarrëse që prej 2007-ës, në kuadër të Dekadës së Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm (DEZHQ).

III. 2 ARSIMI DHE EDUKIMI FILOZOFIK NË SISTEMIN PARASHKOLLOR

Që prej fillimit të shekullit të kaluar, **Xhon Djuj**-i jo vetëm e kuptoi, por edhe e shtroi me forcë nevojën e edukimit filozofik në sistemin arsimor. Sipas tij, ekziston “*një marrëdhënie e ngushtë dhe jetike midis nevojës për filozofi dhe domosdoshmërisë për arsim*”. Modeli filozofik i të mësuarit është modeli që çon drejt edukimit me kërkimin e mundësive që ka njeriu drejt një jetese më të mirë. Nëse arsimit synon një aftësim dhe edukim të fëmijëve është e natyrshme që ky edukim të përfshijë detyrimisht dhe të menduarit filozofikisht.

Në veprën e tij “Shkolla dhe Shoqëria”, 1899, ai shprehej se, kur fëmijët fillojnë arsimin zyrtar kanë në vetvete **4 shtysa të lindura**:

1. *shtysën për të komunikuar,*
2. *shtysën për të ndërtuar,*
3. *shtysën për të pyetur,*
4. *shtysën për të shprehur në formën më të zgjedhur.*

Këto ai quan “**burime natyrore, kapital i painvestuar**”, nga ushtrimi i të cilave varet rritja gjithmonë në veprim e fëmijës. Është detyra e edukatorëve në sistemin arsimor që ta vlerësojnë, ta përdorin këtë kapital me qëllim që, në bashkëveprim me atë të edukatorëve në sistem të prodhojnë **vlera humane dhe standarde të sistemit**.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, 1989, ka qenë dhe është një dokument referent për llogaridhënës, pikësëpari, për çdo qeveri a organizëm shtetëror në qëllime a objektiva



direkte apo reflektare të punës me fëmijët apo të shërbimeve të ofruara atyre. Konventa me përmbajtjen e saj filozofike është një kontribut shërbim, i mendjes njerëzore për fëmijët pa dallim race, kombi, kulture, e për më tepër është instrumenti filozofiko-politik që mundëson shanse të barabarta për çdo fëmijë, në vetëqenësi, vend dhe rol në jetën shoqërore.

Detyrimet dhe interpretimet rreth saj janë një pjesë e atij ushqimi që i duhet realizuar fëmijëve, me qëllim që mendimi dhe cilësia e tij të ushqejë veprimin në shoqëri, pra janë “praktizim” i filozofisë pedagogjike funksionaliste të Djui-t rreth 1 shekull më parë. Thelbi i kësaj Konvente ka të bëjë me një ripërcaktim të konceptit “fëmijë”, i cili ka nevojë: a) për mbrojtje, b) për shërbime të veçanta, c) për të marrë pjesë aktive në jetën e tyre.

Qëllimin e këtij edukimi e shprehin qartazi disa nene të kësaj Konvente.

Në Nenin 12 të Konventës, theksohet “e drejta për të shprehur lirshëm mendimin”; Neni 13, “e drejta për lirinë e shprehjes...për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacion dhe ide të çdo lloji”; Neni 14, “liria e zotërimit të mendimit”.

Nga ky përcaktim mund të konkludojmë në nevojën e studimit të dy elementëve që e mundësojnë këtë qasje konceptuale:

a- Edukimi, kurrikula edukative, e cila do mundësojë këtë mënyrë edukimi.

b- Edukatorët (edukatorët dhe mësuesit), të cilët do mundësojnë realizimin e kësaj kurrikule dhe shndërrimin e “kapitalit të heshtur” në kapital të investuar.

Kjo do të thotë, se analiza e standardeve të një edukimi me qasje filozofike si nevojë konkrete e një realiteti faktik, domosdoshmërisht kërkon dhe formatimin e një edukatori të aftë për të kuptuar kurrikulën e për ta përcjellë që nga moshat parashkollore.

Kjo mënyrë e analizës përcakton atë që, arsimimi në tërësi duhet të realizojë në qenësinë e tij, të Drejtat e Fëmijëve. Një fëmijë i dhunuar në këto të drejta, i keqtrajtuar as që mund të mendohet se mund të jetë një pjesëmarrës aktiv real, për më tepër që të mendohet se ai ose ajo do të mund të jetë autor/e i/e jetës së tij/saj.

Nga ana tjetër, një fëmijë që nuk merr pjesë në mbrojtjen e tij/saj kthehet në një objekt, pasiv në të cilin të tjerët imponojnë gjithçka mbi të. Koncepti “interesi më i mirë i fëmijës”, Neni 3, ka një rëndësi të veçantë për atë që arsimi (institucione e subjekte arsimore) duhet t’i njoh vetes në raport me rëndësinë që ka filozofia dhe mënyrën e të filozofuarit në nxënien e dijes drejt shprehive qytetare.

Dhjetëvjeçari i fundit i shekullit XX dhe ky dhjetëvjeçar i shekullit XXI ka shprehur

tendencën e shumë edukatoreve të fëmijëve që **krijojnë kushte të kërkojnë rrugë e vende të reja të bashkëveprimit me “komunitetin filozofik të pyetjeve”**. Kështu, edukatorët e këtij shekulli janë të angazhuar në praktika filozofike me fëmijët përmes një dëshire detyruese për t’u realizuar nga ato vetë përballë një historie që ushtron jo pak presion në vite mbi atë që “si duhet t’i arsimojmë këta fëmijë që nesër të jenë të rritur të përgjegjshëm në këtë botë globale?”. Kjo pyetje në përgjigjen që pret, pikësëpari, i kërkon refleksionin filozofik të vetë edukatorëve.

Nuk është e rastit që në tryezat botërore të edukimit nëpërmjet arsimit të silltet si problem kryesor nevoja për një edukim filozofik si pjesë e shtyllës së arsimimit të brezave të rinj. *Edukimi filozofik nuk është thjeshtë lënda e filozofisë, por është qasja e të gjitha lëndëve ndaj këtij edukimi*. Por kjo kërkon një rifomatim të të gjithë kurrikulës shkollore dhe njëkohësisht gjetjen e mundësive konkrete për të siguruar nivelin e mësimdhënies në të gjitha lëndët, sipas qasjeve filozofike. *Të edukohesh filozofikisht do të thotë të krijosh atë model qytetari që i shërben vetes dhe të ardhmes së përbashkët*.

A mund të kemi një edukim filozofik në nivelet e një formimi parashkollor?

Sigurisht, përgjigjja është pozitive. Modele të edukimit filozofik janë modele të njohura prej kohësh. Por, në kushtet e një progresi të jashtëzakonshëm të teknologjive të komunikimit dhe ndryshimeve të vrullshme që përjeton vetë shoqëria njerëzore, edukimi i specializuar filozofik në moshat parashkollore merr përparësi.

III. 2.a Modelet bashkëkohore të edukimit filozofik në sistemin parashkollor

Po analizojmë modelin francez⁵⁰ të edukimit nga parashkollori deri në 10 vjeç. I gjithë ky sistem mbështetet në disa shkolla e FpF. Kështu, referuar informacioneve që jepen në studimin e UNESCO-s, të vitit 2007, mësojmë se përdoren:

1. **Matthew Lipman** dhe metoda e tij është e njohur për ndikimin e madh që ka patur në zhvillimin e FpF-së. Ai këshillon se mund të mësojnë të mendojnë për veten e tyre nëse atyre u sigurohen kushtet që i duhen edukimit. Lipman e zhvilloi metodën e tij bazuar në:

- Konceptin e të mësuarit aktiv të John Dewey nga ana pedagogjike;

50. Nuk është rastësi studimi i modelit francez, pasi, ky model ka qenë modeli referues në arsimin shqiptar para vitit 1944.



- Teoritë e Piaget-it për zhvillimin e fëmijës nga ana psikologjike;
- Teknikat reflektive dhe deduktive që vijnë nga Logjika e Aristotelit për t'u bashkuar me skepticizmin metodologjik dekartian në aspektin filozofik.

2. **Michel Tozi**, i njëjtë me Lipmanin në objektiva, por i fuqishëm në metodikat e debatit demokratik apo debatit të ngritur mbi pyetje filozofike, apo inkurajimin e grupeve të diskursit filozofik pas pyetjeve të tipit filozofik. P.sh, pyetja “A mund të vazhdojmë udhëtimin nën sirenë të ambulancës ndonëse semafori është i kuq?” ku debati ndërtohet: 1) në rrafshin teknik (Po, është e mundur); 2) në rrafshin ligjor (Jo, pasi është shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor.); 3) në rrafshin etik (Mundet dhe dëshirohet pasi nga ky kalim varet jeta e një të sëmuri në sekonda kritike për jetën.).

3. **Oscar Brenifier**, themeluesi i Institutit të Filozofisë praktike, i cili rivlerëson dialogun sokratik, ndihmën për nxënësit dhe studentët për të zhvilluar idetë e tyre nëpërmjet pyetjeve dhe ndërveprimit të rifrazimit nën mendim kritik.

Brenifier i përcakton workshopet e tij si mundësi për të mësuar “artin e të pyeturit”, ndërsa ai i motivon, angazhon pjesëmarrësit në të menduarin, të pyeturin dhe të kuptuarit e ideve. Në një intervistë të dhënë për të përditshmen turke “Zaman” (7 qershor 2015), ndërsa pyetet për cilësinë e edukimit në kohën tonë, ai shprehet: “Sot ka një diskutim në lidhje me nëse ne duhet të largohemi nga konceptimi i arsimit thjesht transmetues në një konceptim më konstruktivist të tij. Kjo është jo vetëm në rastin e filozofisë, por edhe të matematikës, shkencave të tjera ... Kjo është një zhvendosje; ky është një ndryshim shumë i rëndësishëm, paradigmë, dhe kjo është e vështirë”.

Modelet e edukimit filozofik për fëmijë sot bazohen në një seri librash të titulluar “*Filozofia feminare*”. Duke ju referuar botimeve që i dedikohen moshës nga 7 vjeç, propozohen fillesat e para të pyetjeve të rëndësishme që çdo fëmijë ja bën vetes mbi jetën, mbi vetveten, botën. P.sh.: **Teksti shkollor “Çfarë është jeta?” i O. Brenifier** ofron kuptimin për 6 koncepte bazë për fëmijën mbi 7 vjeç:

Lumturia, Ambicia, Fatkeqësia, Ekzistenca, Kuptimi mbi jetën dhe Vdekja.

Ai merr përsipër të ofrojë gjykim të fëmijës mbi disa alternative të jetës praktike të tij për 6 pyetje madhore, të cilat kanë të bëjnë me jetën dhe kuptimin e saj.

Të tilla janë:


1. Si mund të jesh ti i lumtur në jetë?
2. Përse jeta është e vështirë?
3. Përse ekziston njeriu?
4. Përse jetojmë?
5. Do të jesh ti kampion më vonë?
6. Përse vdesim?

Në tekst pyetjeve u ofrohen shumë përgjigje, disa duken të qarta, të tjerat misterioze, të tjera të çuditshme. Të gjitha do të bëhen objekt i pyetjeve të reja, sepse mendimi është një rrugë që nuk njeh fund. Pyetjet mund të mbeten edhe pa përgjigje. “Aq më mirë”, - thotë autori. Nuk është e nevojshme të përgjigjemi. Një pyetje është e pëlqyer, sepse është një pyetje e bukur, sepse paraqet një problem interesant, bartës kuptimi dhe vlere. Të gjitha këto nën mesazhin:

“Të mendosh është një lojë fëmije⁵¹”.

A ka modele që mund t’i sjellim si shembull? Natyrisht që ka shumë të tilla. Por, modeli bazë mbi të cilin mbështetet një edukim filozofik te fëmijët mund të përshkruhet si më poshtë:

Grafik 3. Procesi i të filozofuarit tek fëmijët



51. Koncepti “Lumturia” përfshihet në 6 tema-situata, që përmblihen në një temë të 7-të përsëritëse, kujtesë. Si mund të jemi të lumtur në jetë? Kjo alternohet në çdo orë mësimore. Shih Shtojca 3.



Sikundër shihet, ka një qasje shumë të veçantë të edukimit me konceptin e lirisë së mendimit apo të edukuarit filozofikisht, e që varet jo vetëm në konceptimin kurrikular, por edhe në cilësinë e ndërtimit të pyetjeve, situatave apo zbërthimit të kurrikulës.

III. 2/b Modeli klasik shqiptar i edukimit parashkollor

Le të analizojmë gjendjen reale të procesit edukativ në sistemin parashkollor. Sikundër provuam edukimi në fëmijërinë e hershme është premisa më e sigurt e një edukimi të qëndrueshëm. Shqipëria ka pretenduar se ka zhvilluar e po zhvillon reforma të rëndësishme në krijimin e një modeli bashkëkohor për edukimin në sistemin parashkollor. Duke krahasuar këto pretendime me studimin në realitet (në qytetin e Tiranës) të gjendjes reale kemi disa përfundime jo të kënaqshme.

Si paraqitet ky edukim në nivelin e parashkollorit?

Analizë e situatës në edukimin parashkollor në qytetin e Tiranës⁵².

Tabela 27

Të dhëna për instiucionet dhe burimet njerëzore për arsimin parashkollor, qyteti Tiranë			
EMERTIMI	2012	2013	2014
Kopshte Publike	43	43	43
Kopshte Jopublike	62	51	46
Edukatore në kopshte publike	342	347	349
Ndarë sipas nivelit arsimor:			
I mesëm i përgjithshëm	16	15	12
I mesëm pedagogjik	113	108	93
Arsimi i lartë për CU (ose ILP)	167	163	175
Universitet, sistemi i ri bachelor, CUP	13	26	33
Universitete të tjera (degë të tjera)	33	35	36

Në qytetin e Tiranës sot kemi këtë gjendje⁵³ të institucioneve parashkollore.

- Sikundër shihet, në Tiranë funksionojnë 89 institucione të edukimit parashkollor. Ky numër është i vogël në raport me kërkesat e mëdha që lindin nga: **a)** shtimi natyror i popullsisë, **b)** migracioni i brendshëm, **c)** rikthimi i emigrantëve në vend.

52. Studimi është përqëndruar në qytetin e Tiranës si metropoli i vendit.

53. Të dhënat janë marrë nga DAR-i Tiranë.

Sektori publik, pra institucionet e këtij sektori, pavarësisht se numri i fëmijëve për të frekuentuar këto kopshte është i lartë, sërish, nga viti 2012 e në vazhdim, *nuk ka shtuar ASNJË institucion publik*. Jo vetëm kaq, por ka mbyllje të institucioneve jopublike (pa gjuar këtu për shkaqet e mbylljes së tyre). Nga kjo tabelë mund të konkludojmë thjeshtë se:

Mungesa e institucioneve të edukimit parashkollor është pengesa e parë që vjen në edukimin e fëmijëve. Nëse fëmijët nuk arrijnë të kenë akses në një edukim të mirdrejtuar në një sistem edukativ, nuk mund të kërkojmë edukimin e tyre në standardin e të mësuarit filozofik.

Ky problem duket qartazi si shkak mjaft i rëndësishëm për një cilësi edukimi në sistemet e tjera shkollore. Sipas raportit të Bankës Botërore rezulton se: “Vetëm 48% e djemve shqiptarë kanë frekuentuar më shumë se një vit sistemin parashkollor ndërsa për vajzat kjo shifër është 58%. Në vendet e OBZHE-së, pjesa e fëmijëve që kanë frekuentuar më shumë sesa një vit institucione të sistemit parashkollor është 70% dhe diferenca gjinore është 2.5 pikë. Gjithashtu, ndërsa 78% e nxënësve të OBZHE-së e nisin arsimin formal në moshën 6-vjeçare ose më të vegjël, për vitin 2009, këtë e kanë bërë vetëm 49% e fëmijëve shqiptarë⁵⁴.

Problemi tjetër që lidhet drejtpërdrejt me sistemin e edukimit parashkollor është cilësia edukative. Këtu nuk është fjala për programet e miratuara apo për kurrikulën zyrtare por për rezultatin që kjo kurrikul prodhon gjatë implementimit të vet. Po i referohem sërish Raportit të muajit qershor 2014 të BB-së: Ja si shprehet në këtë analizë:

“Efekti i arsimit parashkollor” tek të mësuarit, që vihet re në vendet e OBZHE-së nuk është i pranishëm në Shqipëri. *Diferenca në performancën në lexim ndërmjet nxënësve që nuk kishin frekuentuar institucion parashkollor dhe atyre që kishin frekuentuar institucion parashkollor për më shumë se një vit është 32 pikë (dhe 14 pikë, duke krahasuar mosfrekuentim të institucionit parashkollor me frekuentimin për një vit), shumë më pak se diferenca në vendet e OBZHE-së (66 pikë), por larg krahasuesve rajonalë si Krocia (28 pikë) dhe Sllovenia (40 pikë). Pas kontrollimit të faktorëve të tjerë (si p.sh.: statusi socio-ekonomik, moshë, klasa dhe gjinia), ndikimi pozitiv nga frekuentimi për më shumë se një vit i institucioneve parashkollore bie në 5 pikë, që*

54. Raporti i BB-së mbi Analizën e rezultateve të PVNN-së, 2000-2012. <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/al-pisa-report-al.pdf>



nënkupton se pjesa e efektit të frekuentimit të institucioneve parashkollore është e përzierë me efekte të karakteristikave të tjera. Edhe pse të dhënat nuk lejojnë që të kemi një përgjigje plotësisht të qartë se përse efekti parashkollor nuk është aq i madh në Shqipëri, një nga shpjegimet ka lidhje me cilësinë e programeve që ofrohen. Në mënyrë që t'i japim përgjigje kësaj pyetjeje, nevojitet një analizë që del jashtë objektit të këtij studimi, por provat globale tregojnë se "sigurimi i arsimit parashkollor cilësor ka rëndësi për të mbështetur zhvillimin social, emocional, fizik dhe njohës; gjithashtu ai rrit përgatitjen për në shkollë, që ndihmon për të mësuarin⁵⁵". Diferencat në aftësitë njohëse fillojnë herët dhe pabarazitë në aksesin në institucionet parashkollore bëjnë që këto të vazhdojnë të ekzistojnë pa fund. Përveç problemeve të cilësisë, Shqipëria ballafaqohet me një sfidë për aksesin dhe barazinë. Të dhënat e Anketimit për Matjen e Standardeve të Jetesës (AMSJ, 2012) bëjnë të mundur që të bëhet zbërthimi sipas kuantileve të konsumit dhe tregojnë se niveli i regjistrimit varion ndërmjet 20% (për më të varfërit) dhe 48% (për më të pasurit)⁵⁶.

Nëse i hedhin një sy kurrikulës me të cilën punojnë institucionet e edukimit publik parashkollor do vërejmë se, nga 43 kopshte, 26 prej tyre punojnë me kurrikulën tradicionale, pra nuk ka asnjë ndryshim në një qasje të re të politikave edukative në këtë sistem edukimi. Madje, nga vlerësimi i kurrikulës edhe programit të kopshtit 6 Tiranë, edhe kur pranohet se vijnë nga përvoja nga projekti "*Step by step*", në vëzhgimet e bëra në orët mësimore konstatohet lehtë se nuk kanë ndonjë ndryshim të dukshëm mes orëve të projektit nga ato të programit tradicionale⁵⁷. Këtu faktorizohet edhe dobësia në kurrikulën e parashkollorit në universitetet përkatëse që prodhojnë këto edukatore apo mangësia e edukatoreve nga mungesa e filozofisë në formimin e tyre. Në një intervistë me ish-drejtoreshën e këtij projekti pranë AEDP-së, Dr. Gerda Sula, shpjegohen edhe shkaqet e kësaj gjendje⁵⁸. Mosmarrja e përgjegjësive të institucioneve shtetërore shqiptarë për mbështetjen në infrastrukturë, mjete didaktike, kualifikimet në vazhdim nën filozofinë e projektit, prishja e qendrave me ToT mund të cilësohen disa nga shkaqet që nuk jetësojnë dot filozofinë e "*Step by step*" sot: "rrënjosjen e

55. Heckman and LaFontaine 2010; Engle et al. 2011 pg. 12.

56. Raporti i BB-së mbi Analizën e rezultateve të PVNN-së, 2000-2012. <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/al-pisa-report-al.pdf>

57. Shtojca 4 - Cilësia e programeve të parashkollorit për kopshtet publike në Tiranë, 2014-2015.

58. Intervista me Dr. Gerda Sula me këtë platformë: Cila ka qenë filozofia e këtij projekti? Pse nuk kaloi dot në një model të qëndrueshëm edhe pas mbylljes së AEDP? Cilat janë rrugët e rijetësimi të tij? (2014)

parimeve demokratike në kopshte e shkolla përmes vendosjes së fëmijëve në qendër të procesit të të nxënës dhe përfshirjes së vazhdueshme të prindërve dhe komunitetit në proces”. (Sula. G. 2000)⁵⁹

Tabela 28

Programet e edukimit parashkollor në qytetin e Tiranës (2010-2015)	
Programet në zbatim	Numri i kopshteve
Tradicionale	26
Step by step	5
Reggio Emilia	4

Kur flasim për program tradicional është e qartë që si në përmbajtjen e kurrikulës, ashtu dhe në mënyrën me të cilën kjo kurrikul transmetohet, prodhon pa më të voglin dyshim fëmijë që mësohen t’i binden më të mëdhenjve e që duhet të sillen “mirë” sipas konceptit të edukatores. Madje, edhe në rastet kur kemi modelin “step by step”, sërisht kurrikula nuk ka ndonjë dallim nga kurrikula tradicionale, e cila vazhdon të zhvillohet prej vitit 1992 pa patur asnjë ndryshim thelbësor. Stafi është pa dyshim problemi tjetër i rëndësishëm me të cilin lidhet performanca e edukimit në këtë sistem. Nga analiza e të dhënave rezulton se:

Edukimi i stafëve me arsim të lartë universitar ka ardhur në rritje, si nevojë për t’ju përgjigjur kërkesave të reformave cilësore në edukim. Por ajo që na rikthen sërisht në problemin kryesor është pyetja e shtruar më sipër:

Sa janë të aftë edukatores e këtij sistemi të ofrojnë një edukim filozofik te fëmijët? Madje, më parë duhet të shtrojmë pyetjen: Sa janë edukuar ata vetë me një sistem të tillë? Sa prej tyre e njohin filozofinë dhe mënyrën filozofike të edukimit?

Nga vlerësimi mbi statistikën e DAR-it, Tiranë rezulton se:

Nga 349 edukatore, 175 janë me arsim të lartë universitar, kryesisht ILP dhe vetëm 9 janë me sistem universitar në gjuhë-letërsi ose histori-geografi. Në kurrikulën e programeve të këtyre degëve nuk gjen prej kohësh edukim filozofik ose qasje filozofike në edukim. Kjo do të thotë se këto edukatore nuk kanë vetë një edukim të tillë, ndaj dhe nuk pritët që këtë ta përçojnë tek fëmijët.

59. Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë. “Shkolla jonë”. Shtëpia Botuese “Maluka”. 2004. faqja 63



Le të ndalemi më konkretisht.

Në formimin e një edukimi të qëndrueshëm merr rëndësi të jashtëzakonshme mënyra e formulimit të pyetjeve⁶⁰. Cilësia e pyetjeve dhe e ndërtimit të një logjike vetjake duhet të jetë synimi i një kurrikule të shëndetshme.

Nga studimi rezulton se në përgjithësi edukatoret përdorin pyetje jo vetëm jashtë karakterit formues, por edhe tipikë të një edukimi klasik: “*unë them, ju duhet të thoni këtë që them unë*”. Në ndërtimin e pyetjeve vërehet dukshëm mungesa e formimit filozofik që kanë vetë edukatoret.

Nga vëzhgimet e bëra, por dhe nga jetët tona prindërore, ne sjellim me dhjetëra shembuj të “pyetjeve filozofike” të fëmijës. Gjithsecili prej nesh e njih kuriozitetin e fëmijëve për jetën, vdekjen, Zotin, dashurinë, rritjen apo vogëlinë e supozuar, pa harruar surprizat e tyre në përcaktime.

Përgjigjet në këto raste i janë lënë tërësisht “të lira” gjykimit personal (aspak profesional) të edukatoreve, të cilat, sipas rastit u japin jo rrallë përgjigje të gabuara që ndikojnë në konceptimin real të fëmijëve ndaj dukurive të ndryshme. Madje gjenden dhe përgjigje të tipit “Nuk është mosha juaj për të bërë të tilla pyetje”... kur dihet se lidhjet midis filozofisë dhe fëmijërisë së hershme fillojnë rreth moshës 3 vjeç. Kjo është mosha kur shënohen pyetjet e para me përmbajtje ekzistenciale apo metafizike rreth origjinës së sendeve, tokës, Zotit, miqësisë apo dashurisë, jetës apo vdekjes, rritjes apo plakjes. Dekarti na këshillon se vetëm filozofia mund të tejkalojë paragjykimet e lindura.

Fëmijët janë kuriozë, ata e kanë të lindur “dashurinë për dijen”, e përngjashme kjo me vetë etimologjinë e konceptit “filozofi”, *pilo-sophos*. Filo - fabulat të shoqëruara me aktivitete krijuese filozofike janë ato që shoqërojnë kopshtet elitare përmes kurrikulës filozofike, po aq sa edhe literaturës bashkëshoqëruese për fëmijë. Po ashtu janë revista shkencore që poshtë trajtesave të tyre kanë “praktikimin” përmes dijes së ofruar nga edukatoret tek fëmijët e këtij raporti.

Filozofia e fëmijërisë është pjesë e kurrikulave universitare e Universiteteve më në zë. Një prej autorëve të shumëpërdorur për këtë çështje sot, Prof. Gareth Matthews, në publikimin me të njëjtin titull argumenton se kjo lloj filozofie është po aq e qenësishme sa edhe filozofia e shkencës, filozofia e historisë, filozofia e fesë etj. FpF, filozofia që kërkoj vëmendje për t’u fuqizuar në sistemin tonë parashkollor arsimor e më gjerë ka

60. Shtojca 5 – Ditar i edukatoreve të një kopshti në Tiranë.

vlerë terapeutike, pasi që nga mençuria e lashtësisë ajo shënon drejt e në shpirt, kjo jo duke e trajtuar problemin direkt por me shumë argumentime në të menduar mbi atë se si duhet kuptuar jeta e vdekja, hidhërimi apo lumturia. **Platforma filozofike e shtrimit të problemit, e sjelljes së argumenteve në mendim është prologu i të nxënimit të dijes në këto mosha. Ajo sugjeron se nuk duhet të ushqejmë mitizimin në fëmijëri.** Është më mirë që pyetjeve të kësaj grup-moshe, shpesh të lidhura dhe me frikën, t'u japim përgjigje, pasi kështu fëmijët ndjehen më të sigurt kur ndeshen me probleme të ekzistencës.

A e kanë shprehur standardet e parashkollorit shqiptar këtë ambicie? Sa edukatorët tanë e realizojnë këtë brenda komuniteteve të dijes fëmijërore?

Ne duhet të strukturojmë në matrica angazhime që afektojnë sistemin tonë të trajnimit dhe vlerësimit, atë që Lipmani, babai i FpF e shpreh... *“të mundësojmë që fëmija të kalojë gradualisht nga qëndrimi egocentrik, monologjist (që flet pa pushim) tek qëndrimi kritik, bashkëbisedues në grup”*⁶¹.

Në raportin e UNICEF-it për “Plan Aksion” në lidhje me fëmijët është planifikuar që, në vitet 2012-2015, objektiv i rëndësishëm do të jetë: “rritja e aksesit të fëmijëve në arsim-in parashkollor, ndërtimi i kopshteve të reja, rehabilitimin e atyre ekzistuese dhe plotësimin me pajisjet e domosdoshme për një funksionim dinjitoz, duke këmbëngulur në përmirësimin në vazhdimësi të kurrikulës shkollore, duke synuar shmangien e ngarkesave të tepërta, si dhe duke patur në konsideratë zhvillimin e fëmijëve. Realizimi i këtij objekti kërkon krijimin dhe forcimin e infrastrukturës të përshtatshme mësimdhënëse në shkollat e arsimit të detyruar dhe arsimit të mesëm, me qëllim rritjen e efektivitetit në përvetësimin e kurrikulës arsimore që përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, e shoqëruar me rritjen e kapaciteteve mësimdhënëse.”⁶²

Duke qenë se shkrimi i kësaj teze ka kapur vitin 2015, mund të them se *qeveritë shqiptare e kanë patur këtë objektiv të tyre virtual, pasi, realisht gjendja është sikundër e përshkruam.*

61. Tema: “Jeta” në një vizatim. Fëmija M.D pikturon vetëm qarqe të zinj. Kjo për shkak se kishte humbur prindët në aksident automobilistik. Nuk pranonte vdekjen e tyre por i strehonte në qiell me tv cilin nënkuptonte pjesën e paqarkuar në të zezë. Vajza Arsi që ndërsa pyetet se “Kush e bën jetën e bukur për ne?”, ajo na tregoi fabulën e saj mbi Zanën (element i përrallave për fëmijë dhe i mitologjisë shqiptare) që mundësonte çdo gjë në botë bile edhe të martuarit e teta guzhinieres me djalin e bukur në dashuri apo deri tek pretendimi se Zana do mundësonte edhe dobësimin e saj për t'u bërë balerinë (nga vëzhgimi i një ore mësimi në kopshtin Nr. 8 Tiranë në vitin 2012)

62. http://www.unicef.org/albania/Action_Plan_Shqip13.pdf fq. 14



Në Udhëzimin e Ministrisë⁶³ për vitin shkollor 2014-2015 nuk gjen qoftë edhe një fjalë për frymën e një rikonceptimi në sistemin e edukimit.

Kjo situatë na shtron përpara një problemi të madh: **nevojën e përfshirjes së këtij formimi në vetë kurrikulën e Departamentit të Filozofisë së FSHS, Universiteti Publik i Tiranës. Më tej, ky departament mund të ndër marrë përgjegjësinë e trajnimeve për edukatorët në proces, por edhe të realizimit efektiv të këtij edukimi në institucionet e larta të përgatitjes së edukatorëve të shekullit të ri.**

A ekziston ndonjë përvojë pozitive në këtë fushë në vendin tonë?

Nga sondazhet na rezulton se ekzistojnë disa kopshte jopublike, të cilat po praktikojnë kurrikula të veçanta që synojnë edukimin filozofik në këtë nivel fëmijësh. Në kopshtin "Maria Montessori", fëmijët shfaqin interesat e tyre rreth dukurive të jetës, pyeten rreth tyre dhe vlerësohen në bazë të përkatësisë individuale. Kjo mënyrë edukimi ka sjellë një qasje të dukshme në vlerësimin e përgjithshëm të fëmijëve. Ata njohin disa nga të drejtat e tyre, themelore, mësohen ta thonë pa kompleksitet mendimin e tyre, janë në gjendje të arsyetojnë sipas gjykimit të tyre duke e "mbrojtur" mendimin me argumentet që ata përpiqen ti lidhin përgjigjes. Ky model i këtij kopshti është nën trajtimin e modeleve ndërkombëtare të edukimit.

Cila do të ishte një kurrikul standarde e cila vë në qendër edukimin filozofik?


Nëse do t'i referoheshim modelit IB⁶⁴ të edukimit, e cila në Shqipëri ka zënë vend në Word Academy of Tirana, do të gjejmë një konceptim krejt të ndryshëm nga kurrikulat tona ekzistuese në moshat parashkollore. Kjo kurrikul konceptohet si një trup për fëmijët nga parashkollorët deri në klasën e pestë. Kurrikula e këtij modeli është si më poshtë me anë të Grafikut nr. 4.

Nën këtë model punohet në kopshtin "Maria Montessori"⁶⁵. Gjatë intervistës që kemi bërë me një ndër edukatorët amerikane që punojnë në këtë institucion mes të tjerash ajo tha: *"Ne j'u mësojmë fëmijëve si të bëjnë pyetje, si të mendojnë apo edhe si të zgjidhin një situatë të caktuar. Ne i vendosim fëmijëve përpara situata të reja që edhe ata të mos shtangen ose të mos hezitojnë për të marrë një vendim apo të veprojnë në një mënyrë të caktuar. Askush prej nesh nuk do që t'i mësojë fëmijët të funksionojnë si një makinë pa logjikë."*

63. Udhëzimi i Ministrisë së MES-it të RSH-së, nr 23, dt. 08.08/2014.

64. The International Baccalaureate® (IB) Primary Years Programme (PYP) is for students aged 3-12.

65. Shtojca 6. Intervista me Viktoria Virlee, mësuese në kopshtin "Maria Montessori". Intervista e plotë.

Grafiku 4. Modeli i kurrikulës së IB-së për fëmijët 3-12 vjeç

Shoqëria ka nevojë për njerëz që gjenerojnë ide, dhe metoda jonë në të gjithë botën këtu përpiqet që të bëjë pikërisht këtë gjë:

- a) **Të aftësojë njerëz** që prodhojnë ide të reja.
- b) **Të jenë të pavarur dhe të lirë** për të shprehur mendimin e tyre.

Realisht kjo duhet të jetë filozofia e fëmijëve shqiptarë.

Pavarësisht se ekziston një model ndërkombëtar, ndërkohë që Departamentet e Filozofisë në disa Universitete Publike (UT dhe UK) kanë filluar të prodhojnë material pedagogjike shkencore mbi epërsitë e modeleve kurrikulare bazuar në edukimin filozofik në sistemin parashkollor, *MES-i dhe IZHA nuk kanë marrë ende në konsideratë propozimet nga universitetet.*

Gjatë studimit doktorial është ndjekur edhe politika e literaturës që ofron MES-i për edukimin parashkollor në Shqipëri apo mjetet didaktike për fëmijët. Bordet përzgjedhëse për literaturën e sugjeruar pak kanë qasje me udhëzime për moralitetin apo filozofinë që duhet të kenë librat me përralla që rekomandohen të blejnë Bordet e Kopshteve. Për të mos u ndalur më pas në aftësimin që edukatorët duhet të kenë ndërsa ofrojnë përralla për edukimin e parashkollorëve. Përvoja e sotme botërore sjell në vëmendje jo vetëm rëndësinë që ka përzgjedhja e kujdesshme e literaturës së



rekomanduar, por edhe rëndësinë që kanë kuptimet dhe interpretimet filozofike të tyre. Kështu Jana Mohr Lone⁶⁶, dërsa i referohet rëndësisë që ka përzgjedhja e literaturës filozofike për t’u lexuar për fëmijët parashkollorë, ofron si të tillë “Rosaku i shëmtuar” të Hans Christian Andersen, për të cilën pohon se “evokon shumë pyetje rreth bukurisë, identitetit dhe perceptimeve. A është “i shëmtuar” rosaku realisht? Çfarë do të thotë të jesh i shëmtuar? A mund të jeni ju një ditë i shëmtuar dhe në tjetrën jo? Si e përcaktojmë ne se çfarë është e bukur dhe çfarë jo?”⁶⁷

Përvoja e sotme botërore ka përcaktuar edhe literaturë filozofike për fëmijë përmes të cilave ushqehen fëmijët me procesin e të filozofuarit si pikënisje e sigurtë e formimit të qytetarit të aftësuar me logjikë, mendim kritik, komunikues, shpirt diskutativ dhe vendimarrës.

Bazuar me modelin e librave me shumë figura shohim se spikasin mjeshtrit e rrëfimit dhe përrallës si Hans Christian Andersen, Vëllezërit Grimm, Wolf Erlbruch⁶⁸, deri tek bashkëkohorët si, Leo Lionni⁶⁹, Pija Lindenbaum⁷⁰ etj., të ofruara këto në një listë nga filozofja Lone⁷¹. Kemi një iniciativë për t’u vlerësuar në kontekstin shqiptar siç është angazhimi i “Qendrës Shqiptare për Zhvillimin e Shëndetit Mendor” me botimet e saj në shqip ku do të veçoja “Tutu mëson të dëgjojë”, libër didaktik me përralla dhe tregime për parashkollorët, me autore të tregimeve dhe përrallave Adelina Mamaqi dhe Rovena Rrozhani (2013). Në botim vërehen rubrika për edukatorët dhe prindërit që ofrojnë kualifikim të tyre në këtë proces edukimi me objektiva të qarta për shëndetin mendor të parashkollorëve. Po kjo qendër ka sjellë edhe botimin me titull “Kush e shëroi elefantushin?” (2015). Në një intervistë me drejtuesen e kësaj qendre⁷² theksohet që: edukimi sot duhet të vlerësojë dhe mbështesë kthimin e filozofive të projekteve të suksesshme si ky i yni, në politika të qëndrueshme dhe mbështetjen nga fondet publike të qendrave të mirëfillta shkencore dhe të shoqërisë civile për kualifikimet kombëtare të edukatorëve në sistem. Edukatorët kanë nevojë të mëdha të edukohen me formatet

66. Drejtore e Qendrës “Northwest” për Filozofinë për Fëmijë në Departamentin e Filozofisë në Universitetin e Washingtonit

67. Jane Lone, “The philosophical child”. By Rowman & Littlefield Publisher, Inc. 2015. Pg. 28.

68. https://en.wikipedia.org/wiki/Wolf_Erlbruch

69. https://en.wikipedia.org/wiki/Leo_Lionni

70. https://sv.wikipedia.org/wiki/Pija_Lindenbaum

71. Lone, J. “The philosophical child”. (2015). Pg. 136, 137, 138.

72. Intervistë me Dr. Blerta Bodinaku, prill 2015, me platformë: 1. Cili ishte synimi juaj për këtë botim?; 2. Raporti mes botimit dhe kualifikimit të edukatoreve; 3. Problematika të edukimeve bashkëkohore për sistemin parashkollor; 4. Probleme të kualifikimit të edukatoreve në vijimësi.

bashkëkohore të edukimit të fëmijës bazuar në logjikë e komunikim, gjë e cila do të ndihmonte fëmijët të shprehnin dhe kontrollonin emocionet e tyre. Kualifikimet e realizuara në ato qytete të projektit kishin identifikuar edukatore që vetë nuk arrinin të shprehnin dhe kontrollonin emocionet e tyre (Tiranë, Malësi e Madhe, Shkodër).

Bashkërendimi i objektivave të një edukimi për ZHQ-në me bazë procesin e të filozofuarit nga fëmija me ato të shëndetit mendor në Shqipëri, do të ishte një model shqiptar që do sillte shumë cilësi në edukimin sidomos në arsimin parashkollor dhe atë detyrueshëm në vend. **Fakulteti i Shkencave Sociale i Universitetit të Tiranës**, i ka të gjithë burimet e ekspertizës për të marrë një udhëheqësi të tillë në fushën e edukimit.

III. 3 ARSIMI DHE EDUKIMI FILOZOFIK NË SISTEMIN 9-VJEÇAR

Arsimi i detyrueshëm, ai nëntëvjeçar, mbetet sfida dhe njëkohësisht themeli i përfitimit nga edukimi filozofik i fëmijëve për cilësinë e edukimit për zhvillim të qëndrueshëm në vend. Arsyeja është e thjeshtë: ky arsim arrin të tejkalojë humbjet që janë shkaktuar nga nivelet kritike të përfshirjes së fëmijëve në sistemin parashkollor, ndërsa kemi prezent një nivel të vlerësueshëm të përfshirjes së tyre në sistemin 9-vjeçar në sistemin publik dhe jopublik. Përqëndrimi dhe fuqizimi i edukimit filozofik në kurrikulën e 9-vjeçarit do të sillte vlerësimin e procesit të edukimit në **6 fusha**:

1. *Të menduarit për vete dhe rëndësinë e identitetit;*
2. *Të edukuarit me mendimin dhe edukimin qytetar;*
3. *Të ndihmuarit në zhvillimin personal të fëmijës;*
4. *Fuqizimin e gjuhës, shprehitë e të folurit dhe të debatuarit;*
5. *Angazhimin e fëmijës në mendimin kritik dhe në “të filozofuar”;*
6. *Pasurimin e metodave didaktike në klasë.*

Kur flasim për edukim filozofik nuk kemi parasysh një kurrikul të ndarë në një tip lënde që i ofron fëmijës ose adoleshentit të hershëm një dije filozofike. Në këtë nivel të dytë të edukimit nxënësi ka nevojë për një edukim filozofik më të qenësishëm e që shkon përtej një kurrikule lënde të mirëformatuar. Ka me qindra pyetje që fëmijët e kësaj moshe shtrojnë me njëri-tjetrin. Ka me dhjetëra situata ku ata gjenden pa ditur si të veprojnë. *Të filozofuarit bashkë me fëmijët në arsimin e detyrueshëm vjen bashkë me krijimin e ushtrimeve metodike në klasa, pavarësisht nga lënda, ku pretendohen qëndrime dhe kompetenca për fëmijët. Me objektivin e zhvillimit personal të tyre*



mundësohet vetëndërgjegjësimi përmes ushtrimeve filozofike.

Të argumentuarit si një shprehje mundësohet përmes argumentimit të problemeve dhe vlerësimit të argumenteve. Në këtë mënyrë, ***filozofia nuk vjen si histori idesh lidhur me vendet ku ka lindur, por vjen si aktivitet i cilësisë së mendjes dhe krijimit të vetes te fëmija.*** **Dialogu sokratic** apo **diskutimi filozofik**, të mësuarit me rregullat dhe procesin që mundësojnë ato, kontribuojnë në krijimin e qytetarit aktiv dhe pjesëmarrës. UNESCO në materialin e saj analitik, por edhe të perspektivës së filozofisë jep modele dhe përvoja nga e gjithë bota në këtë nivel edukimi. Ajo që vërehet është mendimi kritik i autorëve të materialit për të gjitha shkollat dhe modelet, duke i lënë si opsione zgjedhëse këto të fundit për të gjitha ato vende që ende nuk kanë hyrë në konceptime, institucionalizime dhe shërbime kualifikuese për filozofinë dhe të filozofuarit e fëmijëve si pjesë e kurrikulës, didaktikës dhe trajnimeve kombëtare të punonjësve të edukimit. **Ky është dhe rasti i Shqipërisë.** Përtej zgjedhjes së përfshirjes së filozofisë në sistemin 9-vjeçar vjen koncepti “institucionalizim” ***nga filozofia e përfshirë në edukim, nga procesi i realizuar i së cilit sistemi i edukimit përfiton:***

- 1. duke promovuar aspekte kulturore e ndërkulturore** mes shtetit përkatës dhe botës,
- 2. duke promovuar inovacionin** brenda dhe jashtë institucioneve arsimore me tendencë zgjerimin nga universitetet drejt njësive të tjera të arsimit (parauniversitar, parashkollor),
- 3. duke organizuar dhe siguruar cilësi edukimi** në tre nivelet zyrtare të edukimit për zhvillim të qëndrueshëm në vend, në botë,
- 4. duke institucionalizuar edhe disa praktika rrjetesh komunikimi** mes vendesh e kulturash sikundër janë: klubet e filozofëve, rrjeti i grave filozofe, klubet e filozofëve të rinj, grupet e debatit, komunitetet e edukatorëve që zhvillojnë të njëjta modele filozofike etj.
- 5. duke pasuruar dhe bërë cilësisht më përfituese kurrikulat zyrtare** qasur problemeve që ka zhvillimi i sotëm në botë, në vend, përkatësisht si zhvillim i qëndrueshëm dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Në Shqipëri, specialistët e arsimit dhe politikbërësit janë të mendimit se këto objektiva realizohen nga lënda “Edukatë Qytetare” apo “Edukatë shoqërore”.

Le të shikojmë se sa ky model i pretenduar nga specialistët e Institutit të Zhvillimit të Arsimit (më parë Instituti i Studimeve Pedagogjike) në vite ka mundësuar:

- *Edukimin filozofik të fëmijëve* në kurrikulën shkollore ekzistuese.
- *Cilësinë e shprehur në edukim* nga kualifikimi i mësuesve me të filozofuarit dhe filozofinë për fëmijë.
- *Cilësinë më të mirë të teksteve tona.*
- *Bashkëpërgjegjësinë me dy nivelet e tjera të edukimit:* parashkollor dhe të mesëm.

Edukata qytetare që shihet si një edukim i përcaktuar zyrtar në kurrikulën e ciklit 9-vjeçar, është pa dyshim një hap që ndikon pozitivisht në këtë edukim. Por nga sondazhet vihen re **3 problematika:**

1. Edukimi qytetar në përmbajtjen e tij është shndërruar gati në një “Manual përdorues” për fëmijët, e që shpesh shndërrohet në të panevojshëm fare në periferi të mësimi.
2. Ky ndërtim i kurrikulës çon vetiu në një të mësuar “përmendësh” me synim kthimin e drejtë të përgjigjes së shkruar në tekste.
3. Kjo lëndë shihet si plotësuese e normës mësimore për mësues të profileve të ndryshme. Ky është një precedent në vite në sistem dhe ka pësuar thyerje vetëm kur arsimit drejtohet nga profesionistë të shkencave sociale.

Çfarë ndodh në këtë qasje që i bën shkolla 9-vjeçare edukimit filozofik?

Fëmijët jo rrallë mundohen të kujtojnë “përgjigjen” që kërkon mësuesi e që është shkruar në tekste. Dhe kur fëmijët i dinë “mirë” këto përgjigje sërish ata gjenden të papërgatitur para një situatë konkrete. Le të pasqyrojmë një shembull nga sondazhi:

Pyetjes së sondazhit në tre shkolla 9-vjeçare të qytetit të Tiranës⁷³ se:

1. Nëse **ti i kërkon leje prindërve** për të shkuar në një film me shokët **dhe ata të përgjigjen “JO”**, Si do veprësh ti?

Më tej pyetjes se:

2. **Jeni para një semafori** dhe jeni me babanë tuaj të kapur nga dora. Ende nuk është ndez ur drita e gjelbër dhe, duke qenë se **babai shikon se nuk ka makina, ju tërheq për të kaluar rrugën**. Si do vepronit:

73. Shtojca 7. Sondazh i kryer me 300 nxënës të klasave të 5-ta në shkollat: “S. Gabrani”, “1 Maji”, “O Myderizi”.



Nga këto pyetje duket qartë se sa sipërfaqësore është "edukimi i tyre qytetar". Duke mësuar në mënyrë automatike se "prindërit duhen dëgjuar në çdo rast" dhe duke mësuar se "kalimi më semafor të kuq" është i ndaluar, prevalon e para. Nuk mund të themi nëse kjo është e vërtetë e përgjithësuar, por ama "siguria" që u jep prindi duket se shkon përtej të "qenit" qytetar i mirë.

3. Në pyetjen tjetër: **Cili sipas jush është një "nxënës i edukuar dhe i mirë"?**

Renditni cilësitë sipas preferencave tuaja nga më e rëndësishmja 1:

- a. Ai që dëgjon prindërit dhe sillet si e kërkojnë ata.
- b. Ai që dëgjon mësuesin dhe sillet si e kërkon ai/ajo.
- c. Ai që mëson mirë dhe vjen çdo ditë i përgatitur.
- d. Ai që grindet me prindërit.
- e. Ai që grindet me shokët e mësuesit.
- f. Ai që ndihmon të tjerët.
- g. Ai që sillet gjithnjë si i thonë më të rriturit.

Përgjigjet në këtë rast janë shumë të "çuditshme". Të gjithë nxënësit kanë lënë pa renditur pikën "d" dhe "e". Duket se fjala "grindje" ka tek ata një perceptim negativ që nuk i bën "qytetar i mirë".

Pra, edhe nëse kurrikula jonë shkollore e pretendon edukimin filozofik të shprehur në "Edukimin Qytetar", duket se nuk është fort produktive. Në mendimin tim dhe nëse ne arrijmë që nxënësi të na japë përgjigje të "drejta" në pyetjet që i shtrojmë, dhe nëse ne mbetemi të kënaqur nga cilësia e notës duke pretenduar se kemi cilësi produkti, sërish jam e bindur se: **Koncepti ynë për "qytetar i mirë" shkon drejt konceptit "qytetar i bindur"**. Kjo do të thotë që ne po synojmë të prodhojmë qytetarë të bindur (dhe pse edhe për këtë kam rezervat e mia që do i parashtroj më poshtë). Në pamjen e parë, kjo duket një qasje mjaft e vlerësueshme, por *përvojat botërore na tregojnë se njerëzit e "bindur" mund të manipulohen më lehtësisht për t'u shndërruar nesër në "qytetarë të këqij". Me se lidhet ky përfundim?*

Mënyra e hartimit të teksteve me problematika të shumta, shpesh sipërfaqësore, çon vetiu në një përfundim të tillë. Nëse shikojmë kurrikulën e klasës së katërt⁷⁴ vëmë re

74. 01. Njohja e nxënësve me tekstin e Edukatës Qytetare për klasën e katërt; 02. Shëndeti dhe higjiena; 03. Trupi ynë; 04. Fuqia e muskujve; 05. Dhëmbët dhe dentist; 06. Veprimtari zbatuese: Vizitë te dentist; 07. Vizitë te mjeku; 08. Sëmundjet; 09. Barnat dhe farmacia; 10. Ndhima e shpejtë; 11. Spitali dhe ambulanca; 12. Mjedisi dhe shëndeti; 13. Ushqimi; 14. Koha e lire; 15. Veprimtaritë sportive dhe çlodhëse; 16. Si të mbrohem nga aksidentet; 17. Veprimtari zbatuese: Vlerësim i shëndetit personal; 18. Test vlerësues; 19. Rregullat dhe ligji; 20. Si sillemi në rrugë; 21. Policia; 22. Gjykata; 23. Dënimet; 24. Dhuna në familje; 25. Dhuna në shkollë; 26. Si ta mbrojmë veten; 27. Përkujtojmë çkemi mësuar - Qeverisja dhe qytetaria; 28. Bota e lirisë dhe të drejtave; 29. Të drejtat e fëmijëve; 30. Liria e njeriut; 31. Test vlerësues;

menjëherë se kjo kurrikul është shumë e shpërndarë, me shumë fusha. Kjo shpërndarje sjell domosdoshmërisht pasojën e të kaluarit sipërfaqësisht të çdo problemi. *Konceptet bëhen sipërfaqësore dhe qëndrueshmëria e tyre është lehtësisht e atakueshme nga realiteti.*

Po nga sondazhet rezulton se konceptet e trajtuara në sistemin tonë të kurrikulës “Edukim qytetar”, nuk janë të konsoliduar edhe “në memorien” e nxënësve. Në klasën 7-të dhe e 8-të zhvillohen si tema “Liritë e të drejtat e njeriut” dhe Institucionet. Nga sondazhi me nxënës të klasave të nënta të shkollave të mësipërme⁷⁵ pyetjes:

“Rendisni disa institucione që ndihmojnë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut” i janë përgjigjur:

- **48%** kanë renditur të parën: **Gjykatën.**
- **27%** kanë renditur të parën: **Policinë.**
- **28%** kanë renditur të parën: **Televizionin.**

Sikundër shihet, përgjigjet janë më shumë rezultat i perceptimit shoqëror se sa i të mësuarit realisht në edukatën qytetare.

Metodat e të mësuarit në edukimin filozofik duket se nuk i kanë shpëtuar defekteve të mësimit në klasë sipas “librit” apo asaj çka mësuesi shpjegon. Referuar raportit të Bankës Botërore në qershor (2014) mbi rezultatet dhe analizën e testit, del si përfundim se:

“Nxënësit shqiptarë dalin shumë më mirë në ushtrimet që lidhen me hapësirën, por kanë vështirësi që të lidhin problemet matematikore me situatat e jetës reale. Rezultatet në elementët e proceseve tregojnë se *nxënësit dalin nën nivel kur duhet të përdorin aftësitë për vendosjen e gjërave në kontekst për të lidhur problemet me jetën e vërtetë dhe me situata të përditshme.*

Nxënësit shqiptarë e kuptojnë tekstin e vazhdueshëm shumë më mirë sesa tekstin jo të vazhdueshëm, dhe është e nevojshme që të përmirësohen aftësitë e tyre për të reflektuar dhe për të vlerësuar. Duke krahasuar rezultatet e elementëve të leximit me performancën mesatare të leximit del që Shqipëria tregon më shumë variacion ndërmjet elementëve sesa vendet e OBZHE-së, që do të thotë se ka shumë vend për përmirësim në disa elementë. Në veçanti, nxënësit dalin më mirë në lidhje me tekstet tradicionale sesa në tekste që përmbahen në lista, grafikë ose diagrame (më shumë

75. Sondazhi me 300 nxënës të klasave të 9-ta të po atyre shkollave.

se 25 pikë diferencë, e barabartë kjo me gjysmë viti shkollim). Gjithashtu, PVNN-ja tregon dobësitë e nxënësve shqiptarë në bërjen e lidhjes mes përvojave të tyre dhe tekstit, duke reflektuar kështu një shkëputje ndërmjet asaj që nxënësit mësojnë dhe aftësisë së tyre për ta aplikuar atë në situata të jetës reale.⁷⁶

Të drejtat e fëmijëve në procesin e edukimit

Ky është një problem po aq i mprehtë sa edukimi qytetar. Nuk mund të mendohet një edukim qytetar pa siguruar më parë një njohje dhe edukim të vetë të drejtave që kanë fëmijët. Realisht, në mjaft kurrikula botërore, filozofia e edukimit përfshin në vetvete edukimin me të drejtat e fëmijëve. Në një studim⁷⁷, të bërë pjesë edhe e Strategjisë Kombëtare në Arsimin Parauniversitar, rezultojnë këto përgjigje për pyetjen:

Pse nuk është mirë të jesh fëmijë në kohën e sotme?

- Nuk merren për bazë mendimet tona, ndihemi keq për këtë.
- Mungesë lirie për gjithçka që duam.
- Të drejtat tona shkelen shumë lehtësisht.
- Nuk kemi mundësi për t'u argëtuar, të kufizuar për të luajtur e shpalosur talentet.
- Ndhemi vulnerabël ndaj dhunës apo dhe padrejtësive.
- Në rast se do të kishim probleme, nuk dimë ku mund të shkojmë për ndihmë.

Nga analiza e përgjigjeve mund të nxjerrim disa përfundime:

- Këto përgjigje janë në fakt produkti i mungesës së një edukimi të qëndrueshëm filozofik në gjithë sistemin tonë arsimor.
- Nga ana tjetër, këto përgjigje mund t'i konsiderojmë edhe si tregues të një kurrikule klasike, pa një përmbajtje konkrete e të vlerësueshme për përgatitjen e fëmijëve për jetën.
- Këto përgjigje dëshmojnë për **paaftësinë e të konceptuarit që në kurrikulën shkollore të nevojës për konceptin e lirisë dhe të drejtave që burojnë prej kësaj lirie.**
- Së fundmi, këto përgjigje dëshmojnë edhe faktin e nevojës së menjëhershme për të ndryshuar konceptimin e kurrikulës në favor të edukimit me konceptet e lirisë dhe mendimit kritik.

Pra, mund të konkludojmë se, me gjithë hapat pozitivë që janë ndërmarrë për kurrikulën

76. <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/al-pisa-report-al.pdf>

77. Grup diskutimi drejtuar nga ASHMDF-ja, me 30 të rinj të mbledhur në datë 4 nëntor 2014, në Elbasan, lehtësuar nga "Save the Children".

e edukimit qytetar, përballë situatave kritike të të menduarit dhe gjykuarit të nxënësve, problem mbetet përfshirja e edukimit filozofik, pra e një edukimi të qëndrueshëm me arsyetim kritik e të pavarur për nxënësit. *Ky edukim i pretenduar nga specialistët e arsimit deri më sot është sa sipërfaqësor po aq edhe jashtë kontekstit të nevojave tona shoqërore, pa neglizhuar edhe tendencat e sotme të zhvillimit të arsimit global që përherë e më shumë po këmbëngul për edukimin që prodhon qytetarin bazuar në procesin e të filozofuarit.*

Edukimi filozofik në sistemin 9-vjeçar dhe pse në kurrikulën e vet ka problematika që gjenden në kurrikulën e sistemit parashkollor, sërish nuk gjen një fill lidhës që të sigurojë një edukim të qëndrueshëm kritik e të pavarur.

Por ajo që vihet re është se në politikat e së ardhmes për edukimin filozofik në arsimin 9 vjeçar sërish nuk gjen ndonjë ndryshim vizioni apo ndonjë rikonceptim të thelbit të këtij procesi kaq të rëndësishëm. Në seksionin e quajtur: “Shoqëria dhe Mjediti”, sërish në materialin përmbledhës të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve rezulton se ky seksion do të zhvillohet në 28 orë javore sipas kësaj kurrikule: Edukim për shoqërinë me nga një (1) orë në javë për klasat e 1-ra deri te e 3-ta dhe nga dy (2) orë në javë për klasat e 4-ta dhe të 5-ta. Ndërsa nga klasa e 6-të e deri në klasën e 9-të zhvillohet Qytetaria me nga 1 orë mësimi. Madje shihet një tendencë dobësimi në të ardhmen i lëndës me titull “Qytetari”. Sot kjo lëndë zhvillohet me 3 orë javore, ndërsa në të ardhmen është projektuar të zhvillohet me 2 orë. Paradoksale kur mendon se lëndë të tilla si matematika zhvillohen 4 herë më shumë. Ky shtrembërim kurrikular nuk mund të prodhojë në të ardhmen qytetarë të edukuar me frymën e kohës dhe të aftë për t’u bërë vetvetja! Natyrisht kam përjashtuar këtu ndërtimin kurrikular të këtyre lëndëve. Duket se institucionet e hartimit të politikave arsimore nuk kanë aspak në objektivin e tyre mbështetjen e një edukimi filozofik tek sistemi 9-vjeçar.

Mendimi kritik dhe cilësia e pyetjes mbetet problemi i madh i sistemit tonë edukativ

Albert Einstein ndërsa shprehej për edukimin pohonte se: “Edukim nuk është të mësuarit e fakteve, por trajnimi i mendjes për të menduar”. Për të trajnuar mendjet e fëmijëve nevojiten trajnerë që e kanë art trajnimin e mendjes. Komponentë të rëndësishëm të këtij procesi janë të edukuarit me mendimin kritik dhe cilësia e pyetjes.



Po çfarë ndodhi me trajnim-kualifikimin e mësuesve ndërsa bota fuqizonte mendimin kritik, edukimin filozofik për një edukim për zhvillim të qëndrueshëm në Dekadën që mbyllet me 2015-ën?

Mësuesit mbeten për kohë të gjatë jashtë trendeve kualifikuese dhe po kaq jashtë arritjeve bashkëkohore në edukimin me mendim kritik. Dhe pse investuar, për mendimin kritik rreth 10 vite nga Projekti për Arsimin, pranë Fondacionit “SOROS” në Shqipëri, duket se ky investim nuk arriti të pasqyrohet në tekste, kualifikime në vijim të mësuesve, pretendime dhe ambicie të politikave të zhvillimit në arsim. E pa investuar në mënyrë të qëndrueshme si një kërkesë për cilësinë e dijës dhe aftësimin të fëmijëve në edukim, kjo mungesë pasqyrohet më tej në të gjithë produktin që nxjerrin këta mësues ndër vite. Në raportin vlerësues mbi arsimin parauniversitar shkruhet:

“Për më tepër, trajnimi i punonjësve arsimorë është konceptuar nga individët dhe institucionet më shumë si *element fakultativ*. Planifikimi vjetor i trajnimeve *nuk mbështetet në plane kombëtare dhe/ose vendore*. Trajnimet nuk janë planifikuar sipas standardeve profesionale dhe përmbajtja e tyre *nuk është hartuar për të përmirësuar kompetencat profesionale*. Në seancat trajnuese, vendin e metodave ndërvepruese e kanë zënë përgjithësisht leksionet. Shërbimi trajnues *është i kufizuar për nga larmia e agjencive ofruese, pasi në to nuk janë të përfshira sa e si duhet universitetet*. Ky proces vuan nga përshtatshmëria tejet e ulët ndaj nevojave individuale dhe ekipore të mësuesve, në veçanti, ndaj mësuesve të rinj. Kjo ka bërë që në shkolla, procesi i të nxënimit të rezultojë si përzierje e praktikave të vjetruara me idetë e reja, por të paqarta ose të patretura mirë⁷⁸ .

Kjo situatë kritike e paqëndrueshme është një ndër faktorët e prezencës së dukurisë së “Analfabetizmit funksional” të pranuar nga Raporti i 2012-ës për Shqipërinë.

Nëse i referohemi përvojave botërore në tekste shkollore por edhe në manual për mësuesit a prindërit vërejnë se një vend spikatur i jepet *këshillave për të njohur e zbatuar rregullat e lojës së diskursit filozofik*. Në këto rregulla ndjehet rëndësia e 2 elementëve të mësipërm si edhe të dëgjuarit aktiv, etika në komunikim etj.

Këshilla për diskursin filozofik për fëmijë

- Ngri dorën për të kërkuar fjalën, për të mësuar të diferencosh dëshirën dhe

78. Pëllumb Karameta, et al (2014) “Reforma e sistemit arsimor parauniversitar” – Raport Vlerësues paraprak, Grupi i punës për reformimin e arsimit parauniversitar, MAS.

veprimin si dhe të jesh i vëmendshëm ndaj të tjerëve!

- Mos u nxito! Nuk është i pari ai që ngre dorën dhe që do të flasë. Të ngresh dorën nuk do të thotë të ekzistosh!
- Mos e ngre dorën ndërsa dikush flet, kjo me qëllim që të mos përqendrohesh tek vetja ndërsa të duhet të dëgjosh të tjerët!
- Ruaje pyetjen në mendje, aftësohu ta formulosh mirë atë para se t'i përgjigjesh pyetjes!
- Kujdes në riformulimin e fjalëve të shokut ndërsa ti do të shprehësh mosaprovimin tënd për to!
- Para se ta shprehësh, verifiko qartësinë e idesë!
- Verifiko nëse ideja jote është e re që të mos përsërisësh idetë e të tjerëve!
- Verifiko që përgjigjja që do japësh i përkon pyetjes së bërë!
- Nëse ke një ide të re për të shtuar në diskurs, kujdes me raportin që duhet të ketë ajo me idetë e mëparshme!
- Çdo ide e hedhur duhet të argumentohet dhe të problematizohet!
- Çdo opinion ndryshe duhet të identifikohet e të debatohet, d.m.th. vlerëso vlefshmërinë e një ideje ose zgjidh mes 2 a më shumë ideve!
- Duhet të dëgjojmë atë që thuhet jo atë që donim të thuhej!
- Të ndihmojmë në diskurs dikë nëse ai ajo vetë e kërkon!

Të analizuara në tërësi, këto këshilla përmbajnë edhe standardet e prodhimit të një teksti ndërsa flasim, sikurse edhe elementët e mendimit si *qartësia*, *vërtetësia*, *dobishmëria*, *zbatimi i rregullave të logjikës formale* ndërkohë që paralel ndjehet edhe *etika* në mënyrën që duhet të ndërtojmë komunikimin me tjetrin apo grupin.

Këto lloj **këshillash metodike** do të pasuronin orët e mësimit nga kopshti në auditorë universitetesh ndërsa në shumësinë e orëve të vëzhguara për arsye të studimit në arsimin parauniversitar, nga kopshti në shkollë të mesme, më së shumti këto nuk pasqyrohen as në ndëraktivitetin mësues-nxënës në klasë, por as në dokumentacionin “ditar” të mësuesve.

Pas një programi cilësor lëndor, kualifikimit shkencor dhe metodik të mësuesve, kohës dhe sfidave informative dhe komunikuese që koha, gjenerata ofron, një element tjetër që do të ndikonte në cilësinë e edukimit të fëmijëve tanë në shkolla është ajo që *Aristoteli* tek “*Etika e Nikonomahut*” e quante si “*ideja e kapacitetit për perceptime morale, e*



cila, kur kultivohet, na aftëson ne të njohim lehtësisht përmasat sinjifikuese të situatave komplekse etike". Shkolla, kurrikula shkollore duhet të jetë ajo që mundëson aftësimin e kuptimit të rëndësisë që kanë aspektet morale në eksperiencat tona jetësore apo atë se çfarë i bën të rëndësishëm standardet e vendimeve tona ku bën pjesë edhe morali, etika.

Ne po studiojmë, analizojmë dhe mundohemi të japim instrumente dhe alternativa edukimi cilësor bazuar në etikë dhe filozofi ndërsa jetojmë tek ai që quhet shekulli i **Twitter**-it apo **Facebook**-ut për komunikim të çdo lloji. Në dukje këto të fundit mendohen si forma të lehta për t'u realizuar, pa u menduar shumë në saktësi dhe ligjësi gjuhësore, madje me kode fjalësh të krijuar enkas për këtë komunikim mes fëmijësh. Në të vërtetë edhe këto duhet të shkojnë drejt precizimit të një etike në komunikim, pa kufij shtetesh, por me shumësi rregullash morale dhe gjuhësore për të cilat duhet një orientim i saktë dhe i koncentruar i mendimit të tyre në rrjete sociale.

Ndërsa ndjek adresarë të fëmijëve shqiptarë (në një sondazh të bërë në shkollat shqiptare nga "World Vision"⁷⁹) në 100 fëmijë, 97 prej tyre kanë një faqe në rrjetet sociale) vëren po atë fenomen që prek edhe orët e mësimin në klasat e fëmijëve në arsimin e detyruar, moskuptimin si, duhet të pyetjeve që mësuesit ju bëjnë dhe shoqërimin e saj me pasaktësinë dhe paqartësinë e përmbajtjes së përgjigjeve që fëmijët japin apo nivelin kritik të përdorimit të rregullave gjuhësore në kompozim. Krahas kësaj kategorie ekziston edhe një kategori tjetër nxënësish që hezitojnë të pyesin, po aq sa ka të tjerë që të "injuar" nga mjedisi në klasë apo nga mësuesi në një pyetje të mëparshme refuzojnë totalisht të pyesin. Pra, nuk ushtrojnë të menduarit për pyetje, që në fakt kanë shkakun në vetë ekzistencën e tyre në këtë moshë. Ky komunitet kaq i madh fëmijësh që nuk pyesin papritur kthehen në superaktivë në shifrat e mësipërme në rrjete sociale.

Pa ju kthyer problemeve të mësuesve në cilësinë e kualifikimit të tyre edhe për cilësinë e të pyeturit përballë një gjenerate me plot pyetje, do theksoja edhe një herë rëndësinë që ka të kuptuarit e rëndësisë që merr përdorimi i procesit të të filozofuarit nga fëmijët për cilësinë e edukimit të tyre, proces që kërkon angazhim, koncentrim, të dëgjuar aktiv, ku pyetja pas një përgjigje riplotësohet me një pyetje tjetër dhe ku në kërkim të saktësisë dhe vërtetësisë bëhesh pjesë e lojës "Ja, edhe një pyetje tjetër", ndërsa

79. Studimi "Siguria e fëmijëve në internet", "World Vision" Albania, gazeta "Dita", dt. 3 shkurt 2013.



respekton edukimin me thellësinë dhe imagjinatën më të mundshme të mendimit, reflektimit duke konsumuar një kohë ku fëmija mendon rreth të menduarit të vet përmes perfeksionimit të pyetje përgjigjeve me tjetrin. Edukimi shqiptar duhet të heqë dorë nga rendja e mësuesve për pranimin vetëm të përgjigjes së saktë, por duhet të ndërtojë procesin ku përgjigjet specifike të secilit kontribuojnë për përgjigjen e saktë. Po në këtë proces, mësuesit duhet të mos ndjehen të prekur në autoritetin e tyre ndërsa dëgjojnë cilësinë e pyetjeve të nxënësve pasi ora e edukimit duhet të ketë nxënësin në qendër, jo mësuesin. Aftësimi i nxënësve në arsimin e detyrueshëm rritet ndërsa kornizohet mirë, qartë dhe me kompetencë, procesi i pyetje përgjigjeve nga mësuesi tek nxënësit proces që aftëson përmes praktikës.

“Pyetjet - dhe relacionet midis pyetjeve të ndryshme - janë themeli i filozofisë. Nga ana tjetër, filozofia është një nga disiplinat më të fuqishme që ndihmon studentët se si të bëjnë pyetje të mira. Rabbi Abraham Joshua Heschel e pat propozuar që filozofia të mund të përcaktohej si “arti i të kërkuarit të pyetjeve të duhura”⁸⁰.

III. 4 ARSIMI DHE EDUKIMI FILOZOFIK NË SHKOLLËN E MESME

III. 4.a Çfarë duhet të kuptojmë me “filozofi” dhe “të filozofuar “ për nxënësit e shkollës së mesme?

Ky problem, në dukje, pa sens është problem kyç që ndeshim në të kuptuarit dhe të mësuarit e “të filozofuarit” dhe filozofisë në arsimin e mesëm. Është problem real se çfarë duhet të kuptojmë me “filozofi” jo vetëm për shkak të koncepteve të shumta që ekzistojnë sot mbi “filozofinë” por edhe për shkak të përdorimit të shumëllojshëm të kësaj fjale në përdorimin e përditshëm. Filozofia nuk është një sistem i mbyllur ku konceptet duhen mësuar ashtu si serviren, por është një proces i cili bazohet në interpretime dhe argumentime të reja, është gjithnjë njëfarë “oponence” ndaj çdo argumenti pasi qëllimi i saj është zbulimi i të vërtetave.

Pra, çfarë kërkohet nga filozofia?

Ajo që nuk kërkohet është padyshim riprodhimi mekanik i tezave apo i teorive filozofike që shpesh nuk përtypen mirë nga nxënësit. Por ajo që kërkohet duhet të jetë gjykimi i pavarur, pozicionet autonome që nxënësi duhet të marrë në trajtimin e problemeve të shtruara. Në mendimin tim, filozofia është dije për të mësuar të jetosh mirë.

80. Jana Lone, “The philosophical child” 2015, Pg. 29, 30.



Dhe kjo nuk bëhet me slogane sepse jeta nuk realizohet me slogane.

Të mësosh filozofinë në shkollat e mesme do të thotë të krijosh tek ata dyshimin për çdo gjë që i rrethon me dëshirën për të kuptuar të vërtetën. Asnjë shkencë nuk mund të japë një dije të qëndrueshme për botën, ndaj dhe t'i kërkohet nxënësit ta pranojë shkencën pa asnjë debat e diskutim paraprak, do të ishte gabim. Filozofia duhet t'i shërbejë nxënësit pikërisht për të kuptuar shkencën, për të debatuar në lidhje me të vërtetat që me tej në jetë ai (nxënësi) të mos jetë një njeri pasiv që konsumon "çdo lloj informacioni" pa e përtypur, por që gjykon me mendjen e tij duke kërkuar të kuptojë thelbin. Pa një reflektim personal nuk mund të kemi kulturë, dhe pse mund të gjejmë eruditizëm. Më shumë se çdo popull tjetër, ne shqiptarët kemi nevojë për të kultivuar kulturën, ndaj dhe filozofia merr kështu një rëndësi të dorës së parë.

Në trajtesat e mësipërme është dhënë edhe një farë historiku i marrëdhënies që të filozofuarit" dhe filozofia si pjesë e kurrikulës në sistemin arsimor shqiptar ka prodhuar. Më tej do ndalemi me zhvillimet që erdhën pas Reformës në Arsimin Parauniversitar në Shqipëri pas 2005-ës. Kalimi i filozofisë si lëndë me zgjedhje (viti 2012-të) në shkollat e mesme dëshmoi për një politikë jo zhvilluese dhe të mbyllur të instancave shtetërore në misionin dhe objektivat e shtetit shqiptar për edukimin e nxënësve, duke rendur pas iniciativës "Shqipëria në moshën e internetit", e cila përqendroi investimet e MASH-it në laboratorë informatike dhe politikën e krediteve për kualifikim në rendje për aftësim me kompjuterin. Filozofia kalon në statusin e lëndës me zgjedhje.

Pse nuk duhet të ndodhte ky degradim statusi?

Konformizmi është sot karakteristikë e shoqërive postmoderne, por në Shqipëri ky konformizëm ka rrënjë edhe më të thella historike që çojnë drejt një indiference sociale. Nga ana tjetër, të rinjtë e sotëm jetojnë në një botë "alienësh": ku teknologjia i ka vënë përpara një pafundësi mesazhesh ndaj të cilave ndjehet i pafuqishëm për të gjetur modelin e tij të referimit. Sipas një studimi të fundit mbi *sigurinë e fëmijëve në Shqipëri online*⁸¹; 19, 85% e fëmijëve 13-18 vjeç kanë akses në internet nëpërmjet një kompjuteri në shtëpi, që në shumicën e rasteve gjendet në dhomat e tyre. Internet-kafetë janë gjerësisht të aksesueshme si në zonat rurale dhe ato urbane. Sipas tij, 44 % e fëmijëve e përdorin internetin për të shikuar material pornografik çdo ditë. Vetëm

81. Studim për sigurinë në rrjet të fëmijëve, World Vision (2014).

gjatë vitit të fundi, të (2014), rreth 47% e 13 - 18-vjeçarëve janë kontaktuar në internet nga persona të panjohur ku në 40% të rasteve ishte një i huaj. Vërehet nivel i ulët i informimit të fëmijëve lidhur me shkëmbimin e informacionit të sigurt në internet dhe strukturave përgjegjëse ku duhet të raportojnë incidentet online.

Në dukje kjo gjendje shkon sipas mënyrës së sotme të jetesës. Por, në të vërtetë nuk është kështu. Sapo jeta i ballafaqon me problemet e saj të cilat kërkojnë zgjidhje personale, ata ndjehen të pafuqishëm dhe jo rrallë kalojnë në stresa të padëshiruara. Modelet egocentrike dhe individualiste që po krijohen sot, nesër do të shndërrohen në probleme të mëdha për shoqërinë.

I gjithë ky arsyetim, qasur dhe kuptimësisë për “të filozofuarin” dhe filozofinë në arsimin 9-vjeçar shkon për të provuar dy probleme madhore:

Së pari: Filozofia si lëndë e veçantë duhet zhvilluar domosdoshmërisht në shkollat e mesme si pjesë e kurrikulës së detyrueshme, jo me zgjedhje.

Së dyti: Filozofia duhet trajtuar si një metodologji ndërlëndore për të arritur:

- a) *objektiva njohëse racionale* të vendosura në mjedis real e që stimulojnë gjykim e sjellje personale
- b) *zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë*
- c) *zhvillimin drejt një sjellje demokratike*
- d) *pjesëmarrjen aktive në jetën shkollore dhe shoqërore.*

Pra, filozofia duhet parë si një “trajnim” i mendimit dhe logjikës së pavarur. Nxënësit nëpërmjet filozofisë duhet të kuptojnë se, kur duhet të japin mendim më se pari duhen gjetur argumente e vlefshëm për objektin dhe më tej të arsyetohet rreth tij. Filozofia është dhe duhet të jetë një shtytje drejt përgjegjshmërisë së nxënësit sepse pa përgjegjshmëri nuk mund të realizohet liria. Në përfundim duhet të mendojmë se filozofia sot është një “metadisciplinë” pra një disiplinë transersvale e cila synon që me metodën e saj dhe logjikën e saj të reflektojë në disiplinat e tjera. Vetëm nëse do ta shikojmë si të tillë filozofia do përmbushë misionin e saj. Kjo është dhe një arsye më shumë pse “Strategjia ndërsektorale e filozofisë - UNESCO” (2005) por dhe studimi “Philosophy: a school of freedom” (2007) nga UNESCO për edukimin filozofik dhe procesin e të filozofuarit i jep një vëmendje të veçantë studimit të filozofisë në shkollën e mesme. Koïchiro Matsuura, Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s në kohën e studimit të sipërpërmendur e shpreh në këtë mënyrë misionin e saj: **“Filozofia aktualisht të**



implikon në ushtrimin e lirisë dhe përmes refleksionit, sepse ajo është një matës i të realizuarit të një gjykimi racional dhe jo të opinionëve; sepse ajo është një matës jo vetëm i asaj që njohim por e të kuptuarit të përmbajtjes dhe parimeve të njohjes; sepse ajo është një masë e zhvillimit të një mendjeje kritike *fortesë par excellence kundër të gjitha formave të pasionit doktrinar.*"

Studimi sërish ka vënë në fokus qytetin e Tiranës, ku janë pyetur mbi çështje që edhe studimi i UNESCO "Philosophy: a school of freedom" ka shtruar në pyetësorin mbi statusin e filozofisë në shkollat e mesme (blloku i tretë i pyetjeve në pyetësorin drejtuar e realizuar mbi përvojat e 126 nga 192 vende anëtare të UNESCO-s, ku të dhënat mbi Shqipërinë nuk janë pjesë e studimit).

Por, si paraqitet gjendja e filozofisë në arsimin e mesëm referuar rezultateve të studimit të UNESCO-s?

III. 4/b Rezultatet e studimit mbi edukimin filozofik në shkollat e mesme, (Tiranë)

Ky sondazh është realizuar në vitin 2011⁸². Përmbajtja e pyetjeve ka një qasje shumë të konsiderueshme me studimin e UNESCO-s në 2007-ën.

- Qëllimi i vrojtimit: synon vlerësimin e statusit të filozofisë në shkollat e mesme dhe disa elemente të këshillimit të karrierës në Maturën Shtetërore 2011.
- Shtrirja gjeografike e vrojtimit: Qyteti i Tiranës (600 nxënës).
- Objekti i vrojtimit: nxënës të "Maturës Shtetërore" 2011-të (vite të 4-ta në shkollat e mesme të përgjithshme apo të 5-ta në ato profesionale).


Grafiku 5: TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI RUBRIKA TË PYETËSORIT




82. Shtojca 8. Ky është viti i fundit ku filozofia ka patur statusin e një lënde të bërthamës kurrikulare. Pas kësaj, filozofia është lënë si lëndë me zgjedhje të lirë nga nxënësit.

Raporti i nxënësve pjesëmarrës midis shkollave të mesme të përgjithshme dhe atyre profesionale shprehej përmes raportit real që kishte arsimi i mesëm i përgjithshëm me atë profesional në qytetin e Tiranës 2011.

Grafiku 6: GJINIA E TË ANKETUARVE




Grafiku 7: NGARKESA NË ORË E LËNDËS



Sikundër shihet qartazi, lënda e filozofisë zhvillohet si lëndë e detyrueshme në një frekuencë prej 2 ose 1 orë në javë, ku 2 orë ishte në shkollat e mesme të përgjithshme dhe 1 orë në ato profesionale.



Grafiku 8: PËR ÇFARË SHËRZEN FILOZOFIA?



Nga përgjigjet rezulton se nxënësit në përgjithësi vlerësojnë si objekt të kësaj lënde: **Ndërtimin e aftësive gjyquese**. Ndërkohë që shfaqet kritik nivelit të ndikimit të lëndës në fuqizimin e pavarësisë. Por nga përgjigjet e pyetjeve të tjera kryqëzore rezulton se këtë përgjigje e japin sipërfaqësisht ndikimin në rubrikat e dhëna, jo se e besojnë një objekt të tillë. Kjo, sepse në pyetjen e mëposhtme:


Grafiku 9: METODA E ZHVILLIMIT TË ORËS SË FILOZOFISË



Pra, me një metodë mësimi tradicional me pyetje të gatshme sipas tekstit dhe me përsëritje gati automatike (që pohojnë 42% e të pyeturve) nuk mund të pretendojmë që objekti i filozofisë të jetë “ndërtimi i aftësive gjyquese” ndërkohë që ky pohim justifikon mospranimin e konsiderueshëm të ndikimit në pavarësinë e tyre. Nga studimi rezulton

se rreth 63% e nxënësve pohojnë metoda jo rezultative, tradicionale me një dije që vjen si “kopje” e tekstit mësimor apo mësuesit tradicional në metodika. Edhe një herë konfirmohet neglizhenca e politikave shtetërore (ISP apo departamenti në UT) për të përfshirë në kualifikime dhe trajnime të mirëfillta sipas zhvillimeve bashkëkohore mësimdhënësit e saj. Këtë e ripohon edhe grafiku i mëposhtëm që shpreh varësinë pothuaj totale të cilësisë së orës së mësimorit nga teksti mësimor (Kujtoj që jemi vetëm me një tekst për filozofinë në sistem.).

Grafiku 10: MBI Ç’MATERIALE BAZË ZHVILLOHET ORA JUAJ?



Grafiku 11: SI VLERËSOHET NGARKESA E ORËS TUAJ MËSIMORE?



Grafiku i mësipërm na dëshmon se nxënësit nuk kanë asnjë shqetësim (3 në 4 të pyetur) për ngarkesën e dijes gjatë orës së mësimorit të filozofisë.


Grafiku 12: ARËSYET E BRENDA 26% TË CILËSIMIT “E TEJNGARKUAR”



Kjo do të thotë se në edukimin filozofik, cilësia e dijes së nxënësve mbetet në varësi nga trajtesat klasike e mësimi nga mësues të pakualifikuar në vijimësi gjë që solli modelin e të mësuarit gati "përmendësh" të tekstit.


Nga të dhënat e mëposhtme rezulton se dhe koha që i kushtojnë ata përgatitjes së tyre në filozofi nuk shkon më shumë se një orë në ditë. Kjo është e mjaftueshme (Këtu duhet të mbajmë parasysh se nga modeli referent i pyetësorit, blloku III, nga UNESCO nuk ka patur zgjedhje nën një orë).

Grafiku 13: SA ORË STUDIOHET FILOZOFI NË DITË?



Grafiku 14: PËRDORIMI I INTERNETIT PËR DIJEN FILOZOFIKE


A keni përdorur internetin për formimin tuaj filozofik?



Duke ndjekur trendin e përgjigjeve vërejmë se, **ndonëse ishim në kulmin e pretendimit të shkollës dixhitale në përgjigje, 2 në 3 nxënës nuk e përdorin fare internetin si një burim plotësues apo perfeksionues të dijes filozofike në klasë.**

Grafiku 15: A E KENI ZGJEDHUR FILOZOFINË NË PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2011?

A është filozofia pjesë e lëndëve me zgjedhje në Maturën shtetërore 2011?




Viti kur është bërë studimi sjell një pamje pozitive. Matura 2011-të, filozofinë e kishte si lëndë e provimeve me zgjedhje së bashku me ekonominë e zbatuar, të dyja bashkë ishin për në Fakultetin Ekonomik. Ndërkohë, në po atë vit në studentët e vitit të 1-rë filozofi, vetëm 4 prej tyre kishin filozofinë si zgjedhje për të studiuar filozofi në Universitetin e Tiranës, (me shkallë rëndësie nga 5 në 10 në renditje). Pra asnjëri nuk e kishte parë filozofinë si formim i sigurtë për karrierën universitare, ndonëse Matura Shtetërore pretendonte të sillte në universitete meritë preferencën.

Studimi vazhdon thellimin në studimin e cilësisë së dijës filozofike.


Grafiku 16: DIJA SHKOLLORE DHE KURSET SHITESË PËR DIJEN FILOZOFIKE

Nëse "Po" a do të përdorni (po përdorni) kurse shtesë?




Nga 83% e të anketuarve janë shprehur se e kanë zgjedhur filozofinë si lëndë për provimet e maturës dhe më shumë se gjysma e tyre do ndjekin kurse private në lidhje me përgatitjen e tyre. *Kjo e dhënë edhe një herë rikonfirmon "dëmin" që sjellim në sistemin arsimor, ndërsa nuk kontribuojmë në sistemin e kualifikimit të burimeve njerëzore dhe publikisht sistemi (nxënësit drejtohen në kurse private të domosdoshme) vetë përfshihet në "korrupsion" publikisht.* Vetë këto qendra kursesh private në funksion kanë po këto mësues shkollash. Studimi ju referua edhe kërkimit për të studiuar cilësitë e përgjigjeve në raport me gjininë e të intervistuarve (2 grafikët më poshtë), nga të cilat *nuk vërehet ndikim në përgjigje:*

Grafiku 17: METODA E SHPJEGIMIT TË VLERËSUARA NGA GJINIA



Grafiku 18: CILËSIA E MATERIALEVE TË PËRDORURA VLERËSUAR NGA GJINIA



Le të ndalemi në analizën e disa të dhënave kryesore për t'i krahasuar më tej me sondazhin që ka bërë UNESCO për të shprehur ndikimin që mundëson filozofia dhe të filozofuarit në zhvillimin e nxënësve.

Së pari: përgjigjet e nxënësve shqiptarë rezultojnë të rrumbullakosura dhe priren të japin përgjigjen që e gjykojnë më afër asaj “çka duhet” se sa asaj çka ata vetë vlerësojnë. *Kjo dëshmon edhe një herë për formim të deformuar të nxënësit shqiptar i vërejtur nga studimi që në arsimin 9-vjeçar. Të mësuarit dhe të edukuarit në modelin “klasik” shekullar, ka krijuar një model nxënësi, i cili përpiqet të bëjë figurë të mirë sipas modelit të edukuar.* Le të shikojmë përgjigjet e nxënësve në raport me pyetjen: Cili sipas mendimit tuaj është objekti i kësaj lënde? Le të krahasojmë përgjigjet e nxënësve shqiptarë me standardin e mesatarizuar për 126 vendet e përfshira në studim nga UNESCO⁸³.

Grafiku 19: OBJEKTIVI I LËNDËS NGA SHQIPËRIA DHE STUDIMI I UNESCO-S



Çfarë rezulton nga ky krahasim?


Në përgjithësi, standardet e përgjigjeve të nxënësve të vendeve ku është kryer studimi rezultojnë në një masë prej gati 50% të ndryshme nga përgjigjet e nxënësve tanë. Madje, të krahasuara dhe me ndikimin që filozofia ka në lëndët e tjera, kemi këtë krahasim:

83. “Philosophy: a school for freedom”, 2007, UNESCO.



Grafiku 20: PRANIA E DIJES FILOZOFIKE NË LËNDËT E TJERA SHKOLLORE

Sipas opinionit tuaj përmbajtja e lëndës së filozofisë është trajtuar edhe nga lëndë të tjera



Ajo që të bën dukshëm përshtypje është përgjigjja që nxënësit japin për lidhjen që gjejnë mes filozofisë dhe shkencave të natyrës. Sikundër vërehet sërish, nxënësit tanë kanë një diferencë të dukshme në përgjigje. Madje mund të shihet se perceptimi i tyre për filozofinë është më afër historisë dhe qytetarisë. Kjo do të thotë se *filozofia nuk perceptohet në misionin e saj metodologjik e të formuarit të pavarur e kritik*. Të mësosh shkenca natyre pa e kuptuar nevojën e lidhjes me filozofinë është sa vjetër, aq edhe absurde në kohët e sotme. Por përgjigjet rezultojnë të tilla.

- **Stafet mësimore në arsimin e mesëm**


Stafi mësimor është një element tjetër i qenësishëm me të cilin ballafaqohemi në trajtimin e edukimit filozofik në shkollat e mesme. Gjendja aktuale e stafit të mësuesve me diplomë filozofie apo të kryqëzuar me sociologji që deklarohen zyrtarisht nga DAR, Tiranë si mësues që japin ose mund të japin filozofi në qytetin e Tiranës (2014-2015) është:

Tabela 29

Cilësia e diplomimit të mësuesëve që japin filozofi në qytetin e Tiranës				
Cilësia e diplomimit	Filozofi	Sociologji	Filozofi - sociologji	Gjithësejt
Nr. i mësuesve që japin filozofi	33	42	29	104

Në dukje kjo shifër është e mjaftueshme për të treguar rëndësinë që ka edukimi filozofik në shkollat e mesme të Tiranës. Por nëse i shkojmë deri në fund analizës vërejmë se në shkollat e Tiranës shumë pak nxënës kanë zgjedhur të zhvillojnë lëndën e filozofisë⁸⁴. Në këto kushte, rezulton se këta mësues duke mos plotësuar dot ngarkesën mësimore janë të “detyruar” të japin lëndë të tjera që në raste të caktuara janë edhe jashtë profilit. Gjithsesi mësuesit e filozofisë mendojnë se zgjedhja e kësaj lënde nga nxënësit varet shumë nga politikat që institucionet arsimore zhvillojnë në raport me këtë lëndë.

Grafiku 21: NGA SA PREJ TË DIPLOMUARËVE PËR FILOZOFI ZHVILLOHET LËNDA?



Pra, në ato shkolla ku mësuesit punojnë me pasion dhe drejtuesit e shkollave janë mbështetës në këtë zgjedhje kanë arritur që kjo lëndë të përzgjidhet nga *të paktën dy klasa*. Por **ka dhe shkolla, sikundër e pamë nga të dhënat, ku filozofia nuk zhvillohet fare**. Duket paradoksale, por politikat arsimore për këtë lëndë vazhdojnë të mos inkurajojnë nevojën e zhvillimit të filozofisë në shkollat e mesme.

Arsyet:

Sipas mësuesve, ka disa arsye që kemi këtë gjendje, por **kryesorja mbeten politikat arsimore të cilat nuk nxisin nxënësit për të studiuar filozofinë**.

Le të shohim grafikun e mëposhtëm:

84. Shtojca 9. Sondazhi i zhvilluar me 25 mësues të filozofisë në qytetin e Tiranës, pjesëmarrës në Tryezat e organizuara për këtë studim.



Grafiku 22: ARSYET PSE NUK ËSHTË ZGJEDHUR




Pra, arsyeja madhore është mungesa e politikave të qarta në lidhje me studimin e filozofisë si lëndë në shkollat e mesme.


Cilat janë pasojat e këtyre politikave? Në një qasje pragmatiste të nxënësve për të mësuar filozofinë si lëndë, padyshim luan rol dhe vlerësimi që i bëjnë institucionet arsimore me pikaverazhin që u ofrohet në formën e koeficientit të lëndës si faktorë për studimet e ardhshme. Ky koeficient për filozofinë është 1, në një kohë kur lëndët e tjera kanë koeficient mbi 1.

Le të analizojmë kërkesat që nxënësit kanë patur për të vazhduar studimet në degën e Filozofisë grafiku 24. Ndërsa 2 vite më vonë, pra kur kemi dhe produktin e parë pas heqjes së filozofisë nga kurrikula bazë, kemi këtë rezultat: grafiku 25

Grafiku 23: MATURA SHTETËRORE 2011, FILOZOFI - SOCIOLOGJI




Grafiku 24: MATURA SHTETËRORE 2013, FILOZOFI - SOCIOLOGJI



Nga 10282 nxënës që kanë kërkuar të ndjekin studimet në degën e Filozofisë në vitin 2011 (viti i fundit kur Filozofia ishte lëndë në kurrikulën bazë), dy vite më vonë, pra në vitin 2013, **shifra zbret në mënyrë drastike në 1363 nxënës!**

Pse kjo diferencë kaq e madhe? Ja si përgjigjen mësuesit:

Grafiku 25: SI VLERËSOHET STATUSI I FILOZOFISË NË SHKOLLËN E MESME?



Pra, në shkollat e mesme filozofia si lëndë është në një status të diskriminuar. Kujdesi i politikave arsimore ka shkuar në favor të lëndëve të tjera sociale, si: Sociologji, Psikologji, Qytetari, të cilat presupozohet se zëvendësojnë mjaftueshëm lëndën e Filozofisë.

Duke ndjekur shqetësimin e mësuesve në shkollat e mesme mbi një rikonceptim të kurrikulës së saj në lidhje me Filozofinë si lëndë, përgjigjja e tyre është:



Grafiku 26: A JENI GATI PËR NDRYSHIM TË GJENDJES TË STATUSIT?



Pra, të dy faktorët: a) **nevoja për një rikonceptim kurrikular** dhe b) dhe **gatishmëria e burimeve njerëzore për ta implementuar këtë rikonceptim ekzistojnë. Mungon vetëm faktori tjetër: Politikat arsimore** që duken se ende janë jo dashamirëse në pranimin e filozofisë si pjesë e kurrikulës bërthamë, të detyruar edhe me ndryshimet e bëra nga IZHA për Reformën në Arsimin Parauniversitar në Shqipëri, 2015.

Shqipëria përballlet sot me dukuri sociale të shumta e shpesh të vështira. Mungesa e lirisë është e pranishme si në mendësitë e popullsisë, ashtu dhe te rinia. Liria për të menduar dhe marrë mbi vete përgjegjësi, duket e largët edhe në brezat aktualë të nxënësve e studentëve. Dembelizmi intelektual e ka burimin në këtë dembelizëm mendor. Të mësuarit me Lirinë dhe frymën e saj, të mësuarit me kritikën dhe rolin e saj, të vlerësuarit e situatave nën përgjegjësinë personale janë pjesë e edukimit filozofik, i cili duket se ka mangësi serioze që në edukimin e tri cikleve të parasistemeve universitare. Për të gjitha këto arsye ne vazhdojmë të përballemi me mungesën e tolerancës, me dhunën dhe mungesën e etikës. Në kushtet kur feja dhe institucione të tjera edukative nuk kanë ndonjë rol të ndikueshëm në shoqërinë shqiptare, lipset të insistohet në edukimin e qëndrueshëm filozofik e më tej edhe në ndryshimin e statusit aktual të vetë filozofisë. Për secilin prej nesh tani është i qartë fakti që ka vite që mendimi njerëzor përmbajtjen e konceptit “filozofi” e ka përsosur për ta çuar gjithnjë e më shumë në aftësimin e

individit për t'u referuar në një sistem vlerash universal, për t'u orientuar e fuqizuar në “sënsin e përbashkët praktik”, ku nevoja dhe eksperiencia për realizimin e tij shmanë konfliktet në më të shumtën e mundshme për vendimmarrje progresive në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm botëror. Në shumëpërdorimet e saj, ajo kurdoherë mbetet e bashkëngjitur me shumatoren e vlerave tona personale, me eksperiencën jetësore, me stilet e jetës, me refleksionet e qarta mbi veprimet tona që duhet të jenë shumë profesionale me gjithçka përreth. Kjo disiplinë dijesh e aftësimesh në rezultat prodhon logjikë dhe qartësi për vendimet që ne marrim për veten, me grupet shoqërore ku ne realizojmë veten (mjedis, familje, shkollë, punësim, aktivitet qytetar, kontribut rajonal e ndërkombëtar).

Ndonëse tepër kontributore në modelimin dhe aktivitetin e qytetarit të botës sot, në Shqipëri, *ajo lexohet e papërfillur, deri e denigruar*, që nga kurrikula shkollore e deri tek mungesa e të rreshtuarit në profesionet e shërbimet në lista të profesioneve të para apo ndihmëse nga Ministria e Punës. Asaj, këto 3 vitet e fundit, askush nuk ka dashur ‘t’i ofrojë statusin profesional, ndonëse universiteti vazhdon të prodhojnë të rinj të aftësuar në këtë fushë. Për më tepër se kaq, ajo përfshihet në tezën se **“Shkencat shoqërore (edhe filozofia) janë në krizë!”**.

Kjo tezë e lexueshme në vlerësimin e mësipërm apo paraqitur edhe në opinione e debate mediatike nuk ka mundur të më bëjë të qartë mua dhe të tjerëve në po këtë shqetësim, apo të bëjë objekt të diskutimi me avokatin e djallit pyetje dhe përgjigje se si edukimi mundëson individin :

- mbi të ndjerite vetes, shqiptar, evropian edhe “qytetar i botës” në çdo vendimmarrje dhe veprim personal në raport me kërkesat e shtuara për të përfituar nga liritë dhe të drejtat njerëzore si pikënisje e të trajtuarit të barabartë mes të barabartëve në këtë botë, për sot e brezat që vijnë;
- mbi ATË që do prodhojë alternativat e zhvillimit dhe progresivitetit të ekonomisë shqiptare me cilësinë e qëndrueshmërisë së saj,
- mbi nevojën e vlerësimit të pasojave nga tronditja e thellë që ka pësuar shoqëria shqiptare në qenësimin përmes edukimit të sistemit të vlerave që kërkon ndërtimi i familjes përkundrejt numrit progresiv në shtim të divorceve në vend, e shoqëruar me “injorancën publike” në rritje përkundrejt domosdoshmërisë së një filozofie kombëtare mjedisore transparente. I referohem asaj filozofie si mendësi

kombëtare dhe frymë personale e kolektive, ajo e "përdorimit pa abuzim" ndaj burimeve natyrore dhe njerëzore në kushtet e përfshirjes së shoqërisë shqiptare në procese urbanizuese, shoqëri në të cilat njihet rendja drejt marrjes së mallrave, shërbimeve të shoqëruara nga tjetërsime të parashikueshme, por duke e parë në sy riskun edhe të tjetërsimeve të paparashikueshme.

- Në politikat mbi arsimin në vitet e ardhshme njëkohësisht edhe për arsimin e mesëm shihet dukshëm një mungesë e trajtimit të edukimit filozofik. Jo vetëm lënda e filozofisë mendohet të vazhdojë të konsiderohet "me zgjedhje", por dhe lënde të tilla si Qytetari e cila zhvillohet në klasën e X- dhe XI, përkatësisht me 1 dhe 2 orë në javë kur lëndë të tilla, si: matematika, fizika, biologjia etj zhvillohen me nga 2-3 orë në javë në të tri vitet e shkollës së mesme. Dukshëm ndjehet tendenca e nënvlerësimit të edukimit qytetar, edukimit filozofik, ndaj dhe në të ardhmen ne do të vazhdojmë të formojmë njerëz që do dinë të përsërisin dije, por jo të edukuar, do kenë (njohuri mbi natyrën, por jo mbi shoqërinë. Ky nënvlerësim duket më qartazi në kurrikulën e Qytetarisë, kur adoleshentit të kohës së TCH-së i mësohet "çfarë të hajë" dhe si të kalojë në vijat e bardha.

III. 4/c Sfida të edukimit qytetar për shekullin XXI dhe DotNets-at

Në trajtesat më sipër, por dhe duke i qasur me modelet e ndjekura nga edukimi shqiptar deri më sot për edukimin qytetar, edhe pse është i pakundërshtueshëm fakti se edukimi qytetar është një mjet për progresivin e mirëqenies së kombit dhe realizimin e idealeve demokratike, dekadat e fundit, për të gjithë botën demokratike, nga SHBA e deri tek ne, na ofrojnë **1. nivelet e ulëta të pjesëmarrjes në votim dhe 2. performanca të pamjaftueshme të nxënësve dhe studentëve në testet e edukimit qytetar dhe disiplinave që shprehin atë në parauniversitar dhe universitar.** Reformatorët në Amerikë i janë përgjigjur këtyre dy fenomeneve me përpjekjet për të rritur sasinë dhe cilësinë e kohës së shpenzuar në mësimdhënie të edukimit qytetar në sistem sikurse dhe për të krijuar standarde të përbashkëta të fokusuara në studimet sociale.

Sistemi i edukimit shqiptar në tërësi në rendje të nevojës për reforma në 25 vite në edukim në raport me objektivin për një demokraci dhe mirëqenie të qëndrueshme ka rrisuar e rrisikon ende:

1. në rendje të pretenduar të pasqyrimin të atyre objektivave që mijëvjeçari i ri i detyronte sistemit përmes refleksioneve të tij në zhvillimet në vend, por të porealizuar cilësisht edhe nga rezultatet e këtij studimi, veç atyre të Bankës Botërore, OECD etj.
2. nga rendja për të shpallur reforma të reja sa herë kryhen rrotacionet politike që jo rrallë ktheheshin në pseudoreforma pa objektiv e tregues matës dhe aspak vizionare dhe në perspektivë;
3. pasuar me ndikimin që partnerët e donatorët e huaj në sistem kërkonin të “ngjiznin modelet e tyre” në sistemin e edukimi dhe në edukimin qytetar në veçanti duke imponuar zgjedhje jashtë kontekstit të analizës së riskut (ku janë pretenduar mori projektet e programeve të ofruara, edhe kontraversale me njëra-tjetrën me kosto shumë të mëdha financiare përkundrejt qëndrueshmërisë në ndikim);
4. ndikuar nga buxhetet gjithmonë e në reduktim për arsimin brenda GDP-së kombëtare;
5. apo klima e polarizuar dhe konfliktuale e politikbërësve edhe për edukimin dhe strategjitë e zhvillimit të tij që merrnin ngjyrimet politike dhe jo kombëtare;
6. po ashtu hapja pa principe e standarde për licencimet në sektorin jopublik në edukim;
7. ndjekur nga politika e korruptuar në zbatim për AlerteKërkimin;
8. apo anemizmi i shtetit në monitorim e kontroll të cilësisë së edukimit në tërësi dhe atij qytetar në veçanti;
9. sikurse nga dobësimi i cilësisë së dijes qytetare përmes degradimit të statusit të filozofisë, sociologjisë, psikologjisë si lëndë me zgjedhje brenda kurrikulës së detyrueshme.

Të gjitha këto risqe ende prezentë në ndikim kanë larguar sistemin nga kontributi real që duhet të jepte përmes edukimit qytetar për Shqipërinë e gjeneratave të reja. Referuar faktorit të fundit të listuar, pra degradimi i statusit të filozofisë në kurrikulën e arsimit të mesëm, gjendje të tilla si ajo e vitit shkollor 2012-2013 në gjimnazin më të vjetër të Tiranës “Qemal Stafa”, në të cilin nuk zgjidhet filozofia as në cilësinë e një klase për mësim dhe këtë e quajnë edhe këshillim karriere!

Se çfarë rrisojmë me këtë qasje që pretendojmë t'i bëjmë arsimit të mesëm, le të



shikojmë tabelën e krimeve të kryera nga të miturit shqiptarë:

Tabela 29/1

Të dhëna për krimin nga minorenë në nivel Republike (për vitet që kap studimi doktoral).					
Të dënuar të mitur	2010	2011	2012	2013	2014
Për krime	594	610	826	589	545
Për kundravajtje	62	73	57	91	228
Totali	656	683	883	680	773

Në nivel vendi⁸⁵, krimi nga minorenët shënon 6% të të dënuarve për vitin 2014 (në total kanë qenë 13.618 të dënuar).

Siç shihet, **viti 2012** (Viti kur Reforma Politike në arsim e çon në lëndë me zgjedhje në arsimin e mesëm) është viti me të dhënat më kritike për nivelin e krimit nga minorenët, ndërsa në dy vitet më pas kemi një tendencë ulje të numrit të të dënuarve të mitur për krime (94%, 87%, 71%) ndërsa na shtohet numri i të dënuarve të mitur për kundravajtje nga (57, 91, 228).

Në cilësi krimi mbizotëron dënimi për vjedhje, vetëm dhe në bashkëpunim (Neni 134 i kodit PENAL të RSH-së).

Për vitin 2014, në 228 të mitur të dënuar për kundravajtje, 188 prej tyre janë me arsim të detyrueshëm të përfunduar ose edhe në ndjekje të arsimit të mesëm.

Nga sa më sipër rezultojnë dukshëm disa probleme:

Së pari: sistemi ynë edukativ ka shumë për të bërë në drejtim të edukimit me ligjin, rregullin dhe normat, gjë e cila mundësohet edhe nga të mësuarit filozofik.

Së dyti: këshillimi dhe karriera duhet të fillojnë që në sistemin 9-vjeçar, me synim që t'u ofrohen profesioneve të cilat i bëjnë të rinjtë të aftë për tregun e punës.

Së treti: reformat në arsim duhet të burojnë dhe paraprihen nga të dhëna e analiza shumëdimensionale të tyre dhe jo të shkojnë në të kundërt (2012-ta) të nevojave që jeta e fëmijëve dhe të rinjve sjell në këtë tranzicion të zgjatur të vendit drejt demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Po në arsimin botëror, cilat janë trendet dhe perspektivat e filozofisë?

Finlanda është një nga ato vende që cilësohen me një nga sistemet më të mirë të edukimit, e rreshtuar në krye të listimit të PISA-s, 2012 në matematikë, lexim dhe

85. Statistikë e Ministrisë së Drejtësisë, 2015.



shkencë.

Ajo është referenca e shumë zhvillimeve në kurrikulat e vendeve të tjera, sikurse edhe e sistemit të kualifikimit dhe karrierës së mësuesve para dhe në sistem. Edhe pas këtij listimi prestigjioz, pas studimeve dhe kërkimeve mbi cilësinë e dijes në anglisht dhe fizikë tek 16-vjeçarët finlandezë, në shkollat e Helsinkit u hoq dorë nga të mësuarit bazuar në lëndë për të kaluar në të mësuar bazuar në fenomene.

Finlandezët po mësojnë mbi fenomenet ashtu si Bashkimi Evropian këshillon të mësohen të përfshira në një gjuhët, historia, politika dhe gjeografia e një vendi. Po hiqet dorë në shkollat finlandeze nga oraret që ora e historisë pasohet me kiminë e kështu me radhë, dhe kjo me qëllim që të eliminojnë shqetësimin dhe mosvlerësimin që 16-vjeçarët kanë mbi lëndë që në fund të orës pyesin veten: "Cila ishte ajo pikë për të cilën unë duhet ta mësoja këtë?". *Ky është detyrimi i shtetit, i sistemit të edukimit që ka në qendër individin me kompetenca, detyra e politikbërjes ndaj një gjenerate që përdor mrekullisht kompjuterin ndaj dhe lëndët shkollore duhet të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare bazuar në arsyen se pse duhen studiuar.*

Shkollat amerikane po i kthehen mësimin të filozofisë dhe kjo lëvizje ka sjellë përfitimet e para. "Por në disa shkolla ambicioze përreth vendit, lënda e filozofisë ka sjellë përmirësime në mënyrën se si nxënësit mësojnë... Të mësuarit e filozofisë i ka aftësuar nxënësit të dëgjojnë më mirë, të pranojnë këndvështrime të ndryshme mbi botën, të flasin qartë, të arrijnë të artikulojnë si duhet opinionet e tyre.⁸⁶". Ndërsa artikulli sjell në vëmendje aktivitetin e pedagogëve, doktorantëve për filozofinë sjell një model të tillë: "Nuk është e thënë të zhvillosh lëndën e filozofisë që të bësh përsiatje filozofike tek nxënësit në klasë," - thotë Lone, e cila ka ndihmuar mësuesit që nuk japin filozofi të qartësojnë konceptet në studimet e tyre. "Këto pyetje ngrihen në të gjitha lëndët."

Diskutimet rreth shtrirjes periferike të Amerikës pas Luftës së Dytë Botërore, mund të ndezin biseda mbi identitetin personal. Vërtetime të thjeshta gjeometrike përdorin aftësitë e të menduarit që i hasim tek logjika. Dhe gjëja më e mirë sipas Lone, është se filozofia është demokratike, të gjithë mund të thonë mendimin e tyre.

"Shoh një fëmijë që e ka të vështirë të artikulojë se çfarë po mendon, dhe fëmijët e tjerë në klasë thjesht rrinë duke pritur sa të mbarojë së foluri shoku apo shoqja, - thotë ajo.

86. <http://www.businessinsider.com/teaching-philosophy-in-schools-has-huge-impacts-2015-7?IR=T&r=UK>



Kjo është një gjë tepër e fuqishme për t'u parë, dhe unë e shoh pothuaj çdo vit.⁸⁷

Këto janë zhvillime që pretendojnë të qasin sistemet e edukimit me prioritetet që duhet t'iu mundësojnë shoqërive respektive (finlandeze dhe amerikane) edukimin për gjeneratat e reja dhe zhvillimin e qëndrueshëm për vendet e tyre. Ato shoqëri, ndonëse të zhvilluara dhe me tregues të vlerësueshëm të ZHQ-së vijojnë të rikonceptojnë instrumentet me të cilat qeveriste më mirë sistemi i edukimit, instrumente që afektojnë në cilësi të drejtën për t'u arsimuar po aq sa edhe në favor të parimit se edukimi është një e mirë publike përfitimet e të cilit i marrim të gjithë jashtë, pavarësisht kufijve shtetërorë dhe gjeografik, falë këtij shekulli të informacionit dhe komunikimit masiv.

87. <http://www.businessinsider.com/teaching-philosophy-in-schools-has-huge-impacts-2015-7?IR=T&r=UK>

KAPITULLI IV

EDUKIMI FILOZOFIK DHE ARSIMI I LARTË

IV.1 FILOZOFIA NË ARSIMIN E LARTË

“Kur filozofia përshkruhet bardhezi atëherë një aspekt i jetës është plakur dhe nga bardhezi nuk arrin të rinohet, por vetëm të njohë: kukuvajka e Minervës fillon udhëtimin e saj drejt muzgut...”

Hegel

Në botën postmoderne, të studiosh filozofi mund të konsiderohet si kohë e humbur. Ndoshta sepse edukimi filozofik duhet të mbështjellë gjithë edukimin institucional në të gjitha nivelet e veta edukative. Kjo përforcohet edhe me faktin që mendjet gjeniale të njerëzimit kanë folur për gjithçka dhe kanë kundërshtuar çdo gjë. E megjithatë, në kohën e mbiquajtur pragmatiste pyetja është e thjeshtë: përse duhet të studiojmë Filozofi në Universitet?

Përse na duhet ky shpenzim kohe dhe energjie nëse nuk përkthehet në një investim utilitar?

Filozofia nuk merret me studimin apo njohjen e çështjeve të veçanta që mund t’iu interesojnë njerëzve në një moment të caktuar të jetës, por me çështje universale që i përkasin të gjithëve e në të gjitha kohët. Ndaj:

1. Mungesa e kulturës filozofike ndikon drejtpërdrejt në rrezikun e absolutizimit të së sotmes. Kjo do të thotë të mos kuptosh të “djeshmen” dhe të mos besosh në të ardhmen e për më tepër të pranosh se ajo çka thuhet, “zbulohet” apo trajtohet, sot, është e vërteta e fundit! Rreziku bëhet edhe më i madh kur në kushtet e TCH-së informacionet spekulative mbushin në mënyrë të shpejtë mendjet e boshatisura nga logjika dhe mendimi kritik. Si mund të kuptohet shkenca dhe arritjet e saj pa epistemologjinë! Nëse duhet të kuptojmë ndonjë informacion

që vjen nga shkenca, më së pari duhet kuptuar se “të vërtetat shkencore” janë të tilla për çdo kohë e çdo vend, por zbulimet e reja përmirësojnë ose e zhvendosin argumentin në një fushë tjetër aplikative. Vetëm nëse arrijmë e gjykojmë në këtë mënyrë do jemi të aftë të mos hidhemi nëpërmjet entuziastë nga “zbulimi” i “qelizës së Zotit”!

2. Është më se e vërtetë që njaft filozofë të njohur kanë formuluar teza e teori tërësisht të ndryshme për të njëjtat argumente. Kjo situatë duket sikur e dobëson Filozofinë. Përkundrazi idetë dhe teoritë filozofike janë fryt jo i mendjeve të “sëmura” apo sharlatane, por e debateve të gjera, dhe kjo është një tjetër shenjë e forcës dhe e nevojës që kanë njerëzit për të pranuar diferencën në mendime, për të kritikuar dhe për t’ju afruar gjithnjë e më shumë thelbit të debatit. Individualisht njeriu mund të arrijë në një përfundim, por duke e vënë në diskutim të “vërtetën e tij” e cila, vetëm kur bëhet objekt debate, fiton edhe më shumë vlerë.
3. Nëse arrin të njohësh shumë ide dhe mendime të djeshme e të sotme njeriut i vijnë në ndihmë shumë refleksione mbi probleme të ndryshme që bëhen çdo ditë të pranishme në jetët tona. Teoritë politike janë zhvilluar nga filozofët. Filozofia të furnizon me modele të arsyes, me përgjigje dhe aftësi për të gjykuar në Liri, me aftësinë për të parë gabimet pa ndroje e për të gjetur forca për t’i korrigjuar ato. Filozofët kanë përcaktuar epoka në histori dhe kanë gjeneruar modele që u kanë dhënë formë jetës.

Filozofia nuk të armatos me përgjigje të gatshme, filozofia të armatos me probleme!

Së fundmi: Filozofia nuk është citat! Filozofia është metodologji e arsyetimit, kritikës dhe dyshimit, dhe shoqëria jonë shqiptare ka shumë nevojë për këtë lloj ushqimi mendor.

Janë pikërisht këto arsye që kërkojnë në universitet një cilësi të caktuar studentësh, të cilët, mbi të gjitha, të kenë dëshirën për të “filo-sofos”, pra për të dashur dijen. Është e vërtetë se nuk të bën filozof të studiosh tre apo pesë vite filozofinë, por është po kaq e vërtetë se nëse dëshiron të kesh një mendje të mprehtë e një gjykim të shëndetshëm studimi, i filozofisë është i domosdoshëm. Nëse këtë problem e shtrojmë edhe në sensin praktik, pyetja e mësipërme merr këtë përgjigje:

Edukimi filozofik në të gjithë sistemin tonë shkollor parauniversitar kërkon njerëz të aftë që të njohin filozofinë e të kenë të qartë se çfarë do të thotë të edukosh filozofikisht

*fëmijët apo këdo tjetër!*

Në gjithë këto situata kritike socio ekonomike të vendit në nivel kombëtar apo lokal, në kushte të krizës ekonomike dhe pasojave të saj sociale mbi qytetarët, na kërkohet t'i konsiderojmë e ideojmë universitetet (publike dhe jopublike) si qendra të vizionit dhe të kërkimit shkencor të DEAR-it dhe mjediset ku fuqizohet qytetari global që zgjidh problemet e zhvillimit por dhe mundësohet avokatia qytetare.

Këtë mision ato e kryejnë përmes institucionit të dijes dhe kurrikulës së ngritur mbi kushte pjesore apo rastësore njëkohësisht mbi strategji të menduara të parapritjes përmes dijes në të ardhmen. Kjo për të gjitha nivelet e organizimet dhe me shumësi formash konkurruese. Kjo fuqi mendimi, minimalisht duhet të pasqyrohet edhe në kurrikulat tona ndërdisiplinore universitare, në tematikat e studimeve në nivele të ndryshme të thellimit të dijes në fusha apo ndërfusha, në shkëmbimin e pasqyrimin e përvojave, risive dhe botimeve në fusha ku disiplinat konvertojnë apo ndahen me njëra-tjetrën.

Nëse do t'i referohesha John Maxwell tek "Të mendojmë për ndryshimin", gjykoj se dialogu apo analizat filozofike mbi ZHIQ-të Tiranës, mbi bazën e "Të menduarit kritik e global" duhet të përdoret për të drejtuar të menduarin dhe organizimin tonë në auditorët studentore apo mes kolegësh por më shumë se kaq është detyrimi ynë për të dalë tek "Auditori Publik". Ky auditor nuk kërkon shumë formalizëm, ai ndjek nevojën dhe shqetësimin, individual a komunitar qoftë. Por, domosdoshmërisht "Auditori Publik" duhet të vijë në vendin e kohën e caktuar, pasi nuk duhet të pranojmë të gjithë se "E thamë apo vepruam vonë ndaj...".

E ardhmja jonë dhe e pasardhësve nuk e pranon këtë lloj vonese.



IV. 2 STUDIM KRAHASUES MBI EDUKIMIN FILOZOFIK NË ARSIMIN E LARTË SHQIPËRI / GRANADA, SPANJË / JENA, GJERMANI

Në Universitetin e Tiranës prej vitesh ekziston një departament i Filozofisë, i cili pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar ndër vitet, mbetet i vetmi i këtij lloji në Shqipëri. Pyetja mbetet si gjithnjë: Kohët e filozofisë sokratiane apo kantiane kanë perënduar, atëherë çfarë kërkojnë studentët që studiojnë filozofi? A e bëjnë këtë për pasion apo sepse kanë përfitime utilitare në jetë? Çdo vit nga dega e filozofisë në Universitetin e Tiranës laureohen rreth 90 studentë në sistemin bachelor dhe rreth 80 studentë në nivelin master. Një pjesë e madhe e tyre mbeten të papunë, për shkakun se mësuesia ku ata punësoheshin më parë (me heqjen e filozofisë si lëndë në shkollat e mesme) u reduktua si mundësi. Megjithatë, ky nuk është problem thjeshtë shqiptar. Në mendimin tim, ky është problem global. Por perceptimi im shkon në favor të së ardhmes së studimit të filozofisë në Universitet. Unë mendoj se koha e universiteteve populiste po mbaron dhe nesër studimi i filozofisë do shndërrohet sërish në një problem preference individuale, por edhe nevojë shoqërore. Kush më mirë se filozofia do të mund t'iu përgjigjet tri pyetjeve: “Kush jam”, “nga vij”, “ku shkoj”? Ndaj e konsideroj statusin e filozofisë në universitet si të shenjtë e të domosdoshëm për shoqërinë tonë. Pretendimet burokratike që propozojnë të kufizojnë numrin e studentëve që duhet të ndjekin filozofinë, pasi nevojat e punësimit shkojnë në përpjesëtim të zhdrejtë me diplomimin, janë pretendime që shkojnë kundër nevojave, rrjedhës dhe të ardhmes së edukimit me lirinë dhe hapjes 360 gradë të mendjes.


Për të parë se si qaset filozofia në universitetin shqiptar në raport me universitetet e tjera në Evropë, kam zhvilluar studimin e mëposhtëm, i cili është ndërtuar mbi bazën standarde të pyetësorit të realizuar nga UNESCO.

Në këtë studim synoj të krijoj dhe një mundësi krahasimore me dy vende të tjera,

sikundër janë Spanja dhe Gjermania⁸⁸. Qëllimi i studimit: është:

- të njohë opinionin e studentëve të filozofisë në lidhje me vendin që zë Filozofia në universitete, si edhe mundësitë për punësim pas studimeve në filozofi.
- të shikojë nevojat që kanë studentët për t'u ballafaquar me realitetin e shekullit XXI. Rezultatet e këtij studimi na sjellin një qasje krahasimore për të vlerësuar nevojën, por dhe standardet e studimeve të filozofisë në sistemin Universitar.

Grafiku 27: SA VITE KENI QË STUDIONI / LEXONI FILOZOFI?



Sikundër shihet, rezultatet janë pothuaj të njëjta dhe nuk gjejmë ndonjë diferencë të dukshme në interesin që studentët shqiptarë, tregojnë ndaj filozofisë në raport me interesin e studentëve në Gjermani apo Spanjë. Pra, nëse ushqehet dëshira për të studiuar filozofi, studentët e zgjedhin me dëshirë! Megjithatë mendoj se të studiosh filozofi në universitet duhet ta bësh këtë i shtyrë nga dy premisa:


- dëshira për të studiuar filozofinë;
- mundësia për t'u punësuar.

Modeli i këtij krahasimi në qasjet me vendet e tjera do të duket në grafiket e tabelat në vijim.

88. Shtojca 10. Kam zgjedhur dy universitete: \ Granadën dhe \ Jena në Gjermani të njohura për studime në fushën e filozofisë. Përmbajtja e pyetësorit është ajo e zhvilluar nga UNESCO. Fakulteti i Filozofisë në Granada, përbëhet nga dy departamente filozofie (Filozofia 1 dhe Filozofia 2) Në këtë fakultet studiojnë pesë mijë studentë, dhe rreth treqind e pesëdhjetë pedagogë të stafit të kërkimit. Kurrikula është e ndarë në katër blloqe: filozofi, logjikë dhe filozofi e shkencës: moral dhe filozofi politike: Estetikë dhe Teoria e Artit.


Universiteti "Friedrich Schiller" i Jenas në Gjermani ka fakultetin e Filozofisë në të cilin japin leksione 70 profesorë dhe 180 pedagogë. Përveç kësaj, më shumë se 180 akademikë të rinj janë në proces duke punuar në doktoraturë e filozofi. Fakulteti e sheh veten si një shkollë klasike me një fokus në gjuhën dhe letërsinë, artin dhe filozofinë, historinë dhe të komunikimit.


Grafiku 28: A KENI PASUR EKSPERIENCA BOTIMESH FILOZOFIKE?




Nga të dhënat rezulton se studentët shqiptarë kanë mundësi të publikojnë esetë ose opinionet e tyre në po atë mundësi që kanë edhe studentët në Gjermani. Por, në gjykimin tim, kjo e dhënë lidhet me faktin e të qenit një vend i vogël dhe pa shumë përvojë në publikime shkencore apo opinonative. Ky fakt iu krijon më shumë mundësi studentëve që të botojnë ese ose refleksione edhe nëse niveli i tyre le për të dëshiruar. Nga ana tjetër, studentët e fakultetit të filozofisë në Universitetin e Jenas janë prirur drejt komunikimit ndaj dhe e kanë mundësinë të provojnë vetën në fushën e botimeve., gjë që nuk duket në studentët e Universitetit të Granadës.

Grafiku 29: A KENI EKSPERIENCA BLOGJESH DHE RRJETESH SOCIALE FILOZOFIKE?



Grafiku 30: A JENI NDJEKËS TË JETËS SHKENCORE NË UNIVERSITETET?


Pra, modeli shqiptar i aktivizimit të studentëve përafrohet me modelin gjerman për shkak të ngjashmërive të studimeve klasike në kurrikulën universitare, ndërsa Spanja ka një kurrikul shumë të hapur me lëndë me zgjedhje. Orientimet universitare, edhe në këtë pikë, bëjnë diferencën e tyre. **Është e dukshme që modeli gjerman është shumë pranë modelit shqiptar.** Mendoj se kjo ngjashmëri lidhet me arsyen e organizimit të fakultetit të filozofisë dhe aktivitetit akademik, që kanë pothuaj të njëjtën qasje si në Gjermani, ashtu dhe në Shqipëri. Ndryshe ndodh në Spanjë, e cila e ka të organizuar sistemin e kërkimit shkencor më vetë, pra jashtë studimeve universitare.

Grafiku 31: SA ORË NË DITË ZË STUDIMI JUAJ?

Sërish kemi përgjigje që të tërheqin vëmendjen në dy problematika:

Opsionit “nuk studioj fare” asnjë student i Universiteteve të Jenit apo Granadës nuk i është përgjigjur, ndërsa 7% e të pyeturve në Shqipëri i janë përgjigjur pozitivisht. Kjo dëshmon për mungesën e seriozitetit me të cilën studentët vlerësojnë studimin e pavarur, që tërthorazi dëshmon për mungesën e dëshirës për të studiuar filozofi. Pra, kjo shifër shkon në favor të premisë së dytë për të ndjekur studimet në filozofi, me synim marrjen e diplomës dhe jo dijes.


Grafiku 32: ÇFARË NIVELI STUDIMESH UNIVERSITARE OFRON UNIVERSITETI JUAJ PËR FILOZOFI?



Sikundër shihet, të bën përshtypje një përfaqësi e organizimit të sistemit në nivel bachelor, por në ndryshim nga Shqipëria dhe Spanja, Gjermania nuk organizon doktoraturën si cikël të tretë. Spanja organizon kërkimin shkencor si të ndarë nga studimet universitare e doktoraturën. Studentët shqiptarë atë vit (2011) njohën politikat e studimeve universitare 3+2 dhe pak prej tyre njihnin faktin se prej një viti kishte rifilluar shkolla doktorale për filozofi pranë FSHS-së, UT.




Grafiku 33: SI MUND TË VLERËSOHET NIVELI I STUDIMEVE TUAJA NË FILOZOFI?




Sërish duket ngjashmëria me sistemin gjerman dhe ndryshimi me sistemin spanjoll.

Grafiku 34: SA E PËRDORNI INTERNETIN NË STUDIMET TUAJA UNIVERSITARE



Sikundër vihet re, studentët shqiptarë përdorin rregullisht internetin në një masë 77%, kjo dhe për shkak të teksteve universitare në shqip, por bie ndjeshëm përdorimi intensiv i tij. Duket se studentët spanjollë e gjermanë e kanë më të qëndrueshëm studimin nëpërmjet internetit.

Grafiku 35: KU JANË MUNDËSIT E PUNËSIMIT TUAJ?



Stabiliteti në punësim është i dukshëm si te studentët gjermanë, ashtu dhe te ata spanjollë. Studentët shqiptarë janë më të paqëndrueshëm në tregun e punës.

Sikundër shihet qartazi mënyra e organizimit të studimeve filozofike në Universitetin tonë është pranë parametrave evropianë. Ajo që nënvizohet ka të bëjë me standardet kurrikulare dhe ndikimin nxitës të studentëve për të studiuar filozofi. Periudha në të cilën jetojmë si dhe interesat pragmatiste na çojnë në mendimin se zgjedhja e studimeve filozofike në Universitetin e Tiranës (ku është dhe departamenti i vetëm në shkallë vendi) në një pjesë të madhe priren nga mundësia e punësimit të tyre, në një kohë kur në universitetet e tjera priren nga dëshira për të studiuar dhe vazhduar kërkimet në fushën e filozofisë.

Departamenti i filozofisë pranë FSHS-së në Universitetin e Tiranës

Departamenti i Filozofisë i ka fillimet e veta që në vitin 1965 si pjesë e “Fakultetit të Shkencave Politike dhe Juridike”, ku përfshihej edhe dega e filozofisë. Nën një sistem totalitar ku edukimi me filozofinë marksiste-leniniste konsiderohej “detyrë” prioritare



e propagandës partiake, studimet në degën e filozofisë kishin angazhuar: a) pedagogët më të mirë të fushës, b) studentët me rezultatet më të larta e me një mbështetje të fortë politike. Ndaj dhe për një farë kohe diploma mbante si “profesion” “**Specialist i shkencave politike**”. Këto fakte e kishin limituar mundësinë e studimeve në fushën e filozofisë, për masën e madhe të të rinjve. Numri shumë i kufizuar i studentëve në këtë degë lidhet me “frikën” që sistemi i atëhershëm kishte ndaj të diplomuarve në këtë fushë. Kjo do të thoshte se Filozofia, edhe nën atë trysni ideologjike, mundësonte një edukim me lirinë e mendimit, e cila u reflektua qartazi me vendosjen e demokracisë. Studentët që kishin mbaruar filozofinë u shndërruan menjëherë në frymëzues të ideve të demokracisë dhe mendimit të lirë, duke mbajtur edhe sot protagonizmin në diskursin publik, pavarësisht shkollave apo mendimeve që përfaqësojnë⁸⁹.

Pas ndryshimeve demokratike në vend, në vitin akademik 1992-1993, dega e Filozofisë u shndërrua në Departamentin e Filozofi-Sociologjisë në Fakultetin të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Kjo ndërhyrje sërish pati karakterin e vet politik dhe aspak akademik. Shkak u bë jo vetëm paragjykimi për prodhimin e dalë nga departamenti i filozofisë në Universitetin e Tiranës, por edhe nevoja për një ringritje në nivele të departamenteve bashkëkohore të filozofisë. Dhe në këtë periudhë, profesorë të filozofisë jo vetëm u bënë mbështetës të frymës demokratike, por mbrojtën me argumente shkencore nevojën e rindërtimit të një departamenti filozofie nën një status të veçantë⁹⁰. Në vitin 1992, pedagogu Gj. Sinani i propozon Rektorit të kohës (Prof. Marenglen Spiro) aplikimin e modelit francez të filozofisë sipas Universitetit “Pol Valeri” në Montpellier të Francës edhe nën ndikimin që krijoi ardhja e Prof. Frank Tinland pranë departamentit. Ky propozim, i cili do t’i kishte dhënë një qasje të re departamentit, jo vetëm nuk u miratua asnjëherë, por përkundrazi u nxor urdhri i pezullimit të degës së Filozofisë .

Në vitin 2010 Departamenti i Filozofisë e rifiton sërish statusin e vet të pavarur. Ky departament është realisht departamenti i vetëm në Shqipëri.

Politika e kuotave të studimit në degën e filozofisë në 4 vitet e fundit.

Kuotimet në numër të studentëve në degën e Filozofisë në respektim të politikave

89. Profesorët, Gjergj Sinani, Artan Fuga, Zyhdi Dervishi, Zamira Cavo, Servet Pëllumbi, Përparim Kabo, Fatos Tarifa etj.

90. Në forume akademike, në shtypin e ditës, pranë institutit pedagogjik dhe tryeza politikash arsimore lektorë si: Gjergj Sinani, Artan Fuga, Aleksandër Kocani, Adriana Anxhaku etj., si dhe ekspertë të fushës së edukimit (ish-studentë të Filozofisë) si Fatmira Myteberi, Shpresa Petrela, u bënë zëri mbështetës i domosdoshmërisë së dhënies së një statusi të veçantë të Filozofisë si degë studimi.

nga Ministria e Arsimit ndjekin linjën: propozohet nga departamenti, miratohen në Dekanat dhe Rektorat, miratohen në Ministrinë e Arsimit. Duhet theksuar që në këto vite, përveç prognozës në departamente ka ndikuar edhe standardi filtrues që Matura Shtetërore bëri për pranimin e studentëve në universitete. Ndonëse departamenti ka kërkuar po ato kuota (nuk është kërkuar rritja e numrit mbi 100 për faktin e humbjes së statusit të saj në shkollën e mesme shqiptare pas 2011-ës) vërehet se numri i aprovuar nga MES-i ka pësuar reduktim të dukshëm. Kjo situatë shpreh vetëm elementin “numër studentësh të pranuar”. Ndërkohë me “cilësinë e studentëve” dhe meritë: preferencën e pretenduar ndodhi devijanca më e madhe. Pas humbjes së statusit si lëndë në shkollat e mesme, pas vitit akademik 2011-2012-të vërehet se 1 deri në 10 studentë në kurset e viteve të para, fitues të Maturës Shtetërore, e kishin patur filozofinë si zgjedhje nga 1 deri në të pestën. Shumica e studentëve vinin me cilësinë e zgjedhjes nga 5 në dhjetë. Shumica e studentëve (mbi 90%) nuk kishin zhvilluar filozofinë në shkollën e mesme. Në pamje të kundërt vijnë nga studentët e vitit të tretë vlerësimi për filozofinë ndërsa mbyllin nivelin Bachelor në FSHS.

Le të vlerësojmë këtë dinamikë të hyrjes në universitet. Numri i studentëve (niveli Bachelor) pas ndryshimeve të fundit (2011) paraqitet:

Tabela 30

Të dhëna për studentë që studiojnë filozofi				
Viti	2011/2012	2012/2013	2013/2014	2014/ 2015
Gjithsej	101	78	101	68
Vajza	77	68	92	63
Djem	24	10	9	5

Sikundër vihet re, numri i studentëve që realisht studiojnë filozofi në raport me nevojat që ka vendi për zhvillimin e qëndrueshëm në vend është tepër i vogël. Po ashtu edhe pjesëmarrja e meshkujve në të është shumë kritike. Por, në raport me degët e përafërta, si: sociologji, psikologji apo shkenca politike kemi një situatë krahasimisht të njëjtë⁹¹.

91. Janë shfrytëzuar të dhënat e FSHS, të UT, 2014.

**Tabela 31**

Të dhëna për studentë që studjojnë filozofi vite/profile						
Viti	Filozofi	Sociologji	Psikologji	Shkenca Politike	Punë Sociale	Administrim dhe politika sociale
2011/2012	101	101	111	109	102	99
2012/2013	78	84	109	88	89	81
2013/2014	101	86	122	87	115	107
2014/ 2015	68	88	111	87	114	103

Ndërsa tregu i arsimit jopublik pas 2005-ës në arsimin e lartë ofroi shumë fakultete të shkencave sociale në disa nga Institucionet e Arsimit të Lartë apo Universitetet Jopublike, ato nuk përfshinë "Filozofinë" si mundësi e diplomimit në to. Kjo bëri që Universiteti i Tiranës të mbetet i vetmi që prodhonte nën këtë cilësim diplome në të dy nivelet e arsimit të lartë, Bachelor dhe Master.

Pse ndodhi kjo?

Përgjigjen mund ta gjejmë në pyetësorët e studimit, ku studentët e shikojnë Filozofinë si një mundësi jo fort të mirë për punësim. Por nga ana tjetër, po në studimet e këtij punimi nuk gjen vend pretendimi se studentët nuk e preferojnë degën e filozofisë. Gjithsesi, **mungesa e rregullimeve në statusin e profesioneve për studentët e filozofisë mbetet problem për punësimin e tyre.**

Sot, Departamenti i Filozofisë në Universitetin e Tiranës ofron: studime në Bachelor filozofi , ku ka si **fusha studimi bazë:**

- Histori filozofie (antike dhe bashkëkohore).
- Logjikë dhe Filozofi gjuhe
- Etikë dhe estetikë.
- Filozofi politike dhe të drejtës.
- Filozofi feje dhe historie
- Si dhe një sërë kursesh speciale me zgjedhje e fusha të ndërmjetme të afërta me filozofinë.

Departamenti ofron dhe **tri mastera për studime filozofike:**

- Master Shkencor në Filozofi Sociale (që nga përmbajtja e programit ofron thellim dhe aplikim kërkimor në fushën e filozofisë).
- Master Shkencor ndërdisiplinor Etika në institucione dhe Lidërsip (ku pranohen studentë edhe nga fusha të afërta me filozofinë, ku mundësohen aftësim e shprehje organizuese e drejtuese në institucione e organizata të ndryshme).
- Master Profesional në Filozofi praktike dhe humane, (që mundëson një kurs konkret dhe aplikativ të filozofisë jo vetëm për studentët e filozofisë, por edhe për ata që e kanë pasion filozofinë e vijnë nga fusha të afërta).

Filozofia si materie e universiteteve

Pavarësisht se në Universitetet shqiptare ka vetëm një departament Filozofie, sërish duhet thënë se filozofia zhvillohet e trajtuar në profile të ndryshme në të gjitha universitetet tona publike dhe jo publike. Në të gjitha degët që përshihen në fakultetet apo departamentet e shkencave sociale, gjenden në kurrikula module filozofike, duke filluar që nga filozofia e artit dhe komunikimit, e deri te filozofia politike apo filozofia e së drejtës⁹². Kjo do të thotë se filozofia në thelbin e vet është dhe realisht nuk mund të mos jetë e pranishme, në të gjithë sistemin tonë të edukimit universitar. Kjo e vërteton katërçipërisht faktin se të gjitha dijet kanë në thelbin e tyre nevojën për tu interpretuar dhe këtë interpretim, si në aspektin historik ashtu dhe në atë metodologjik e gjejnë te Filozofia. Përtej kësaj nevojë, filozofia shihet si një armë e fortë e kulturës individuale. Por në rastin shqiptar unë do ta shihja si një nevojë të përgjithshme të shoqërisë shqiptare.

Edukimi filozofik nuk do të thotë detyrimisht vendosjen e një lënde me përmbajtje fjalën Filozofi, por një proces i tërë i trajtimit kurrikular të çdo diplome nën një metodologji filozofike. Shqipëria sikundër e thamë që në fillim të këtij punimi nuk ka ndonjë trashëgimi të fuqishme kulturore sidomos në konceptet e lirisë individuale në rrokjen e kolektives apo të përbashkëtës. “**Uni**” dhe “**Ne**”, shpesh ngatërrohen, pasi mungesa e lirisë së mendimit dhe qartësisë së gjykimit nuk arrin të saktësojë limitet dhe dallimet mes natyrores dhe sociale. Ndaj edukimi filozofik është dhe duhet të mbetet një nevojë parësore e universiteteve tona.

92. Vetëm në UT-s mund të dallojmë se në Fakulteti i Filologjisë zhvillon Filozofinë e gjuhës, Historinë e Filozofisë, Filozofinë e komunikimit dhe shumë disiplina të tjera filozofike. Fakulteti i gjuhëve të Huaja zhvillon lëndë si Mendim politiko-filozofik shqiptar, Instituti i Studimeve Evropiane zhvillon lëndë si Filozofia e Integritimit evropian, Fakulteti Drejtësisë zhvillon Filozofinë e së Drejtës, Fakulteti Ekonomik zhvillon Etikën e biznesit dhe disiplina të tjera filozofike etj.



Filozofia si materie diplomimi

Në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan gjejmë diploma që kanë të dukshme materien “filozofi”, por të bashkëngjitur me sociologjinë⁹³.

Dega Filozofi-Sociologji u krijua në tetor të vitit 2005⁹⁴. Në dhjetor të vitit 2007, këto degë u atashuan (gjatë riorganizimit të Universitetit të Elbasanit) pranë Departamentit të psikologjisë-sociologjisë dhe shkencave të edukimit në Fakultetin e Shkencave të Edukimit.

Qëllimi dhe misioni i këtij programi sipas faqes zyrtare shprehet:

“Aktiviteti mësimdhënës bazohet në një program bashkëkohor, i cili bën të mundur përgatitjen cilësore të studentëve në profesionet përkatëse. Aktiviteti shkencor është i karakterit të aplikueshëm dhe përqendrohet në studimet sociale, që janë me interes për shoqërinë shqiptare⁹⁵.”

Në Universitetin “Fan Noli”⁹⁶ në Korçë gjejmë një tjetër qasje. Filozofia bashkëlidhet nën një fakultet me shkencat natyrore.

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane është krijuar në 2011-2012, si rezultat i rikompozimit të Fakultetit të Edukimit, duke krijuar 2 fakultete të tjera në këtë universitet:

- Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Sociale
- Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë.

Një nga diplomimet në Bachelor në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Sociale jepet për “Filozofi-Sociologji” dhe në vitin akademik 2014-2015 ka filluar edhe Masteri Shkencor në Filozofi Sociale.

Pyetja qëndron: Sa i kanë shërbyer këto gjetje një kurrikule të qëndrueshme e të përshtatshme me nevojat tona kombëtare? Përgjigjen e gjejmë në përmbajtjen e kurrikulave të këtyre departamenteve simbiotike. Nga pohimet në faqet zyrtare rezulton se edhe pse janë diploma simbiozë (të bashkëlidhura me sociologjinë) pohohet se realizojnë 70% të programit të diplomës “Filozofi” në UT⁹⁷. Pak e diskutueshme për të pretenduar brenda një diplome një përjasje kaq të lartë me një kurrikul, e cila është 100 e “pastër” si Filozofi.

93. Vlen të theksohet se edhe kjo degë hapet një vit pasi po në këtë universitet ishte hapur dega “Punë Sociale” Kjo shihet një hap pozitiv drejt një konceptimi më real të nevojës për filozofi si titull diplome.

94. <http://www.uniel.edu.al/index.php/al/departamentet-shkencat-edukimit/489-soc>

95. <http://www.unkorce.edu.al/en/content/faculty-natural-and-human-sciences>

96. <http://www.unkorce.edu.al/en/content/faculty-natural-and-human-sciences>

97. <http://www.uniel.edu.al/index.php/al/departamentet-shkencat-edukimit/489-soc>

Kjo vërejtje nuk ka kaluar pa u vënë re nga studiuesit dhe e hartuesit e projektligjit të ri për Arsimin e lartë.

“Kurrikulat e studimeve të larta janë të paharmonizuara në nivel kombëtar për të njëjtat programe sipas emërimit, llojit dhe niveleve apo titujve të studimit. Kjo është e vërtetë edhe për programet që testohen pas diplomimit me Provimin e Shtetit.⁹⁸”

Modeli i kurrikulës në departamentin e Filozofisë në UT

Nga viti 2010, kur departamenti fitoi statusin e vet të pavarur nga Sociologjia, kurrikula ka pësuar disa ndryshime, gjithnjë në sensin e përafrimit të kurrikulave bashkëkohore por edhe nevojave kombëtare.

Në prirjen e zhvillimeve të kurrikulës së departamentit në këto vite vërehen 3 tendenca në konceptin e modelit:

- tendenca e të bërit të një *kurrikule klasike filozofike, ku problemorja dhe historikja shkojnë paralel alternuar*(2010-2013), kjo edhe me një sfond të identitetit shqiptar (si syllabusi Mendimi politik, shoqëror, filozofik shqiptar, 1870-1945) dhe atij evropian apo qasjen me globalen (si syllabuset Filozofia e integritetit evropian, Organizatat Ndërkombëtare);
- tendenca e të portretizuarit në maxhorancë si një filozofi komunikimi (ngjashëm afërsisht me Departamentin e Komunikimit dhe Gazetarisë pranë Fakultetit të Shkencave Filologjike), 2012-2014;
- tendenca e zhvillimeve të fundit kurrikulare, 2015-2018, ku po tentohet të përmirësohet modeli i parë, me drejtim të një departamenti filozofie të ngjashëm me universitete të Francës, Gjermanisë apo Italisë.

Kurrikula në këto vite humbet lëndë në Bachelor (si biotika) duke fuqizuar aspektin juridik të formimit. Humbasin terren kurrikula e historisë në shtrirje kohore duke u përqëndruar në atë të Historisë së Shtetit Social apo Histori moderne, këto si *lëndë me zgjedhje*⁹⁹!

Duke parë ndryshimet kurrikulare nuk mund të mos vëresh se këto ndryshime nuk kanë ndjekur ndonjë vijë logjike apo ndonjë përjasje standardesh krahasuese. Ndryshimet duken spontane dhe ndjehet dukshëm paqartësia e lëndëve apo moduleve që hiqen apo shtohen.

98. Raporti përfundimtar për reformimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor Tiranë, korrik 2014, fq. 17.

99. Shih Shtojcën 10



Pavarësisht këtyre vërejtjeve mund të thuhet se kurrikula e diplomës bachelor në filozofi është një kurrikul e pranueshme që në tërësinë e vet përmbush interesin e prodhimit të një diplome filozofie. Por duhet pohuar gjithashtu mungesa e qartësisë së formatimit të fushave dhe sidomos organizimit kurrikular në shërbim të një formimi cilësor, bashkëkohor dhe të krahasueshëm me botën.

Nga studimi në universitetin e Jenës në Gjermani dhe Granada në Spanjë, u vu re se ka një ngjashmëri të dukshme përgjigjesh mes studentëve tanë dhe atyre gjermanë gjë që tregon për përafërsinë mes dy fakulteteve ,atij shqiptar dhe atij gjerman. Është me interes të shihet modeli i organizimit të studimeve në këtë fakultet për të parë krahasimisht gjendjen e studimeve tona akademike n fushën e filozofisë.

Modeli i Universiteti "Friedrich-Schiller" në Jena përfshin:

- Fakultetin e Filozofisë
- Institutin e Filozofisë

Universiteti Friedrich-Schiller në Jena është një universitet klasik gjerman me më shumë se 19.500 studentë ndër të cilët rreth 2000 janë studentë të huaj¹⁰⁰. Gjatë studimeve në këtë universitet e ndien shumë të pranishme faktin e ndërthurjeve të kulturave të ndryshme. Prandaj pa dyshim ai mund të quhet dhe universitet ndërkulturor. Të bie në sy një spektrum i gjerë i degëve të studimit. Universiteti është i përbërë nga 10 fakultete: Fakulteti teologjik, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Filozofisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Fakulteti i Matematikës dhe Informatikës, Fakulteti i Fizikë-Astronomisë, Fakulteti i Kimisë, Fakulteti i Biologjisë dhe Farmaceutikës dhe Fakulteti i Mjekësisë.

Fakulteti i Filozofisë përbën sot, bashkë me Fakultetin e Shkencave Sociale, fakultetin më të madh të universitetit të Jenës. I ndarë në 17 institute, ky fakultet ofron çdo vit të drejta studimi për më shumë se 4000 studentë. Studentëve u jepet mundësia të përzgjedhin midis 15 degëve të bachelorit, 11 degëve të mësuesisë dhe 25 degëve master si dhe të marrin leksione nga 70 docentë e pedagogë. Gjithashtu, në këtë fakultet janë rreth 180 doktorantë që po punojnë për disertacionin e tyre.

Fakulteti i Filozofisë njihet me emërtimin klasik ku spikasin drejtimet dhe profilet

100. Një nga studentët shqiptarë, pjesë e këtij fakulteti ka qenë dhe Marisa Janku, studente e masterit në periudhën 2009-2011, pikërisht në Insitutin e Gjermanistikës dhe e diplomuar në degën "Gjermanistika për të huajt. Gjermanishtja si gjuhë e huaj dhe si gjuhë e dytë". Kjo studente e masterit ofroi ndihmesën e saj për të menaxhuar plotësimin e pyetësorit të punimit tim doktoral në bllokun e pyetjeve për arsimin e lartë me studentët e vitit të dytë filozofi në Fakultetin e Filozofisë në Universitetin Friedrich-Schiller Jena gjatë semestrit të verës në vitin akademik 2010-2011.

kryesore, si: gjuha dhe letërsia, filozofia, arti, historia dhe komunikimi. Gjithashtu, në këtë Fakultet bëjnë pjesë dhe Institutet me gjuhët përkatëse, si: gjermanistika, anglistika, gjuhët sllave dhe romane etj.

Çfarë synojnë studentët që studiojnë filozofi në këtë Fakultet në degën e Filozofisë, sistemi Bachelor?

Studimi në degën e Filozofisë synon fitimin e njohurive në punimet shkencore, në teorinë e edukimit, në mënyrën e argumentimit apo dhe të zgjidhjes së problemeve dhe çështjeve filozofike.

Rreth kurrikulës dhe rregullave të studimit

Kjo kurrikul është hartuar nga Universiteti i Jenës më 21 dhjetor 2006 në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë të Landit të Tyingenit. Këshilli i Fakultetit të Filozofisë e ka përpiluar dhe përfunduar atë me ndryshimet përkatëse më 27 maj 2008, ndërsa Senati i Universitetit të Jenës është pajtuar me të në më pak se një muaj, pikërisht më 15 qershor të vitit 2008. Kjo kurrikul do të miratohej nga Rektori, Prof. Dr. Klaus Dicke, më 5 janar 2009. Siç shihet ndryshimet në kurrikul deri në aprovimin përfundimtar zgjatën rreth 2 vjet duke kaluar respektin e kompetencave që ka çdo strukturë e zgjedhur akademike.

Në këtë kurrikul jepen informacione në lidhje me qëllimet e studimit, kushtet, përmbajtja e lëndëve, apo dhe mënyra se si është ndërtuar sistemi i studimit në degën e Filozofisë për tre vitet e Bachelor-it, i titulluar **Bachelor of Arts** ose shkurtimisht **B.A.** Kusht për pranimin në degën e Filozofisë në Universitetin e Jenës është mbarimi i Maturës në një gjimnaz të përgjithshëm ose profesional, në të cilin studiohen lëndë të veçanta të fushës së filozofisë.

Filozofia shihet si degë parësore dhe dytësore universitare

Për studimet në Filozofi si *degë parësore* janë të nevojshme njohuritë e Latinishtes dhe të Greqishtes, të cilat mund të mësohen paralelisht edhe gjatë studimeve. Njohuritë e këtyre gjuhëve shoqërohen përkatësisht nga dëshmitë e *Latinums dhe Graecums*. Kjo dëshmi është kusht për pranimin në punimin e temës përfundimtare. Përveç kësaj janë të detyrueshme dhe janë dhe njohuritë në një gjuhë perëndimore, ku më e preferuar është gjuha angleze, pasi një pjesë e mirë e teksteve ofrohen pikërisht në këtë gjuhë. Njohuritë e kësaj gjuhe mund të dëshmohen që në fillim me anë të një certificate ose të mësohet paralelisht gjatë studimeve dhe është gjithashtu kusht për pranimin në punimin e temës.



Ndërsa për sa i përket studimeve në Filozofi, si **degë dytësore**, janë të detyrueshme njohuritë e dy gjuhëve perëndimore, si rregull njëra nga këto gjuhë duhet të jetë anglishtja.

Studimet në Fakultetin e Filozofisë, Dega Filozofi, zakonisht fillojnë në semestrin e dimrit, pra përafërsisht në mes të tetorit. Kohëzgjatja e studimeve, duke përfshirë dhe përgatitjet për temën e bachelor-it është 3 vjet. Mund të thuhet se në këtë Fakultet mund të ndiqet dhe studimi me kohë të pjeshme (Part-Time), për të cilin ka rregulla të tjera në lidhje me kohëzgjatjen e tij.

Një orientim i përgjithshëm i **lëndëve të filozofisë në kurrikul**¹⁰¹ është si më poshtë:

- **Teoria e Filozofisë** (Ontologji, Metafizikë, Epistemologji, Filozofia e Gjuhës, Teoria e Shkencës, Antropologji, Filozofi Natyrore, Filozofi Humane dhe Estetika),
- **Logjikë dhe Teori argumentimi**,
- **Filozofia Praktike** (Etikë/Filozofi Morali, Filozofi Politike, Filozofi Sociale, Filozofi Ligjore, Historia e Filozofisë dhe Filozofi Fetare),
- **Historia e Filozofisë** (Filozofia Antike dhe bashkëkohore, Analiza të problemeve historiko-filozofike),
- **Lëndë specifike të filozofisë** (sidomos në fushën e Filozofisë Mediatike, Filozofisë së Artit, Filozofisë Humane dhe asaj Natyrore.)

Studentët fitojnë nga ndjekja e këtyre moduleve bazë përgjatë katër semestrave të parë njohuri të gjera dhe sistematike rreth filozofisë, të cilat thellohen më tej sipas prioriteteve individuale në dy semestrat e fundit (semestri i 5-të dhe 6-të).

Dega e Filozofisë ka një **orientim të theksuar hulumtues dhe mund të studiohet si në nivelin bachelor, ashtu dhe në atë master, duke i ofruar studentëve një kualifikim në karrierën e tyre profesionale e shkencore**. Lidhur me këtë mund të thuhet se **kjo degë ofron si nga ana metodike, ashtu dhe nga ana teorike e empirike një përgatitje cilësore në fushën profesionale**. Përveç kësaj ata mund të fitojnë gjatë viteve të studimit dhe njohuri të gjera në thellimin e aftësive komunikuese, analizuese, shkruese dhe arsyetuese. Gjithashtu, edhe ata studentë që e studiojnë filozofinë si degë dytësore përgatiten për kualifikim të mëtejshme pasuniversitare jo vetëm në Universitetin e Jenës, por edhe në universitete të tjera evropiane.

101. http://www.ifp.uni-jena.de/Studium+_+Beratung/Bachelor.html



Mundësia e studimeve paralele

Studentët e Filozofisë mund të ndjekin paralelisht edhe një degë tjetër duke bërë kështu kombinim të lëndëve brenda nivelit të Bachelor-it.

Kreditet dhe Katalogu Përmbledhës i Moduleve

Studimi i Bachelor-it në Fakultetin e Filozofisë përfshin gjithsej **180 kredite sipas “European Credits Transfer and Accumulation System” (ECTS). 120 kreditet e para duhet të merren nga ndjekja e moduleve bazë, duke përfshirë këtu edhe punimin e temës në fund të studimeve. Ndërsa 20 kreditet e tjera duhen marrë nga lëndët me zgjedhje.** Çdo vit akademik duhen marrë si rregull 60 kredite të cilat mund të jenë si nga lëndë të detyrueshme ashtu dhe nga ato me zgjedhje.

Studimi 3-vjeçar i Bachelor-it përfundon me punimin e temës dhe dorëzimin e saj.

Këto tre vite janë të ndara në module, ku secili modul përbën një njësi arsimore. Modulet përbëhen nga leksione, seminare, ushtrime, por dhe nga studime individuale. Një modul zgjat 1-2 semestra. Lëndët përkatëse të moduleve gjenden në **Katalogun Përmbledhës të Moduleve**, i cili të informon edhe mbi pjesëmarrjen sistematike, format e ndryshme të provimeve (provim me shkrim, me gojë ose në formën e Detyrës së Kursit).

Modulet e detyrueshme si “Hyrje në Filozofi”, “Logjikë dhe mësimdhënie”, “Teoria e Filozofisë” dhe **“Filozofi Praktike”** duhen ndjekur në semestrat e parë. Kështu, p.sh. “Hyrja në Filozofi” është një nga modulet që detyrimisht duhet ndjekur në semestrin e parë. Për sa i përket moduleve të detyrueshme me zgjedhje, si: “Historia e Filozofisë”, “Specifika e Filozofisë” apo dhe “Kurs leximi” *duhet te zgjidhen vetëm dy prej tyre.* Secila nga këto module përmban 10 kredite. Semestri i fundit, pra i 6-ti është llogaritur vetëm për punimin e temës, e cila përmban 10 kredite.

Gjatë studimit janë të këshillueshme qëndrimet dhe e kualifikimet semestrare jashtë vendit, të cilat bëhen të mundura me anë të programeve të partneritetit me universitetet përkatëse.

Pra, siç shihet lëndët në studimet për filozofi ndahen në:

- lëndë të detyrueshme dhe



- lëndë të detyrueshme me zgjedhje, të cilat mund të ofrohen nga vetë Instituti i Filozofisë ose mund të zgjidhen vetë në Katalogun e Moduleve, i cili është i publikuar në faqen e internetit të Fakultetit të Filozofisë.

Moduli "Shkrim dhe arsyetim filozofik" ofron lëndë specifike, duke i bërë të mundur studentëve përfitimin e njohurive të cilat mund të jenë frytdhënëse në aspektin e mëvonshëm profesional. Si shembull mund të përmendim këtu *hartimin e teksteve të ndryshme*, të cilat ndihmojnë në trajnimin e studentëve në aspektin e aftësive retorike dhe kompetencave argumentuese. Gjatë ndjekjes së moduleve të tjera mund të fitohen dhe **kompetenca, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me qëllimet profesionale**, si p.sh.:

1. Kompetenca ndërkulturore e gjuhësore.
2. Kompetenca metodike (aftësi prezantuese, komunikuese, argumentuese).

Studimet jashtë të studentëve, programet evropiane

Në rastin e studentëve, të cilët preferojnë që një pjesë të studimeve t'i ndjekin jashtë vendit, garantohet njohja e lëndëve dhe provimeve në bazë të programit Learning Agreement.

Praktikat

Gjatë studimeve për Filozofi është e detyrueshme dhe ndjekja e praktikës si modul më vete. Ky modul mund të jepet në formën e praktikës mësimore për një periudhë kohe prej 6-javësh. Përpara fillimit të praktikës është i detyrueshëm konsultimi me pedagogun përgjegjës të lëndës. Forma e dytë e mbylljes së këtij moduli do të ishte ndjekja e një prej lëndëve specifike si p.sh.: Didaktikë, Pedagogji, Retorikë dhe Komunikim, Menaxhim, Gjuhë të Huaj. Mbarimi me sukses i praktikës dokumentohet në të ashtuquajturin "**Portofolio**" dosje që përmban të gjithë dokumentacionin përkatës gjatë ndjekjes së praktikës në formën e një artikulli mbi ecurinë dhe përshkrimin e saj.

Orët e konsultimeve, Këshilli Akademik, integrimi i doktorantëve në procesin mësimdhënës.

Interesante për t'u përmendur është edhe fakti se në këtë fakultet, por jo vetëm ofrohen shpesh orë konsultimi nga pedagogët e lëndëve përkatëse. Por veçanërisht për t'u përmendur është i ashtuquajti Këshillim Akademik, i cili ofrohet nga doktorantë të Institutit të Filozofisë për të gjithë studentët, duke i ofruar atyre këshilla dhe orientimet bazë në lidhje me studimet dhe problemet që mund të hasen.

Ky model është ofruar si pasojë e vlerësimit të funksionimit të një modeli të studimeve filozofike në Gjermani. Kjo nuk është sjellë për t'u kopjuar apo për t'u klonuar në version shqiptar. Vëmendja e studimit kërkohet për rëndësinë që duhet t'i japim në politikat tona institucionale universitare kuptimit të eficiencës që mund të ketë veprimtaria e një departamenti, forma e menaxhimit të brendshëm të burimeve njerëzore por edhe dokumentare sikurse edhe strukturat e veta kërkimore në mbështetje të studimeve filozofike universitare në disa programe studimi. Punimi e sjell si një model të mundshëm për t'u realizuar edhe në kontekstin shqiptar, ku në disa elemente ka ngjashmëri, në disa të tjera duhet përsosje e në të tjera duhen iniciativa dhe mbështetje institucionalo-financiare. Në prag të zbatimit të Reformës e Arsimit të Lartë mendoj se gjykimi kritik edhe mbi këtë model do t'i shërbente cilësisë së aktivitetit akademik kërkimor të departamentit dhe studentëve të filozofisë sikurse edhe një transparence dhe besimi publik tek institucioni universitar.

Kërkimi shkencor në Departamentin e Filozofisë dhe ZHQ-së

“Kërkimi shkencor dhe inovacioni janë agjentë të drejtësisë sociale dhe kontribuues vitalë social pasi janë burim i dijes Qeveritë, industria dhe shoqëria shohin nga universitetet për të realizuar një zhvillim të qëndrueshëm pasi vetëm universitetet, përmes kërkimit shkencor dhe inovacionit, mund ta realizojnë atë¹⁰²” .

Fakulteti i Shkencave Sociale, departamenti i filozofisë u bë pjesë e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe në rrugëtimin e vet institucional duhet të respektohet “Deklaratën e Bolonjës”.

102. “Economic growth will come from Europe’s research universities” by Professor Sir Leszek Borysiewicz is Vice -Chancellor of the University of Cambridge, and previously head of the UK’s Medical Research Council. This is a summary of the keynote speech he will give at the LERU 10-th Anniversary conference in Barcelona on 10 May 2012.



Sipas saj, shtetet nënshkruese angazhoheshin të koordinonin politikat e arsimit të lartë, për të arritur në një kohë sa më të afërt, **jo më larg se dhjetëvjeçari i parë i mijëvjeçarit të tretë**, këto objektiva të përgjithshme:

1. *Përshtatjen e një sistemi diplomash të arsimit të lartë të konvertueshëm, për të mundësuar lëvizjen dhe punësimin në çdo vend evropian.*
2. *Përshtatjen e një sistemi studimi, bazuar kryesisht në dy cikle: universitar dhe pasuniversitar. Cikli i parë i studimeve zgjat minimalisht tre vjet. Diploma e fituar për këtë cikël duhet të ketë peshë për tregun evropian të punës si një nivel i përshtatshëm kualifikimi. Kurse cikli i dytë duhet të çojë në diplomën "Master" ose "Doktor".*
3. *Mënjanimi i vlerësimit me notë dhe kalimi në vlerësimin me kredite, ECTS (Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve).*
4. *Qarkullimin e lirë të studentëve për studim dhe kualifikim, të pedagogëve për njohje, kualifikim dhe kërkim shkencor etj.*
5. *Promovimin sistematik të një bashkëpunimi evropian për vlerësimin e cilësisë, për hartimin dhe përshtatjen e kurrikulave, për bashkëpunimin ndërinstitutional.*

Siç vërehet edhe nga trajtesa të mësipërme, departamenti është përpjekur të shprehet në ndryshim (në raport me pikën 2 të mësipërme), kjo përmes ndryshimeve kurrikulare (të sipër trajtuara), plotësimin të niveleve të karrierës universitare, Bachelor në Filozofi, Master Profesional, Master Shkencor (Etika në institucione dhe lidershipi dhe Filozofi Humane), Shkolla Doktorale por është në qëndrime kritike me zhvillimet që duhet të sillte realizimi i 4 objektivave të tjera.

Të studiosh Filozofi e të qëndrosh jashtë kërkimeve, jashtë pjesëmarrjes në debate e diskutime kombëtare e ndërkombëtare duket pa sens. Është e domosdoshme që kërkimi shkencor të jetë në fokusin afatmesëm e afatgjatë të Departamentit të Filozofisë. Orientimi i kërkimit për shkak të veçorive që ka vetë edukimi filozofik, është e duhet të jetë i gjerë dhe afatgjatë që individi të ketë mundësi të ofrojë mendimet e tij në një spektër të gjerë tematikash. Por pavarësisht lirisë së mendimit, të shoqëruar me lirinë e zgjedhjes së doktorantëve, mendoj se përcaktimi i disa blloqeve të mëdha kërkimore nga vetë departamenti, qoftë edhe për faktin e thjeshtë institucional të udhëheqjes dhe zhvillimit të mendimit filozofik në dobi të shtetit të së drejtës, institucionalizimit, zhvillimit të qytetarisë, zhvillimit të qëndrueshëm në vend do t'i shërbente reputacionit

akademiko-shkencor të kësaj fushe studimesh sikurse edhe vetë departamentit.

Nëse do i hedhim një vështrim tematikave të studimeve doktorale në fushën e filozofisë për këtë periudhë 5-vjeçare kemi një pamje të tillë:

- Përvijimi i plotë i hermeneutikës në procesin e njohjes.
- Filozofia e mendimit të Vangjel Koçës gjatë Neoshqiptarizmës.
- Përafrimet dhe diferencat në etikën e Aristotelit dhe Kantit.
- Etika e komunikimit në administratën publike.
- Filozofia e Gylenit një përfaqje praktike në dialogun ndërkulturor.
- Filozofia kontraktualiste si baza filozofike e të drejtave të njeriut në shtetin e së drejtës. Përfaqje nga autorët: Thomas Hobbes, John Locke, Jean-Jacques Rousseau.
- Përfytyrimi në art dhe përfytyrimet e artit çka mbetur ende përtej përfytyrimit.
- Koncepti i arsyes dhe ai i faktit në teorinë hegeliane të historisë.
- Çështje të irracionalizmit në filozofinë e njohjes.
- Edukimi filozofik si nevojë e qenësishme e zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri.
- Raportet e ndërvarësisë reciproke midis paqes dhe konfliktit (Një vështrim filozofik).
- Mendimi Shqiptar i viteve 30-të.
- Lulëzimi i iluminizmit të shekullit XVIII apo fillimi i një rryme të fortë romantizmi.
- Një reflektim logjiko-filozofik mbi mendimin dhe modalitetin e të mundurës.
- Mendimi, të menduarit dhe mendimtaria në filozofinë perëndimore.
- Neoshqiptarizma si koncept filozofik dhe historik.
- Pikëpamjet ekzistencialiste të Zh. P. Sartrit në novelat e tij “Muri”.
- Ideja e emancipimit të njeriut në historinë e mendimit perëndimor.
- Kontrata sociale dhe ndikimi e filozofinë morale dhe politike bashkëkohore të sotme¹⁰³ etj.

Është e dukshme gjerësia e trajtimeve problemore dhe natyrisht kjo tregon se dëshira për studime të mirëfillta filozofike është në qendër të kërkimeve tona shkencore. Por, duke qenë kaq specifike dhe njëkohësisht kaq të gjera këto kërkime rrezikojnë të shndërrohen në vepra pa auditor. Mungesa e një botimi shkencor nga vetë departamenti i

103. Marrë nga dokumentacioni pranë Zyrës së Doktoraturave të FSHS-së.

bën edhe më të paaksesueshme për mjedisin studentor apo në universitetet shqipfolëse. Këtyre faktorëve u shtohet edhe fakti që revista apo botime shkencore në vend janë të interesuara pak në botimet e tyre për studime filozofike. E megjithatë, misioni i punimeve doktorale duhet të gjendet në vetë filozofinë e kërkimit sipas Kartës së Bolonjës.

Deklarata e Bolonjës:

“Pavarësia dhe mëvetësia e universiteteve garantojnë që arsimi i lartë dhe sistemet e kërkimit duhet që në mënyrë të vazhduar të përshtaten në përputhje me ndryshimet e nevojave dhe të kërkesave të shoqërisë, si dhe me ndryshimet e ardhura si pasojë e zhvillimit të shkencës në tërësi”.

Kërkimit shkencor dhe edukimit me aftësi të tilla i ka shërbyer edhe tradita e krijuar tashmë në departament në organizimin e Ditës Ndërkombëtare të Filozofisë¹⁰⁴ ku edukimi i kërkuesve të rinj dhe hapja e detyrë për publikun filozofidashës ka qenë ambicie e gjithë stafit. Një nga panelet e ditës ka qenë ai i kërkuesve të rinj filozofë (me përfaqësues nga të gjithë nivelet e studimeve universitare për filozofi). Ndërkohë, një tipar tjetër i këtij modeli të kërkimit shkencor është edhe prania e përfaqësuesve të katedrave respektive të Universitetit të Prishtinës dhe Tetovës. Kjo ditë mbetet si formati i vetëm publik, ku edhe media ka treguar një vëmendje ndaj kësaj disipline universitare. Me rëndësi kanë qenë auditorët e hapura me Profesorë të Filozofisë apo Ambasadorë të huaj të akredituar në Shqipëri (të ftuar nga departamenti nën moderimin e Prof. Dr. Gjergj Sinani, në 2011, 2013, 2015) që kanë zhvilluar leksione të hapura mbi domosdoshmërinë e të filozofuarit ndër shqiptarë për probleme të zhvillimit të tyre në shekullin e XXI. Në 2014–2015 është pilotuar edhe një bashkëpunim me gjimnazin “Petro Nini Luarasi” dhe Komisionerin për mosdiskriminimin për këshillimin e karrierës për studime filozofike. Në to, si pedagogë të departamentit, kemi zhvilluar auditorë të hapura për të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve, për filozofinë e së drejtës, qytetarinë dhe filozofinë e edukimit, duke evidentuar cilësinë që i shton trajtimi dhe diskursi filozofik trajtesave të tilla në shkolla. Një nga panelet e diskutit nxënës-studentë është moderuar nga vetë studentët e masterit të vitit të parë për “Etikë në

104. Dita Ndërkombëtare e Filozofisë, në të tretën javë të çdo nëntori, festohet pothuaj nga të gjithë vendet anëtare të UNESCO-s që nga 2002.

institucione dhe lidërsip”, 2014-2015¹⁰⁵. Aktivitete të tilla, të institucionalizuara do i shërbejnë qëndrueshmërisë dhe fuqizimit të traditës me edukimin filozofik të gjeneratave të reja edhe në kushtet e statusit të diskriminuar të filozofisë në shkollat e mesme shqiptare. Të moderuara nga kërkuesit e rinj me nxënësit e shkollave të mesme, të mentuar nga pedagogë të departamentit do të formëzonin qëndrueshmërinë e kërkimit shkencor në breza. Modele të tilla të edukimit me kërkimin shkencor duhet të mos jenë sporadike por duhet të kthehen në disiplinë institucionale në departament për t’i shërbyer procesit të zhvillimit të “Shoqërisë bazuar në dije”, e cila kërkon zhvillimin e burimeve njerëzore që marrin pjesë aktive në transformimin social dhe ekonomik të vendit. Shqipëria po zbaton politika në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian për zhvillimin e një Evrope të Dijes, qëllimi strategjik i vendosur nga Këshilli Evropian në Traktatin e Lisbonës.

Vërehet se ka përpjekje të lavdërueshme që si staf pedagogësh, por edhe studentët, nga viti në vit më shumë, të respektojmë filozofinë e kësaj Dite: *“Filozofia, ushtruesja e mendimit kritik dhe e lirisë së shprehjes, është vitalja në kërkimin kolektiv për të përmbushur detyrimet dhe përgjegjësitë që kemi ndaj paqes dhe zhvillimit”*¹⁰⁶.

Zyra e këshillimit të karrierës në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe filozofia

Në të folurën e përditshme fjala “karrierë” përdoret në mënyra të ndryshme e parë nga prespektiva të ndryshme. Autorë dhe studiues të ndryshëm kanë prezantuar dy këndvështrime të konceptit të karrierës.

Sipas këndvështrimit të parë, ai objektiv, me karrierë kuptojmë:

- Sekuencat e pozicioneve të zëna nga një person gjatë kursit të tij të jetës.

Sipas këndvështrimit të dytë, ai subjektiv, karriera konsiston në:

- Ndryshimin e vlerave, qëndrimeve dhe motivimeve që ndodhin ndërsa një person bëhet më i vjetër.

Siç shihet të dy këto këndvështrime fokusohen tek individi dhe të dy supozojnë që individi ka një farë kontrolli mbi fatin e tij, që mund të manipulojë mundëitë me qëllim që të maksimizojë suksesin dhe kënaqësinë që rrjedh nga karriera.

Aristoteli tek “Politika” shprehet se sfera e punës dhe e prodhimit është trajtuar si

105. Revista “Stop diskriminimit. Fillimi fillon nga ne”. 2015.

106. Mesazhi i Irina Bokovanga për nder të Ditës Ndërkombëtare të Filozofisë nga UNESCO, 2011. Paris.



sferë e domosdoshmërisë e detyrimit të qënies. Karriera i referohet një sërë aktiviteteve të cilat janë përcaktuar për të ndihmuar të rinjtë të zgjedhin drejtimet e tyre në arsim dhe punë (dmth, karrierat e tyre) dhe të zbatojnë synimet e karrierës së tyre.

Universiteti i Tiranës ka ndërtuar përvojën e tij për ndërtimin e Zyrave të Karrierës pranë fakultetetve të tij dhe qysh nga 2013-ta organizon Panairin e Karrierës të Universitetit të Tiranës . Hapja e Zyrave të Karrierës, të cilat merren me orientimin dhe përgatitjen e studentit/të rinjve të

Sapo diplomuar për në tregun e punës. Këto zyra kanë bashkëpunime të mundshme me një numër të gjërë të kompanive të cilat operojnë në tregun shqiptar dhe mundësojnë lidhjen e parë midis studentit dhe tregut të punës. Këto zyra u mundësojnë studentëve platformën më të re në treg mbi informimin e punësimit dhe aplikimet online për punësim nëpërmjet portalit. Portali shërben si një urë lidhëse midis kompanive dhe studentëve, duke mënjeluar çdo burokraci apo kosto të panevojshme të të dy palëve dhe duke krijuar një mënyrë më të thjeshtë ndërmjetësimi biznes-student.

Një e tillë është edhe ajo pranë Fakultetit të Shkencave Sociale. Në një vlerësim të punës së kësaj zyre veçoj një studim “Vlerësimi i statusit të punësimit tek studentët e degës Filozofi të Universitetit të Tiranës dhe ndikimi i tij në karrierë” nga drejtuesja e zyrës¹⁰⁷. Qëllimi i këtij punimi është vlerësimi i statusit të punësimit tek studentët e degës Filozofi të Universitetit të Tiranës dhe ndikimi i tij në karrierën e tyre. Prej tij veçoj këto rezultate:

Pa praktikë punësimi	Me Praktikë punësimi	
63%	37%	
	Intership/punësim në sektor shtetëror	Intership/punësim në sektor privat
	26%	74%

Përvoja botërore në veçanti ajo e Mbretërisë së Bashkuar¹⁰⁸ na sjell studime të vitit 2013-2014 të cilat na ofrojnë shifra optimiste për nivelin e punësimit me diplomim në filozofi.

Kështu, thuhet se 85% e studentëve janë të punësuar. Nga këto, në sektor të studimeve doktrale janë 18.2% e tyre ndërsa janë punësuar në mësimdhënie (shkolla) dhe në sektorë të ndryshëm ku përfshihet shërbimi civil, pushteti vendor, marketingu,

107. Zyra e këshillimit të karrierës, Ertilla Habibasi, 2014

108. www.ucl.ac.uk/careers/departments/careers_with_a_philosophy_degree

gazetaria, rekrutimi për burimet njerëzore rreth 66.7% e tyre ndërkohë që 12.1% janë në punësime specifike si psikoterapist etj.

Filozofia dhe të filozofuarit për shqiptarët përtej sistemit të edukimit në Shqipëri

Rrugëtimin çerekshekullor të shqiptarëve drejt perëndimit e nisëm me urrejtjen për filozofinë dhe procesin e të filozofuarit pasi nënkuptonim pas tyre “Lindjen”, të cilën donim ta linim pas. Në fakt, sa më shumë thellohet procesi i kalimit nga “Lindja në Perëndim”, shfaqet nevoja për filozofinë dhe filozofimin jashtë dhe pavarësisht mundësive që krijon vetë sistemi i edukimit në vend.

Kërkesa për to mbështetet në nevojën që kishim dhe kemi të gjithë për të menduar ndryshe, për të rimenduar, për të rijetësuar, për të rigjykuar të shkuarën, rithemeluar njohuritë për jetën dhe suksesin në të, për aftësitë që na duhen, për sistemin e vlerave ku do mbështeteshin dhe të tjerave që do të ridimensiononim, duke respektuar rregullat e logjikës në argument e gjykim, për pyetje dhe çështje të mëdha e të rëndësishme të jetës së gjithësecilit apo të zhvillimit të vendit në tërësi. Këto procese në shumësi i japin kuptim dhe sens jetës së secilit prej nesh, të grupit ku bëjmë pjesë, por edhe të komuniteteve tona po aq sa edhe të shtetit në rrugëtimin e tij drejt familjes së madhe të Bashkimit Evropian.

Në këtë kontekst, integrimi evropian i shqiptarëve kërkon ndërtimin e një filozofie të integritit po aq sa edhe të filozofuarin mbi procesin. Brenda kësaj filozofie të integritit nuk kërkohet vetëm pjesëmarrja e shqiptarëve që jetojnë në kufijtë zyrtarë të Shqipërisë, por edhe të çdo shqiptari me kombësi shqiptare, pavarësisht shtetit ku jeton. Tiranës zyrtare, zyrtarisht institucioneve të akademizmit dhe fidanishtes akademike studentore i duhet t’i paraprijë procesit të të filozofuarit mbi këtë proces integruar të shqiptarëve në shekullin XXI, për Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe faktorin Diasporë. Ky proces nuk mund të vazhdojë me “Unë” shqiptari i Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Diasporës e tjerë, por do të duhet të prodhojë “Ne” shqiptarët për integrimin evropian të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë pasi vetë historia jonë është prodhuar përtej të konceptuarit të izoluar. Nuk ka qenë rastësi që në mendimin shoqëror, politik e filozofik të viteve para themelimit të shtetit të pavarur shqiptar, shqiptarin e ri që i duhej të përbante veten, e ideuan dhe e debatuan ata mentarë që jetuan në këto adresime hapsinore të mësipërme.



Në fillesë të këtij procesi filozofues, në fundshekullin e kaluar dhe në këtë që jemi, NE na duhej të gjithëvë të ishim përfshirë e të vijonim me ideimet dhe debatet tona mendore dhe sociale mbi atë se “Cilët jemi NE shqiptarët?”, nën një fill mendimi kritik dhe risor. Kjo do të na shtronte piketa edukimi që do i vlenin dhe do t’i vlejné edukimit me veten dhe për veten, për më tepër reformave në edukim. Kjo përgjegjësi, ky aftësim i kalon kufijtë e akademizmit dhe kërkon aleatë edhe mbështetës në Shoqërinë Civile, Media dhe faktorin ndërkombëtar.

Një diskurs filozofik tjetër me dimension po sa i pari e që vlen ende për NE është ai mbi raportet nacionalizëm kombëtar dhe procese integruese evropiane.

Në shkrimin e tij “Shqiptarët dhe nacionalizmi” në 1995-ën, Fatos Lubonja, ndërsa pohon “ndjenjën e ekzaltuar kombëtare” të trajtimit të disa ngjarjeve tona historike nga shtypi i përditshëm, periodikët, historiografia komuniste, tërheq vëmendjen se kjo mendësi po shfaqej edhe në vitet e para të demokracisë dhe ndërkohë ndërton një pyetje kuptimplotë që ishte sa ekzistencialiste, kulturore, shpirtërore, terapeutike, politike, sociale sa edhe intelektuale: “Çështja shtrohet: a i duhet sot shqiptarëve një nacionalizëm etnik, i kuptuar si motivim përbashkimi për shkak të frikës apo urrejtjes ndaj etnisë tjetër, apo duhen gjetur rrugë të tjera? Përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje është shumë e vështirë. Sidoqoftë ndaj alternativës së frikës dhe urrejtjes është më lehtë të thuash: Jo! Kurse kërkimi i alternativave pozitive vjen i vështirë jo vetëm pse ato nuk mund të jenë të njëjlojta për të gjithë shqiptarët në të gjitha treva ku banojnë, por edhe pse ato nuk varen vetëm nga vullneti i tyre, por edhe nga qëndrimet e fqinjve ndaj shqiptarëve. Nuk pretendojmë të japim përgjigje nëpërmjet këtij shkrimi, ku më shumë jemi rrekur të shtrojmë problemin”.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm mbetet sfida e shqiptarit të ri, kritik me kulturën e të mësuarit gjatë gjithë jetës në epokën e informacionit dhe teknologjisë. Mbi të gjithë, këtë proces filozofik edukimi, nisja dhe sukcesi mbetet tek të mësuarit se si duhet të mësojmë (Learning to learn). Ky lloj të menduari rreth dijes mbetet sfidë e të konceptuarit të mendësive që udhëheqin reformat për zhvillimin në vend, të reformës në arsim e drejtësi në veçanti, standarde këto që i sigurojnë qëndrueshmëri zhvillimeve tona përmes cilësisë së burimeve njerëzore. Ky proces filozofimi, si teori dhe metodë e të mësuarit, do të na mundësojë shmangien nga përsëritja e gabimeve të së kaluarës në përbamjen e NE, shqiptarëve, cilësitë e shtetbërjes tonë dhe rolin e misionin tonë në



ndërvarësitë rajonale dhe globale.

Po kush do ta drejtojë këtë proces?

Individi apo shoqëria?

Individi apo institucionet?

Iniciativa dhe procesi individual apo institucionalizmi mbështetur nga qytetaria e individëve?

Së pari, le ta nisim me ndryshimin e mendësive politikbërëse mbi statusin e Filozofisë dhe të filozofuarit për shqiptarët në edukimin në Shqipëri.



MBYLLJE

Në fund të këtij punimi jam e bindur se sa më thellë të shkosh në një studim real, konkret, aq më shumë problem që presin zgjidhje gjen dhe aq më tepër një të menduar filozofik vihet në "punë" për të dhënë qoftë edhe disa ide apo rrugë për të ndihmuar shoqërinë për të ecur përpara. Unë e kam provuar këtë gjatë studimit të problematikave që më lindnin njëra pas tjetrës dhe që presin zgjidhje. Ndërkohë jam e bindur se me këtë punim nuk kam mundur dot të ezauroj të gjithë problematikën e raportit Zhvillim i Qëndrueshëm / Edukim për Zhvillimin e Qëndrueshëm pasi është një problematikë mjaft komplekse. *Ky hap imi në fushën e studimeve filozofike, filozofi institucionesh dhe edukimi shkrirë në njëra tjetrën, synoi të sjellë nën argument e analizë pohimin mbi rëndësinë e padiskutueshme që ka filozofia dhe të filozofuarit për cilësinë e Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm, pa të cilin nuk mundësohet dhe sigurohet nga burimet njerëzore vetë Zhvillimi i Qëndrueshëm në vend.* Ndoshta hapi tjetër në kërkimin tim shkencor do i përkasë një rrethi tjetër problemesh që, edhe pse janë nën një emër, me siguri kërkojnë trajtesa të tjera mbi këtë raport dhe zhvillimin në Shqipëri.



PËRFUNDIME

- Ky studim është rezultat i një pune kërkimore 5-vjeçare. Kjo do të thotë që ky punim përfshin një periudhë të mjaftueshme kohore për të parë dhe konkluduar në lidhje me ndryshimet e politikave edukuese, institucionale të shprehura në reforma nga ana e qeverisë shqiptare. Ndërkohë, ky punim është bazuar në kërkesa e rekomandimet e UNESCO-s mbi edukimin filozofik si nevojë për edukimin me Lirinë. Nën këtë optikë, studimi sjell një qasje të dyfishtë sa filozofike aq edhe institucionale; sa argumentuese, aq edhe përgjithësuese. Ky studim është në pikëprerje e filozofisë së edukimit dhe asaj institucionale duke na dhënë një skaner të një situatë reale në edukimin filozofik në institucionet e edukimit shqiptar.
- Shqipëria hyn në shekullin e XXI si një vend me demokraci të brishtë, por që synon krahasimet me standardet e demokracive të konsoliduara. Ndërkohë Shqipëria ka hyrë në shekullin e ri me një gjeneratë të re, ku teknologjia dhe përdorimi i saj është bërë pjesë e jetës së tyre sikurse, kjo gjeneratë përbën maxhorancën e popullsisë duke e shprehur Shqipërinë si një vend me moshë rinore, për shkak të moshës mesatare të re që ka vendi. Të dyja këto karakteristika të kësaj gjenerate e çojnë detyrimisht vëmendjen në rëndësinë e nevojës që ka shoqëria, kjo gjeneratë në mënyrë të veçantë për një edukim cilësor në mbështetje të sigurimit të një zhvillimi të qëndrueshëm. Pa një strategji konkrete në lidhje me sigurimin e kësaj ZhQ-je bazuar në EZHQ-në Shqipëria nuk do të mund të sigurojë standardet bashkëkohore të nevojshme të cilësisë së jetës sikurse dhe për integrimin e saj në Evropën e Bashkuar.
- Ndryshimet e këtij shekulli konsiderohen si ndryshime thelbësore që kanë mundësuar nevojën e trajtimit të qyteteve metropole si qytete inteligjente. Koncepti i "Smart city"-t si koncepti mbështetës i zhvillimit të qëndrueshëm e ka në përmbajtjen e vet krijimin e njeriut inteligjent, të edukuar me konceptin e lirisë dhe me mendim kritik.
- Zhvillimi i qëndrueshëm nuk mund të realizohet pa edukimin për këtë zhvillim . Pa krijimin e një kapitali human efektiv dhe të investuar, bota nuk do të jetë në gjendje të arrijë objektivat për zhvillimin e saj të qëndrueshëm. Edukimi



filozofik nën nevojën e krijimit të, “shkollave të lirisë” është problemi i madh i shekullit dhe i qeverisjes globale. Nën këtë moto, UNESCO ka përcaktuar sfidat e dhjetëvjeçarit, i cili përfundoi në 2014-ën.

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	=>	EDUKIMI PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM
QYTETET INTELIGJENTE	=>	QYTETARI INTELIGJENTE
KRIJIMI I KOMUNITARIZMIT ZHQ	=>	EDUKIMI FILOZOFIK DHE EDUKIM ME FILOZOFINË
Qeverisje demokratike	bazuar në	LIRI

Rekomandimet e UNESCO-s duhet të ishin në thelbin e reformave tona institucionale këto 10 vitet e fundit sepse:

- Jemi një vend me trashëgimi jo fort të pasur me kulturë pjesëmarrëse qytetare dhe jo fort të edukuar me konceptin e lirisë.
- Jemi një vend që kemi një popullsi me moshë të re që jeton me teknologjinë e re por me një mungesë të theksuar në edukimin me mendimin kritik dhe kulturën mjedisore. “Analfabetizmi funksional” shprehet edhe përmes “analfabetizmit mjedisor” dhe “analfabetizmit institucional” standarde këto që nuk mundësojnë përditësimin e politikave dhe instrumenteve politike funksionale për ZHQ-në në vend.
- Jemi një vend që në trashëgiminë tonë institucionale mbizotëron cilësia kritike e një sistemi edukimi të mbyllur dhe moskujdesja institucionale për zhvillimin e burimeve njerëzore po aq sa vazhdojmë të kemi vonesa në përgjigjen ndaj trendeve globale, të gjitha këto si reminishencë e sistemit totalitar në edukim dhe të një politike autoritariste.
- Cilësia e zhvillimit në Shqipëri duhet të ideohet e promovohet nga auditorët dhe departamentet e Universiteteve, ndërkohë që kërkimi shkencor në Shqipëri, ende sfidon me mungesën e të dhënave dhe cilësinë e transparencës së institucioneve për të ofruar informacion; sfidon me cilësinë e lirisë akademike që projektligjet dhe ligjet për arsimin e lartë mundohen ta cenojnë; sfidojnë me mbështetjen financiare sikurse edhe me cilësinë e institucionalizimit dokumentar.



- Në këtë çerek shekulli, pas '90, ndryshimet demografike kanë sjellë pashmangësinë e krijimit të qyteteve të mëdha metropole, sikundër është Tirana, por që kanë nevojë për t'u përshtatur në formën e qeverisjeve "Smart" me bazë dhe fuqi tek cilësitë në edukim, larg analfabetizmit mjedisor dhe qytetar. Ndërsa na duhet të prodhoni "qytetarin inteligjent" për "qytetet inteligjente" politika prodhoi qytetet e shkatërruara në elementët mjedisorë nga betonizimi e informaliteti dhe buxhetet më diskriminuese të mundshme për edukimin në këto 10 vite.

Në këto kushte të përshkruara më sipër, ndonëse bota modelonte alternativa për cilësinë në edukim (DZHQ) në dobi të ZHQ-së:

- Shqipëria jo vetëm nuk u përfshi në këtë studim madhor të UNESCO-s, por as rekomandimet e saj nuk zunë vend në reformat institucionale dhe politikat e zhvillimit të arsimit.
- Konceptet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm nuk janë shndërruar në pjesë të politikave qeverisëse, sinë pushtetin qendror dhe në atë lokal, dhe aq më tepër nuk janë bërë pjesë e edukimit të njerëzve me to.
- Tirana si qytet metropol, në këtë 10-vjeçar, në qeverisje paraqiti mangësi të dukshme në raport me standard dhe indikatorët globalë të zhvillimit të qëndrueshëm, faktorë që e bëjnë gati të pamundshme sfidën për të krijuar qytetin inteligjent dhe qytetarin inteligjent. Mjedisi dhe raportet me cilësinë dhe eficientë e qeverisjes lokale, sikurse edhe sjellja kritike qytetare ndaj tij, edhe pas 25-vjetësh demokraci, janë dëshmuar të kësaj pamundësie.
- Reformat në arsim, shëndetësi, pushtet lokal, drejtësi dhe ekonomi me strategji pa studime paraprake sipas standardeve të ZHQ-së, kanë sjellë paqëndrueshmëri të theksuar në të gjitha fushat e zhvillimit të vendit përkundrejt ZHQ-së.
- Reformat e pretenduara në administratën publike, ndërhyrja dhe ndikimi i politikës në to, për shkak të interesave politike, kanë dobësuar dukshëm konceptin e ndërtimit të një "Smart administration" apo "Smart city"-t apo "Smart country".
- Reformat e ndryshme të pretenduara në sistemin e edukimit në këto 10 vitet e DEZHQ-së kanë sjellë një cilësi kritike edukimi dhe paqëndrueshmëri institucionale, e për pasojë paqëndrueshmëri dhe cilësi kritike në përmbajtjen



e produktit të këtij edukimi- cilësinë e burimeve njerëzore në vend, në breza të ndryshëm.

- Universitetet nuk u panë dhe nuk u trajtuan nga politika si agjentë kryesorë të rrugëtimit të vendit dhe të prodhimit të politikave për ZHQ-në dhe EZHQ-në në vend. Diskriminimi i statusit të filozofisë në sistemin parauniversitar është një tregues i këtij fenomeni.

Projekti PISSA (2012) i Bankës Botërore, si një nga indikatorët e DEZHQ-së pranoi se për 12 vite kemi një rënie nga 57% në 52% të 15-vjeçarëve shqiptarë të cilësuar “**analfabetë funksionalë**”¹⁰⁹. Një analfabet i këtij lloji është në gjendje të lexojë mekanikisht, por jo të kuptojë çfarë ka lexuar. Ndërkohë politika pretendonte dhe “Shqipërinë dixhitale”, dhe “qytetarin dixhital”!

Ishte ky pohim që domosdoshmërisht i impononte vendimmarrjes politike pas 2013-ës *një studim të dytë, të thelluar, vendas* se ku e kishte burimin ky analfabetizëm ndërkohë që në vetvete ai është një cinizëm publik i pohuar midis Shqipërisë dixhitale që pretendohet se rritej dhe trendeve botërore për edukimin në shekullin e XXI që fokusohet në edukimin për zhvillim të qëndrueshëm të humanes përballë pozitës reale të arsimit shqiptar.

Kjo nuk u bë nga kjo qeverisje dhe nuk ka qasje të bëhet ende, megjithëse këtij shteti nuk i mungojnë agjencitë e kërkimit shkencor që duhet t’i kenë prioritet analiza të tilla si detyrim për prodhimin e cilësive të humanes shqiptare në gjithë sistemin e edukimit. Po ato burime humane që justifikuan dhe prodhuan ndryshimet kurrikulare 2012-të në kuadër të Reformës së Arsimit Parauniversitar, të miratuar pothuaj unanimisht në Parlament, po ato ofrojnë përpara politikbërjes dhe publikut kurrikulat “mide” të radhës pa shpjeguar asnjëherë se ku shkoi investimi i bërë mbi humanen profesioniste, kualifikuese pasuar kjo edhe me një faturë financiare të kripur ndërsa printohen e mbrohen “risitë reformatore” të radhës.

Statistika zyrtare¹¹⁰ mbi cilësitë e sjelljes së gjeneratës së re që konsumoi në institucionet e edukimit 10 vitet e DEZHQ-së vjen si më poshtë:

109. Grupi i Bankës Botërore. Qershor 2012. Analizë e rezultateve të PVNN-së 2000 - 2012. Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftwsive në Shqipëri.

110. Statistika është marrë nga Ministria e Drejtësisë, prill 2015.



Tabela 32

Gjendja e krimit ndër të mitur në Republikën e Shqipërisë					
Të dënuar të mitur	2010	2011	2012	2013	2014
Për krime	594	610	826	589	545
Për kundravajtje	62	73	57	91	228
Totali	656	683	883	680	773

Sikundër shihet, procesi i edukimit ka një skarcitet të dukshëm në cilësitë e sjelljes së të fëmijëve që përkthehet edhe në vepra kriminale. Në vitet (2010 - 2012) kur "reformatorët" e zhvillimit të arsimit morën vendimin për kalimin e filozofisë në grupin e lëndëve me zgjedhje në arsimin e mesëm, ne i kishim të pohuar me statistika dobësitë dhe skarcitetin e formimit qytetar nga arsimi i detyruar në vend. Në kundërshti me nevojat për instrumente politike, reformat në edukimin e qytetarit në të drejta, liri, përgjegjshmëri (standarde që i ka të domosdoshme gjenerata e re) u vijuan nga politikbërja edhe pas 2013-ës në raport me statusin e filozofisë në shkollat e mesme dhe vendin e rëndësishëm që ka edukimi filozofik për arsimin e detyrueshëm në vend. Ndërkohë UNESCO-ja shkon drejt raporteve përmbyllëse për realizimet dhe mosrealizimet ndaj objektivave të DEZHQ-së. Shqipëria, cilësia e edukimit shqiptar përkundrajt tyre, mbetet e pabashkëkohëzuar dhe me pamjen e mëposhtme ende kërcënuese:

- A. Arsimi parashkollor:** Mungesa e institucioneve të edukimit parashkollor është pengesa e parë që vjen në edukimin e fëmijëve në përgjithësi. Nëse fëmijët nuk arrijnë të kenë akses në një edukim të mirëgarantuar nuk mund të kërkojë edukimin e tyre në standardin e të mësuarit filozofik.
- Problemi tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me sistemin e edukimit parashkollor është cilësia edukative e prodhuar. Këtu nuk është fjala për programet e miratuara apo për kurrikulën zyrtare (3 programet zyrtare), por për rezultatin që kjo kurrikul po prodhon gjatë impelmentimit të vet.



Nëse i hedhim një sy kurrikulës me të cilën punojnë institucionet e edukimit publik parashkollor do vërejmë se nga 43 kopshte në qytetin e Tiranës, 26 prej tyre punojnë me kurrikulën tradicionale, pra nuk ka asnjë ndryshim në një qasje të re të politikave edukative të DEZHQ-së në këtë sistem edukimi. Madje, nga vlerësimi i kurrikulave dhe programeve të kopshteve me programin "Step by step" vërehet se ato kanë degjeneruar dhe nuk kanë ndonjë ndryshim të dukshëm në programet tradicionale, kjo si pasojë e sistemit jo efikas të kualifikimit të qëndrueshëm me filozofinë e programit dhe mosmbështetjen nga pushteti vendor për cilësi infrastrukture dhe mjetes didaktike.

Tabela 33

Gjendja e aktiviteteve në kopshte	
Programet në zbatim	Numri i kopshteve
Tradicionale	26
Step by step	5
Reggio Emilia	4

Kur flasim për program tradicional, është e qartë që si në përmbajtjen e kurrikulës ashtu dhe në mënyrën me të cilën kjo kurrikul transmetohet, prodhon fëmijë më me shumë risk që mësohen t'i binden më të mëdhenjve e që duhet të sillen "mirë" sipas konceptit të edukatores. Kjo shihet qartë edhe në cilësinë e Plan-Ditareve dhe orët e vëzhguara në kopshtet publike të Tiranës. Edhe kur ekzistojnë modele private që qasen me standarde të EZHQ-së¹¹¹ ato nuk vlerësohen si qendra burimore modeli dhe kualifikimi nga institucionet shqiptare të zhvillimit të arsimit.

B. Arsimi 9-vjeçar: Me gjithë hapat pozitive që janë ndërmarrë për një edukim qytetar, sërisht problem mbetet përfshirja e edukimit filozofik si metodikë kroskurrikulare që do të mundësonte një edukim të qëndrueshëm, në liri, me arsyetim kritik e të pavarur. Ky edukim është sa sipërfaqësor, aq edhe jashtë kontekstit të nevojave tona shoqërore.

Edukimi filozofik në sistemin 9-vjeçar, dhe pse bart dobësitë e kurrikulës së sistemit parashkollor (me shkallë kritike të frekuentimit), sërisht nuk mundëson një fill lidhës që të sigurojë një edukim të qëndrueshëm kritik e të pavarur.

111. Kopshti jopublik "Maria Montessori" Tiranë.

- Por ajo që vihet re është se, dhe në politikat e së ardhmes (zhvillimet pas 2013-ës) për EZHQ-në bazuar në edukimin filozofik në arsimin 9-vjeçar sërish nuk po gjen ndonjë ndryshim vizioni apo ndonjë rikonceptim të thelbit të këtij procesi as në tekstet e reja, as në programin kombëtar të testimit dhe kualifikimit të mësuesve.

C. Arsimi i mesëm: Vuan po nga ato problematika që vuan në përgjithësi edukimi filozofik në nivelin 9 vjeçar. Kurrikula jashtë nevojave në vend apo udhëzimeve për EZHQ nga UNESCO, e konstatuar shprehur përmes cilësisë së edukimit qytetar, teksteve të "Qytetarisë" apo "Këshillimit të karrierës", por edhe përmes trajtimit të diskriminuar të vetë Filozofisë si lëndë me zgjedhje dhe e penguar në modalitete institucionale nga vetë drejtuesit e shkollave¹¹². Këto fenomene e kanë shndërruar edukimin filozofik në një edukim formal dhe pa përmbajtje edhe aty ku ka mbetur.

- Referuar kërkesave të UNESCO-s "se edukimi filozofik arrihet ...Duke zhvilluar mjetet për të analizuar dhe kuptuar konceptet kyç të tilla si: drejtësi, dinjitet dhe liri, duke ndërtuar kapacitetet për mendim dhe gjykim të pavarur, duke shtuar aftësitë për të kuptuar dhe hetuar botën dhe sfidat e saj, dhe duke edukuar reflektimin për vlerat dhe parimet, filozofia është një "shkollë e lirisë"" gjendja reale është ende shumë larg këtij standardi.

Në përgjithësi, sistemi ynë parauniversitar shoqërohet nga këto problematika:

- Ne, edhe pas 25 vitesh demokraci, nuk kemi përcaktuar ende një *filozofi tonën të edukimit* por pranojmë për të tilla reformat e pretenduara nga politika e cila orientimin e përcakton në varësi të rrotacioneve dhe vendimarrjeve politike maxhoritare.
- *Kurrikula shkollore*, si dokument bazë i zhvimit në edukim, nuk ka patur qëndrueshmëri. Cilësia e përmbajtjes së saj ka qenë e varur nga cilësia e stafëve të paqëndrueshme në institucionin e prodhimit, institucion që riformatohen në varësi të rrotacioneve politike.
- Kemi një *sistem karriere dhe kualifikimi* për mësuesit larg të qenit me standarde zhvillimi dhe tregues të matjes në dobi cilësisë në edukimin e fëmijëve dhe lidhshpirtorin arsimor. Tregu i hapur i sigurimit (blerjes) së krediteve kualifikuese

112. Konkluzione të Tryezës së Rrumbullakët me mësues të filozofisë të shkollave të mesme të qytetit të Tiranës.



në qendra private kualifikimi në mungesë të programeve kualifikuese kombëtare afatgjata dhe sistemeve të akreditim inspektim të qendrave jashtë MAS, kanë prodhuar një sektor informal dhe okult të trajnim kualifikimit të edukatorëve në sistem pikërisht gjatë DEZHQ-së.

- *Dokumentet reformatore* në arsim, në pak prej tyre kanë qenë konsensualë në votimin e tyre në Parlament, gjë që ka sjellë një anarshi në formimet dhe kualifikimet e mësuesve po aq sa edhe cilësi kritike në nxënie, arritje të nxënësve. (Raporti i PISSA-s (2012).
- Sistemi ynë edukativ ofron *mangësi formuese në edukimin qytetar*, kjo edhe për ndryshueshmëri të panevojshme të herë pas hershme të programeve dhe teksteve. Fusha më në dobësi është ajo në drejtim të edukimit me ligjin, rregullin dhe normat. Edukimi filozofik, pas statusit të degraduar të filozofisë në 2010, ka thelluar edhe më tej këtë mangësi për APU-në.
- *Këshillimi dhe karriera* konceptohen në nivelin e arsimit të mesëm, ndërkohë që duhet të fillojnë që në sistemin 9-vjeçar me synim që t'u ofrohen profesioneve të cilat i bëjnë të rinjtë të aftë për tregun e punës si një instrument rregullator në orientimin drejt aftësimeve profesionale cilësore që do t'i shërbente ZhQ-së në vend.
- *Reformat në arsim duhet të burojnë dhe paraprihen nga të dhëna dhe analiza shumëdimensionale të tyre* dhe jo të shkojnë në të kundërt të nevojave që jeta e fëmijëve dhe të rinjve sjell në këtë tranzicion të zgjatur të vendit drejt demokracisë dhe shtetit të së drejtës. (si ajo e 2012-tës në APU apo e shumëdiskutuara në AL në 2015-të)
- *Tekstet*, cilësia e tyre dhe reformat me to, në veçanti Alterteksti 2006-2013, kanë sjellë probleme që lidhen me një kakofoni këndvështrimesh e problematikash që kanë përcjellë tek nxënësit.
- Ende *edukimi nuk është shqetësimi kryesor i komuniteteve* tona qytetare, e për pasojë ne ende nuk kemi masën kritike oponente për cilësinë e edukimit.
- Ende ne kemi një *shoqëri civile të brishtë* për oponencën dhe mbështetjen ndaj edukimit.
- Ende kemi *programe të të huajve* që këshillojnë dhe mbështesin reforma edukimi në kundërshtim me njëra tjetrën dhe mbi të gjitha në kundërshti me dokumente kryesore të politikës globale të edukimit sot.

- Ende kemi një *media të pakualifikuar* në oponencën, por edhe në mbështetjen e politikave në arsim.
- Kemi *stafe politikbërëse dhe një standard informimi* drejt organizmave ndërkombëtare si UNESCO që tregojnë një kuptim të thjeshtëzuar të EZHQ-së. Kështu për Shqipërinë në Raportin final të DEZHSë raportohet vetëm për trajnimin e 2500 mësuesve në nivelin 9-vjeçar dhe 1000 në atë mesëm për edukimin mjedisor.¹¹³

D. Arsimi universitar: Në Universitetin e Tiranës prej vitesh ekziston një departament i Filozofisë, i cili, pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar ndër vitet, mbetet i vetmi i këtij lloji në Shqipëri. Pyetje që mbeten si dilema institucionale: Kohët e karrierave vetëm referuar filozofisë sokratiane apo kantiane kanë përcaktuar, atëherë çfarë duhet t'u ofrojmë studentëve që studiojnë filozofi? Duhet ta bëjnë këtë se kanë pasion për literaturën filozofike apo sepse kanë përfitime utilitare dhe mund të ndërtojnë karrierat e tyre profesionale në jetë?

Çdo vit nga dega e filozofisë në Universitetin e Tiranës, laureohen rreth 90 studentë në sistemin Bachelor dhe rreth 100 studentë në nivelin Master në 3 organizimet e tij. Një pjesë e madhe e tyre mbeten të papunë për shkakun se mësuesia ku ata punësoheshin më parë (me heqjen e filozofisë si lëndë në shkollat e mesme) u reduktua si mundësi. Por mbi këtë fakt është ai që sistemi 3+2 për filozofi nuk njihet si mundësi për t'u përfshirë në konkurset për vendet e lira në arsim kjo pasi duhet që të kenë master për "Mësuesi". Vetë politikat e burimeve njerëzore nuk konsiderojnë rëndësinë që ka mbarimi i plotë i studimeve për filozofi dhe aftësimi pedagogjiko didaktik që dega ofron për të rinjtë.

Ndërsa universiteti prodhon këtë formim e aftësim në vijim, megjithë kërkesat e peticionet studentore dhe të pedagogëve në ministritë përkatëse qysh nga 2010, cilësia e këtij diplomimi nuk është përfshirë në Librin e Profesioneve të Rregulluara. Kjo, dhe shumë arsye vizioni, bëjnë që të mos gjejmë në lajmërimi punësimi nga Departamenti i Administratës Publike asnjë që të kërkojë këtë cilësi diplomimi. Paradoksi vazhdon ndërsa po kjo administratë vlerëson për fitime dhe ruajtje vende pune mjeshtrime nga masteri i filozofisë "Etika në institucione dhe lidhshiri".

113. Raporti Final i DEZHQ-së nga UNESCO, fq. 81.



Pyetjet që lind pas kësaj gjendje është: Ku do mundësohet jetësimi i misionit të këtyre studimeve në shoqërinë shqiptare që aspiron ZHQ-ja pa ndërtuar EZHQ-në bazuar në filozofi dhe proces të filozofuari në dhënie dijesh dhe aftësim human qytetar? Si do të tejkalojmë kuptimin e thjeshtëzuar të administratës shqiptare dhe politikbërësve se ZHQ është i lidhur vetëm me çështjet mjedisore?

Ne, shqiptarët e shekullit XXI, DUHET të jemi të ndjehemi pjesë e komuniteteve me njohuri të qëndrueshme dhe cilësore për cilësinë e zhvillimit që na nevojitet dhe që aspiron bota. Cilësia e edukimeve kombëtare në drejtimin e duhur, atë të EZHQ-së bazuar në në edukimin filozofik dhe procesin e të filozofuarit mbi të, do të na çojë në qëndrime të përbashkëta ndaj një shqetësimi të përbashkët për qëndrueshmërinë në një perspektivë afatgjatë të përfitimeve nga menaxhimi i burimeve natyrore, në ato mjedisore, mbi shqetësime ekonomik, të varfërisë dhe sociale kulturore që po kalon bota jonë.

